Grafiku 36 Shpenzimet e pushtetit vendor në rritje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)
Grafiku 37 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë lekë)
Grafiku 38 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE sh.a (në miliardë lekë)
Grafiku 39 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE sh.a (në %)
Grafiku 40 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore gjatë vitit 2019 (MIE dhe Ministritë e tjera), mln lekë
Grafiku 41 Ecuria e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore gjatë vitit 2019 (në milion lekë)
Grafiku 42 Detyrimet e prapambetura vendore, sipas kategorive (në %)
Grafiku 43 Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore (në milionë lekë)
Grafiku 44 Detyrimet e prapambetura vendore për frymë (në lekë)
Grafiku 45 Të ardhurat vendore për periudhën 2017 - 2018
Grafiku 46 Të ardhurat sipas burimit, për njësitë e qeverisjes vendore
Grafiku 47 Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit vendor

Grafiku 48 të ardhurat nga taksa mbi pasurinë
Grafiku 49 të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël
Grafiku 50 Të ardhurat nga taksat lokale

1. REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

PBB-ja nominale u rrit me 2.2% në vitin 2019, duke arritur në 1,688.9 miliardë lekë. Ritmi i rritjes ekonomike për vitin 2019 është ngadalësuar krahasuar me rritjen e vazhdueshme dhe të konsiderueshme që prej vitit 2014. Ky ngadalësim ka ardhur kryesisht si pasojë e faktorëve të paqëndrueshëm apo të përkohshëm përgjatë vitit 2019 dhe si pasojë e pasqyrimit të efekteve të tërmetit që goditi Shqipërinë në muajin nëntor të këtij viti.


Tregu i punës reflektoi zgjerimin e vazhdueshëm ekonomik, me rritje të punësimit prej 2.2% ose 26 mijë të punësuar më shumë se një vit më parë. Në fund të vitit 2019 numri i të punësuarve në Shqipëri ishte 1,210,615 persona. Në vitin 2019 konsumi final regjistroi një rritje reale prej 3.3% duke vijuar të njëjtin trend të periudhave të mëparshme. Ndërkohë, për vitin 2019 eksportet e mallrave dhe shërbimeve kanë kontribuar pozitivisht.

Tkurrja e eksporteve të mallrave është kundër peshuar nga rritja e eksporteve të shërbimeve, ku këto të fundit reflektojnë kryesisht një performancë të mirë të turizmit përgjatë periudhës së verës. Kontributin kryesor në këtë rritje e dhanë: Tregtia me shumicë dhe pakicë etj. me +0.64 pikë përqindje; Aktivitete të pasurive të paluajtshme me +0.39 pikë përqindje; Industria dhe "Administrata publike dhe mbrojtja; arsimi; shëndetësia" etj me nga +0.36 pikë përqindje secila; si dhe Bujqësia, pyjet dhe peshkimi me +0.24 pikë përqindje.

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2019 ishin 460.3 miliardë lekë, ose 10.4 miliardë lekë (2.3%) më shumë se një vit më parë. Rritja e të ardhurave të buxhetit të shtetit për vitin 2019, krahasuar me vitin paraardhës ishte rezultat i rritjes së punësimit dhe aktivitetit të biznesit privat dhe si rezultat i përmirësimit të përformancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Si peshë ndaj ekonomisë, shpenzimet e përgjithshme publike arritën në 28.6% të PBB (nga 29.2% në 2018).

Në terma nominalë, **shpenzimet e përgjithshme** publike gjatë vitit 2019 ishin 491.9 miliardë lekë, ose 15.8 miliardë lekë (3.3%) më shumë se në vitin 2018. Zërat kryesorë që ndikuan në rritjen e shpenzimeve në vitin 2019 ishin rritja e shpenzimeve për fondet speciale si rezultat i reformës së pensioneve dhe rritja e shpenzimeve për buxhetin vendor.

Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike ndaj PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Borxhi publik gjatë vitit 2019 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2019 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB). Në përputhje me objektivat makro-fiskale, niveli i borxhit publik në raport me PBB për të katërtin vit radhazi u vlerësua me rënie. Vlerësimet paraprake sinjalizojnë një rënie të borxhit publik në raport me PBB me rreth 1.7 pikë

përqindje. Në linjë me nevojat buxhetore u realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi rifinancimin e borxhit ekzistues dhe financimin e pjesshëm të deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2019.

Huamarrja u realizua nëpërmjet burimeve të brendshme dhe burimeve të huaja, përkatësisht në nivelin 73.2% dhe 118.8% të planit vjetor. Borxhi publik neto për vitin 2019 ishte 1,089.8 miliardë lekë, ose 64.5% e PBB-së, në ulje nga 64.9% e PBB-së në vitin 2018. Stoku bruto i borxhit që përfshin dhe likuiditetin për financimin e borxhit për 2019 ndaj PBB-së gjithashtu ra, duke arritur 66.2% në vitin 2019 nga 67.9% në vitin 2018. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në uljen e nivelit të borxhit në raport me PBB kanë qenë konsolidimi fiskal dhe mbiçmimi i monedhës vendase në raport me monedhat e tjera të portofolit të borxhit.

2. PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

2.1.1 Sektori real

Ritmi i rritjes ekonomike për vitin 2019 është ngadalësuar krahasuar me rritjen e vazhdueshme dhe të konsiderueshme që prej vitit 2014, që arriti pikën më kulmore prej 4.1% në vitin 2018. Ky ngadalësim ka ardhur kryesisht si pasojë e faktorëve të paqëndrueshëm apo të përkohshëm përgjatë vitit 2019 dhe si pasojë e pasqyrimit të efekteve të tërmetit që goditi Shqipërinë në muajin nëntor të këtij viti. Rritja reale e PBB u rrit me 2.21% përgjatë vitit 2019, bazuar në vlerësimet paraprake tremujore të INSTAT. Kontributin kryesor në këtë rritje e dhanë: Tregtia me shumicë dhe pakicë etj. me +0.64 pikë përqindje; Aktivitete të pasurive të paluajtshme me +0.39 pikë përqindje; Industria dhe "Administrata publike dhe mbrojtja; arsimi; shëndetësia" etj me nga +0.36 pikë përqindje secila; si dhe Bujqësia, pyjet dhe peshkimi me +0.24 pikë përqindje.

Sipas shpenzimeve, rritja ekonomike është gjeneruar kryesisht nga konsumi final si dhe nga kërkesa e brendshme. Në vitin 2019 konsumi final regjistroi një rritje reale prej 3.3% duke vijuar të njëjtin trend të periudhave të mëparshme. Ndërkohë, për 2019 eksportet e mallrave dhe shërbimeve kanë kontribuar pozitivisht. Tkurrja e eksporteve të mallrave është kundër peshuar nga rritja e eksporteve të shërbimeve, ku këto të fundit reflektojnë kryesisht një performancë të mirë të turizmit gjatë periudhës së verës.

Tregu i punës ka vijuar trendin e performancës pozitive. Në fund të vitit 2019, shkalla e papunësisë ra në 11.2% për popullsinë 15 vjeç e lart, ndërsa për grup-moshën 15-64 vjec, shkalla e papunësisë ra në nivelin 11.6% niveli më i ulët që nga tremujori i parë i vitit 2012. Ritmi vjetor i rritjes së punësimit për popullsinë 15-64 vjeç, nga tremujori i katërt i vitit 2018 në tremujorin e katërt të vitit 2019 ishte +2.2% ose me rreth 26 mijë të punësuar. Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore vazhdoi të rritet, duke arritur në 69.7% krahasuar me 68.7% që ishte në tremujorin e katërt të vitit 2018. Në fund të vitit 2019 numri i të punësuarve në Shqipëri ishte 1,210,615 persona.

2.1.2 Sektori monetar

Gjatë vitit 2019, inflacioni mesatar rezultoi 1.4%, ndërkohë inflacioni i fund-vitit rezultoi 1.1%. Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

(i)"Ushqime dhe pije jo alkoolike" me rritje vjetore të çmimit prej +2.6%, duke kontribuar me +0.95 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.1%.

(ii) "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me rritje vjetore të çmimit prej +0.2%, duke kontribuar me +0.07 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.1%.

(iii) Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm ishin:

"Shëndeti" me rënie vjetore të çmimit prej -0.4%, duke kontribuar negativisht me -0.01 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.1%.

"Veshje dhe këpucë" me rënie vjetore të çmimit prej -0.2%, duke kontribuar negativisht me -0.01 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.1%.

Në vitin 2019, *stoku total i kredive bankare* pati një rritje me 7.1% krahasuar me vitin 2018. Stoku i kredive në lekë shënoi rritje prej 11%, ndërsa ai në valutë rritje prej 3.1%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e kontributit në rritjen e stokut total të kredisë gjatë kësaj periudhe ka ardhur prej kredive akorduar bizneseve.

Stoku i kredive akorduar bizneseve jo-financiare (private dhe publike) për muajin dhjetor 2019 shënoi një rritje me 6.5%. Kredia vetëm për bizneset private jo-financiare u rrit me 5.7%, duke kontribuar pozitivisht me 3.4 pikë përqindje në ndryshimin e stokut total të kredisë. Ndërsa, stoku i kredive akorduar bizneseve publike jo-financiare për muajin dhjetor të vitit 2019 ka shënuar rritje me 19.3%, krahasuar me dhjetorin e vitit 2018, me kontribut pozitiv prej 0.7 pikë përqindje. Kushtet e favorshme të financimit kanë ndihmuar në zgjerimin e portofolit të kredisë për sektorin privat. E rregulluar për kreditë e nxjerra jashtë bilancit dhe kursin e këmbimit, ky portofol ka shënuar një rritje vjetore prej 7.5% në muajin dhjetor.

Raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 8.4% në muajin dhjetor, duke pasqyruar masat konkrete të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për reduktimin e tyre, si dhe përmirësimin e ambientit ekonomik dhe të gjendjes financiare të kredimarrësve.

Monedha shqiptare është forcuar kundrejt euros në tregun e brendshëm financiar. Kryesisht kjo është rrjedhojë e përmirësimit të fondamenteve të ekonomisë, vecanërisht pozicionit të jashtëm të saj. Përgjatë vitit 2019, kursi i këmbimit Lek/Euro arriti mesatarisht në nivelin e 123.01, ndërsa kursi ndaj dollarit Lek/Dollar arriti në 109.85.

2.1.3 Sektori i jashtëm

Eksportet e mallrave për periudhën janar-dhjetor 2019 shënuan rënie prej -3.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kontributi pozitiv në rritjen e eksporteve totale ka ardhur kryesisht nga kategoritë "Ushqime, pije, duhan", "Produkte kimike dhe plastike" dhe "Makineri dhe pjesë këmbimi" me rritje vjetore respektivisht 9.4%, 23.6% dhe 16%, dhe me kontribut përkatësisht prej 1.0 pikë përqindje, 0.5 pikë përqindje dhe 0.9 pikë përqindje në rritjen totale të eksporteve.

Importet e mallrave për vitin 2019 u rritën me 1.2% krahasuar me vitin 2018. Kategoritë që kanë ndikuar më shumë në rritjen e importeve totale janë: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me 1.4 pikë përqindje dhe "Ushqime, pije, duhan" me 0.6 pikë përqindje. Deficiti tregtar për periudhën janar-dhjetor 2019 është përkeqësuar me 5.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018. Norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë periudhë progresive është 46.0%. Shkëmbimet tregtare për vitin 2019 me vendet e BE zënë 68,1 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Dhjetor 2019 eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 63,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,4 %), Greqia (7,5 %), Kina (7,4 %) dhe Turqia (7,2 %).

Përgjatë vitit 2019, Bilanci i Pagesave shënoi rënie, duke arritur vlerën -78 milion euro, nga 372 milion euro krahasuar me vitin 2018. Gjithashtu vetëm për tremujorin e katërt të 2019, BP shënoi vlerën -73 milion euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2018 që shënoi vlerën 274 milion euro. Për vitin 2019, defiçiti i llogarisë korente u zgjerua në -1,041 milion euro krahasuar me një vit më parë që ishte –866 milion euro. Llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +896 milion euro krahasuar me +1,247 milion euro që ishte një vit më parë. Ndërkohë, investimet e huaja direkte shënuan vlerën +1,080 milionë euro ose +5.9%, krahasuar me +1,020 milion euro që ishte një vit më parë. Për vitin 2019, Remitancat shënuan rritje në vlerën +702 milionë euro, krahasuar me +670 milion euro që ishte një vit më parë, ose +4.8%.

2.2 Krahasimi me vendet e rajonit

Në vitin 2019, rritja e PBB-së në Ballkanin Perëndimor u ngadalësua në 3.5%, nga 3.9% në vitin 2018, kryesisht për shkak të një ngadalësimi të dukshëm në Shqipëri dhe Bosnjë e Hercegovinë. *Në Shqipëri*, rritja vjetore ekonomike shënoi një rënie të ndjeshme në 2.2% nga 4.1% në vitin 2018, si pasojë e tërmetit të fortë të ndodhur në nëntor, kushteve të pafavorshme për prodhimin energjisë elektrike me anë të hidrocentraleve, si dhe një rënie në investime që

reflekton pjesërisht përfundimin e disa projekteve të mëdha në fushën e ndërtimit. Megjithatë, konsumi privat i fortë vazhdoi të mbështesë rritjen.

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto

Produkti i Brendshëm Bruto *(rritja vjetore ne %, në terma reale)*	**2018**	**2019**
Maqedonia e Veriut	2.7	3.6
Mali i ZI	5.1	3.6
Serbia	4.3	4.2
Turqia	2.8	0.9
Shqipëria	**4.1**	**2.2**
Bosnja dhe Hercegovina	3.3	2.6
Kosova	3.8	4.2

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Rritja ekonomike ka sjellë rritje të mëtejshme të niveleve të punësimit në Ballkanin Perëndimor. Gjatë vitit 2019, ritmi i krijimit të vendeve të punës u përshpejtua në shumicën e vendeve të rajonit. Në përgjithësi, niveli mesatar i normës së punësimit u rrit në 2.8% në të gjithë rajonin në 2019, nga 1.2% në 2018. Fitimet nga tregu i punës kontribuan në regjistrimin e niveleve të ulëta të papunësisë në të gjitha vendet. Gjithsesi, me normat e papunësisë që variojnë nga 10.4% në Serbi dhe 25.7% në Kosovë, mbetet nevoja për të përmirësuar më tej rezultatet në tregun e punës.

Tabela 2 Norma e papunësisë

Norma e Papunësisë *(mesatare vjetore, në %)*	**2018**	**2019**
Maqedonia e Veriut	20.7	17.3
Mali i ZI	15.5	15.4
Serbia	12.7	10.4
Turqia	11.2	14.0
Shqipëria	**12.8**	**12.0**
Bosnja dhe Hercegovina	18.4	15.7
Kosova	29.6	25.7

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Dobësitë në sektorin e jashtëm mbeten një nga sfidat kryesore në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, reflektuar në deficite tregtare shumë të larta. Këto deficite të larta tregtare kompensohen vetëm pjesërisht nga tepricat në shërbime dhe llogaritë e të ardhurave sekondare, duke rezultuar në nevoja të mëdha për financime të huaja. Krahasuar me një vit më parë, deficiti i llogarisë korrente u zgjerua në Maqedoninë e Veriut, *Shqipëri* dhe Serbi, ndërsa në Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë u ngushtua. Në përgjithësi, deficiti i llogarisë korrente në rajon ishte rreth 6% e PBB-së në vitin 2019, krahasuar me 5% një vit më parë. Në një pikëpamje pozitive, deficiti i llogarisë korrente vazhdoi të financohej më së shumti nga flukset neto të IHD-ve.

Tabela 3 Bilanci tregtar

Deficiti i llogarisë korrente *(në % të PBB)*[1]	**2018**	**2019**

[1] Këto shifra i referohen një mesatare rrëshqitëse për 4 tremujorët
** Këto shifra i referohen balancës tremujore pjestuar me PBB vjetore të vlerësuar

Maqedonia e Veriut	-0.1	-2.8
Mali i ZI	-17.0	-15.2
Serbia	-4.8	-6.9
Turqia	-2.7	1.1
Shqipëria	**-6.8**	**-7.6**
Bosnja dhe Hercegovina	-3.6	-3.5
Kosova	-7.6	-5.8

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Dobësimi i dinamikës së inflacionit në Ballkanin Perëndimor gjatë muajve të parë të 2020, i shoqëruar nga lehtësimi monetar i shtuar nga bankat qendrore kryesore për shkak të pandemisë Covid-19, mundësoi vazhdimin e politikës monetare akomoduese në vendet me autonomi të politikës monetare.

Tabela 4 Norma e inflacionit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit/Inflacioni *(ndryshimi vjetor në %)*	**2018**	**2019**
Maqedonia e Veriut	1.4	0.7
Mali i ZI	2.9	0.5
Serbia	2.0	1.7
Turqia	16.3	15.2
Shqipëria	**2.0**	**1.4**
Bosnja dhe Hercegovina	1.4	0.6
Kosova	1.1	2.7

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Në vitin 2019, rritja e të ardhurave tatimore të gjeneruara nga zhvillimi i qendrueshëm ekonomik, vazhdoi të mbështesë reduktimin e deficitit fiskal në shumicën e vendeve të rajonit në Ballkanin Perëndimor. Sidoqoftë, me përjashtim të Serbisë, përmirësimi i bilanceve të buxhetit ndodhi pjesërisht për shkak të nën-ekzekutimit të shpenzimeve kapitale, gjë që reflekton dobësi të vazhdueshme në planifikimin, përzgjedhjen dhe menaxhimin e investimeve publike në të gjithë rajonin.

Tabela 5 Bilanci fiskal

Bilanca e përgjithshme e qeverisë/Deficiti fiskal *(në % të PBB)*	**2018**	**2019**
Maqedonia e Veriut***	-1.8	-2.0
Mali i ZI**	-3.9	-2.0
Serbia***	1.5	-0.2
Turqia***	-2.0	-2.9
Shqipëria**	**-1.6**	**-1.9**
Bosnja dhe Hercegovina***	2.2	:
Kosova (Burimi: FMN)	-2.8	:

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Pavarësisht rënies në disa vende, niveli i borxhit publik mbeti shumë i lartë për vitin 2019 në Mal të Zi (77.2% e PBB-së), *Shqipëri* (66.3%) dhe u rrit akoma më shumë në Serbi (52% e PBB-së).

*** Këto shifra i referohen balancës tremujore pjestuar me PBB tremujore

Tabela 6 Borxhi publik

Borxhi publik total *(në % të PBB)*	**2018**	**2019**
Maqedonia e Veriut	40.5	:
Mali i ZI	70.1	77.2
Serbia	53.7	52.0
Turqia	30.4	33.1
Shqipëria	**67.7**	**66.3**
Bosnja dhe Hercegovina	33.6	32.2
Kosova	17.1	:

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

3. POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE

3.1 Politika fiskale në vitin 2019 dhe efektet në buxhet dhe në ekonomi

Politika fiskale në vitin 2019 ka vijuar të synojë sigurimin e një sistemi taksimi të drejtë, të balancuar dhe që nxit produktivitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë. Ndryshimet në paketën fiskale 2019, synuan përgjithësisht korrektime në elementë të veçantë tatimesh dhe taksash si tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat, akcizat dhe taksat vendore. Qëllimi i paketës fiskale lidhet me thjeshtimin e procedurave dhe mbështetjen e biznesit dhe sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, në veçanti sektorin e turizmit dhe të teknologjisë së informacionit, duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë dhe rritjes ekonomike.[2]

Ndryshimet kryesore paraqiten si mëposhtë:

3.1.1 Paketa fiskale e vitit 2019

Lehtësimin e ngarkesës fiskale mbi dividendin në përputhje me programin e Këshillit të Ministrave. Reduktimi i normës së dividendit nga 15 % në 8 %, prezantohet si një masë për uljen e ngarkesës fiskale të investitorëve, duke nxitur alokimin më të shpejtë të kapitalit në ekonomi apo shtimin e konsumit.

Lehtësimin e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke zgjeruar fashën e të punësuarve që tatohen me shkallën 13%. Ulja e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, nga 130 000 lekë/muaj në 150 000 lekë/muaj, të tatohen me normën 13 %. Nëpërmjet kësaj mase synohet të ulet barra tatimore për rreth 15 400 punëmarrës.

3.1.2 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Përjashtimi nga TVSH i importit të makinerive bujqësore sipas listës së miratuar me VKM, nga çdo importues. Përjashtimi nga TVSH i importit të makinerive bujqësore bëhet me qëllim lehtësimin e sektorit të bujqësisë, për të gjitha llojet e makinerive që përfshihen në listën e miratuar me VKM.

Shkallë e reduktuar e TVSH-së në furnizimet e reklamave nga media audiovizive, furnizimin e librave të çdo lloji, si dhe furnizimin e mjeteve të transportit me kapacitet 9+1: Shërbimet e reklamave nga media audiovizve janë subjekt i një shkalle të reduktuar të TVSH-së në masën 6 për qind. Njëkohësisht, shkalla e reduktuar 6% do të aplikohet edhe mbi furnizimet e librave të do lloji, si dhe furnzimet që lidhen me mjetet e transportit publik të udhëtarëve me kapacitet 9+1. Gjithashtu ndryshim ka edhe përjashtimi nga TVSH i furnizimit me shërbim nga nënkontraktoret për kontraktorët në industrinë fason.

3.1.3 Tatimi mbi të Ardhurat

Nxitës tatimorë për sektorë specifikë:

Nxitja e fermerëve të përfshirë në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor sipas kuptimit të ligjit përkatës të fushës, duke reduktuar normën e tatimit mbi fitimin korporativ nga 15% në 5%;

Nxitja e bizneseve që janë të licencuara dhe operojnë në fushën e agroturizmit, duke reduktuar normën e tatimit mbi fitimin korporativ nga 15% në 5%;

[2] Shtojca 8.2 për një diskutim më të detajuar të efekteve të politikës fiskale.

Lehtësimi i ngarkesës fiskale për një numër të konsiderueshëm tatimpaguesish:

Shkallëzimi i normës së tatimit mbi fitimin. Për bizneset me të ardhura deri në 14 milionë lekë norma e tatimit mbi fitimin propozohet 5% e fitimit para tatimit, ndërsa për bizneset me të ardhura mbi 14 milionë lekë, norma e tatimit mbi fitimin të mbetet 15% e fitimit para tatimit;

3.1.4 Akciza

Heqja e Akcizës për fishekzjarrët, llambat, pilat dhe bateritë, sugjeruar edhe prej Fondit Monetar Ndërkombëtar. Rritja e nivelit të Akcizës për cigaret (që përmbajnë duhan) nga 5850 lekë/1000 copë në vitin 2018, në 6000 lekë/1000 copë në vitin 2019.

3.1.5 Taksat Vendore

Ndryshimet e paketës fiskale 2019, nuk sjellin ndryshime të nivelit të taksave, por kanë si qëllim:

Harmonizimi në tërësi të ligjit me ndryshimet që vetë ligji ka pësuar deri më tani, si dhe me ligjet e veçanta të miratuara, që janë ligji nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligji nr.68/2017 "Për financat vendore", si dhe ligji nr.115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"; si dhe

Lehtësimin e kuptimit dhe të interpretimit ligjor të disa dispozitave të veçanta të tij. Ndryshimet dhe shtesat në ligj synojnë që dispozitat e ligjit të bëhen të kuptueshme dhe të zbatueshme.

3.1.6 Taksat Kombëtare

Rishikim i skemës së taksimit të ambalazheve të plastikës dhe të qelqit

Për plastikën, ndryshimi synon uljen e nivelit të taksës me 2/3 dhe zgjerimin e bazës së saj me produktet e tjera të plastikës. (Produktet që përfshihen në Kodin 39 të NKM).

Për ambalazhet e qelqit, synohet uljen e nivelit të taksës, me qëllim uljen e kostove të prodhimit të produkteve.

Për prodhimin brenda vendit, synohet vendosja e taksës mbi lëndët primare të importuara dhe që përdoren për prodhimin e mallrave plastike, përfshirë ambalazhin.

Rritja e rentës për eksportin e mineralit të kromit të papërpunuar.


Parashikon rritjen e nivelit të rentës minerare për mineralin e kromit që eksportohet. Në dokumentin "Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010-2025", sasia e përgjithshme e rezervave të njohura të nxjerrshme të kromit në vitin 2010 vlerësohej në 10 milion ton. Në këtë dokument theksohet që kromi duhet të shkojë drejt përpunimit, duke ulur eksportin si mineral dhe duke rritur eksportin e kromit të përpunuar si ferrokrom. Për këtë qëllim, u ndërmorën politika që të stimulojnë përpunimin e mineralit në vend dhe rritjen e vlerës së tij për eksport. Një ndër mënyrat është rritja e rentës minerare për të dekurajuar eksportin e mineralit të kromit të papërpunuar.

Incentivimi i eksporteve duke hequr taksën e karbonit për benzinën dhe gazoilin që eksportohet.

3.2 Të Ardhurat e Përgjithshme


Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore 2019, arritën në 460.3 miliardë lekë, me një realizim në masën 97.7 për qind të planit vjetor sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 02.10.2019 (të rishikuar). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018 ky zë ka rezultuar 2.3 për qind ose 10.4 miliardë lekë më shumë. Rritja e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit për vitin 2019, krahasuar me vitin paraardhës është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të përformancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Kjo rritje vjen kryesisht nga impakti i rritjes ekonomike dhe nga përmirësimi në administrimin e taksave. Në terma nominalë, të ardhurat e përgjithshme janë rritur në mënyrë të qëndrueshme nga viti në vit. Në vitin 2018, të ardhurat publike arritën nivelin 27,4% të PBB-së, ose rreth 0.1% më shumë se mesatarja e pesë viteve të fundit. Megjithatë, ritmi i rritjes së ekonomisë ka qenë më i lartë se ai i rritjes së të ardhurave të përgjithshme.

Grafiku 2 Të Ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë) ndaj PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave gjatë vitit 2019



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)


Zërat kryesorë në të ardhurat totale të buxhetit të shtetit janë ndihmat, të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat e pushtetit vendor, të ardhurat nga fondet speciale dhe të ardhurat jotatimore; të cilat zënë përkatësisht 2 për qind, 66 për qind, 5 për qind, 21 për qind dhe 6 për qind të të ardhurave të përgjithshme publike në vitin 2019.

Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë lekë)

	2015	2016	2017	2018	2018 (në % ndaj vitit paraardhës)	2019 (plan fillestar)	2019 (plan I rishikuar)	2019 (fakt)	2019 (në % ndaj planit fillestar)	2019 (në % ndaj planit të rishikuar)	2019 (në % ndaj vitit paraardhës)
Të ardhura nga ndihmat	**11**	**15**	11	8	**73%**	15.5	15.5	8.8	**56.8%**	**56.8%**	**110.0%**
Të ardhura tatimore	**342**	**370**	399	419	**105%**	450.3	448.3	426.3	**94.7%**	**95.1%**	**101.7%**
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	126	131	140	143.5	103%	153.3	151.3	432.4	282.1%	285.8%	301.3%
Tatimi mbi Fitimin	25	29	32	34.5	108%	33.5	33.5	36.6	109.3%	109.3%	106.1%
Akcizat	39	42	45	45	100%	48.3	48.3	46.7	96.7%	96.7%	103.8%
Tatimi mbi te Ardhurat Personale	30	31	32	36.5	114%	41.9	41.9	46.1	110.0%	110.0%	126.3%
Taksa Nacionale dhe te tjera	34	36	39	38.7	99%	41.2	41.2	36.4	88.3%	88.3%	94.1%

Taksa Doganore	6	6	6	6.2	103%	7.4	7.4	6.5	87.8%	87.8%	104.8%
Të ardhura nga Pushteti Vendor	12	15	18	21.9	122%	25.7	25.7	23.1	89.9%	89.9%	105.5%
Të ardhura nga fondet speciale	72	79	87	93.2	107%	99	99	98.4	99.4%	99.4%	105.6%
Të ardhura jotatimore	**26**	**22**	21	22.4	**107%**	22.8	22.8	25.3	**111.0%**	**111.0%**	**112.9%**
TOTALI I TË ARDHURAVE	**379**	**407**	**430**	**450**	**105%**	488.6	486.6	460.4	**94.2%**	**94.6%**	**102.3%**

Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë), sipas kategorive kryesore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

3.2.1 Të ardhurat nga ndihmat

Të ardhurat nga ndihmat për periudhën Janar-Dhjetor 2019 janë 8.8 miliardë lekë nga 8.1 miliardë lekë të një viti më parë, duke pësuar rritje në masën 7.9 për qind ose 0.65 miliardë lekë dhe me realizim ndaj planit në masën 57 për qind.


3.2.2 Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore, ku përfshihen të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti lokal dhe të ardhurat nga fondet speciale, për periudhën 12-mujore arritën në vlerën 423.3 miliardë lekë, me një realizim ndaj planit vjetor në masën 94 për qind dhe me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 1.7 për qind ose 6.9 miliardë lekë.

3.2.3 Të ardhurat nga pushteti vendor


Të ardhurat nga "Pushteti vendor" u realizuan në masën 23.1 miliardë lekë, rreth 10 për qind ose 2.6 miliardë lekë më pak se të ardhurat e planifikuara për vitin 2019 dhe 1.2 miliardë lekë (5.7 për qind) më shumë krahasuar me të ardhurat gjatë vitit 2018. Rritja kryesore e të ardhurave të pushtetit vendor ka ndodhur për shkak të rritjes së taksave (dhe tarifave) vendore, të cilat përbëjnë 76% të të gjithë të ardhurave të pushtetit vendor dhe janë rritur me 1.2 miliardë lekë krahasuar me 2018-ën; ose -0.6 miliardë lekë në krahasim me planin 2019 (-3.1%). Të ardhurat nga taksa e pasurisë janë rritur 0.3 përqind në krahasim me një vit më parë; por nuk kanë arritur pritshmëritë e realizimit më të lartë në krahasim me planin e vitit 2019 (-1.7 miliardë lekë).

Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë në 2018 (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

3.2.4 Të ardhurat nga fondet speciale


Të ardhurat nga "Fondet Speciale" rezultuan 98.4 miliardë lekë, me një realizim ndaj planit fillestar në nivelin 99.3 për qind ose 0.66 miliardë lekë më pak dhe 5.3 miliardë lekë apo 5.6 për qind më shumë sesa një vit më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga "Fondet Speciale" janë: Sigurimi Shoqëror, Sigurimi Shëndetësor dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve, përkatësisht në vlerën 84.3 miliardë lekë, 13.1 miliardë lekë dhe 1 miliardë lekë. Rritja e të ardhurave nga fondet speciale ka ardhur kryesisht nga rritja e të ardhurave të fondit të sigurimit shoqëror (4.8 miliardë lekë më shumë se një vit më parë), si rezultat i reformës së pensioneve si edhe administrimit më të mirë fiskal.

Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

3.2.5 Të ardhurat jotatimore

Të ardhurat jotatimore rezultojnë në vlerën 25.3 miliardë lekë krahasuar me 22.4 miliardë të një viti më parë, me një rritje vjetore prej 12.7 për qind ose 2.9 miliardë lekë më shumë dhe me një realizim ndaj planit në masën 110.6 për qind ose 2.4 miliardë lekë më shumë. Zërat që përbëjnë të ardhurat jotatimore janë: "Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë", "të ardhurat nga institucionet buxhetore", "dividendi" i institucioneve me kapital shtetëror dhe "tarifa shërbimeve dhe të tjera", të cilat kanë mbledhur përkatësisht 0.6 miliardë lekë, 16.6 miliardë lekë, 0.26 miliardë lekë, 2.2 miliardë lekë dhe 5.6 miliard lekë.

Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jotatimore (miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

3.2.6 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat

Të ardhurat nga "Tatimet dhe Dogana"[3] janë burimi kryesor i të ardhurave të përgjithshme dhe kontribuojnë në buxhetin e shtetit me rreth 18.3 për qind të PBB-së. Krahasuar me një vit më parë, ky zë shënon një performancë pozitive në vlerën 4.8 miliardë lekë ose 1.6 për qind më shumë. Në krahasim me planin, realizimi ishte 95.5% e planit të rishikuar vjetor, duke rezultuar në 309 miliardë lekë, nga 323.6 miliardë lekë të planifikuara.


[3] nuk përfshihen të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë lekë) dhe në % të PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 11 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat sipas llojit




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Këto të ardhura, të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshijnë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar; Tatimin mbi fitimin; Tatimin mbi të ardhura personale; Akcizat; Taksat Doganore dhe Taksa të tjera kombëtare.

DPT administron gjithashtu mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Burimet nga të gjitha të ardhurat e administruara nga DPT dhe DPD për vitin 2019, janë realizuar në vlerën 403.4 miliardë lekë, 2.7 për qind ose 10.5 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe në masën 95.9 për qind të planit vjetor fillestar.[4] *Rezultati pozitiv* krahasuar me vitin e kaluar, është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të përformancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Rritja e të ardhurave krahasuar me një vit më parë vjen si nga impakti i rritjes ekonomike, ashtu edhe nga përmirësimi në administrimin e taksave.

[4] Ose 96.5% të planit vjetor të rishikuar sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 02.10.2019.

Tabela 8 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në milionë lekë)




Lloji i taksave	Fakt 12 muajor 2018	Fakt 12 muajor 2019	Plan Fillestar 2019	Diferenca 2019/2018	Ndryshimi në % 2019/2018	Diferenca Fakt/Plan 2019	Ndryshimi në % Fakt/Plan 2019	2019 (plani i rishikuar AN2)	Ndryshimi në % 2019/2018	Diferenca Fakt/Plan i rishikuar 2019
TVSH TOTAL	143,526	136,892	153,314	(6,634)	-4.6%	(16,422)	-10.7%	151,314	(14,422)	-9.5%
Tvsh në import	107,157	107,160	114,814	7,654	7.1%	(7,654)	-6.7%	113,314	(6,154)	-5.4%
Tvsh brenda vendit	36,369	29,732	38,500	(6,637)	-18.2%	(8,768)	-22.8%	38,000	(8,268)	-21.8%
Rimbursim TVSH	14,394	23,509	19,000	9,115	63.3%	4,509	23.7%	19,000	4,509	23.7%
Tatimi mbi fitimin	34,461	36,573	33,500	2,112	6.1%	3,073	9.2%	33,500	3,073	9.2%
Akciza	44,987	46,742	48,300	1,755	3.9%	(1,558)	-3.2%	48,300	(1,558)	-3.2%
Tatimi mbi të ardhurat personale	36,517	46,089	41,900	9,572	26.2%	4,189	10.0%	41,900	4,189	10.0%
Taksa Nacional dhe të tjera	38,673	36,415	41,202	(2,258)	-5.8%	(4,787)	-11.6%	41,202	(4,787)	-11.6%
Taksat nacionale	36,055	33,781	38,400	(2,274)	-6.3%	(4,619)	-12.0%	38,400	(4,619)	-12.0%
Renta Minerare	2,618	2,634	2,802	16	0.6%	(168)	-6.0%	2,802	(168)	-6.0%
Taksë Doganore	6,217	6,482	7,390	265	4.3%	(908)	-12.3%	7,390	(908)	-12.3%
TOTALI TATIME + DOGANA	304,319	309,193	325,606	4,874	1.6%	(16,413)	-5.0%	323,606	(14,413)	-4.5%
Kontributet e mbledhura (DPT)	88,829	94,248	94,571	5,419	6.1%	(323)	-0.3%	94,571	(323)	-0.3%
TOTALI TATIME + DOGANA (përfshirë kontributet)	393,148	403,441	420,177	10,293	2.6%	(16,736)	-4.0%	418,177	(14,736)	-3.5%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të ardhurat nga Administrata Doganore për vitin 2019 arritën në 163 miliardë lekë, me një realizim në masën 94.9 përqind të planit të rishikuar, ose 8.8 miliardë lekë më pak. Në krahasim me vitin 2018, performanca ka qenë pozitive me rreth 2 miliardë lekë më shumë sesa një vit më parë, me rritje 1.3 për qind. Krahasuar me vitin 2018, paraqiten me rritje Akciza (3.9 për qind) dhe Taksa Doganore (4.3 për qind), ndërsa një rritje të lehtë ka pasur gjithashtu edhe Renta Minerare (0.6 për qind). Ndërkohë, TVSH në Import është me realizim po aq sa vlera e vitit 2018. Krahasuar me planin të gjithë zërat e të ardhurave doganore paraqiten me mosrealizim. Deficiti i krijuar me planin lidhet kryesisht me impaktin negativ të kursit të këmbimit mbi të ardhurat doganore, duke sjellë vlera më të ulta të importit të taksuar, çka ka ndikuar në uljen e të ardhurave tatimore nga veprimtaria doganore.

Grafiku 12 Të ardhurat doganore, sipas natyrës (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Të ardhurat nga **Administrata tatimore** (përfshirë kontributet) rezultojnë 232.2 miliardë lekë nga 217.7 miliardë lekë të një viti më parë, me një rritje vjetore prej 6.7 për qind ose 14.5 miliardë

lekë dhe me një realizim ndaj planit të periudhës në masën 100.3 për qind ose 0.8 miliardë lekë më shumë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë rritur me 7.3 për qind mbi baza vjetore dhe 1.1 për qind ose afërsisht 1 miliardë lekë më shumë se parashikimi. Krahasuar me të dhënat e një viti më parë, pothuajse të gjitha llojet e të ardhurave tatimore kanë pasur një ecuri pozitive. Konkretisht TVSH +4 për qind, Tatimi mbi fitimin +8.9 për qind, Tatimi mbi të ardhurat personale +13.7 për qind dhe kontributet 7.3 për qind. ndërsa Taksat Nacionale kanë pësuar një rënie të lehtë në masën -0.5.


Grafiku 13 Të ardhurat tatimore, sipas natyrës së taksave (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Nga të dhënat për 12-mujorin 2019, lidhur me kontributin e sektorëve të ekonomisë në totalin e të ardhurave nga administrata tatimore rezulton se peshën kryesore e zë sektori i "Shërbimeve" dhe sektori i "Tregtisë", përkatësisht 52.7 për qind dhe 17.2 për qind.

Grafiku 14 Të ardhurat tatimore, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

3.3.1 Taksimi Indirekt

Taksimi i konsumit (indirekt) dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Të ardhurat nga T.V.SH edhe në vitin 2019 zënë peshë të rëndësishme në të ardhurat buxhetore, duke përfaqësuar 8.1 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto ose 31.1 për qind të totalit të të ardhurave tatimore. Në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar janë mbledhur për 12-mujorin 2019, 136.9 miliardë lekë, duke shënuar një rënie kundrejt vitit të kaluar në masën 4.6 për qind ose 6.6 miliardë lekë dhe realizim në raport me planin e periudhës në masën 90.5 për qind ose 14.4 miliardë lekë më pak. Të ardhurat e mbledhura nga TVSH në import u realizuan në nivelin 107.2 miliardë lekë, me një realizim në masën 94.6 për qind kundrejt planit, ndërkohë TVSH në import është e barabartë me vlerën e vitit të kaluar. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja

në doganë përbëjnë rreth 78.3 për qind të të ardhurave totale nga TVSh-ja. Performanca e të ardhurave nga TVSH në import u ndikua nga një sërë faktorësh::

-Rënie e kursit të këmbimit të monedhës europiane EUR kundrejt monedhës vendase, përkatësisht në masën 3.6 përqind kundrejt vitit paraardhës, ka dhënë efekte të ndjeshme negative në uljen e të ardhurave nga TVSH e importeve për të gjitha kategoritë e mallrave, në vlerë afro 2.15 miliard lekë.

-Ndryshimi i skemës së taksimit të projektit TAP, duke e kaluar nga furnizimin me TVSH në furnizim të përjashtuar, solli një efekt negativ me rreth 5 miliardë lekë gjatë vitit 2019

-Përjashtimi nga skema e TVSH-së e inputeve bujqësore uli TVSH-në në import me 1.5 miliardë lekë.

-Rritja e Rimbursimit me 9.1 miliardë mbi plan, ka ndikuar performancën e TVSH-së për vitin 2019


Tabela 9 Performanca e TVSH-së në import: faktorët ndikues 2019 krahasuar me 2018

Produktet	Sasia	Arsyet
Energji elektrike	1,450,281 MegaVat orë	Rritje e Importit të energjisë elektrike me 89.8%, si pasoje e rënies së prodhimit vendas të energjisë elektrike.
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	(50,313) ton	Efekti negativ në rënien e sasisë ka ardhur si pasojë e efektit që ka sjellë përfundimi i projektit TAP dhe artikujt e importuar prej tyre me bazë metalore dhe nënprodukte të tjera.
Plehëruesit	+56,000 ton	Efekti negativ në TVSH ka ardhur jo nga rritja e sasisë, por nga përjashtimi nga skema e TVSH-së e plehëruesve.

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të dhënat 12-mujore të vitit 2019, mbi shpërndarjen sektoriale të TVSh-së brenda vendit, tregojnë se "Shërbimet", "Tregtia" dhe "Prodhimi" kanë peshën kryesore në të ardhurat nga TVSH.


Grafiku 15 TVSH-ja brenda vendit, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të ardhurat e mbledhura nga TVSH brenda vendit janë 29.7 miliardë lekë, me rënie kundrejt vitit të kaluar në masën 18.2 për qind ose -6.6 miliardë lekë dhe me realizim ndaj planit të periudhës në nivelin 79.2 për qind ose 8.3 miliardë lekë më pak. Rimbursimi i TVSH-së është realizuar në vlerën 23.5 miliardë lekë, 63.3 për qind ose 9.1 miliardë lekë më shumë se 12-mujori i vitit 2018. Grafiku më poshtë paraqet rimbursimin e TVSH-së në vitet 2012-2019 në milionë lekë.

Grafiku 16 Rimbursimi i TVSH-së në vite (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Akciza

Të ardhurat nga Akciza për periudhën Janar–Dhjetor 2019 arritën në rreth 46.7 miliardë lekë; 1.8 miliardë lekë apo 3.9 për qind më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018; Të ardhurat nga kjo taksë u realizuan nën nivelin e planifikuar me rreth 3.2 për qind ose 1.6 miliardë lekë. Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata për periudhën ka qenë si vijon:

-Importi cigares rezultoi rreth 2978 ton, me një rritje prej 120 ton ose + 4.2 për qind krahasuar me 12 mujorin e vitit 2018, me efekt pozitiv +1.4 miliardë lekë.

-Rritja e sasisë së karburantit të importuar, ku për periudhën 12-mujore 2019 rezulton 3.7 për qind më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me efekt + 1 miliardë lekë.


-Ndërkohë, performancë pozitive si rezultat i rritjes në sasi kanë shënuar: importi dhe prodhimi vendas i birrës me +5 për qind, importi i pijeve alkoolike +19.8 për qind, importi i gazit të lëngët +13.3 për qind, si dhe rritje të deklarimit të prodhimit vendas të duhanit, nga 25 ton në 29 ton të deklaruara në periudhën Janar - Dhjetor 2019.

Tabela 10 Performanca e të ardhurave nga akciza: mallrat kryesorë 2019 - 2018

Mallrat e forta	Njësia e matjes	Janar- Dhjetor		Diferenca	
		2018	2019	në njësi fizike	në përqind
Cigare	Ton	2,858	2,978	120	4 për qind
Birrë (import+prodhim Vendi)	Mijë litra	85,150	89,365	4,215	5 për qind
Gaz i Lëngët	Ton	123,195	139,559	16,365	13.3 për qind
Karburant (Import+Prodhim Vendi)	Ton	501,770	520,201	18,431	3.7 për qind


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 17 Akciza në vite (miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 18 Akciza sipas natyrës së mallrave (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

-Taksat doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar–Dhjetor 2019 janë rreth 6.5 miliardë lekë; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur me 265 milionë lekë ose 4.3 përqind, si dhe realizim në masën 87.7 përqind e planit. Peshën më të madhe në taksën doganore e zënë produket si cigaret (11%), mish importi (10%), materialet e ndërtimit (10%), elektroshtëpiaket (8%). Faktori kryesor që ka ndikuar në këtë mosrealizim lidhet me rënien e kursit të këmbimit kundrejt monedhës EURO.

Taksat nacionale


Të ardhurat nga taksat nacionale për periudhën janë realizuar në vlerën 33.8 miliardë lekë, me realizim ndaj planit në masën 88 për qind ose 4.6 miliardë lekë më pak. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat nga taksat nacionale kanë pësuar rënie në masën 6.1 për qind apo 2.2 miliardë lekë. Diferenca kryesore krahasuar me një vit më parë lidhet me shfuqizimin e pjesës dërrmuese të lojrave të fatit.

Taksimi direkt

Tatimi mbi të ardhurat personale


Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale arritën në 46.1 miliardë lekë për periudhën Janar-Dhjetor 2019, me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 26.6 për qind ose 9.7 miliardë lekë dhe me realizim ndaj planit në masën 110 për qind ose 4.2 miliardë lekë më shumë. Ndikimin kryesor në rritjen kundrejt vitit të kaluar e ka sjellë tatimi mbi dividendin me 7.4 miliardë lekë më shumë, duke reflektuar efektin pozitiv të uljes së normës së tatimit mbi dividendët nga 15% në 8%. Gjithashtu, rritja e të ardhurave të të punësuarve në sektorin publik dhe privat përkatësisht me 9.8% dhe 4.3% ka ndikuar në rritjen e derdhjes së tatimit mbi të ardhurat personale me efekt pozitiv +1.33 miliardë lek krahasuar vitin fiskal 2018. Njëkohësisht, tatimi mbi të ardhurat nga interesat e depozitave është rritur me +0.17 miliardë lekë dhe tatimi mbi të ardhurat nga qeradhënia është rritur me +0.17 miliardë lekë. Sipas burimit të të ardhurave individuale që taksohen, bazuar në të dhënat për 12-mujorin 2019, situata pasqyrohet në grafikun më poshtë:

Grafiku 19 TAP në vite (në miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 20 TAP sipas zërave në vitin 2019 (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Tatim Fitimi


Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin për 12-mujorin 2019 arritën në rreth 36.6 miliardë lekë nga 34.4 miliardë lekë të mbledhura një vit më parë, me një rritje prej 6.2 për qind ose 2.1 miliardë lekë më shumë. Krahasuar me planin këto të ardhura kanë pasur një performancë pozitive me rreth 9.2 për qind ose 3.1 miliardë lekë më shumë. Reflektimi i situatës pozitive ekonomike të vitit 2018 është vënë re në deklaratat e fitimit të tatueshëm si dhe pagesat e tatimit mbi fitimin në Mars 2019. Situata pozitive në sektorin energjitik gjatë vitit 2018, ka lejuar kompanitë e këtij sektori që të paguajnë në Buxhetin e Shtetit edhe detyrimet e papaguara nga vitet e kaluara, duke rritur vlerën e Tatimit mbi Fitimin. Njëkohësisht, pagesa e një tatimi mbi fitimin reflekton gjithashtu situatën e qëndrueshme sidomos në sektorin e prodhimit (me një pagesë tatimi mbi fitimin +2.1 miliardë lekë më shumë se viti 2018), sektori i transportit me +0.3 miliardë lekë dhe sektori i tregtisë me +0.3 miliardë lekë më shumë se pagesa e tatimit mbi fitimin një vit më parë. Ulje në tatimin mbi fitimin e paguar gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin e kaluar ka shënuar sektori i shërbimeve me 0.8 miliardë lekë më pak.

Grafiku 21 Tatimi mbi fitimin në vite (në miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 22 Tatimi mbi fitimin sipas sektorëve në vitin 2019 (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Renta Minerare


Të ardhurat nga Renta Minerare në eksport janë realizuar në vlerën 2.6 miliardë lekë, po aq sa edhe renta minenrare për vitin 2018, si dhe realizim kundrejt planit vjetor në masën 94.1 për qind. Të ardhurat nga renta minerare e naftës bruto janë 2.12 miliardë lekë, 50 milionë ose 2.4% më shumë se renta e vitit 2018. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto kanë rënë si rezultat i i rënies së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare, por efekti i rritjes në sasinë e naftës bruto të eksportuar me +37 mijë ton, ka sjellë efekt pozitiv në rentë me +133 milionë lekë. Gjatë vitit 2019 kemi një rënie të rentës për njësi nga 3.55 lekë/ton në 3.42 lekë/ton. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie në masën 71.3 milionë lekë, për shkak të rënies së madhe të çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare me 19.2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, dukse sjellë një efekt negativ 111.5 milionë lekë, efekt ky që është kompensuar disi nga rritja e sasisë së eksportuar me 155 mijë ton, me efekt në vlerë prej +42.2 milionë lekë. Gjatë vitit 2019 kemi një rënie të rentës për njësi nga 0.26 lekë/ton në 0.21 lekë/ton.së eksportuar, me rreth 147 mijë ton si dhe për shkak të rënies së çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare.

Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat nga Fondet Speciale për periudhën Janar – Dhjetor 2019 arritën në 98.4 miliardë lekë, me një realizmin në masën 99.3 për qind kundrejt planit dhe 5.6 për qind ose 5.3 miliardë lekë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky grup të ardhurash përbën rreth 21.4 për qind të totalit të të ardhurave të përgjithshme për këtë periudhë. Nga totali i


fondeve speciale, rreth 97.4 miliardë lekë janë kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe 1 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve. Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur rreth 84.3 miliardë lekë, 4.8 miliard lekë ose 6.1 për qind më shumë sesa viti i kaluar dhe nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 13.1 miliardë lekë, 0.7 miliardë ose 5.6 për qind më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 12-mujore rezulton se në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve krahasuar me mesataren e një viti më parë. Numri i kontribuesve për muajin dhjetor 2019, është rritur me afërsisht 8300 kontribues ose 1.3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafiku 23 Kontrbuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas llojit të biznesit



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 24 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas sektorit (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Peshën më të madhe, për numër mesatar kontribuesish e zë biznesi i madh (tatimpaguesit e mëdhenj) dhe ndërmarrjet shtetërore buxhetore, përkatësisht 37 për qind dhe 21 për qind. Në sektorin shtetëror vihet re një rënie e këtij treguesi me 0.5 për qind në ndërmarrjet shtetërore buxhetore, dhe rritje 5.4 për qind në ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore. Edhe në sektorin privat

ky tregues ka shënuar rritje dhe konkretisht 7.7 për qind në biznesin vogël me TVSH dhe 4.6 për qind në biznesin e vogël pa TVSH. Duke e analizuar nga këndvështrimi i sektorëve të ekonomisë, peshën kryesore në kontribuuesit aktivë e zënë punonjësit në sektorin e "Shërbimit" me 52%, si dhe "Prodhimi" dhe "Tregtia" me 19% secili sektor. Krahasuar me vitin e kaluar, ky tregues ka pësuar këto ndryshime: sektori i "Shërbimit" është rritur me 2.4 për qind, sektori i "Tregtisë" është rritur me 1.1 për qind, si dhe sektori "Transportit" është rritur me 0.5 për qind.

4. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME

Shpenzimet e përgjithshme publike, për vitin 2019, arritën në rreth 491.9 miliardë lekë me një realizim në masën 94.7 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit fillestar, Aktit Normativ nr.2 datë 2.10.2019 (AN nr.2) dhe Aktit Normativ nr.11 datë 24.12.2019 (AN nr.11). Ndërkohë që, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 3.3 përqind më i lartë ose 15.75 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2019 përbëjnë rreth 28.6 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto. Shpenzimet e përgjithshme kanë ruajtuar një nivel të qëndrueshëm ndër vite kundrejt PBB-së, me një nivel mesatar prej rreth 29.9 përqind.

Grafiku 25 Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (mld lekë),ritmi i rritjes vjetore (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)


4.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike

Shpenzimet korente dhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim respektivisht:

-Shpenzimet korente 97.8 përqind të planit vjetor fillestar (97 përqind të planit sipas AN nr.11).

-Shpenzimet kapitale 82.8 përqind të planit vjetor fillestar (87.1 përqind të planit sipas AN nr.11).

Grafiku 26 Shpenzimet korente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve 2019 (mln lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet korente për vitin 2019 rezultuan në rreth 416.85 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 4.9 përqind më i lartë ose rreth 19.5 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet korente për vitin 2019 zënë 84.8 përqind të totalit të shpenzimeve ndërkohë që krahasuar me Produktin e Brendshëm Bruto zënë rreth 24 përqind. Nga grafiku i mëposhtëm vihet re trendi i qëndrueshëm ndër vite, i raportit të shpenzimeve korente kundrejt PBB, me një nivel mesatar prej 24 përqind.

Shpenzimet kapitale për vitin 2019 paraqesin një realizim në masën rreth 75 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë është 4.4 përqind më i ulët ose rreth 3.44 miliardë lekë më pak. Shpenzimet kapitale për vitin 2019 zënë 15.2 përqind të totalit të shpenzimeve ndërkohë që krahasuar me PBB zënë rreth 4.4 përqind. Edhe për shpenzimet kapitale vihet re një trend i qëndrueshëm ndër vite kundrejt PBB, me një nivel mesatar prej 5.3 përqind.

Grafiku 27 Struktura e shpenzimeve të përgjithshme dhe raporti me PBB-në ndër vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet korente në raport me planin fillestar të vitit 2019 paraqesin një realizim prej 97.8 përqind (97 përqind të planit vjetor sipas AN nr.11), duke rezultuar në rreth 416.85 miliardë lekë.


Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente janë përkatësisht:

Shpenzimet për buxhetin vendor me 109.6 përqind të planit vjetor fillestar (101.7 përqind të planit vjetor sipas AN nr. 11),

Shpenzimet e tjera sociale me 101.1 përqind të planit vjetor fillestar (98.2 përqind të planit vjetor sipas AN nr. 11),

Shpenzimet operative mirëmbajtje me 100.8 përqind të planit vjetor fillestar (98.6 përqind të planit vjetor sipas AN nr. 11).

Grafiku 28 Struktura e shpenzimeve korente (milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet e Personelit, gjatë vitit 2019, përfaqësuan 18.5 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 76.96 miliardë lekë, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin vjetor fillestar në masën 95.3 përqind (96 përqind të planit vjetor sipas AN nr.11). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë është 4.6 përqind më i lartë ose 3.38 miliardë lekë më shumë.


Grafiku 29 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet për Interesa, gjatë vitit 2019, kanë përfaqësuar 8.4 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 84.3 përqind të planit vjetor fillestar (87.6 përqind sipas AN nr.11). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 3.8 përqind më i ulët ose 1.37 miliardë LEK më pak.

Grafiku 30 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë vitit që lamë pas, kanë shënuar një realizim në masën rreth 47.2 miliardë LEK, ose 100.8 përqind të planit vjetor fillestar (98.6 përqind të planit vjetor sipas AN nr.11). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 3.8 përqind më i lartë, ose rreth 1.7 miliardë LEK më shumë.


Grafiku 31 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet për Subvencione, në fund të vitit 2019, arritën nivelin rreth 1.42 miliardë LEK, me një realizim në masën 95.3 përqind të planit vjetor fillestar (99.3 përqind të planit vjetor sipas AN nr.11). Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 shpenzimet për subvencione rezultojnë 24.5 përqind më të ulëta ose 462 milion LEK më pak.

Grafiku 32 Shpenzimet per subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet për Fondet Speciale, për vitin 2019, rezultuan në nivelin rreth 175.6 miliardë LEK, me një realizim prej 97.6 përqind kundrejt planit vjetor fillestar (97.4 përqind kundrejt planit vjetor sipas AN nr.11). Përkatësisht:

-Shpenzimet për sigurime shoqërore arritën në vlerën rreth 131.2 miliardë LEK, duke rezultuar me një realizim 100.5 përqind të planit vjetor fillestar (100.2 përqind sipas AN nr.11).

-Shpenzimet për sigurime shëndetësore arritën në vlerën rreth 42.1 miliardë LEK, duke rezultuar me një realizim 100.5 përqind të planit vjetor fillestar (dhe AN nr.11).

- Shpenzimet për kompensimin e ish-pronarëve arritën në vlerën rreth 2.27 miliardë LEK, duke rezultuar me një realizim 45.4 përqind të planit vjetor fillestar (dhe AN nr.11).

Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 5.87 miliardë LEK më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë rreth 1.96 miliard lekë më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve janë 460 milion LEK më të ulëta.

Grafiku 33 Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)


Shpenzimet për Papunësinë, për vitin 2019, janë realizuar në masën 101 përqind e planit vjetor fillestar (93.5 përqind të planit vjetor sipas AN nr.11). Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 50.4 përqind, ose 169 milion LEK më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK), për vitin 2019, u realizuan në masën 98.5 përqind të planit vjetor fillestar (95.7 përqind sipas AN nr.11). Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 2.3 përqind ose 482 milion LEK më pak në terma nominalë.

Kompensimi për ish-të Përndjekurit Politikë, për vitin 2019, u realizua në masën 119.9 përqind të planit vjetor fillestar (99.9 përqind sipas nr.11). Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 20.2 përqind ose 202 milion LEK më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve, për vitin 2019, u realizuan në masën rreth 2.36 miliardë LEK duke rezultuar 118.2 përqind e planit vjetor fillestar (126.4 përqind sipas AN nr.11).

Grafiku 34 Shpenzimet per ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet kapitale, në vijim të analizës së ecurisë së realizimit të investimeve publike, për vitin 2019 janë konstatuar me një realizim në masën rreth 75 miliardë LEK ose 82.8 përqind në raport me planin vjetor fillestar (87.1 përqind të planit vjetor sipas AN nr.11). Respektivisht:

Projektet e investimeve me financim të brendshëm kanë shënuar një realizim në masën rreth 50.6 miliardë LEK ose 89 përqind në raport me planin vjetor fillestar (93.7 përqind të planit vjetor sipas AN nr.11). Investimet nga të ardhurat e Arsimit të Lartë kanë shënuar një realizim në masën 890 milion lekë ose 80.9 përqind në raport me planin vjetor fillestar (dhe AN nr.11).

Projektet e investimeve me financim të huaj janë realizuar në masën rreth 23.46 miliardë LEK ose 72 përqind në raport me planin vjetor fillestar (75.7 përqind të planit vjetor sipas AN nr.11).

*Grafiku 35 S*hpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Fondet buxhetore të alokuara për investime kanë prekur fushat më të rëndësishme të ekonomisë: Infrastruktura, Energjia, Arsimi, Shëndetësia, Turizmi, Rendi dhe Siguria Publike etj. Realizimi i investimeve në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për financimin e

brendshëm. Kjo dëshmon për një menaxhim eficient të fondeve buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Megjithatë, diferencat në realizimin me planin fillestar lidhen kryesisht me mosrealizimin në kohë të procedurave të prokurimit, pavarësisht angazhimit nga institucionet buxhetore.

Me buxhetin e vitit 2019 janë **financuar dhe mbyllur rreth 400 kontrata investimesh me financim të brendshëm**. Konkretisht:

-Janë mbyllur 15 kontrata investimi të transportit rrugor me vlerë totale rreth 7.7 miliardë lekë.

-Janë mbyllur 89 kontrata investimi për ujësjellësa dhe kanalizime me vlerë totale 1.92 miliardë lekë.

-Janë mbyllur 50 kontrata investimi për energjinë, burimet natyrore, industrinë, transportin hekurudhor, planifkimin urban dhe mbetjet urbane me vlerë totale rreth 1.8 miliardë lekë.

-Janë mbyllur 17 kontrata investimi për arxhinaturat e lumenjve dhe mbrojtjen prej tyre, me vlerë totale 900 milionë lekë.

-Janë mbyllur 25 kontrata për rikonstruksione të ambieneteve në disa spitale dhe poliklinika, ndërtim depo barnash, furnizim dhe vendosje pajisjesh spitalore, projekt preventiva për rikonsruksione etj.

-Janë mbyllur 35 kontrata kontrata të rëndësishme për rikonstruksione/ndërtime të bazave prodhuese/ pajisje dhe hartim projekt preventativash për disa shkolla profesionale në vend, për strehimin , doganat dhe tatimet, me vlerë totale rreth 2.2 miliardë lekë.

-Janë mbyllur 60 kontrata investimi per rikonstruksione/rindërtime/shtesa/ ambjente sportive të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në shumë bashki të vendit, me vlerë totale rreth 2.8 miliardë lekë.

-Janë mbyllur 36 kontrata për policinë e shtetit për armatime, lexues optikë etj. me vlerë totale rreth 736.5 milionë lekë.

-Janë mbyllur 11 kontrata investimi për sisteme armatimi, sisteme vëzhgimi të hapësirës ajrore dhe aktivitete të tjera të Ministrisë së Mbrojtjes me vlerë totale rreth 2.4 miliardë lekë.

- Kanë përfunduar 2 projekte të rëndësishme në fushën kulturore me vlerë totale 69.6 milionë lekë: Projekti i Restaurimit të Muzeut Historik Kombëtar dhe Restaurimi i muzeut "Mësonjëtorja e parë shqipe".

-Janë mbyllur 22 kontrata për sistemin e burgjeve dhe arkivën e gjendjes gjyqësore, me vlerë totale 170.3 milionë lekë:

-Janë mbyllur 9 kontrata për programet e mjedisit, me vlerë totale 153.8 milionë lekë.

-Janë mbyllur 7 kontrata me vlerë 8 milionë lekë për blerje pajisjesh të ndryshme për Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

4.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale

Sektori me peshën më të lartë në shpenzimet buxhetore është mbrojtja sociale, me 32 përqind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2019, e dominuar nga shpenzimet për fondin e pensioneve si edhe programet në mbështetje të familjeve dhe individëve në nevojë (ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar).

Arsimi dhe shëndetësia përbëjnë përkatësisht 11 përqind dhe 10 përqind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2019. Çështjet ekonomike dhe strehimi dhe komoditetet e komunitetit (ku përfshihen infrastruktura rrugore, ujësjellës kanalizime, mbetjet urbane si dhe planifikimi urban) zënë përkatësisht 10 përqind dhe 7% të shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2019. Shpenzimet e përgjithshme publike përbëjnë 17% të buxhetit për vitin 2019, përfshirë edhe pagesat e borxhit.

Tabela 11 Shpenzimet sipas funksionit (në milionë lekë)

Kodi	Funksioni	2019 Plan	2019 Plan (në % ndaj totalit)	2019 Fakt	2019 Fakt (në % ndaj totalit)	2019 Fakt (i korrigjuar)**	2019 Fakt i korrigjuar (në % ndaj totalit)	2019 Faktii korrigjuar (në % ndaj planit)
1	Sherbimet e Pergjithshme Publike	40,496	8%	84,438	17%	35,873	9%	89%
2	Mbrojtja	13,807	3%	13,337	3%	13,327	3%	97%
3	Rendi dhe Siguria Publike	29,500	6%	30,908	6%	29,084	7%	99%
4	Ceshtjet Ekonomike	42,617	8%	50,333	10%	36,619	9%	86%
5	Mbrojtja e Mjedisit	1,071	0%	2,997	1%	1,102	0%	103%
6	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	28,332	5%	36,754	7%	24,634	6%	87%
7	Shendetesia	50,454	10%	51,182	10%	51,156	13%	101%
8	Argetimi, Kultura dhe Ceshtjet Fetare	3,590	1%	7,310	1%	4,748	1%	132%
9	Arsimi	42,155	8%	55,684	11%	43,888	11%	104%
10	Mbrojtja Sociale	155,127	30%	158,954	32%	156,719	39%	101%
	Të paklasifikuara*	112,428	22%		0%			
	TOTALI	519,577	100%	491,897	100%	397,150	100%	76%

** Ne zerin "Shpenzime te tjera te paklasifikuara" (Totali) jane perfshire: (i) pagesat per sherbimin e borxhit, (ii) kontigjenca per politika pagash dhe pensionesh, (iii) fondi rezerve, dhe (iv) shpenzimet e pushtetit vendor*
*** Vlerësim i përafërt, korrigjuar për interesat, shpenzimet e buxhetit vendor dhe rezervat*

Plani fillestar i vitit 2019 kishte parashikuar po këto nivele, pak a shumë të ngjashme, të peshave relative të shpenzimeve sipas klasifikimit funksional, kundrejt një viti më parë. Në shmangien e vërejtur kundrejt rezultatit faktik 2019, ka ndikuar shpërndarja gjatë vitit 2019 e atyre shpenzime të paklasifikuara, të lidhura respektivisht me shërbimin e borxhit, shpenzimet e pushtetit vendor dhe me fondin rezervë, sidomos tek ky i fundit ndikim patën alokimet e rezervave dhe shpërndarja e tyre pas tërmetit të datës 26.11.2019. Në çdo rast, rezultati faktik tregon nivele të kënaqshme të realizimit të planit sipas funskioneve për vitin 2019.

4.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2019

Gjatë vitit 2019, buxheti i shtetit u ndryshua me dy Akte Normative dhe më specifikisht:

Akti Normativ Nr.2 datë 02.10.2019 *"Për disa ndryshime në Ligjin nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019":*

Hartimi i këtij akti normativ u bazua në performancën makro-fiskale e buxhetore të 9mujorit 2019, si edhe në parashikimin e pritshëm të treguesve deri në fund të vitit buxhetor 2019. Ai siguroi ruajtjen e parametrave kryesore të buxhetit fillestar, përsa kohë që deficiti buxhetor mbeti i pandryshuar. Njëkohësisht, bëri të mundur arritjen e disa objektivave të rëndësishëm, të cilët konsistuan specifikisht në:

-ruajtjen të pandryshuar të nivelit të planifikuar të parametrave kryesorë makroekonomikë;
-garantimin e financimit të nevojave të pushtetit vendor;
-garantimin e financimit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit, për përballimin optimal të situatës emergjente.
-rritjen e efiçencës së përdorimit të burimeve publike përmes rialokimeve mes zërave të shpenzimeve
-rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit.

Akti Normativ Nr.11 datë 24.12.2019 *"Për disa ndryshime në Ligjin nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019,* i ndryshuar":

Bazuar në performancën makro-fiskale e buxhetore të 11-mujorit 2019, Akti Normativ i dha zgjidhje disa problematikave të hasuara gjatë implementimit të buxhetit të shtetit për vitin 2019, duke rritur efiçiencën në përdorimin e fondeve publike, duke bërë të mundur arritjen e objektivave të rëndësishëm si:

Të alokojë fondet e nevojshme buxhetore për mundësimin e akordimit të shpërblimit të fundvitit për kategorinë e pensionistëve, në përputhje me programin ekonomik të Qeverisë dhe mbështetur në dispozitat ligjore të fushës së shpërblimeve dhe përfitimeve të tjera sociale.

Të ruajë nivelin e planifikuar në buxhetin e vitit 2019, të parametrave kryesorë makroekonomikë të tillë si: nivelin e deficitit buxhetor (rrjedhimisht dhe nivelin e borxhit publik), ndërkohë që niveli i sufiçitit primar vazhdon të ruhet në terma pozitivë nominalë dhe kundrejt PBB-së.

Të realizojë disa rialokime të brendshme mes zërave të shpenzimeve, pa efekt shtesë buxhetor, me qëllim optimizimin e performancës së realizimit të shpenzimeve, si korente ashtu edhe kapitale.

Është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskal, duke ruajtuar deficitin në nivele të pandryshueshme, e duke forcuar më tej objektivin e qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

4.4 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

Buxheti i vitit 2019, ka financuar 127 programe buxhetore dhe ka synuar realizimin e 708 produkteve të 11 ministrive të linjës dhe fondeve speciale. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e 61 bashkive dhe 12 qarqeve. Në përgjithësi evidentohet një performancë relativisht e mirë e realizimit të produkteve buxhetore nga ministritë e linjës. Nga 708 produkte të parashikuara për vitin 2019, janë realizuar plotësisht 546 produkte ose 77.11 përqind; realizuar pjesërisht 104 produkte ose 14.68 përqind dhe nuk janë realizuar vëtëm 58 produkte ose 8.1 përqind nga të planifikuarat në vitin 2019.

Tabela në vijim jep në mënyrë të përmbledhur, sa mësipër cituar:

Tabela 12 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

Nr	Ministria e Linjës	Produktet (në numër)			
			Realizuar		
		Planifikuar	Plotesisht	Pjeserisht	Pa realizuar
1	**Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural**	83	54	17	12
2	**Ministria e Infrastruktures dhe Energjise**	119	98	12	9
3	**Ministria e Financave dhe Ekonomise**	72	65	7	0
4	**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise**	62	51	6	5
5	**Ministria e Kultures**	22	15	6	1
6	**Ministria e Shendetesise dhe Mbrotjes Sociale**	43	28	9	6
7	**Ministria e Drejtesise**	63	32	24	7
8	**Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme**	37	21	9	7
9	**Ministria e Brendshme**	113	96	6	11
10	**Ministria e Mbrojtjes**	34	32	2	-
11	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	60	54	6	-
	TOTALI	**708**	**546**	**104**	**58**

Tabela 13 Realizimi i buxhetit 2019 në disa institucione kryesore qendrore

Institucionet	2019 (plan fillestar)	2019 (plan i rishikuar)	2019 (fakt)	2018 (fakt)	Shpenzime korrente (fakt/plan)	Shpenzime kapitale (fakt/plan)	Total (fakt/plan 2019)	Fakti 2019/Fakti 2018
Presidenca	248,000	249,567	205,060	233,422	84%	27%	83%	88%
Kuvendi	1,323,788	1,230,873	957,362	989,814	76%	49%	72%	97%
Kryeministria	1,000,000	1,014,985	605,903	593,430	92%	32%	61%	102%
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	9,903,962	9,102,839	6,955,170	8,193,954	93%	55%	70%	85%
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	46,703,704	45,508,829	39,616,641	44,955,260	95%	84%	85%	88%
Ministria e Financave dhe Ekonomise	58,031,139	58,011,514	56,636,375	57,529,009	99%	80%	98%	98%
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	33,132,927	33,393,567	32,202,653	37,234,965	99%	87%	97%	86%
Ministria e Kultures	2,165,867	2,275,687	2,129,864	2,257,490	94%	107%	98%	94%
Ministria e Shendetesise	59,564,277	44,490,292	44,128,994	58,444,203	72%	111%	74%	76%
Ministria e Drejtesise	12,201,758	12,158,642	10,732,728	10,195,335	88%	84%	88%	105%
Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	3,180,500	3,241,375	3,044,973	2,744,015	101%	58%	96%	111%
Ministria e Brendshme	20,775,335	21,892,987	20,870,904	20,619,600	102%	83%	100%	101%
Ministria e Mbrojtjes	21,702,417	22,612,917	21,669,923	18,994,755	100%	99%	100%	114%

Sherbimi Informativ Kombetar	1,575,000	1,629,809	1,573,189	1,450,604	102%	48%	100%	108%
Akademia e Shkencave	111,000	108,243	99,850	97,077	90%	89%	90%	103%
Kontrolli Larte i Shtetit	417,900	419,100	377,009	404,462	95%	1%	90%	93%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,637,880	2,732,490	2,645,741	2,221,833	112%	89%	100%	119%
Prokuroria e Pergjithshme	1,750,000	2,352,200	2,171,758	1,594,708	134%	5%	124%	136%
Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	2,380,150	2,741,568	2,633,137	2,109,558	113%	75%	111%	125%
Gjykata Kushtetuese	162,700	115,003	102,312	102,928	62%	79%	63%	99%
Fondi i Zhvillimit Shqipetar	16,870,000	14,399,000	13,224,069	16,059,765		78%	78%	82%
Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivleresimit ne sistemin e Drejtesise	524,500	460,627	440,149	376,994	84%	66%	84%	117%
Institucione te tjera Qeveritare	5,611,168	6,045,711	5,535,273	4,340,276	97%	102%	99%	128%

4.4.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2019, performanca e treguesve buxhetorë për këto katër programe kryesore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, paraqitet si më poshtë:

Tabela 14 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në mijë lekë)

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		% e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	7,108,371	440,433	7,092,960	420,332	100	95
	Financimi i huaj	0	278,000	0	301,168	0	108
2	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	23,184,097	1,446,534	22,798,467	1,374,898	98	95
	Financimi i huaj	0	762,000	0	1,226,627	0	161
3	Shërbime të Shëndetit Publik	2,873,379	15,850	2,664,239	9,771	93	62
4	Përkujdesi Social	23,529,579	41,535	23,438,011	30,101	100	72
	Financimi i huaj	0	100,000	0	70,274	0	70

Në programin **"Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor**" janë realizuar objektivat:

Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve për persona që do të kryejnë kontrollin mjekësor bazë periodik.

Përmirësim i ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve për të gjithë popullatën e siguruar ose jo.

Plotësim i qendrave shëndetësore me infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e sistemit të informacionit.

Këto objektiva janë arritur nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

- "Mbulimi me kujdesin parësor ", janë realizuar vizita tek mjeku i familjes, gjatë kësaj periudhe, 6.733.220 pacientë me një kosto faktike rreth 2,944 milionë lekë.

-"Kryerja e Chek-Up", ku gjatë vitit 2019 kanë kryer chek-up rreth 483 mijë pacientë.

-"Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes" , me një kosto faktike prej 3,273 milionë lekë për rreth 410.000 pacientë

Në programin **"Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor"** janë realizuar objektivat:

Mbulimit të popullatës me kujdes mjekësor spitalor;

Rritja e efektshmërisë në dhënien e shërbimit spitalor nëpërmjet uljes së kohës së pritjes së pacientëve që kanë nevojë për shërbim spitalor të 10 paketave të shërbimeve në spitalet publike e private të financuara nga FSDKSH.

Rritja e sigurisë së shërbimit të rregjistrimit dhe kontrollit të barnave dhe materialeve mjekësore;

Rritja e aksesit të pacientëve për shërbimin e dializës, nëpërmjet ofrimit në qendra të reja;

Plotësimin e nevojave të spitaleve me infrastrukturë ndërtimore,

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2019, është realizuar, si më poshtë:

"Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale", ku janë shtruar 310.315 pacientë me një kosto faktike prej rreth18,374 milionë lekë.

"Pacientë të trajtuar nga paketat spitalore, të kardiollogjisë dhe Kardiokirurgjisë", ku janë trajtuar 8.323 pacientë, me një kosto faktike, prej rreth 1,224 milion lekë;

"Trajtimi i pacientëve në spitalet psikiatrike", ku janë trajtuar 2.342 pacientë, me një kosto faktike, prej rreth 677 milionë lekë.

"Pacientë të trajtuar me dializë", ku janë kryer 189.687 seanca me një kosto faktike prej rreth 2,265 milionë lekë, duke rritur aksesin e pacientëve për shërbimin e dializës nëpërmjet ofrimit në 5 qendra të reja.

Në programin **"Shërbime të Shëndetit Publik"** janë realizuar objektivat:

Sigurimit të qëndrueshmërisë së mbulesës vaksinare, për vaksinat e kalendarit të vaksinimit;

Reduktimit të numrit të shpërthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit;

Rritjes së përputhshmërisë ligjore dhe ndështkimin e parregullsive të evidentuara nëpërmjet sigurimit të kryerjes së inspektime shëndetësore;

Depistimit të grave për kancerin e gjirit.

Këto objektiva, për vitin 2019, janë realizuar nëpërmjet realizimit të produkteve, performanca e të cilave paraqitet si më poshtë:

"Inspektime të kryera nga inspektoriatet" është realizuar me një kosto faktike prej 243,55 milion lekë dhe janë kryer 24.616 inspektime.

"Fëmijë të vaksinuar nga 0-18 vjeç" është realizuar me një kosto faktike prej 365 milion lekë dhe janë vaksinuar rreth 193.135 fëmijë.

"Monitorimi i situatave epidemiollogjike", është realizuar me një kosto faktike prej 2.049 milion lekë dhe janë kryer rreth 2.350 kontrolle për të monitoruar agjentët mjedisore për ujrat, ambjentin, ushqyerjen, shëndetin në punë, duke respektuar standartet e BE-se.

"Gra të depistuara për kancerin e gjirit", ku janë depistuar 4.261 gra me një kosto faktike prej 6,427 milionë lekë.

Në programin **"Përkujdesi Social"** janë realizuar objektivat:

Rritjes së efikasitetit dhe transparencës së skemës të ndihmës ekonomike nëpërmjet administrimit të regjistrit elektronik kombëtar dhe përdorimit të sistemit të pikëzimit;

Reformimit të sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar, duke vënë në zbatim sistemin e ri të vlerësimit sipas Modelit Social dhe duke ulur përqindjen e rasteve abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar;

Ngritjes së një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore dhe ofrimi i modeleve të reja të shërbimeve sociale;

Zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për mbrojtjen sociale;

Rritjes së kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së ndihmës ekonomike dhe përmirësimi i shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2019, është realizuar, si më poshtë:

"Familje dhe individë në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike", është realizuar me një kosto faktike prej rreth 4,250 milion lekë për 62.523 familje përfituese.

"Persona me aftësi të kufizuar përfitues nga programi i aftësisë së kufizuar" është realizuar me një kosto faktike prej rreth 15,9860 milion lekë për 165.233 persona përfitues.

"Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qëndrat rezidenciale publike", është realizuar me një kosto faktike prej rreth 953 milionë lekë për 1.005 persona.

"Shperblimi i lindjes" ku kanë përfituar 37.810 bebe me një kosto faktike prej rreth 2,364 milion lekë.

Për sa i përket **investimeve publike** janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë sipas programeve buxhetore kryesore:

4 kontrata për shërbimet e kujdesit parësor ku veçojmë rikonstruksione të Qendrave Shëndetësore në qytete/njësi administrative të vendit

10 kontrata për shërbimet e kujdesit dytësor ku veçojmë:

Furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe hotelerie për ish-godinën e kirurgjisë të rikonstruktuar Spitali Elbasan,

Rikonstruksion i ish-kirurgjisë së vjetër Spitali Elbasan,

Përgatitje e dokumentacionit për leje ndërtimi për rikonstruksionin e godinës së Spitalit Kukës, Faza I,

Rikonstruksion i Poliklinikës së Spitalit Vlorë,

Projekt preventiva për rikonstruksione të godinave të QSUT,

Ndërtimi i depos qendrore të barnave në QSUT,

Rikonstruksione të disa ambienteve në SU. Shefqet Ndroqi,

Blerje pajisje mjekesore për autoambulancat e shërbimit të urgjencës

4 kontrata për përkujdesin social ku veçojmë: Ngritja e sistemit të Menaxhimit të Informacionit për programin e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar dhe Rikonstruksion Shtëpia e të Moshuarve Shkodër (Faza II)

4.4.2 Arsimi

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2019, performanca e treguesve buxhetorë për këto katër programe kryesore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 15 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në mijë lekë)

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		% e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Arsimi Bazë	21,288,877	1,720,000	20,770,006	1,659,815	98	97
2	Arsimi i Mesëm i Pergjithshëm	6,425,767	1,062,000	6,126,039	1,036,106	95	98
3	Arsimi i Universitar	8,894,977	276,500	8,352,659	203,409	94	74
	Financimi i huaj	0	100,000	0	211,705	0	212
4	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	218,100	250,000	197,861	249,764	91	100

Në programin **"Arsimi Bazë**" janë realizuar objektivat :

-Sigurimi i një arsimi cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar;

-Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotesimin e standardeve Europiane;

-Rritja e aksesit në Arsimin Parashkollor, përfshirja e 100% e fëmijëve 5 vjeçare në klasat përgatitore;

-Rritja e viteve të shkollimit;

- Rritja e autonomise se shkollave;

-Ulja e nxënësve që braktisin shkollën në Arsimin Bazë;

-Tërheqia e fëmijëve romë/egjiptian në Arsimin Bazë;

-Rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve /shkollave sipas standardeve;

-Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e Arsimin Bazë;

-Shtrirja e shërbimit të punonjësit social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara;

-Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2019, është realizuar, si më poshtë:

-Trajtimin me një kompensim shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar, ku përveç pagës, punonjësit mësimorë, që punojnë larg vendbanimit, përfitojnë

një kompensim në masën, 2.700 lekë në muaj deri në 5 km larg vendbanimin dhe 6.000 lekë në muaj mbi 5 km larg vendbanimin, duke përfituar rreth 11 400 punonjës mësimorë;

-Ofrimi i shërbimit të transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin për rreth 31 mijë nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla, për transportin për rreth 2.870 mijë fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor dhe edukatorëve të tyre, si dhe transportin për rreth 10.733 mësuesve që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë ;

-Ofrimi i teksteve shkollore falas në përdorim për të gjithë nxënësit nga klasa e parë në klasën e pestë, si dhe nxënës të 16 kategorve sociale nga klasa e gjashtë në klasën e nëntë dukë siguruar rreth 223 mijë nxënës të arsimit bazë për blerjen e teksteve shkollore, realizuar me rreth 500 milion lekë për vitin 2019.

-Ofrimi i kuotës ushqimore, bursa me fonde të buxhetit të shtetit, për të mbuluar shpenzimet për kuotë ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta, për rreth 1.400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë.

-Mbi arsimin gjithpërfshirës, do të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës më synim që 100% e femijëve të grupmoshës 6-16 vjeç të ndjekin arsimin bazë. Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me aftësi të kufizuar , ndaj vitit paraardhës. Rritja e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në rreth 940 mësues.

Në programin **"Arsimi Mesëm i Përgjithshëm"** janë realizuar objektivat:

Nxënës që rregjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë pasi përfundojnë arsimin bazë.

Zbatimi i kurrikules së re dhe trajnimi i mësuesve të klasës së 11 në gjimnaze dhe shkollat social-kulturore, si dhe zbatimi i sistemit të ri të zhvillimit profesional.

Realizimi i Maturës Shtetërore 2019, realizimi i testimit "Mësues per Shqipërinë", në formë elektronikë.

Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në arsimin e mesëm, rehabilitimi i klasave në gjimnaze në zonat urbane, shtimi i klasave të reja në zonat urbane, pajisja me mjete didaktike për Fizikë-Kimi-Biologji të shkollave të mesme, pajisja e shkollave me klasa mësimore inteligjente/ digjitale, si dhe pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave është realizuar, si më poshtë:

Në vitin shkollor 2018-2019, afro 96,1 % e nxënësve që përfunduan arsimin e detyrueshëm u regjistruan në arsimin e mesëm. Në këtë vit shkollor marrin shërbim arsimor në arsimin e mesëm 111,430 nxënës.

Në procesin e kualifikimit për vitin 2019, morën pjesë mësues të të gjitha cikleve dhe drejtues të shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm.

Plotësimi i paketës kurrikulare sipas qasjes me bazë kompetencat në arsimin e mesëm të lartë ka të bëjë me hartimin e udhëzuesve kurrikularë lëndorë. Këta udhëzues janë hartuar sipas profileve lëndore në ndihmë të mësuesve të arsimit të mesëm të lartë me shembuj konkretë dhe praktikë për zbatimin e kurikulës në klasat 10-12.

U hartuan dhe u miratuan formularët A1 dhe A1/Z dhe u shpallën në fqen e MASR-së

U riaktivizua portali U-Albania

U përcaktuan dhe u miratuan qendrat se ku do të zhvilloheshin provimet për Maturën Shtetërore 2019.

U monitorua dhe u realizua me sukses, procesi i aplikimit online, ku brenda afateve të përcaktuara, u bënë rreth 42.000 aplikime të reja.

Në programin **"Arsimi Lartë",** gjatë vitit 2019, tashmë me një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, që synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cenuar aspak mundësitë e të rinjve për t'u arsimuar, janë realizuar objektivat :

Rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet kualifikimit shkencor të stafit akademik me 5% deri 10% në vit dhe nëpërmjet rritjes së numrit të stafit akademik me kohë të plotë duke synuar uljen e raportit pedagog/student në 1/26.

Garantimi i aksesit në bazë të meritës dhe rritja e dimensionit social në arsimin e lartë duke mbështetur me bursë financiare individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë nga kategoritë sociale në nevojë në masën 16% deri 18% të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë dhe në përputhje me parimet e barazise gjinore.

Akreditimi i 47 programeve të studimit nga 905 ose 5,2 % të IAL publike të cilat janë në proces vlerësimi.

Përmirësimi i standardeve infrastrukturore duke rritur raportin sipërfaqe/student së paku me $1m^2$/student dhe vende për punë dhe kërkim në laboratore e biblioteka.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2019, është realizuar, si më poshtë:

ASCAL për vitin shkollor 2018-2019, ka akreditуar 17 programe të ciklit të parë dhe të dytë në IAL publike në Shqipëri, duke aktivizuar ekspertë të kualifikuar akademikë për vlerësimin e programeve në arsimin e lartë. Gjatë vitit 2019, janë hartuar dokumenta standarde për vlerësim.

Hartimi i akteve nënligjore, në dhe për zbatim të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

Ndërmarrja e paketës për studentët ku synimi kryesor, ka qënë i fokuasur në financimin me bursa i studentëve me notën mesatare 9 deri në 10-të, i studentëve nga kategorive sociale në nevojë, si dhe përjashtimi 100 % nga tarifa vjetore e shkollimit apo reduktimi në masën 50% nga trifa vjetore e shkollimit për studentët e ciklit të dytë për vitin akademik 2018-2019;

Në Agjencinë Kombëtare të Provimeve është ndërtuar baza elektronike e të dhënave të arsimit të lartë, që përfshin Regjistrin Kombëtar të Studentëve, ku çdo student i regjistruar në cdo shkollë të lartë, publike apo private, duke filluar që nga viti akademik 2011-2012, në të tri ciklet e studimeve universitare do të ketë numrin kombëtar të identifikimit, përvec atij që ka marrë në universitetin ku studion;

Në programin **"Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë"** janë realizuar objektivat :

Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpike dhe jo Olimpike në aktivitete, Evropiane, Boterore dhe Ballkanike, në përputhje me parimet e barazise gjinore.

Rritja e mbështetjes financiare për aktivitete kombëtare dhe ndërkombetare për Federatat Sportive, rritja e % për sportin në fondin kombëtar të zhvillimit të Sportit, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve.

Mbështetja financiare me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve sportive, në funksion të përmirësimit të kushteve, për nxitjen rritjen e numrit të ushtruesve në sport. Implementimi i marrveshjeve në kuadër të kthimit të shkollës në qendër komunitare në disa disiplina sportive;

Mbështetje financiare për 20-25 sportistë elitarë në vit, reformimi i Komisionit Kombëtar Antidoping me qëllim përshtatjes se direktivave të organizmave nderkombetar ËADA, si dhe realizimi i 30 analizave antidoping në të gjitha disiplinat sportive.

Mbështetja e programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime 20-25% çdo vit për stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar.

Të përmirësojmë cilësinë e jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre, në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimarrje.

Mbështetja financiare me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, në funksion të përmirësimit të kushteve për argëtim, përmirësimin e infrastrukturës të qendrave rinore rajonale, nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të qendrave rinore rajonale, etj.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2019, është realizuar, si më poshtë:

Është realizuar ndarja e fondit grand për federatat, në funksion dhe në zbatim të Udhëzimi të Përbashkët nr.4 date 11.-3.2014 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave "Për mënyrën e përdorimit të fondit grand/ transfertë korrente e brendshme për federatat dhe Komitetin Olimpik shqiptar"

Realizimi i trajnimeve me mësuesit e 20 shkollave në disa qytete të shqipërisë në kuadër të marrëveshjes me Federatën e Henbollit.

Trajnime me mësues të 40 shkollave për realizimin e Kampionateve të shkollave në disiplinën e shahut , në kuadër të marrëveshjes me Federatën Botërore të Shahut.

Janë mbështur dhe trajnuar në bashkëpunim me Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar 20 sportistë elitar, në kuadër të përgatitjeve dhe kualifikimit të tyre në lojrat Olimpike Tokyo 2020, ku gjate këtij viti janë dhene shpërblimet per Sportitet te cilët kanë arritur relzultate në aktivitete ndërkombëtare.

Ka përfunduar reformimi i Komisionit Kombëtar të Antidopingut. Tashmë kemi Organizatën Kombëtare Antidoping formë e re në sisitemin sportiv kombëtar , duke e kthyer në një organizatë jo fitimprurëse , sipas standarteve ndërkombëtare. Gjatë këtij viti janë realizuar mbi 30 analiza antidoping në bashkëpunim me ËADA Evrope dhe Bote ne disiplinat olimpike, ku pjesën më të madhe e ka zënë sporti i peshëngritjes.

Rritja e pjesëmarrjes se të rinjve në programin e praktikave të punës 600-800 në vit, punësimi 200 të rinjve në institucionet e administratës shtetërore.

Rritja e pjesëmarrjes se të rinjve në aktivitete me karakter social-kulturor dhe edukativ.

Rritja e pjesëmarrjes/ mbështetjes financiare të organizatave rinore në projekteve rajonale dhe të BE (RYCO, ERASMUS +, etj).

Përmirësimi i infrastrukturës të qendrave rinore rajonale, nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të tre qendrave rinore rajonale

Krijimin e infrastrukturës së nevojshme për të rinjtë, për argëtim, rekreacion, shplodhje, ushtrimin e sporteve e veçanërisht sportet masive duke synuar ngrupmoshën 15-29 vjeç, e pranishme në shkollat e mesme, universitete, në punë e jashtë saj, duke ndërtuar mjedise sportive apo parqe olimpike.

Për sa i përket **investimeve publike** janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë sipas programeve buxhetore:

Në programin e Arsimit Bazë kanë përfunduar 38 kontrata investimi me vlerë totale rreth 1.6 miliardë lekë, për rikonstruksione/rindërtime/shtesa të shkollave 9-vjeçare në shumë bashki të vendit.

Në programin e Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm janë kanë përfunduar 12 kontrata me vlerë totale rreth 594.5 milionë lekë për rikonstruksione/ shtesa/ të shkollave të mesme në bashkitë Kuçovë, Kukës, Tropojë, Prrenjas, Librazhd, Lushnje, Kolonjë, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë-Arrëz. Një investim i rëndësishmë ka qenë edhe Ndërtimi i sallës së koncerteve, pranë auditorit të Liceut Artistik "Jordan Misja", Tiranë

Në programin e Arsimit të Lartë janë mbyllur 2 kontrata me vlerë totale 123.4 milionë lekë. Konkretisht: Porta hyrese për në UBT dhe rrethim i Kampusit universitar dhe Rikonstruksion i ndërtesës së korpusit kryesor, Universiteti i Arteve.

Në programin e Sportit dhe Rinisë janë mbyllur 8 kontrata me vlerë 351.9 milionë lekë.

4.4.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Performanca e treguesve buxhetorë për shtatë programet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, paraqitet si më poshtë:

Tabela 16 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë lekë)

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		% e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	316,842	5,000	287,532	4,896	90.7	97.9
2.	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit		53,326	1,079,401	53,241	90.4	99.8

	Financimi i huaj	1,194,343	215,012		263,881		122.7
3.	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	692,706	1,934,166	683,814	1,818,823	98.7	94.0
	Financimi i huaj		901,634		767707		85.1
4.	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	1,184,796	42,240	1,122,177	12,758	94.7	30.2
	Financimi i huaj		1,707,442		174,943		10.2
5.	Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor	412,292	20,000	380,218	16,384	92.2	81.9
6.	Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore	18,500	-	13,396		72.4	-
7.	Mbeshtetje per Peshkimin	127,940	94,000	113,520	67,910	88.7	72.2
	Financimi i huaj		182,600		65,990		36.1

Në programin e **"Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.",** janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 1,309,877 (në mijë lekë), të tilla si:

-"Fermerë përfitues të skemave kombëtare" kanë qenë 4 009 fermerë dhe agrobiznese me një kosto faktike 674 078 mijë lekë.

-"Përfitues nga programi IPARD" janë 73 përfitues ndërkohë është hapur edhe thirrja e dytë. Kosto faktike e këtij produkti ishte 155 209 mujë lekë.

- "Produktet shqiptare të sektorit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, të promovuara", është realizuar përmes pjesëmarrjes në 8 panaire, me një kosto faktike 5 365 mijë lekë.

- "Mostra të degustuara të duhanit për ruajtjen e shëndetit të konsumatorit" janë degustuar 253 mostra, me kosto faktike 27 173 mijë lekë.

"Njësi të rikonstrukturuara dhe të pajisura (Agropikat)" janë rikonstrukturuar dhe pajisur 15 njësi (Agropika) me kosto faktike 47 044 mijë lekë.

"Vrojtime statistikore " janë realizuar 4, me kosto faktike 11 924 mijë lekë.

"Fara dhe Fidan të analizuar, testuara dhe certifikuara" janë kryer 4 845 177, kosto faktike 24 475 mijë lekë.

"Vreshta dhe Ullishte të rregjistruara" janë rregjistruar 6 234 njësi, me kosto faktike 9 865 mijë lekë.

"Përfitues nga projekti ASDO" kanë përfitura 337 aplikantë, me një kosto prej 139 408 mijë lekë.

"Rritja e kapaciteteve të ekstensionit publik nëpërmjet trainimeve nga IPA 2013, në Blegtori" janë trajnuar 102 specialistë në nivel kombëtar dhe janë përgatitur 2 manuale, me një kosto faktike 47 229 mijë lekë.

Në programin **"Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit",** janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 1,396,524 (në mijë lekë), ku ndër to përmendim:

-"Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmuara" janë realizuar blerja e 874 770 vaksinave dhe pagesa e vaksinimeve te kryera nga veterineret e kontraktuar nga klinikat veterinare, me një kosto faktike prej 32 696 mijë lekë.

-"Blerje matrikujsh për kafshë të gjalla" janë blerë 2 501 000 matrikuj me një kosto faktike prej 90 000 mijë lekë.

-"Analiza të kryera sipas programit për mbetje në kafshë të gjalla dhe molusqe bivale", janë realizuar 55 000 analiza me një kosto faktike prej 176 603 mijë lekë.

-"Inspektimi dhe menaxhimi i riskut në fushën e sigurisë ushqimore (AKU)" janë kryer 89 400 inspektime me një kosto faktike prej 410 034 mijë lekë.

Në programin **"Këshillimi dhe informacioni bujqësor",** janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 201,299 mijë lekë, ku përmendim:

-"Karta dhe paketa teknologjike me elementë të përmirësuar të ofruara", janë realizuar 15 karta dhe paketa po aq sa planifikuar, me kosto faktike 137 834 mijë lekë.

-"Gra të trajnuara dhe informuara nga shërbimi këshillimor publik" janë 270 gra të këshilluar nga 5 Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, me një kosto faktike prej 1 484 mijë lekë.

- “Fermerë të asistuar nga Agjensitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor për aplikimet në skemat kombëtare dhe IPARD” janë asistuar 7 500 fermerë në procesin e aplikimit, me një kosto faktike prej 18 995 mijë lekë.

-“Fermerë të kontaktuar dhe ofruar shërbime ekstensioni”, janë realizuar kontaktime dhe ofruar shërbime 63 400 nga 70 000 të planifikuar, me kosto faktike 170 958 mijë lekë.

-“Magazinë me sandëich për ruajtjen e prodhimit në QTTB Lushnjë e ndërtuar” është ndërtuar magazina prej 180m2 për ruajtjen e prodhimit në QTTBLushnje, me një kosto faktike 6 560 mijë lekë.

Në programin “**Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**”, janë parashikuar disa produkte me një kosto totale prej 2,685,975 mijë lekë, ndër to përmendim:

-“Sipërfaqe kulluese me rrjetin kryesorë kullues të pastruar”, janë realizuar 45 000 ha po aq sa planifikuar, me kosto faktike 191 440 mijë lekë.

-“Sipërfaqe ujitëse me rrjetin kryesorë ujitës të mirëmbajtur”, janë realizuar 25 000 ha po aq sa planifikuar, me kosto faktike 62 050 mijë lekë.

-“Sipërfaqe kulluese, që i mundësohet kullimi me ngritje mekanike me hidrovorë”, janë realizuar 70 000 ha po aq sa planifikuar, me kosto faktike 191 122 mijë lekë.

-“Rrjete te kanaleve te kullimit/kolektore të rehabilituara dhe të përmirësuara”, janë realizuar 9 km po aq sa planifikuar, me kosto faktike 179 687 mijë lekë.

-“Sipërfaqe ujitëse me rrjetin kryesor ujitës të përmirësuar/(rehabilitim i pjesshëm i kanaleve kryesorë ujitës)” janë realizuar 7 000 ha po aq sa planifikuar, me kosto faktike 457 933 mijë lekë.

-“Sipërfaqe ujitëse me rrjetin ujitës të rehabilituar”, janë realizuar 7 000 ha po aq sa planifikuar, me kosto faktike 790 694 mijë lekë.

-“Diga të reabilituara” kanë përfunduar punimet në digat e rezervuarit të Tapizës dhe vazhdojnë punimet në digat e tjara, financimi i të cilave shtrihet në dy vite 2019-2020, kosto faktike e dy digave të përfunduara ishte 239 305 mijë lekë.

-“Argjinatura te rehabilituara/ndërtuara”, janë realizuar 33 km po aq sa planifikuar, me kosto faktike 938 198 mijë lekë.

-“Hidrovore të rikonstruktuar pjesërisht”, realizuar 1 po aq sa planifikuar, me kosto faktike 3 560 mijë lekë.

Për sa i përket **investimeve publike** janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë sipas programeve buxhetore:

Në programin e Ujitjes dhe Kullimit kanë përfunduar 17 kontrata për objekte të mbrojtjes nga përmbytja. Ndër objektet kryesore janë: Ndërhyrjet në Argjinaturën e lumit Buna në segmentin Pentar-Luarez, Mbrojtja nga përmbytja dhe gërryerjet e lumit Vjosa në Selenicë dhe Kashisht, Sistemimi i shtratit të përroit të Zaranikes (faza e parë).

Në programin Mbështetje për Peshkimin, është mundësuar investimi i markatës së peshkut të Shëngjinit dhe projekti për dokumentin sektorial të peshkimit.

Në programin Siguria Ushqimore janë forcuar më tej kapacitetet laboratorike të ISUV dhe AKU nëpërmjet projekteve IPA 2013 e 2016.

4.4.4 Infrastruktura dhe Energjia

Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet kryesore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 17 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Transporti Rrugor	1,880,000	15,124,100	1,765,923	15,097,086	93.93%	99.82%
	Financimi i huaj		7,348,132		6,871,423		93.51%
2.	Mbështetje për Energjinë	102,930	1,697,000	37,546	1,632,347	36.48%	96.19%
	Financimi i huaj		3,160,000		1,357,668		42.96%

3.	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	478,785	4,432,000	475,959	4,140,724	99.41%	93.43%
	Financimi i huaj		5,220,000		4,074,116		78.05%
4.	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	500,000	1,531,272	500,000	1,408,001	100%	91.95%
	Financimi i huaj		700,000		74,433		10.63%

Për programin **"Transporti Rrugor**" është realizuar qëllimi i programit i cili është Forcimi dhe integrimi me rrjetin rajonal dhe TEN-T. Dyfishimin e numrit te lidhjeve nderkombetare toksore me Kosoven, Maqedonine, Greqine dhe Malin e Zi (v.2020 ndaj v.2007), qe do te dyfishonte transportin nderkombetar te udhetareve dhe te mallrave. Perfundimin e Korridoreve me te gjitha korsite dhe parametrat teknike deri ne v. 2020, duke perfshire arterie strategjike si: autostrada Adriatiko-Joniane ne kuader te procesit te Berlinit dhe Konektivitetit; Korridori 8; Korridori Durrës-Morinë. Qëllimi i këtij programi është realizuar nëpërmjet dy objektivave, specifikisht Ndërtim dhe rehabilitim sipas standarteve të projektimit, rrugë të rrjetit kombëtar dhe Sistemim asfaltim e riveshje për rrugë të rrjetit kombëtar. Realizimi i produkteve për secilen nga objektivat paraqitet si më poshtë:

Për objektivin **"Ndërtim dhe rehabilitim sipas standarteve të projektimit, rrugë të rrjetit kombëtar"**, janë realizuar fondet në masën 6,059 milionë lekë ose rreth 100 % e fondeve të planifikuara, duke kontribuar kështu në realizmin e qëllimit të progamit. Disa nga produketet kryesore të realizuara janë:

Tipi i rrugës *A2 me katër korsi,* për të cilin janë realizuar fondet e planifikuara për vitin 2019, në masën prej 347 milionë lekë. Disa nga objektet e rëndësishme të realizuara nga ky produkt janë:

Ndërtim rruga Kukës - Morinë Loti 2 (dy viadukte) dublimi"

"Ndërtim rruga Kukës - Morinë Loti 2 (dy viadukte) dublimi (shtesë punimesh);

"Plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore në viaduktet e aksit Kukës-Morinë";

"Vendosja e mbikalimeve në aksin rrugor Thumanë - Milot dhe Kukës – Morinë";

Tipi i rrugës A2' 2x2 me trotuar dhe ndriçim, për të cilin fondet e planifikuara për vitin buxhetor 2019 paraqiten të realizuar në masën prej 2,496 milionë lekë. Disa nga objektet e rëndësishme, që janë në proces paraqiten si më poshtë:

"Përfundim i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit";

"Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 1, Loti 2, Loti 3";

"Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3";

"Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh dhe Loti 2";

Rruga tip B1' me dy korsi, për të cilën janë realizuar plotësisht fondet e planifikuara, në masën prej 1,696 milionë lekë, për vitin buxhetor 2019. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet me ritme të parashikuara janë:

"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, Loti 5, Loti 6";

"Ndërtim rruga Milot - F. Krujë (dublimi i superstradës) Loti 3";

Për rrugën tip C2 me dy korsi, janë realizuar fondet e planifikuara, në masën prej 1,517 milionë lekë, për vitin buxhetor 2019. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet normalisht dhe që janë në proces janë:

"Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1"

"Ndërtim i aksit Skrapar-Përmet Loti 1+ shtesë punimesh"

"Rikonstruksioni aksit rrugor ura e Gajdarit hyrja Sarandë"

"Ndërtim mure mbajtës dhe pritës në segmentin rrugor Kuben – Vasije"

Për rrugën tip A me katër korsi (2x2) sipas Standarteve të Reja, realizimi i shpenzimeve të këtij produkti, janë në vlerën 4 milionë lekë. Në këtë grup product përfshuhen objektet si më poshtë:

"Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3";

Studim projektim mbikalimi TEG;

Studim projektim, rishikim i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të unazës së madhe Tiranë nga sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri;

Për objektivin "**Sistemim asfaltim e riveshje për rrugë të rrjetit kombëtar"**, janë realizuar fonde në masën 873 milionë lekë. Disa nga objektet më të rëndësishme, të cilët kanë kontribuar në realizimin e objektivit të programit, paraqiten si më poshtë:

"Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21+050, në rrugën Qafë Thanë Lin-Pogradec + shtesë punimesh";

"Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21+050, ne rrugen Qafe Thane Lin-Pogradec+ Shtesë punimesh";

"Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21";

"Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Elbasan- Banjë, Loti 3+ shtesë punimesh";

Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Verior, Loti 1;

Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Verior, Loti 1, vazhdimi;

Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Qendror, Loti 2;

Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3;

Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3, vazhdimi;

Punime ndërtimi për eleminimin e pikave të zeza në rrugë (bashkëfinancim IPA 2013, Siguria rrugore).

Në programin "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime" është realizuar qëllimi i programit i cili synon: "*Shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për të gjithë popullsinë me cilësi dhe sipas standarteve ndërkombëtare.*" Produktet e realizuara, me synim realizmin e qëllimit, paraqiten si më poshtë:

Realizimi i 196,599 ml, ose 94% e fondeve të planifikuara për linja të reja ujësjellësi për furnizimin me ujë.

U realizua rreth 78,241 ml ose 95% e fondeve të planifikuara për produktin "Rikonstruksion Ujësjellësi".

Realizimi i 23,426 ml, ose 91% e fondeve të planifikuara për produktin "Kanalizime të Reja".

U realizua rreth 6,348 ml ose 99% e fondeve të planifikuara për produktin "Rikonstruksion KUZ".

Lidhur me fondin prej 400 milionë lekë për subvencionimin e ujësjellës kanalizimeve për ujin e pijshëm, sqarojmë se ky fond është detajuara i plotë, me një këst gjatë vitit 2019, me qëllim kontribuimin në përmirësimin e performancës së Usjllës – Kanalizimeve SHA.

Në programin "Mbështetje për Burimet Natyrore" është realizuar qëllimi i programit lidhur me "*Mbështetjen e politikave në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore, që synojnë jo vetëm zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, por dhe rritjen e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore*". Për realizimin e këtij objektivi janë realizuar fondet rreth 269 milionë lekë. Produktet të cilët kanë kontribuar në realizimin e qëllimit të programit renditen sa më poshtë:

Janë përditësuar 705 të dhëna të lejeve minerare gjeohapsinor

Është realizuar promovimi i minerave të rinj dhe kërkimeve teknologjike e mjedisore.

Është kryer monitorimi i Fenomeneve të post shfrytezimit në minierat e mbyllura

Është realizuar 100% projekti i studimit mbi zonimin minerar dhe hartimit të planit vjetor dhe 3-vjecar minerar.

Është kryer akredimi dhe certifikimi i laboratorit kimik.

U realizua projekti mbi "Raportin vjetor të gjëndjes mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji"

Me programin "Menaxhimi i Mbetjeve urbane" është realizuar qëllimi i programit i cili është "Përmirësimi i infrastukurës për trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane". Qëllimi është arritur nëpërmjet realizimit të dy objektivave të këtij programi. Lidhur me objektivin "Trajtimi i

mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet ndërtimit të lendfilleve rajonale", për të cilin janë realizuar fondet në masën 499,9 milionë lekë apo 100% të fondeve të planifikuara për vitin 2019. Produketet e realizuara paraqiten si më poshtë:

Sipërfaqe landfilli e ndërtuar në rajonin e Korcës.

Venddepozitimi i Bushatit i ndërtuar

Studim për sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit.

Sipërfaqe landfilli e ndërtuar në Qarkun e Vlorës

Nëpëmjet objektivit "Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet ndërtimit të Inceneratorëve", janë realizuara fondet në masën 1,414 milionë lekë për vitin 2019 apo me rreth 100% të fondeve të planifikuara. Për realizimin e këtij objektivi kanë kontribuar produktet sa më poshtë:

Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier (Inceneratori i Fierit) i ndërtuar

Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan (Inceneratori i Elbasanit) i ndërtuar

Për sa i përket **investimeve publike** më poshtë jepen kontratat kryesore të mbyllura në 2019:

Tek transporti rrugor janë financuar plotësisht 15 kontrata investimi me vlerë totale rreth 7.7 miliardë lekë. Ndër më të rëndësishmet janë:

Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti 2 (dy viadukte) dublimi, me vlerë rreth 1 miliardë lekë,

Plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore në viaduktet e aksit Kukës-Morinë, me vlerë 248.7 milionë lekë,

Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (seg Kthesa e Saukut - Bregu i lumit Loti 1), me vlerë 2.3 miliardë lekë,

Rikonstruksioni aksit rrugor ura e Gajdarit hyrja Sarandë me vlerë 280.3 milionë lekë,

Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, me vlerë 1.3 miliardë lekë,

Masa inxhinierike për stabilizimin e shembjes në segmentin Lin – Pogradec, me vlerë 225.7 milionë lekë,

Stabilizim i rrëshqitjes në aksin Tunel - Elbasan dhe dalje tuneli i Krrabës me vlerë 445.4 milionë lekë,

Tek programi i ujësjellësa kanalizimeve janë financuar 89 kontrata investimi me vlerë 1.92 miliardë lekë. Ndër më të rëndësishmet janë:

Ndërtimi i sistemit të KUZ për katër qytete, Vlorë, Ksamil, Kavaje dhe Shëngjin , IPA 2009, me vlerë totale 1.8 miliardë lekë

Përfundimi i sistemit të KUZ dhe zgjerimi ITUP në Vlorë IPA 2012, me vlerë totale 1.6 miliardë lekë

Ndërtimi i Kolektorit kryesor të ujrave të zeza dhe I.T.U.P, në zonën turistike Gjiri i Lalzit, Durrës, me vlerë 355.2 milionë lekë,

Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujrave të Zeza në zonën e Përroi i Agait - Qerret, me vlerë 187.8 milionë lekë,

Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit të qytetit të Përmetit, me vlerë 102.5 milionë lekë,

Ndërtimi i linjave të shpërndarjes së qytetit Tepelenë, me vlerë 102.4 milionë lekë,

Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga Stacioni pompave Poshnje, me vlerë 68.7 milionë lekë,

Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Këlcyrë,Bashkia Këlcyre, Faza e I, me vlerë 68.6 milionë lekë,

Rikonstruksion i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në Bashkinë Rrogozhinë Loti II, me vlerë 62 milionë lekë,

Ndërtim i rrjetit shpërndarës i furnizimit me ujë të qytetit të Poliçanit, rikonstruksion i stacionit të pompimit dhe linjës së dërgimit, me vlerë 61.4 milionë lekë,

Rikonstriksion i rrjetit të ujësjellesit Memaliaj, me vlerë 57.3 milionë lekë

Rikonstruksion i ujësjellësit Sukth, me vlerë 55.3 milionë lekë,

Ndertimi i rrjetit shpërndarës i furnizimit me ujë të qytetit Rrëshen, me vlerë 53.4 milionë lekë,

Ndërtimi i linjës së jashtme të ujësjellësit rajonal Mallakastër, me vlerë 45.6 milionë lekë.

4.4.5 Turizmi dhe Mjedisi

Performanca e treguesve buxhetorë për tre programet kryesore në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit paraqitet si më poshtë:

Tabela 18 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Turzimit dhe Mjedisit

NR	Emërtimi i Programit *(në mijë lekë)*	Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
		Korrente	**Investime**	**Korrente**	**Investime**	**Korrente**	Investime
1.	Mbrojtja e Mjedisit	502,500	166,670	456,030	155,268	90.75%	93.16%
	Financimi i huaj		215,000		485 246		226%
2.	Administrimi i Pyjeve	440,390	97,970	403,715	96,603	91.67%	98.79%
	Financimi i huaj		300,000		242,235		80.75%
3.	Zhvillimi i Turizmit	427,000	353,500	348,325	234,624	81.57%	66.37%

Në programin "Mbrojtja e Mjedisit" janë realizuar objektivat e politikës së programit, të cilat specifikisht kanë të bëjnë me:

Hartimi i legjislacionit për transpozimin të acquis së mjedisit dhe acquis së ndryshimeve klimatike sipas planifikimit në PKIE (2018-2020). Fondet per këtë objektiv janë realizuar me rreth 92% të planit buxhetor për vitin 2019.

Zbatimi i legjislacionit që lidhet me :

Monitorimin e mjedisit nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për fushën e cilësisë së ajrit, zhurmave, cilësisë së ujërave, mbetjeve, biodiversitetit. Fondet janë realizuar në masën 93% të planit buxhetorë për vitin 2019.

Inspektime kontrolli për aktivitetet industriale dhe veprimtari prodhuese, lidhur me shkarkimet në ajër, menaxhimin e mbetjeve industriale dhe urbane si dhe zhurmave, realizuar nëpërmjet 4,368 produkteve ose 84% të shpenzimeve të planifikuara.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet realizimit të produkteve si më poshtë:

Teknologji të aplikuara për përdorimin e bip-energjisë në industrinë e përpunimit të vajit të ullirit, realizuar fondet e planifikuara në masën 100% për vitin 2019.

Qendra vizitorësh të zonave të mbrojtura dhe informacione të ngritura e të ristrukturuara, me fonde të realizuara për vitin 2019 rreth 42%.

Paketa turistike në dispozicion për një zhvillim të qendrueshëm të burimeve natyrore dhe turizmit, realizuar fondet e planifikuara në masën 100% për vitin 2019.

Hartë e përgatitur për burimet e mbetjeve të ngurta për prodhuesit industrialë (SËAN), realizuar me rreth 50% të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2019.

Trupa ndërkufitarë të ngritur për menaxhimin e qendrueshëm të biodiversitetit, habitateve dhe ekosistemeve në 3 zona detare dhe bregdetare Blue Land, realizuar me 100% të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2019.

Në programin "Administrimi i Pyjeve" janë hartuar dhe zbatuar politika lidhur me:

Menaxhimin e qendrueshëm të pyjeve dhe kullotave, realizuar nëpëmjet 3,142 produkteve.

Zhvillimin e një ekonomie të gjelbër, me realizuimk të shpenzimeve faktike rreth 88% ndaj shpenzimeve të planifikuara, për vitin 2019.

Automatizimi i bazës së të dhënave për rregjistrin pyjor dhe digjitalizimi i hartave, mbështetjen e kërkimit, zhvillimit teknologjik e inovacioneve në pyje, dhënia e shërbimit këshillimor dhe aftësimin e kapaciteteve të personelit pyjor dhe administrativ lokal, harmonizimi ligjor e nënligjor, bashkëpunimi institucional me struktura të tjera të interesuara për menaxhimin e qëndrueshëm e ruajtjen e biodiversitetit. Arritur nëpëmjët realizimit të 76 produkteve dhe realizimit të fondeve në masën 62% të fondeve të planifikuara për vitin 2019.

Në programin "Zhvillimi i Turizmit" është realizuar objektivi lidhur me Diversifikimin e ofertës turistike duke synuar praninë e turistëve gjatë gjithë vitit, ky objektiv është realizuar nëpërmjet produkteve si më poshtë:

Kryerjes së 1,827 monitorimeve të vijës bregdetare për evidentimin e zhvillimeve më të fundit duke nisur nga çështjet e ndërtimeve të reja, ndotjet mjedisore, përdorimin e hapësirave publike, kriteret për stacion plazhi.

Sigurimi i pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare, si dhe organizmi i aktiviteteve të tjera promovuese si udhëtime familjarizuese dhe Press Tripe, disa nga organizimet kryesore listohen mëposhtë:

-Panairi " MATKA " Filande 2019
-Panairi " FITUR " Spanje 2019
-Panairi "BIT " Milano 2019
-Panairi "IMTM " Izrael 2019
-Panairi "ITB" Berlin 2019
-Panairi "MITT" Moske 2019
-Panairi "UITT" Kiev 2019
-Panairi Nderkombetar i Tiranës 2019
-Panairi "ITB " Singapor 2019
-Panairi "ËTM " Londer 2019
-Panairi "TT" Varshave 2019
-Press-trip me delegacionin frances per Kongresin "Les entreprises du Vojage" qe do te zhvillohet ne 2020
-Press-trip me Mediat Filandeze te grupit ËORD TRAVEL MEDIA GUILD 2019
-Fam-trip me Mediat Turke , pjesmarres ne Panairin e Tiranes. 2019
-KALA FEST 2019
-Press-Tripp me gazetare frances 2019
-Press-Tripp me mediat sllovake "FIJET SLLOVAKE" 2019
-Press-Tripp me gazetare Hollandez 2019
-Fam-trip me Tour Operator Gjeman":Berger & Meer Company 2019

Për sa i përket **investimeve publike** më poshtë jepen kontratat kryesore të mbyllura në 2019:
Plani i menaxhimit dhe zhvillimit për Syrin e Kaltër, 6.9 milionë lekë
Studim i zonave të mbrojtura në Shqipëri, 32.4 milionë lekë
Studim: "Strategjia e Brandit dhe Marketingut të Turizmit Shqiptar", 41.8 milionë lekë
Studimi mbi vendepozitime të rehabilituara, 3.9 milionë lekë

4.4.6 Drejtësia

Performanca e treguesve buxhetorë për tetë programet kryesore në Ministrinë Drejtësisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 19 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Drejtësisë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	351,828	474,300	315,400	380,503	89.6	80.2
2.	Publikimet Zyrtare	40,460	38,000	37,843	38,000	93.5	100.0
3.	Mjekësia Ligjore	79,500	11,000	77,041	8,493	96.9	77.2
4.	Shërbimi për Çështjet e Birësimit	10,800	200	7,630	198	70.6	99.2
5.	Agjencia e Trajtimit të Pronave ALUIZNI	4,822,100	33,680	3,832,623	33,456	79.5	99.3
6.	Ndihma juridike	40,000	3,000	14,021	2,292	35.1	76.4
7.	Shërbimi i Përmbarimit gjyqësor	139,800	10,000	133,947	7,460	95.8	74.6
8.	Sistemi i Burgjeve	5,515,674	429,000	5,329,775	369,889	96.6	86.2
9.	Shërbimi i Provës	137,900	21,400	133,929	10,228	97.1	47.8

Në programin "**Sistemi i burgjeve**" për 12 mujorin e vitit 2019 janë realizuar produkte, me një kosto faktike 3,866,079 mijë lekë, si mëposhtë:

"Të dënuar të trajtuar me shërbim shëndetësor" rezulton të jenë trajtuar 599 të trajtuar me një kosto faktike prej 75 116 mijë lekë.

"Trajtimi i të dënuarve të mitur në ambjente të përshtatshme të vuajtjes së dënimit" janë trajtuar 28 të mitur me një kosto faktike prej 9 520 mijë lekë.

"Trajtimi i të dënuarve gra me kushte të veçanta në ambjentet e vuajtjes së dënimit" janë trajtuar 90 gra, kosto faktike ishte 24 480 mijë lekë.

"Të burgosur të integruar burra" janë 772 persona dhe "Të burgosur të integruar të mitur" janë 7 të mitur të integruar, kosto faktike ishte përkatësisht 20 834 mijë lekë dhe 1 231 mijë lekë.

Në programin "**Agjencia e Trajtimit të Pronave**" janë realizuar produkte me kosto faktike prej 5,699,664 mijë lekë, ndër produktet përmendim:

"Përfitues nga fondi fizik dhe financiar të kompesuar" kanë përfituar 245 subjekte, kosto faktike e tyre ishte 3 230 325 mijë lekë.

"Shpërndarje e fondit të ALUIZNIT" është bërë për 1 249 subjekte, kosto faktike e të cilave është 1 648 241 mijë lekë.

"Vendime përfundimtare për kompensim të njohur të përditësuar" janë realizuar 1 346 vendime, me një kosto faktike 9 897 mijë lekë.

"Trajtimi me vendim i kërkesave për kalimin në pronësi të oborreve në përdorim" janë trajtuar 214 vendime, me një kosto faktike 2 102 mijë lekë.

"Vendime të ankimuara në gjykatë" janë ankimuar 779 raste gjygjësore në gjykatë kosto faktike e të cilave ishte 1 187 mijë lekë.

"Trajtimi i kërkesave ndër vite për njohje pronësie" janë realizuar 3 000 vendime me kosto faktike 18 110 mijë lekë.

"Legalizim dhe përpunim i informacionit tekniko-ligjor për ndërtimet informale " janë realizuar 12 018 leje me kosto faktike 737 963 mijë lekë.

-Për sa i përket **investimeve publike** janë mbyllur 22 kontrata me vlerë totale 170.3 milionë lekë. Më poshtë jepen kontratat kryesore:

-Rehabilitim emergjent i arkivës së Ministrisë së Drejtësisë, 67.1 milionë lekë,

-Përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore në IEVP 7, 12.3 milionë lekë,

-Përmiresimi i infrastrukturës ndërtimore në IEVP 8, 6.8 milionë lekë,

-Rikonstruksion i dhomës së serverave në D.P.B, 12.3 milionë lekë,

-Pajisje të ndryshme për sistemin e burgjeve 230.6 milionë lekë,

-Rikonstruksion i godinës së vuajtjes së dënimit në IEVP Lezhë, godina 4 e 5, me vlerë 27 mln lekë,

-Krijimi i sistemit Upgrade për zyrën e gjendjes gjyqësore, 25.2 milionë lekë

-Krijimi i databazës për sigurinë e kushteve normale të punës dhe ruajtjen e të dhënave, informatizimi i rregjistrave themeltar të periudhës së dënimit, 5.9 milionë lekë.

4.4.7 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për vitin 2018 për Ministrinë e Mbrojtjes, paraqiten si më poshtë:

Tabela 20 Realizimi i buxhetit 2019 për Institucionet e Drejtësisë

NR	Emërtimi I Programit/Institucionit	Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit / **Komisioni I Pavarur I Kualifikimit**	196,823	4,000	194,760	2,949	98.95%	73.73%
2	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar / **Kolegji I Posaçëm I Apelimit**	136,500	4,700	124,860	3,721	91.47%	79.17%
3	Veprimtaria e komisionerit publik / **Komisionerët Publikë**	72,762	1,500	68,162	1,356	93.68%	90.38%

Në lidhje me disa nga treguesit e performancës për **Komisionin e Pavarur të Kualifikimit** për vitin 2019, përmendim:

-Numri dosjeve të shortuara është 477 subjekte.

-Numri i dosjeve të marra në shqyrtim është rreth 370 dosje.

-Numri i vendimeve të marra nga KPK është për 129 subjekte të rivlerësimit kalimtar.

Nga ana e **Komisionerëve Publikë** për vitin 2019 janë shqyrtuar 128 çështje të njoftuara nga KPK, nga 120 të planifikuara.

Nga ana e **Kolegjit të Posaçëm i Apelimit** për vitin 2019 janë shqyrtuar 63 çështje 50 të planifikuara.

Për sa i përket **investimeve publike**, me fondet e realizuara për investime (në total për 4 institucionet) prej 8 milionë lekë në vitin 2019, janë realizuar blerje të pajisjeve për zyra, pajisje kompjuterike, pajisje audio-vizuale dhe Softëare formatimi vendimesh gjyqësore.

4.4.8 Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për vitin 2019 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të gjithë programet, paraqiten si më poshtë:

Tabela 21 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

		Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
NR	**Emërtimi i Programit**	**Korrente**	**Investime**	**Korrente**	**Investime**	**Korrente**	**Investime**
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	709,747	658,623	692,604	574,403	97.58%	87.21%
	Financimi i huaj		318,919		817,091		256.21%
2	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	470,673	5,000	452,670	71	96.18%	1.42%
3	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	349,856	92,452	324,232	90,490	92.68%	97.88%
4	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,249,601	938,000	2,121,638	748,905	94.31%	79.84%
	Financimi i huaj		0		2,025		#DIV/0!
5	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,257,187	472,227	3,186,814	282,564	97.84%	59.84%
	Financimi i huaj		76,437		2,697		3.53%
6	Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	89,543	27,000	77,523	25,891	86.58%	95.89%
7	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	273,120	91,300	241,885	80,422	88.56%	88.09%
	Financimi i huaj		100,000		142,579		142.58%
8	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Cilës. dhe Pron. Industr.	309,700	29,000	235,984	14,602	76.20%	50.35%
9	Sigurimi Shoqëror	41,726,350		41,725,350		100.00%	
10	Tregu i Punës	1,637,557	53,400	1,512,710	21,857	92.38%	40.93%
11	Inspektimi në Punë	173,264	10,000	146,515	0	84.56%	0.00%
12	Arsimi i Mesëm Profesional	1,809,000	878,248	1,649,622	827,730	91.19%	94.25%
	Financimi i huaj		692,644		180,334		26.04%
13	Strehimi	307,874	317,126	215,799	310,687	70.09%	97.97%

Në programin "***Tregu i Punës***", me fondet e buxhetit për vitin 2019 është arritur që:

Në periudhën Janar - Dhjetor 2019 janë punësuar 33,391 punëkërkues të papunë duke realizuar 111.3% të objektivit vjetor prej 30,000 të planifikuar.

-Për periudhën Janar- Dhjetor 2019 janë trajtuar me pagesë papunësie 2871 individë nga 3200 të planifikuar dhe është shpenzuar një fond prej rreth 504.2 milionë lekë.

-Për periudhën Janar - Dhjetor 2019 nga zbatimi i programeve të nxitjes punësimit janë mbështetur 2589 punëkërkues të papunë nga 2000 të planifikuar për të cilët është shpenzuar fondi prej rreth 345.9 milionë lekë.

-Për periudhën Janar - Dhjetor 2019 nga zbatimi i programeve të formimit profesional kanë përfituar 8818 pjesëmarrës punëkërkues të papunë nga 10000 të planifikuar për të cilët është shpenzuar fondi prej rreth 263.4 milionë lekë.

- Në programin "***Strehimi***", fondet e programeve sociale të strehimit janë rritur me 23.7% në krahasim me 1 vit më parë duke arritur vlerën e rreth 625 milionë lekë në vitin 2019. Realizimi faktik i këtij programi është në masën 526.5 milionë lekë pra rreth 4% më shumë se një vit më

parë. Objektivi i programit të strehimit është të sigurojë strehim të përshtatshëm e të përballueshëm për individë e familje që nuk përballojnë dot kostot e tregut të banesave.

Realizimi i këtij objektivi është bërë duke shënuar arritje cilësore dhe sasiore nëpërmjet produkteve të përmbledhura si më poshtë:

Investime për përmirësimin e banesave – 857 familje

Subvencionimi i interesave të kredive – 4021 familje

Bonus qiraje – 2951 familje. Në këtë numër pëfshihen edhe 2277 familje që kanë përfituar bonus qiraje pas termetit të datës 26.11.2019.

Grant i menjëhershëm – 25 familje të kategorisë PAK përfituan 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët ndërtuar nga EKB.

Banesa me kosto të ulët (mbështetje me financime pjesore për rduktimin e kostove të ndërtimit të EKB) eshtë realizuar 100% për vitin 2019 me 80 familje përfituese.

Në programin "***Sigurimi Shoqëror***", për vitin 2019mund të rendisim disa arritje:

Koha e caktimit të pensioneve është ulur nga 24.3 ditë që ishte në vitin 2018, në 23 ditë në vitin 2019.

Pensionet janë rritur në masën 2.8%, paralelisht me indeksin e çmimeve dhe nivelin e inflacionit në vend.

Të ardhurat e drejtëpërdrejta nga kontributet e personave juridikë e fizikë dhe të ardhurat e tjera të Fondit të Sigurimeve Shoqërore, në vitin 2019 arritën 84 199 milionë lekë, me një rritje prej 6.1% ndaj vitit 2018.

Përfitimiet e pensionistëve, pra transfertat në buxhetet familjare nga fondet e sigurimeve shoqërore arritën në 128 945 milionë lekë në vitin 2019 kundrejt 123 241 milionë lekë në vitin 2018, që rezulton një rritje prej 4.6% nga viti paraardhës.

Në vitin 2019 numri i kontribuesve total arriti 781 928 persona. Kundrejt vitit 2013, i cili është përcaktuar si vit bazë i reformës së pensioneve të vitit 2014, numri i kontribuesve është rritur me 220 759 persona ose 39% më shumë.

Evidentohet një rritje e ndjeshme e numrit fizik të personave të siguruar në skemën e Qytetit. Në vitin 2019, numri i kontribuesve në subjektet juridike e fizike në qytet arriti në rreth 660 280 persona kundrejt 654 267 persona që ishte në vitin 2018, duke rezultuar me një rritje prej 6 013 kontribues se një vit më parë.

Përsa i përket **investimeve publike**, veçojmë:

Për arsimin e mesëm profesional janë financuar 9 kontrata me vlerë totale rreth 1.3 miliardë lekë, si:

Ndërtim i shkollës profesionale IT, Tiranë

Rikonstruksion i Shkollës "Ali Myftiu" Elbasan

Shkolla "Kristo Isak", Berat

Ndërtimi i Bazës prodhuese të shkollës "Arben Broci" Shkodër

Ndërtimi i Bazës prodhuese të shkollës "Petro Sota" Fier

Ndërtimi i shkollës "Beqir Çela" Durrës

Rikonstruksioni i shkollës profesionale në Kamëz

Për Strehimin janë financuar 6 kontrata me vlerë totale rreth 80 milionë lekë për projektin e "*Rikonstruksionit të godinave në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim social*" në bashkitë Patos, Kuçovë, Peqin, Tepelenë, Vlorë dhe Maliq.

Për Tregun e Punës janë financuar 5 kontrata me vlerë rreth 30 milionë lekë për rikonstruksionin e zyrave të punës në Kukës, Malësi të Madhe, Berat, dhe Tropojë dhe për rikonstruksionin e QFP në Durrës.

Për Doganat janë financuar kontratat si më poshtë:

Upgrade i pajisjeve fizike të dëmtuara të sistemit të monitorimit me kamera në degët dhe pikat doganore si dhe shtimi i tyre në 12 pika të tjera doganore me vlerë 208.6 milionë lekë,

Rikonstruksion fasade dhe ambientesh në disa pika doganore , 8 kontrata përkatësisht për pika të ndryshme doganore, me vlerë rreth 70 milionë lekë.

Për Tatimet ka përfunduar kontrata për "*Krijimin e një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRT",* me vlerë 74.3 milionë lekë.

Si MFE aparat janë financuar 4 kontrata me vlerë totale rreth 400 milionë lekë:

Sistemi i qendërzuar kompjuterik për përdoruesit e Ministrisë së Financave (Thin-CLIENT)

Blerja dhe implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Dokumentave Elektronikë

Blerje pajisje dhe mobilje për institucionet e reja të Polit të Drejtësisë
Rritja e kapaciteteve netëork për aparatin e Ministrisë së Financave

4.4.9 Mbrojtja

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për vitin 2019 për Ministrinë e Mbrojtjes, paraqiten si më poshtë:

Tabela 22 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Mbrojtjes

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,191,489	30,000	1,166,239	7,343	97.88	24.48
2	Forcat e Luftimit	5,107,918	3,175,500	4,981,866	3,031,668	97.53	95.47
3	Arsimi Ushtarak	603,266	4500	541,625	0	89.78	0.00
4	Mbështetja e Luftimit	5,365,661	125,000	5,234,516	78,792	97.56	63.03
5	Mbështetje për Shëndetësinë	912,195	70,500	901,748	66,881	98.85	94.87
6	Sigurimet Shoqerore per ushtaraket	5,143,400	0	5,143,400	0	100	
7	Emergjencat Civile	295,488	588,000	179,803	336,042	60.85	57.15

Ministria e Mbrojtjes ka synuar që nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura, të arrijë realizimin e disa prej treguesëve kryesorë të përformancës, ku renditen:

Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut

Implementimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, Karta e Atlantikut, etj; i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të 19 marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë.

Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione për Forcat e Armatosura, sistemet e mbështetjes për zjarr apo vendosja e kamerave Infra të Kuqe stacionare të integruara me sistemin SIVHD.

Projektet prioritare në aspektin e ndërveprueshmërisë me strukturat e NATO-s, si dhe në kuadër të rritjes së sigurisë kombëtare, janë:

Sistemet e Integruara të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore e Hapësirës Detare.

Kompletimi i Forcave të Armatosura me pajisje individuale të luftimit, në funksion të certifikimit të Batalionit të dytë të këmbësorisë si një komponent i gatshëm i NATO Response Force.

Shpenzimet operacionale u përdoren me efikasitet për kryerjen e misionit të Forcave të Armatosura si në rang kombëtar ashtu dhe në kuadër të misioneve paqeruajtëse, duke rritur prezencën e Forcave të Armatosura në Detin Egje, Afganistan, KFOR, etj.

Në programin **"Mbështetja e Luftimit"** janë parashikuar objektiva specifike për realizimin e tyre ku ndër më të rëndësishmit janë:

Objektivi 1: Sigurimi i logjistikes së nevojshme si dhe mbështetja në operacione humanitare dhe misione ndërkombëtare. Treguesit e performancës për këtë objektiv Nr 1:

-% e Furnizimit në kohë dhe mbështetja logjistike e FA.

-Menaxhimi në kohë dhe profesional i operacioneve të EC dhe CIMIC.

-Dokumente të procesuara dhe arkivuara sipas legjislacionit ne fuqi.

Objektivi 2: Sigurimi i inteligjencës strategjike te nevojshme dhe sipas standardeve të NATO-s për siguri dhe stabilitet. Treguesit e performancës për këtë objektiv Nr 2.

-% e arritjes së përmbushjes së objektivave të kapaciteteve në fushën e inteligjencës ushtarake dhe të NATO-s.

-% e arritjes së kapaciteteve te nevojshme operacionale.

Objektivi 3: Sigurimi dhe mbështesja e sistemeve të teknologjisë brenda standardeve të NATO-s. Treguesit e performancës për këtë objektiv Nr 3.

-Kapacitete operacionale për ASNI

-Ruajtja e nivelit operacional për Repartin nr. 6630

Janë planifikuar 21 Produkte, 13 produkteve në zërat "Shpenzime Korrente " dhe 8 Projekte Investimi në zërin "Shpenzime Kapitale".

Në programin **"Forcat e Luftimit"** janë parashikuar objektiva specifike ku më kryesorët janë:

Objektivi 1: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Tokësore;

Objektivi 2: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Detare;

Objektivi 3: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Ajrore;

Treguesit e performancës për këto objektiva:

-Përgatitjsa e trupave për misione paqëruajtëse.

-Aftësia dislokuese e trupave përpërmbushjen e misionit në kohë rekord.

-Ndërveprueshmëria e trupave për përmbushjen e misioneve në det.

-Kontrolli i hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë program janë planifikuar 18 Produkte, 6 produkteve në zërat "Shpenzime Korrente " dhe 12 Projekte Investimi në zërin "Shpenzime Kapitale".

Sa i përket programit **"Emergjencat Civile"**, gjatë vitit 2019, Forcat e Armatosura morën pjesë aktive ne përballimin e emergjencave civile dhe në ndihmë të komunitetit si me personel të gatshëm ashtu dhe me ndihma të menjëhershme për popullatën në vështirësi. Shpenzimet e parashikuara për Emergjencat Civile nuk u realizuan në masën 100% për arsye të alokimit të buxhetit në fund të vitit për shkak të emergjencës ardhur nga tërmeti i datës 26.11.2019. Nga rezervat e shtetit të përdorura në mbështetje të familjeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, u është ardhur në ndihmë të rreth 4000 familjeve të dëmtuara.

Për sa i përket **investimeve publike** janë mbyllur 11 kontrata me vlerë totale rreth 2.4 miliardë lekë. Më poshtë jepen kontratat kryesore:

-Pajisje e anijeve të klasit ILIRIA me sistem armatimi

-Rikonstruksion i depove të kazermimit

-Ndërtim rrethimi i repartit 1040, 4050

-Përmirësimi i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD)-blerje softi dhe pajisjeve të sistemit të menaxhimit të trafikut detar.

-Ndërtimi i sistemit të telefonisë VOIP & VTC në Forcat e Armatosura

-Rikonstruksioni i Pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit për Këmbën Diabetike, SUT

4.4.10 Kultura

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Kulturës paraqitet si mëposhtë:

Tabela 23 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Kulturës

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi Administrimi	160 930		147 271		91.5	
2.	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	534 757	35 000	488 751	34 177	91.3	97.6
	Financimi i huaj		30 000		-		-
3.	Arti dhe Kultura	795 000	720 000	741 014	717 488	93.2	99.6

Në programin **"Trashëgimia Kulturore**" është realizuar promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimisë dhe aktiviteteve

në funksion të saj. Këto objektiva gjatë vitit 2019 janë arritur nëpërmjet realizimit të produkteve si më poshtë:

"Objekte të restauruara", të realizuara me fondet e investimeve me një kosto faktike prej 34.2 milion lekë, ku u realizua restaurimi i Muzeut "Mësonjëtorja e parë Shqipe, me një shpenzim faktik për 29.6 milion lekë, si edhe u realizua hartimi i projektit për Restaurimin dhe Riformulimin e linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar –Tiranë, me nje shpenzim faktik prej 4.9 milion lekë.

"Objekte monument kulture të ruajtura dhe mbrojtura", me një kosto faktike prej 282 milion lekë, janë kryer punime rutinë mirëmbajtje dhe pastrime në rreth 109 objekte monument kulture dhe pastrim vegjetacioni në 83 objekte.

Kështu në Durrës jane kryer pastrim nga vegjetacioni dhe mirëmbajtje **në rreth 22 objekte** si dhe restaurime dhe mirëmbajtje **në 8 objekte:** është realizuar Mbulesa e Mozaikut të Tiranës si dhe rrethimi me zinxhirë dhe rrethimi anësor me tenda të tejdukshme, punime mirëmbajtjeje dhe pajantimi i disa mureve, që ndodhen pranë zonave ku kanë filluar gërmime arkeologjike tek Amfiteatri, Durrës. Pastrime nga vegjetacioni dhe mirëmbajtje periodike kryesisht në objektet e vizitueshëm të qytetit të Durrësit, Tiranës, Elbasanit, Muzeun Arkeologjik, Amfiteatër, Kalaja e Krujës, etj

Në Berat janë kryer ndërhyrje restauruese, mirëmbajtje pastrime në **36 objekte si:** restaurimi i Urës së Kasabashit ,në Qendrën Historike Berat, lagjja "Kala".

Në Gjirokastër janë kryer restaurime të pjesshme dhe mirëmbajtje në **40 objekte** si dhe pastrime sistemime në **11 objekte.** Është kryer restaurim total i shtëpisë së Andon Zako Çajupit në Sheper të Zagorisë .

Në Vlore në 28 objekte. U kryen restaurime tek Kisha e Armenit, Restaurim, mirëmbajtje, Kisha e Shën Stefanit

Në Shkodër janë kryer punime mirëmbajtje në Kalanë e Shkodrës , Kalanë e Lezhës etj.

"Muze të mirëmbajtura dhe të vizitueshëm nga publiku " me një kosto faktike 149.8 milion lekë, ku:

Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi", përveç performancës lidhur me vizitueshmërinë, ka realizuar dhe 61 aktivitete të tjera me qëllim publikime të objekteve të trashëgimisë kulturore, si edhe në kuadër të Programit të Edukimit: janë organizuar aktivitete si "Vizato portretin", "Bëj maskën tënde", Ekspozita si; "Dinastia marubi, Njëqind vite të studios fotografike shqiptare"; Ekrani i Artit.

Muzeu Historik Kombëtar, gjatë këtij viti, ka realizuar 168 aktivitete, veprimtari me karakter promovues, edukues në të gjithë hapësirat muzeore dhe ato mbështetëse. Janë restauruar një sërë objektesh të trashëgimisë kulturore pjesë e fondit të muzeut, trajtim dhe mirëmbajtje objektesh në bashkëpunim me IMK etj.

Muzeu kombëtar i Artit Mesjetar, Arsimit dhe Arkeologjik, Korçë, ka organizuar veprimtari qe janë lidhur me prritjen e vizitorëve dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë që administrohen nga këta muze.

Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat ka kryer 37 veprimtari me karakter promovues dhe njëkohësisht dhe mirëmbajtje të objekteve muzeore.

Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë gjatë vitit ka kryer një sërë aktivitetesh në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme histotiko-kulturore.

Muzeu Kombëtar "Gjethi" gjatë këtij viti është fokusuar në objektivat kryesore për promovimin e vlerave historiko-kulturore si dhe pritjen e vizitorëve si projektet" Kujtojmë për të mos harruar", dhe "Mbresa" në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" përgjatë vitit 2019 aplikoi për të marrë pjesë në garën për të fituar Çmimin "Muzeu Evropian i Vitit" për 2020, i cili arriti të fitojë çmimin prestigjioz: Muzeu i Këshillit të Evropës 2020.

Realizimi i punimeve restauruese të parqeve të Butrintit dhe Apolonisë.

Aktivitete, të fushës së trashëgimisë jomateriale", realizuar me nje kosto faktike prej 48 milion lekë.

Projektet me thirrje për vitin 2019 të trashëgimisë jo materiale janë 41 e janë të ndara per programin kombëtar "Edukimi përmes kulturës", Dokumentimi i vlerave të trashëgimisë, projekte dedikuar artizanatit , festivale, panaire, aktivitete multikulturore, inovacione etj.

Projekti "Dita e Verës 2019 Përmet –edicioni IV, u zhvillua më dt 16-17 mars 2019.

Projekti "Dore për dore breza vallesh", organizuar nga shoqata multifunksionale për kulturë, Edukim dhe Zhvillim, Gjirokastër ku morën pjesë 68 artistë.

Projekti "Peligrinazhi i bijve të Arbërisë në Trojet Shqiptare", 26-28 Prill. U organizua Festivali i 15-të Mbarëkombëtar i Instrumentistëve të vegjël popullorë në qytetin e Fushë Arrëzit në datat 18, 19, 20 maj, zhvilluar nga Shoqata Eko-Turistike, Pukë.Morën pjesë 140 artistë të vegjël nga të gjithë trevat shqipfolëse.

Projekti "Festivali Mbarëkombëtar i Instrumentistëve të Vegjël Popullorë" ku morën pjesë 100 artistë të vegjël nga Shqipëria Kosova, shqiptarët e Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Projekti"Festivale Kcimi i Tropojës" u zhvillua në Bajram Curri.

Projekti "Kthim në vite", organizuar nga z.Myrdar Jera

"Trashëgimia materiale e jomateriale e inventarizuar", me një kosto faktike prej 8.1 milion lekë. Gjatë vitit 2019 rezultojnë të regjistruara në Bazën e të dhënave shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore gjithsej 98 218 objekte nga të cilat 96 423 objekte në pronësi shtetërore dhe 1795 objekte në pronësi private.

Në programin **"Arti dhe Kultura"** janë realizuar projekte artistike kulturore të cilët kanë siguruar gjithëpërfshirje në jetën social kulturore, në veçanti ato projekte të cilat kanë në fokus krijimtarinë artistike, edukimin dhe zhvillimin e audiencave si dhe integrimin gjinor. Ky objektiv është arritur nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

"Investime të reja në skenat bashkëkohore" përfshihen ndërtime e rikonstruksione si dhe blerje pajisje, në institucionet e artit dhe kulturës, ku përmendim "Rikonstruksionin e Teatrit të Operas dhe Baletit, që është në proces .Për vitin 2019 shpenzimet faktike arrijnë 717.4 milion lekë.

"Veprimtari të realizuara në institucionet e art-kulturës" nga të cilat përmendim:

'Premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorik kombëtar", 161 shfaqje me nje kosto faktike 281 milion lekë,

"Premiera dhe shfaqie artistike të zhanrit skenik teatror klasik dhe bashkekohor" , 120 shfaqje me nje kosto faktike 98 milion lekë.

"Premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik teatror eksperimental klasik dhe bashkekohor ", 449 shfaqje me një kosto faktike 38 milion leke

"Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur", ku janë realizuar 130 aktivitete me një kosto faktike 80 milion lekë.

Për sa i përket **investimeve publike** janë mbyllur 2 kontrata me vlerë totale 69.6 milionë lekë:

Projekti i Restaurimit dhe Riformulimi i linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar-Tiranë, 39.9 milionë lekë

Restaurimi i muzeut "Mësonjëtorja e parë shqipe", 29.6 milionë lekë

4.4.11 Rendi dhe Siguria Publike

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Brendshme paraqitet si mëposhtë:

Tabela 24 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë e Brendshme

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Policia e Shtetit	15,411,522	1,121,856	15,189,919	1,108,742	98.56	98.83
	Financimi i huaj		818,868		569,638		69.56
2.	Garda e Republikës	1,560,769	12,000	1,537,321	11,362	98.5	94.68

3.	Shërbimi i Gjendjes Civile	695,560	13,000	664,034	12,958	95.47	99.68
4.	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguar	523,308	88,600	504,296	83,972	96.37	94.78
	Financimi i huaj		176,000		5,007		2.84

Në programin **"Policia e Shtetit**", me realizimin e fondeve me 99%, është realizuar qëllimi i politikës së programit. Qëllimi i këtij progami është: "Lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe/ose organizatave kriminale të ndryshme, si dhe i grupeve me axhenda ekstremiste të dhunshme dhe terroriste duke shënjestëruar dhe goditur veprimtarinë e krimit të organizuar e rrjetet kriminale, gjurmuar, identifikuar, sekuestruar dhe konfiskuar çdo aset ekonomik të paligjshëm. Përforcimi i zbatimit të ligjit për rritjen e nivelit të sigurisë publike dhe asaj rrugore. Menaxhimi efektiv, efeçient dhe i integruar i kufijve nëpërmjet mirëfunksionimit të 27 pikave të kalimit kufitar në Republikën e Shqipërisë. Forcimi i kapaciteteve institucionale, garantimi i pavarësisë operacionale të policisë së shtetit dhe konsolidimi i arsimit, kualifikimit dhe veçanërisht trajnimit të vazhdueshëm e të profilizuar të strukturave të Policisë së Shtetit." Janë planifikuar 64 produkte dhe janë realizuar 60 prej tyre, të cilat konsistojnë në :

Realizimin e 184 "Operacione të posaçme Konvencionale", që shoqërohen me një kosto prej 234 milionë lekë.

Realizimin e 94 programeve për "Mbështetjen për Strategjinë Anti-Kanabis, mbikqyrje ajrore", i cili është shoqëruar me një kosto prej 70.4 milionë lekë.

Janë kryer 37,601"Operacione policore të hetuara dhe shërbime", të shoqëruara me një kosto prej 37.6 milionë lekë.

Realizimi i 6589 "Shërbime të policisë rrugore të kryera në rrugët nacionale", me kosto prej 243.8 milionë lekë.

Janë realizuar 540 shërbime të Forcave Speciale dhe e NSH për sigurimin e Rendit Publik, me kosto rreth 1,142 milionë lekë.

Janë realizuar 5,678 shërbime të patrullave të përgjithshme.

U realizuan 103 operacione të sigurisë në kufirin blu, të shoqëruar me një kosto prej 229 milionë lekë.

Janë procesuar 1929,871,000 persona në PKK, kategoria I; II dhe e II-të (ajrore, detare, tokësore), shoqëruar me një kosto prej 1.763 milionë lekë.

Janë trajnuar 190 Qen policie në kushte shërbimi, me kosto prej 43.3 milionë lekë.

U trajnuan 735 rekrut të rinj, shoqëruar me kosto prej 248.5 milionë lekë.

U trajtuan 96 bashkëshorte të punonjësve të policisë së shtetit, shoqëruar me një kosto prej 33.8 milionë lekë.

Në programin "Garda e Republikës", ka realizim të fondeve rreth 98 %, duke realizuar kështu edhe qëllimin e politikës së programit, e cila është : *"Të kontribuojë në përmiresimin e vazhdueshëm të Sigurise së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë, duke synuar arritjen e nivelit 100% të sigurisë."*

Janë realizuar plotësisht 2 produkte nga 3 të planifikuara. Produktet që kanë kontribuar në realizimin e qëllimit të programit janë:

Ruajtja e 109 Personalitete VIP vendas dhe të huaj, me një kosto prej 1,537 milionë lekë.

Është rikostruktuar magazina dhe oficina në gardë me një kosto prej 11.4 milionë lekë.

Në programin "Shërbimi i Gjendjes Civile", ka realizim të fondeve rreth 96 %, duke realizuar kështu edhe qëllimin e politikës së programit, e cila është : *"Konsolidimi i mëtejshëm të një sistemi të dixhitalizuar të regjistrit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrit kombëtar të adresave (RKA) dhe regjistrimi/përditësimi i të dhënave të shtetasve në Republikën e Shqipërisë me vërtetësi dhe në kohë reale."* Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet produkteve sa më poshtë:

Rregjistrimit të 906,610 akte dhe dokumente të lëshuara nga shërbimi i Gjendjes Civile, me kosto prej 390 milionë lekë.

Nëpërmjet funksionitmit të sistemit të adresavë të përmirësuar dhe rritjen e funksionalitetit të RKGJC me kosto prej 274 milionë lekë.

Programi "Prefektura dhe Funksionet e Deleguara", ka realizuar fondet për vitin 2019 me rreth 75%. Qëllimi i politikës së programit është: *"Ndjekia e zbatimit të programit të Qeverisë në nivel vendor si përfaqësues i qeverisë", i cili synohet të realizohet nëpërmjet objektivit: "Rritja e performacës së Prefektit të Qarkut në nivel vendor për zbatimin e reformës Administrativo – Territoriale. Për realizimin e objektivit kanë kontribuar produktet sa më poshtë:*

Janë kryer 1,800 monitorime në nivel qarku nga Perfekti i Qarkut me kosto prej 82 milionë lekë.

Është dhënë ndihmë për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale, me kosto rreth 27 milionë lekë.

Për sa i përket **investimeve publike** janë mbyllur 36 kontrata me vlerë totale rreth 736.5 milionë lekë. Nga këto veçojmë:

Studim projektimi për ndërtimin e Korpusit të Policisë së Shtetit, me vlerë 43.5 milionë lekë,

Armatime të blera, me vlerë 109.8 milionë lekë,

Pajisje per leximin optik për pasaporta të blera për Policinë Kufitare, me vlerë 24.8 milionë lekë,

Pajisje për Policine e Rendit, me vlerë 150.1 milionë lekë,

Motora për mjetet lundruese në kufi me vlerë 16.9 milionë lekë.

4.4.12 Politika e Jashtme

Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet kryesore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqitet si më poshtë:

Tabela 25 Realizimi i buxhetit 2019 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2019		Fakti 2019		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	141,000	87,000	130,019	84,898	92.2	97.6
	Financim i huaj		-		8,316		
2.	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,428,875	35,000	2,393,875	34,496	98.6	98.6
3.	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	207,500	-	190,737	-	91.9	
4.	Mbeshtetje institucionale për procesin e Integrimit	91,000	-	84,126	-	92.4	
	Financim i huaj		251,000		118,506		47.2

Programi "**Mbështetje institucionale në procesin e integrimit**" ka në thelb të tij zbatimin e prioriteteve të politikes së jashtme të qeverisë dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim me qasje drejtimin teknik dhe bashkërendim të procesit të anëtarësimit të RSH-së në Bashkimin Evropian. Programi fokusohet kryesisht në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në, përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së, zhvillimin e negociatave për anëtarësim dhe përmirësimin e menaxhimit të fondeve të BE të dhe përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe.

Objektivi i këtij programi për vitin 2019 ishte hapja e negociatave të anëtarësimit dhe demonstrimi përpara shteteve anëtare të BE-së i aftësisë së Shqipërisë për të plotësuar kriteret e anëtarësimit në BE.

Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 202,632 mijë lekë, ku përmendim:

U zhvilluan takimet shpjeguese për 28 kapituj negociues, në kuadër të procesit screening si hapi i parë i negociatave të anëtarësimit;

U ngrit Komiteti Teknik i Grupeve Ndërinstitucionale të Punës dhe u riorganizuan grupet ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian si pjesë e strukturës institucionale për negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian;

U hartua dhe miratua Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2019 – 2021;

U zhvilluan 8 takime të institucioneve të përbashkëta Bashkimi Evropian – Shqipëri ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

U programuan njëkohësisht paketat e programimit IPA 2019 dhe IPA 2020, të cilat u miratuan nga Komisioni Evropian në nëntor 2019.

Për sa i përket **investimeve publike**, vlen të përmenden financimet në kuadër të fondeve IPA, projekteve ndërkufitare me vendet e rajonit, të cilat janë projekte në vazhdim.

4.5 Fondi Rezervë dhe Kontigjenca

Fondi Rezervë 2019, i planifikuar për 2.9 miliardë lekë në buxhetin fillestar, i ndryshuar me Aktin Normativ nr.2 datë 02.10.2019, në 3.35 miliardë lekë dhe me Aktin Normativ nr.11 datë 24.12.2019 në 3.585 miliardë lekë (2.235 miliardë lekë për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe 1.35 miliardë lekë për Sistemin e Drejtësisë), gjatë vitit 2019 është përdorur si më poshtë:

Fondi Rezervë prej 2.235 miliardë lekë i planifikuar për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme, është përdorur gjatë vitit 2019 për shpenzime të tjera korrente (shpenzime operative dhe transferta të brendshme rreth 79 përqind); për investime publike (rreth 4 përqind) dhe për shpenzime personeli (rreth 9 përqind).


Fondi Rezervë për Sistemin e Drejtësisë prej 1.35 miliardë lekë, është përdorur për shpenzime personeli (rreth 85 perqind); shpenzime operative (rreth 3 përqind) dhe shpenzime për investime (rreth 10 përqind).

Fondi Kontigjencë për risqet e borxhit, i planifikuar në masën prej 4.3 miliard lekë, rezulton i papërdorur gjatë vitit 2019.[5]

5. BUXHETI VENDOR

Shpenzimet për Pushtetin Vendor, për vitin 2019, kanë përbërë 13.5 përqind të shpenzimeve korente. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 ky nivel rezulton 13.3 përqind më i lartë ose rreth 6.6 miliardë LEK më shumë. Niveli i shpenzimeve për Pushtetin Vendor, për vitin 2019, arriti në masën rreth 56.2 miliard LEK.

Grafiku 36 Shpenzimet e pushtetit vendor në rritje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet e Pushtetit Vendor janë një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Ndër vite shpenzimet e pushtetit vendor paraqiten si një tregues me rritje të lehtë dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve dhe funksioneve që pushteti vendor ofron tashmë për qytetarët. Buxheti vendor për vitin 2019 ishte planifikuar rreth 3 për qind e PBB-së dhe krahasuar me vitin 2013 është rritur me 1.1 për qind të PBB-së, ndërkohë që për periudhën 2006 - 2013 ishte rritur nga 0.1 deri në 0.4 për qind e PBB-së. Rritja e

[5] *Shih raportin e posaçëm për Fondin rezervë dhe të kontingjencës për më shumë detaje.*

buxhetit vendor në një vlerë të konsiderueshmë prej rreth 56.2 miliard lekë në vitin 2019 ose e thënë ndryshe 13 % më shumë se një vit më parë, tregon rëndësinë dhe vlerësimin që i është kushtuar procesit të decentralizmit dhe zbatimit të reformës administrativo-territoriale. Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës kanë pësuar luhatje të vogla por në tërësi struktura ka mbetur e njëjtë. Duke ju referuara grafikut të mëposhtëm pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet kapitale dhe ato të personelit ndërkohë që pas tyre vinë shpenzimet operative që kryejnë NJVQV-të.

Grafiku 37 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Menaxhimi financiar në nivel vendor tashmë ka hyrë në një fazë të detajuar analize dhe monitorimi, proces i cili do të vazhdojë për të identifikuar problematikat financiare që tashmë po marrin zgjidhje në pjesën më të madhe të njësive. Pas miratimit të reformës në vitin 2015 janë bërë përpjekje për të analizuar vazhdimisht sjelljen e shpenzimeve vendore në raport me shpenzimet para reformës. Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor në nivel artikulli për dy vitet e fundit buxheore.

Tabela 26 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës

		Të dhëna progresive (në milionë LEK)			
Nr	**E M Ë R T I M I**	**Fakt 12 mujori**		**Diferenca**	
		2019	**2018**	**2019 / 2019**	**% e 2019 kundrejt 2018**
I.	**Të ardhura nga Pushteti vendor**	**23,102**	**21,863**	**1,239**	**106%**
I.1	Taksa mbi pasurinë	5,208	5,192	16	100%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	355	316	39	112%
I.3	Taksa Lokale	17,539	16,354	1,185	107%
II	**Shpenzime nga Pushtetit Vendor**	**56,227**	**49,606**	**6,621**	**113%**
II.1	**Shpenzime Korente**	**38,340**	**35,383**	**2,957**	108%
	Personeli	21,835	20,689	1,146	106%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	14,966	13,475	1,491	111%
	Subvencione	180	127	53	142%
	Te tjera	1,359	1,092	267	124%
II.2	**Shpenzime Kapitale nga të cilat:**	**17,887**	**14,223**	**3,664**	**126%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet vendore të Personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të NJVQV. Për vitin 2019 këto shpenzime janë realizuar në masën 21.8 miliard lekë ose rreth 1.1 miliard lekë më shumë se viti 2018. Rritja e shpenzimeve të personelit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk përbën rritje të ndjeshme por është një trend natyror i rritjes që njësitë vendore

realizojnë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve. Këto shpenzime për vitin 2019 zënë rreth 38.8% të totalit të shpenzimeve të pushetit vendor, trend i cili ka qënë i qëndrueshëm krahasuar edhe me vitet paraardhëse. Me rritjen e kompetencave që pushteti vendor ka për të ushtruar në shërbim të qytetarëve, ka lindur nevoja për rritjen e personelit në funksion të mbulimit me shërbime cilësore ndaj qytetarëve.

Shpenzimet vendore Operative që janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve, rezultojnë më një rritje të lehtë në vitin 2019 në raport me një vit më parë. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 26.6% të shpenzimeve të pushtetit vendor për vitin 2019, trend i cili rezulton i njëjtë edhe në raport me vitin 2018. Parë në këndvështrimin e procesit të menaxhimit financiar publik, rritja e shpenzimeve operative dhe të mirambajtjes me rreth 1.6 miliard lekë vjen për shkak të rritjes së veprave infrastrukturore që kanë nevojë për mirëmbajtje dhe janë nën përgjegjësinë e NJVQV. Sigurisht, rritja e shpenzimeve të mirëmbajtjes është një shpenzim komplimentar i shpenzimeve për investime në kushtet kur në pothuajse 3 vitet e shkuara shpenzimet për investime nga NJVQV janë rritur ndjeshëm.

Shpenzimet Vendore për subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë NJVQV për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipër në raport me vitin 2018, këto shpenzime në vitin 2019 kanë rritje në zërin të tjera dhe kanë rënie të zërin subvencione, ndryshime të cilat zënë një peshë të vogël në shpenzimet e pushtetit vendor. Tashmë njësitë e reja vendore duhet të planifikojnë më afatgjatë dhe mbështetur mbi një strategji të qartë zhvillimi dhe ofrimi të shërbimit publik, e në këto kushte është e nevojshme që në mënyrë vazhdueshme të mbështesë me subvencione zhvillimin ekonomik të zonës nën juridiksion.

Shpenzimet Kapitale vendore janë një zë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për faktin që përbëjnë një ndër zërat më të mëdha në shpenzimet e pushtetit vendor por edhe për shkak sepse këto shpenzime janë ato çfarë prek drejtpërdrejt qytetari e që kanë ndikim në cilësinë e jetës. Në vitin 2019 shpenzimet kapitale rezultojnë në një vlerë të konsiderueshme prej rreth 17.8 miliard lekë ose 3.8% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor. Ndërkohë, që sipas të dhënave shpenzimet për investime janë ato që kanë pësuar rrijen më të madhe për vitin 2019 ose rreth 3.7 miliard lekë më shumë ose 26% më shumë se viti 2018. Në mënyrë të vazhdueshme pushteti vendor po i vë një theks gjithmonë e më të madh rritjes së nivelit të investimeve me qëllim përmirësimin infrastrukturor të hapsirave që menaxhohen nga Bashkitë. Vlen të theksohet fakti që viti 2019 është viti i parë që raporti i shpenzimeve kapitale tejkalon shpenzimet e personelit ndaj totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.

Si përfundim, mund të themi që buxheti i vitit 2019 për NJVQV, ka garantuar një ndarje më të drejtë dhe transparente të financave dhe ka siguruar një proces efektiv të menaxhimit financiar në nivel vendor. Mbështetur mbi treguesit e mësipërm financiar të cilët kanë shënuar një rritje pozitive, konstatohet fakti që përfshirja nën proceset e menaxhimit financiar publik që imponon Ligji nr.68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" për NJVQV-të ka përmirësuar ndjeshëm jo vetëm treguesit e të ardhurave por gjithashtu edhe të shpenzimeve.

6. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik vitit 2019 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2019 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB). Në përputhje me objektivat makro-fiskale, niveli i borxhit publik në raport me PBB për të katërtin vit radhazi u vlerësua me rënie. Vlerësimet paraprake sinjalizojnë një rënie të borxhit publik në raport me PBB me rreth 2.0 pikë përqindje. Në linjë me nevojat buxhetore u realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi rifinancimin e borxhit ekzistues dhe financimin e pjesshëm të deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2019. Huamarrja u realizua nëpërmjet burimeve të brendshme dhe burimeve të huaja, përkatësisht në nivelin 73.2% dhe 118.8% të planit vjetor. Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2019 u menaxhua reduktimi i

mëtejshëm i ekspozimit ndaj risqeve të borxhit të brendshëm në raport me kostot, si edhe u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

Në portofolin e borxhit të brendshëm është ulur pesha e borxhit që maturohet brenda një viti dhe pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme, duke mundësuar reduktimin e ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit. Kosto mesatare e portofolit të borxhit ka vijuar të ulet edhe përgjatë këtij viti, kryesisht ndikuar nga rënia e mëtejshme e normave të interesit në tregun e brendshëm të titujve shtetërorë. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë vitit 2019 është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë. Në këtë drejtim vlen të përmendet vijimi me Projektin Pilot për emetimin e obligacionit 5 vjeçar referencë dhe shtrirja edhe tek obligacioni 3 vjeçar.

Për sa i përket zhvillimeve në tregun primar, kërkesa për tituj shtetërorë, megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, gjatë vitit 2019 ka qenë e kënaqshme dhe ka mbuluar plotësisht nevojat e qeverisë për huamarrje të brendshme. Gjatë vitit 2020 dhe në vijim, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostove.

Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet rifinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të realizohet huamarrja e re e planifikuar.

Huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja do të shërbejë si plotësues i burimeve të brendshme, duke kontribuar në uljen e presionit për hua në tregun e brendshëm, optimizimin e kostos së borxhit, si edhe sigurimin e pjesshëm të flukseve valutore të nevojshme për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë.

Burimet kryesore të huamarrjes së huaj do të jenë huatë me terma të buta ose pjesërisht të buta, cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria, si edhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur reformat dhe politikat zhvillimore të vendit. Gjithashtu, edhe humarrja nëpërmjet instrumenteve të huasë nga burime private (p.sh. Eurobond) është planifikuar dhe do të shërbejë kryesisht për rifinancimin e instrumenteve që maturohen dhe menaxhim të detyrimeve të borxhit.

7. RREZIQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE GJATË 2019

Me qëllim ndjekjen e performancës të zbatimit të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e FMN dhe BB që prej vitit 2017 ka iniciiuar monitorimin e risqeve që shoqërojnë zbatimin e tij. Ky proces ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara, të rekomandojë zbutjen dhe/apo parandalimin në kohë të rreziqeve fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente.

Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara. Ato mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve *ad-hoc* mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontingjente.

Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të risqeve fiskale kryhet në bazë të analizave të thelluara dhe parashikimeve në kuadër të Buxhetit Afatmesëm. Përkatësisht vlerësohen dy kategori risqesh:

Eksplicite", Detyrime të njohura nga qeveria dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi apo kontrata të ndryshme të cilat mund të lidhen me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimin e borxhit, etj.

"Implicite", kontingjente, Detyrime (indirekte) që mund të lindin si pasojë e presionit politik apo presionit të grupeve të ndryshme të interesit si detyrimet e lidhura me PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike

me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.

Tabela 27 Matrica e riskut

Lloji i rrezikut	Skenarët e mundshëm
Risqet dhe detyrimet eksplicite	
Goditje Makroekonomike	Zhvillime makroekonomike të paparashikuara, që mund të ndryshojnë perspektivën e rritjes ekonomike dhe pozicionin fiskal
Parashikimi i të ardhurave	Mosrealizimi i të ardhurave, që mund të sjellë përkeqësimin e bilancit fiskal
Shpenzime të paplanifikuara	Detyrime ligjore ose presione politike, që mund të sjellin rishpërndarje të shpenzimeve
Borxhi publik	Zhvillime të papritura të tregut, ndryshime në normën e interesit ose në kursin e këmbimit, që mund të rrisin nivelin e borxhit publik
Risqet implicite dhe detyrimet kontigjente	
Pagesat për PPP	Pagesat vjetore për PPP-të, mund të tejkalojnë nivelin e lejuar ligjor prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës
Vështirësia financiare e Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH)	Qeverisë mund t'i duhet të ndërhyjë për të mbështur financiarisht NSH-të
Risqe të tjera	Vendime gjyqësore, arbitrazhe ndërkombëtare, fatkeqësi natyrore, etj, që mund të sjellin kosto buxhetore shtesë në buxhetin e shtetit

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Gjatë vitit 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vijoi monitorimin e risqeve kryesore fiskale/buxhetore, sipas Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.1 datë 17.01.2019 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019, i ndryshuar", nëpërmjet strukturës së Monitorimit të Risqeve Buxhetore. Kryesisht, raportimi në adresë të MFE u kanalizua përmes skeduleve kohore strikte dhe formateve standarde të miratuara, një proces tashmë i institucionalizuar për monitorimin e risqeve, krahas intensifikimit të punës në drejtim të rritjes së cilësisë së përpunimit, raportimit dhe publikimit të informacionit të grumbulluar, me synim final:

Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të performancës financiare të tre ndërmarrjeve shtetërore të sektorit të energjisë;

Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të stokut të akumuluar të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes qendrore dhe skedulin e parashikuar të shlyerjes së tyre;

Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë mujore, të performancës së kontratave koncesionare/PPP, me mbështetje buxhetore.

Mëposhtë jepet një tablo e vlerësimeve mbi disa nga tipologjitë e risqeve fiskale, si rezultat i monitorimit nga njësitë përgjegjëse në MFE, për vitin 2019:


7.1 Sektori Energjetik

Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm në ekonomi të tij. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH, OSHEE dhe OST.

Në mbështetje të nenit 4/2 të ligjit 57 datë 02.06.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar", sipas së cilit: *"...Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme, dorëzohen në Ministrinë e Financave...",* Ministria e Financave dhe Ekonomisë, periodikisht mbi bazë tremujore, ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjitik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga


sektori energjitik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sesitive që e karakterizojnë.

Grafiku 38 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE sh.a (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 39 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE sh.a (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Mbështetja buxhetore neto për vitin 2019 në sektorin e energjisë, u miratua në nivelin 3 miliardë lekë sipas buxhetit fillestar dhe në 2 miliardë lekë sipas Aktit Normativ nr.11 datë 24.12.2019 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 99/2019 'Për buxhetin e vitit 2019'". Gjatë vitit 2019, sektori energjitik u përball me një situatë të vështirë kryesisht në drejtim të prodhimit të gjeneruar, i cili pati një rënie të konsiderushme krahasuar me një vit më parë. Prodhimi neto vendas i energjisë, për vitin 2019, ishte rreth 39 përqind më i ulët se sa prodhimi i vitit 2018, por duhet nënvizuar që viti 2018 ishte një vit rekord referuar nivelit të prodhimit. Në terma të rriskut fiskal, impakti i sektorit si kosto apo të ardhura të munguara në financat publike, për vitin 2019, vlerësohet rreth 6.2 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2018 vihet re një përmirësim i ndjeshëm, pasi sektori pati një kosto rreth 9 miliardë lekë për buxhetin e shtetit. Ky përmirësim tregon ecurinë pozitive të sektorit në tërësi dhe impaktin stimulues që kishte performanca, përtej pritshmërive të vitit 2018. Një arritje e rëndësishmë për vitin 2019 është edhe niveli rekord minimal i humbjeve në rrjet me 21.79 përqind, duke shënuar një ulje të humbjeve krahasuar me vlerën 23.96% të vitit 2018. Gjithashtu, një tregues mjaft i rëndësishëm për sektorin energjitik mbetet niveli i arkëtimeve i cili është rritur me rreth 2 miliardë lekë krahasuar me vitin 2018, duke shënuar një nivel prej 67.82 përqind.


7.2 Detyrimet e prapambetura (qendrore)

Një nga çështjet problematike në sistemin tonë buxhetor, u vërtetua se ishte akumulimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara përpara vitit 2014. Qeveria jo vetëm e adresoi me prioritet çështjen e shlyerjes së tyre, por me angazhimin maksimal si të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe të institucioneve buxhetore të përfshira në këtë proces, u arrrit që brenda dy viteve (2014-2015) të shlyen të gjitha detyrimet e prapambetura të raportuara, në vlerën 67 miliardë lekë. Bazuar në VKM nr. 50 datë 05.02.2014 "*Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*" dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura.

Ky është një proçes i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera. Duke nisur nga muaji Shtator 2017, ky monitorim dhe raportim i cili më parë kryhej mbi bazë katërmujorësh, tashmë ndiqet dhe analizohet mbi bazë tremujore, në funksion të intensifikimit të rolit mbikqyrës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në këtë drejtim.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2019, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministrive të tjera të linjës.

Grafiku 40 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore gjatë vitit 2019 (MIE dhe Ministritë e tjera), mln lekë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Gjatë vitit 2019, MFE ka monitoruar edhe ecurinë e shlyerjeve të detyrimeve të prapambetura për secilën periudhë. Në total, gjatë vitit 2019, janë shlyer rreth 7 miliardë Lek detyrime të prapambetura nga periudhat e mëparshme.

Në këto kushte, duke konsideruar që procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve bëhët në respektim të parimit FIFO (First in, First out), rezulton se detyrimet që mbeten për t'u shlyer gjatë vitit 2020 karakterizohen nga një "moshë mesatare" e re e krijimit të tyre.


Vendimet gjyqësore administrative të formës së prerë:

Këto vendime kanë kryesisht në sfond largimet e padrejta nga puna të ish-punonjësve, të cilat në çdo rast implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Këto detyrime monitorohen dhe raportohen nga Miinistria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të monitorimit të përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura.

Për vitin 2019, detyrimet e prapambetura për vendime gjyqësore rezultuan në rreth 3.4 miliardë lekë ose rreth 42 përqind e stokut total të detyrimeve të prapambetura qendrore. Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e nivelit të detyrimeve të prapambetura *për vendime gjyqësore,* për vitin 2019, mbi bazë tremujore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për t'i paraprirë akumulimit të tyre në kohë, përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel nëpërmjet aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste të pagesës për përfituesit apo instrumentave të tjerë të lehtësimit dhe/ose zhvendosjes në kohë të të barrës së tyre buxhetore.

Grafiku 41 Ecuria e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore gjatë vitit 2019 (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Në përfundim, parë në një aspekt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në "*Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2018 – 2020*" të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësive publike. Kjo, përsa kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësive publike, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.


7.3 Detyrimet e prapambetura (vendore)

Në kuadër të evidentimit të detyrimeve të prapambetura të krijuara rishtazi, si dhe monitorimit të shlyerjes së tyre, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vazhduar monitorimin e tyre edhe përgjatë vitit 2019. Për periudhën deri në dhjetor të vitit 2019, rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2019, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme është rreth 8.1 miliard lekë.

Vlera neto e stokut të detyrimeve të prapambetura është rritur me rreth 1.9 miliard lekë, krahasuar me vlerën e detyrimeve të raportuar në tremujorin e tretë të vitit 2019, dhe është rritur me rreth 1.4 miliard lekë krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2018.

Sipas kategorive, zëri "Investime" zë peshën më të madhe të stokut të detyrimeve me rreth 47%, "Mallra dhe Shërbime" me rreth 23%, "Vendime Gjyqësore" me rreth 13%, dhe "Të tjera" me rreth 11%. Pesha që zë stoku i detyrimit të mbetur në kategorinë "Vendime Gjyqësore" është ulur në 13%, krahasuar me tremujori e tretë të vitit 2019 që ishte 17%, ndërkohë që pesha që zë stoku i detyrimit të mbetur në kategoritë e tjera mbetet thuajse në të njëjtat nivele.


Grafiku 42 Detyrimet e prapambetura vendore, sipas kategorive (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Sipas informacionit të njësive të vetëqeverisjes vendore, stoku i detyrimit të mbetur është rritur ndjeshëm për arsye të cilat lidhen më së shumti me procedurat e likuidimit për mbylljen e vitit fiskal dhe gjithashtu një pjesë e detyrimeve janë krijuar si pasojë e fatkeqësisë natyrore të ndodhur gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Detyrimet e krijuara rishtazi lidhen kryesisht me kategorinë "Investime", "Mallra dhe Shërbime" dhe "Vendime Gjyqësore". Në përbërjen e detyrimeve për investime peshën më të madhe e zënë investimet për infrastrukturën vendore, dhe rikonstruksion ndërtesash. Megjithatë, një pjesë e detyrimeve të krijuara deri në dhjetor 2019 janë në proces likuidimi dhe ndërkohë pritet likuidimi i plotë i tyre në periudhën në vazhdim. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e detyrimeve të prapambetura përgjatë periudhës 2015-2019. Sic vihet re ka patur një luhatje të tyre nga njëri vit në tjetrin. Në fund të vitit 2015, vlera e detyrimit ka qënë në shumën 11.8 mld lekë, shumë e cila ka ardhur duke u ulur si rezultat edhe i objektivave dhe prioriteteve që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore ka vendosur në programin buxhetor afatmesëm për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.


Grafiku 43 Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Duke iu referuar detyrimeve në total, rezulton se bashkia e cila ka vlerën më të lartë të detyrimeve të lindura është bashkia Tiranë, me një vlerë prej 1.7 miliardë lekë në total, e ndjekur nga bashkia Kavajë me vlerë prej 766.2 milionë lekë, bashkia Kamëz me vlerë 408.3 milion lekëshkia Pogradec me vlerë 404.5 milion lekë, bashkia Lezhë me vlerë 360.5 milion lekë. Stoku i detyrimit të mbetur i bashkisë Tiranë zë peshën më të madhe ndaj totalit të detyrimit në masën 22%. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet detyrimi për frymë sipas bashkive. Vihet re se, bashkia Kavajë është bashkia me detyrimin më lartë për frymë, e ndjekur nga bashkia Konispol, Poliçan, Finiq, Rrogozhinë, Libohovë.

Grafiku 44 Detyrimet e prapambetura vendore për frymë (në lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

7.4 Koncesionet/PPP-të

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma totale e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Gjatë vitit 2019, MFE ka vijuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar ecurinë e pagesave faktike buxhetore dhe treguesit e performancës të planifikuar/realizuar, për secilën kontratë koncesionare/PPP[6].

Monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar edhe përmes përfshirjes në udhëzimin plotësues nr.1, datë 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim është kryer në bazë mujore, me qëllim identifikimin dhe monitorimin hap pas hapi të risqeve potenciale që mund të materializohen nga implementimi i tyre.

Në këto kushte, referuar përgjegjësive specifike të njësive monitoruese respektive në MFE, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, ndërmarrjet shtetërore dhe autoritetet kontraktuese janë të detyruara të paraqesin:

Pranë Sektorit të Risqeve Fiskale në MFE:

Raportin periodik të detyrimeve të prapambetura dhe detyrimeve të krijuara rishtazi në njësitë e qeverisjes qendrore;

Raportin e detyrimeve të prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-së;

Skedulin e pagesave të detyrimeve të prapambetura;

Ndërmarrjet shtetërore në sektorin e energjisë dërgojnë pasqyrat financiare tre mujore dhe ndërmarrjet e tjera shtetërore raportojnë lidhur me treguesit kryesorë financiarë sipas formateve të përcaktuara në udhëzimin e zbatimit të buxhetit 2019;

Raportin mujor mbi ecurinë e performancës financiare dhe jo financiare (treguesit e performancës) për kontratat e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore.

---

[6] Shih *ANEKSI b)/1 "Performanca 2019 e Kontratave Koncesionare/PPP" bashkelidhur këtij Raporti, I cili është një dokument vjetor i përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonimisë, që jep një tablo të qartë të ecurisë së këtyre projekteve gjatë vitit 2019.*

Pranë Drejtorisë së Koncesioneve në MFE:

Raportin mbi ecurinë e termave të kontratës për të gjitha kontratat koncesionare/PPP;

Raportin periodik të risqeve të përcaktuara në kontratë për të gjitha kontratat koncesionare/PPP.

Pranë ATRAKO-s në MFE:

Kontratat e lidhura nga Autoritetet Kontraktore me dhe pa mbështetje buxhetore.

Në fund të vitit 2019, në nivel total rezultoi se:

Nga 14 kontrata koncesionare/PPP, me mbështetje buxhetore:

Për 10 kontrata u regjistruan pagesa faktike buxhetore, për periudhën 12 mujore.

Për 4 kontrata nuk u krye asnjë pagesë.

Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2019, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, në total ishin rreth 13.75 miliardë lekë.

Pagesat faktike për vitin 2019, në total rezultuan në rreth 13.7 miliardë lekë ose 99.6% e planit vjetor 2019, të ndryshuar.

Respektimi i rregullit fiskal, për vitin 2019:

Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit 2018, përllogaritet në rreth 20.97 miliardë lekë.

Referuar tabelës së mëposhtme, pagesat vjetore neto të realizuara (faktike) nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, rezultuan në rreth 13.7 mld lekë.

Rrjedhimisht, në buxhetin 2019 është respektuar kufizimin ligjor i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e realizuar prej 13.7 miliardë lekë, për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare apo PPP, për vitin 2019, përbën vetëm 3.27 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2018, prej rreth 419.3 miliardë lekë.

Tabela 28 Koncesionet/PPT-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë lekë)

Autoriteti Kontraktor	Nr	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	Programi	Lloji i Shpenzimit	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	% realizimit
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2014	2020	06220	Investime 231	601,429	661,500	631,317	95.4%
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2023	06220	Investime 231	752,771	752,772	752,770	100.0%
	3	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rinbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	2015	2019	04320	Investime 231	1,355,108	1,506,276	1,505,822	99.97%
	4	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit	2018	2030	04520	Investime 231		3,913,800	3,910,860	99.9%
		Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje	2018	2031	04520	Investime 231		3,780,000	3,780,000	100.0%
		Supervizion	2018	2023	04520	Investime 231		133,800	130,860	97.8%
	5	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investime 231	308,183	575,753	570,642	99.1%
		Defektet e Fshehura			04520	Investime 231	249,939	269,000	268,273	99.7%
		Supervizioni			04520	Investime 231	58,244	60,000	59,393	99.0%
		Subvencion			04520	Investime 231		246,753	242,977	98.5%
	6	Ndërtimi dhe Operimi i Portit Jahteve Orikum - Dukat			04520	Investime 231		-		
	7	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren			04520	Investime 231		-		
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	**1**	**Shërbimi i Skanimit në Dogana**	**2013**	**2030**	**01150**	**Korente 602**	**1,525,579**	**1,512,571**	**1,509,659**	**99.8%**
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	**1**	**Koncesioni/PPP Kontrolli bazë i popullisë (check up)**	**2015**	**2024**	**07220**	**Korente 604**	**876,083**	**876,083**	**876,083**	**100.0%**
	2	**Koncesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)**	**2015**	**2025**	**07330**	**Korente 604**	**1,625,581**	**2,168,827**	**2,163,282**	**99.7%**
	3	**Koncesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)**	**2016**	**2025**	**07330**	**Korente 604**	**738,911**	**807,448**	**804,388**	**99.6%**
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2019		07330	Korente 604		-	-	
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	**1**	**Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës**	**2018**	**2025**	**09120**	**Investime 231**		-		
MIE / Bashkia Tiranë	**1**	**Inceneratori i Tiranës**	**2017**	**2047**			**977,000**	**977,125**	**977,126**	**100.0%**
					06260	Korente 602	224,000	477,125	477,125	100.0%
					06220	Korente 602	753,000	500,000	500,001	100.0%
	14	TOTAL					8,760,645	13,752,155	13,701,948	99.6%
Totali i të Ardhurave Tatimore							419,334,130		426,270,680	
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)									3.27%	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

7.5 Detyrime të tjera Kontigjente:

7.5.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së janë të karakterizuara nga një aftësi e dobët parashikuese, përsa kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ, përmes likujdimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonese për çdo ditë vonesë.

Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MFE ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe proceduriale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negocim me përfituesit.

Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin "*Për Avokaturën e Shtetit*", përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku specifikisht në nenin 19/4 përcaktohen 2 mënyra ekzekutimi të shpërblimit:

Vendimet me detyrim financiar mbi 10.000 EUR, implikojnë nxjerrjen e VKM-ve respektive për ekzekutimin e tyre.

Vendimet me detyrim financiar deri në 10.000 EUR, ekzekutohen drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas kërkesës zyrtare të Avokaturës së Shtetit.

Gjatë vitit 2019, me propozim të Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave ka miratuar dy VKM lidhur me vendimet e GJEDNJ-së, me një vlerë totale prej 114.000 Euro (14.305.319 lekë), të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxheti i shtetit i miratuar për vitin 2019.

Gjatë vitit 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ekzekutuar 3 vendime të GJEDNJ-së, me vlera përkatëse nën 10.000 EUR, me një vlerë totale prej 8.860 Euro (1.151.231 lekë).

7.5.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të ARBITRAZHIT

Ato kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke patur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit.

Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje), të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet 'shteti shqiptar' apo 'qeveria shqiptare', këto vendime likujdohen përmes buxhetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe/ose Fondit rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja.

Në vitin 2019, vlera totale e vendimeve të Arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit rezultoi në masën rreth 153.37 milion lekë. Nga këto:

-95.83 milion lekë, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për likujdimin e faturave të shërbimeve juridike dhe kostot paraprake administrative, për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar.

-2.38 milion lekë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pagesën e kostove fillestare të arbitrazhit ndërkombëtar.

-55.16 milion lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pagesën e shërbimeve juridike, kostot administrative dhe kostot e aplikimit, për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në vazhdimësi dhe me këmbëngulje, ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e proçesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllimin final të lehtësimit, reduktimit dhe/ose shmangies së barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.

8. SHTOJCAT

8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale

Ligji Nr.57 datë 02.06.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar" (referuar në vijim si Ligji Organik i Buxhetit - LOB), në nenin 4/1 sanksionon disa parime dhe rregulla fiskale për mirëmenaxhimin e financave publike në Shqipëri. Ky seksison paraqet zbatueshmërinë e këtyre parimeve dhe rregullave fiskalë përgjatë vitit 2019.

Përcaktimi ligjor (1):

Neni 4/1, pika (1.a) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.

Zbatimi i ligjit (1):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2019 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e secilit ligj të buxhetit për vitin 2019 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2019

Ligj Nr. 99, dt. 03.12.2018		AN. Nr. 2, dt. 02.10.2019		AN. Nr. 11, dt. 24.12.2019	
Borxhi i vlerësuar për vitin 2018 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2019 (% PBB)	Borxhi i vlerësuar për vitin 2018 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2019 (% PBB)	Borxhi i vlerësuar për vitin 2018 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2019 (% PBB)
67.9%	65.5%	67.9%	66.2%	67.9%	66.2%

Shënim: Niveli i borxhit faktik i rezultuar në fund të 2019 nuk është relevant për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen sanksionon vetëm nivelin e planifikuar të borxhit për 2019 dhe jo atë të rezultuar faktikisht në fund të vitit. Niveli faktik i rezultuar në fund të vitit është informues mbi efektshmërinë e LOB sa i takon uljes faktike të borxhit, por nuk është relevant sa i takon zbatueshmërisë/përputhshmërisë me ligjin.

Sa i takon efektshmërisë së këtij rregulli fiskal në LOB lidhur me uljen e borxhit gjatë vitit 2019 edhe ajo rezulton të ketë qenë "e plotë", pasi niveli i borxhit faktik për vitin 2019 (sipas shifrave të disponueshme deri në këtë moment të hartimit të këtij raporti) rezulton 66.3% e PBB. Kjo konsiston në një ulje prej rreth 2 pikë përqindje të borxhit publik total nga niveli prej 67.9% që ishte në vitin 2018.

Ndërsa, nëse në konsideratë do merrej treguesi i borxhit publik total, neto nga gjendja e depozitës së qeverisë në Bankën e Shqipërisë (Llogarisë unike të thesarit), atëherë rënia e borxhit sipas këtij treguesi (borxhi neto) rezulton me 1 pikë përqindje, nga 64.9% në vitin 2018, në 63.9% në vitin 2019.

Përcaktimi ligjor (2):

Neni 4/1, pika (1.b) i LOB përcakton që përjashtim nga sanksionet e pikës së mësipërme të këtij neni (pikës "a") mund të bëhet vetëm në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 4/4 të këtij LOB.

Zbatimi i ligjit (2):

Gjatë vitit 2019 është shpallur gjendja e jashtëzakonshme në qarkun e Tiranës dhe Durrësit si pasojë e tërmetit ne muajin nëntor 2019, duke mos cënuar zbatueshmërinë e Nenit 4/1, pika (1.a) i LOB.

Përcaktimi ligjor (3):

Neni 4/1, pika (1.c) i LOB sanksionon që vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva Ekonomike Botërore" (Ëorld Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (3):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2019 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e secilit ligj të buxhetit për vitin 2019 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2019

Ligj Nr. 99, dt. 03.12.2018				AN. Nr. 2, dt. 02.10.2019				AN. Nr. 11, dt. 24.12.2019			
PBB sipas FMN [1] (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN [2] (miliardë lekë)		PBB e perdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN [3] (miliardë lekë)		PBB e perdorur në planifikim (miliardë lekë)	
2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
1,654	1,754	1,648	1,753	1,649	1,748	1,631	1,689	1,626	1,705	1,631	1,689

(1) WEO - Tetor 2018; (2) WEO - Prill 2019; (3) WEO - Tetor 2019

***Shënim**: Vlerat faktike të PBB të vitit 2019 të vlerësuara dhe publikuara nga INSTAT nuk janë relevante për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen/pikë sanksionon vetëm limitin e sipërm sa i takon PBB të parashikuar dhe përdorur gjatë planifikimeve të çdo ligji vjetor buxheti (pra, jo më i lartë se sa parashikmi respektiv i FMN). Ndërkohë që PBB faktike (pra, sipas INSTAT) e rezultuar në fund të vitit është informuese sa i takon efektshmërisë së LOB lidhur me "realizmin" e parashikimeve të PBB, dhe veçanërisht elemiminin e devijimeve "optimiste" sistematike (të përsëritura disa vite rresht).*

Përcaktimi ligjor (4):

Neni 4/1, pika (1.ç) i LOB sanksionon që në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Zbatimi i ligjit (4):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2019 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e secilit ligj të buxhetit për vitin 2019 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2019

Vlera e Buxhetuar e zërit "Kontingjencë për luhatjet e normave të Interesit, etj."		
Ligj Nr. 99, dt. 03.12.2018	AN. Nr. 2, dt. 02.10.2019	AN. Nr. 11, dt. 24.12.2019
4.3 miliardë Lekë ose 0.8% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.3 miliardë Lekë ose 0.8% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.3 miliardë Lekë ose 0.8% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji

Përcaktimi ligjor (5):

Neni 4/1, pika (1.d) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor fillestar të buxhetit, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, kur rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto, e parashikuar në raportin respektiv "Perspektiva Ekonomike Botërore", të FMN-së, është të paktën 5 për qind, atëherë deficiti i përgjithshëm nuk mund të jetë më i lartë se 2 për qind e Produktit të Brendshëm Bruto, përveç rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në shkronjat "a", "b" e "c", të nenit 4/4, të këtij ligji.

Zbatimi i ligjit (5):

Në cdo fazë të hartimit dhe miratimit të ligjeve vjetore të buxhetit për vitin 2019 kjo pikë nuk ka qenë rasti të jetë kufizuese për sa i takon sanksionit ligjor që ajo përcakton, pasi në asnjë nga raportet "Perspektivës Ekonomike Botërore" të FMN-së të publikuar gjatë vitit 2019 nuk

parashikohej një rritje reale për vitin 2019 të paktën 5%. Rrjedhimisht, të gjitha ligjet vjetore të buxhetit të hartuara dhe miratuara për vitin 2018 kanë qenë në përputhje me këtë pikë.

Shënim: *Kjo pikë ka si synim të ankorojë në mënyrë kundra-ciklike politikën fiskale. Pra, nëse ekonomia parashikohet të rritet "përtej potencialit të natyrshëm" të saj, që në rastin konkret ky prag është kuantifikuar në LOB si "rritja reale e parashikuar nga FMN të paktën 5%", atëherë në këtë rast kjo pikë ankoron politikën fiskale drejt një konsolidimi më të lartë në terma të borxhit publik, duke vendosur një limit direkt mbi deficitin e targetuar në jo më shumë se 2% e PBB. P.sh., një rast hipotetik, ilustrues, nëse do të ndodhte që në një vit të caktuar rritja reale do të ishte 5% dhe nëse deficiti do të ankorohej sipas kësaj pike 2% (maksimumi i lejueshëm në këtë rast), duke supozuar një normë inflacioni (deflator) 3% dhe variablat e tjerë të pandryshuar, atëherë borxhi publik përgjatë vetëm atij viti do të reduktohej me rreth 4 pikë përqindje. Ndërkohë pika (ç) në nenin 4/4 përcakton rastin e kundërt të pikës më sipër, pra përcakton një opsion manovrimi ekspansionist të politikës fiskale për të ndikuar në stabilizimin e ciklit të ekonomisë nëse do të ndodhte një rast ku ekonomia të gjendej "në një pikë tejet të dobët të saj", e cila është kuantifikuar në LOB si "rritje reale e parashikuar nga FMN në 1% ose më e ulët". Por në këtë rast, që të mund të përdoret ky opsion lehtësues për stabilizim kundra-ciklik duhet që gjithashtu të jetë siguruar një farë niveli relativisht i qëndrueshëm i borxhit publik, i cili në këtë pikë të LOB kuantifikohet si niveli poshtë 60% të PBB.*

Përcaktimi ligjor (6):

Neni 4/1, pika (1.dh) i LOB sanksionon që në në fazat monitoruese të buxheteve faktike, nëse për shkak të rishikimeve të mundshme të PBB-së nominale ose për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit, që përdoren për vlerësimin e stokut faktik të borxhit publik, rezulton se raporti i borxhit publik ndaj PBB-së nuk është më i ulët, kundrejt nivelit të vitit pararendës, atëherë, si rregull këto devijime duhet të kompensohen në planifikimet e viteve buxhetore pasuese.

Zbatimi i ligjit (6):

Në fund të vitit 2019 niveli i borxhit faktik ka rezultuar më i ulët se sa niveli që shënonte në vitin 2018, specifikisht (deri në këtë moment të përgatitjes së këtij raporti) borxhi në vitin 2018 shënonte 67.9% ndërsa në fund të 2019 shënon 65.9%. Rrjedhimisht, kjo pikë nuk është relevante për sa i takon planifikimive në buxhetet pasuese.

Shënim: Gjithsesi, kjo pikë nuk është relevante sa i takon përputhshmërisë me LOB për vitin që analizohet aktualisht, konkretisht viti 2019, por ajo ka implikime që duhen adresuar në ligjet e buxheteve të viteve të tjera në vijim nëse ndodh rasti që parashikohet në këtë pikë të LOB.

Përcaktimi ligjor (7):

Neni 4/1, pika (2) i LOB sanksionon që të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (7):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2019 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Së pari, në asnjë ligj vjetor të buxhetit 2019 nuk janë parashikuar të ardhura shtesë nga privatizimet. Së dyti, të ardhurat nga privatizimet të realizuara gjatë vitit 2019 kanë qenë në fakt marxhinale, në vlerën e rreth 0.2 miliard Lekë, por gjithsesi përdorimi i tyre ka qenë në përputhje të plotë me përcaktimet e këtij ligji. Kjo ndikohet nga fakti se ndërkohë që programimi në buxhetin fillestar për huamarrjen e brendshme neto ishte rreth 22.9 miliardë Lekë, huamarrja e brendshme faktike në fund të vitit rezulton më poshtë në rreth 17.8 miliardë, pra me një diferencë negative prej rreth 5.1 miliardë e cila kapërcen disa herë vlerën e realizuar të privatizimeve dhe rrjedhimisht ndikon se të ardhurat prej tyre janë përdorur të gjitha për uljen e borxhit publik, në përputhje me përcaktimet e kesaj pike të LOB.

Përcaktimi ligjor (8):

Neni 4/1, pika (3) i LOB sanksionon që ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.

Zbatimi i ligjit (8):

Amendimet e ligjeve tatimore me efekt në të ardhurat e buxhetit për vitin 2019 kanë nisur në fillim të 6-mujorit të dytë 2018. Paketa e ndryshimeve ligjore i është nënshtruar diskutimit dhe marrjes së mendimeve nga Ministritë e linjës, si dhe nga organizatat përfaqësuese dhe grupet e interesuara të biznesit, duke reflektuar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Paketa fiskale është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në tetor dhe është miratuar nga Kuvendi në dhjetor 2018. Efektet e paketës fiskale përgjithësisht janë marrë në konsideratë në planifikimin e të ardhurave tatimore të buxhetit 2019, buxhet i cili u miratua pas miratimit të ndryshimeve në paketën fiskale.

Përcaktimi ligjor (9):

Neni 4/1, pika (4) i LOB sanksionon që masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Zbatimi i ligjit (9):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2019 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e secilit ligj të buxhetit për vitin 2018 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2019

Ligj Nr. 99, dt. 03.12.2018		AN. Nr. 2, dt. 02.10.2019		AN. Nr. 11, dt. 24.12.2019	
Deficiti i targetuar (miliardë Lekë)	Shpenzimet kapitale të targetuara (miliardë Lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë Lekë)	Shpenzimet kapitale të targetuara (miliardë Lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë Lekë)	Shpenzimet kapitale të targetuara (miliardë Lekë)
32.9	90.6	32.9	87.5	32.9	86.1

Shënim: *Edhe kjo pikë e LOB jep përcaktime ligjore të detyrueshme për fazën planifikuese të buxhetit, ndërkohë që nuk është sanksionuese për rezultatin faktik në mbyllje të vitit. Megjithatë, për informacion mbi efektivitetin e këtij rregulli fiskal, duket qartëse edhe rezultati faktik i fund-vitit 2019 ishte në përputhje të plotë me atë ç'ka synon kjo pikë e LOB, pra mbajtjen e investimeve publike të qeverisë qëndrore jo më pak se sa deficiti buxhetor (huamarrje plus privatizime), rregull i cili njihet ndryshe edhe si "rregulli i artë" i buxhetit. Konktretisht në fund të vitit 2019, deficiti i përgjithshëm buxhetor faktik ishte 31.5 miliardë LEK, ndërkohë që shpenzimet kapitale faktike ishin 75 miliardë LEK.*

Përcaktimi ligjor (10):

Neni 4/3 sanksionon që në vitet buxhetore, gjatë të cilave mbahen zgjedhjet e përgjithshme, ekzekutimi i deficitit buxhetor të qeverisjes së përgjithshme, përveç rasteve të jashtëzakonshme, të parashikuara në nenin 4/4, të këtij ligji, bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni si më poshtë:

a) ekzekutimi i deficitit deri në fund të tremujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 30 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;

b) ekzekutimi i deficitit deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 55 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;

c) ekzekutimi i deficitit deri në fund të nëntëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 80 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor.

Zbatimi i ligjit (10):

Gjatë vitit 2019, nuk janë mbajtur zgjedhje të përgjithshme dhe rrjedhimisht nuk aplikohet përcaktimi ligjor i mësipërm.

8.2 Shtojca 2 – Efektet e paketës fiskale 2019

Masat	Efekti i parashikuar i paketës	Të ardhura të mbledhura si efekt i masës fiskale	Diferenca Parashikimi/ Të ardhura të mbledhura	Diferenca Fakt 2019/Fakt 2018	Faktorët	Efektet
Rritet niveli i akcizës së cigareve për vitin 2018, nga 5850 lekë/1000 fije që ishte parashikuar në kalendar, në lekë/1000 fije.	+0.76 miliard lekë	+0.9 miliard lekë	+0.2 miliard lekë	+1.47 miliard lekë	Rritje e sasisë së cigareve, e shoqëruar me rritje të njëkohshme edhe të nivelit të akcizës.	Rrije e nivelit të të ardhurave të mbledhura në buxhetin e shtetit nga akciza për vitin 2019, me efekt total +1.47 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë.
Ulja e normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%.	+4.5 miliard lekë	+7.4 miliard lekë	+2.9 miliard lekë	+7.9 miliard lekë	Ulja e shkallës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8% nxiti kompanitë të shpërndanin dividendë.	Shpërndarja e dividendëve në vitin 2019, duke u tatuar me 8% ka sjellë rritjen e tatimit të paguar me +7.9 miliardë lekë krahasuar me vitin 2018, si dhe +7.4 miliardë lekë mbi parashikimin e bërë.
Rritja e fashës nga 130.000 në 150.000 lekë për normën e tatimit 13%	-0.3 miliard lekë	-	-0.38 miliard lekë	-	Rritja e fashës ul tatimin e paguar përpara këtij ndryshimi, për diferencën e pagës mbi 130.000 lekë me 150.000 lekë	Ky ndryshim ka shkaktuar ulje të tatimit të paguar me 65 milionë lekë vetëm për fashat e pagave nga 130.000 – 150.000 lekë duke rezultuar në vlerën 0.38 miliard lekë, ose 0.08 miliardë lekë më shumë se parashikimi
Përjashtimi në import i inputeve dhe makinerive bujqësore	-	-	-1.7 miliard lekë	-	Përjashtimi në import i inputeve bujqësore sjell rënien e TVSH-së së mbledhur në import	Ky ndryshim nuk ka qenë parashikuar në paketen fiskale 2019, por është miratuar gjatë vitit. Përjashtimi nga skema e TVSH-së për këtë kategori në import ka sjellë 1.7 miliard lekë më pak në buxhetin e shtetit.

Shtojca 3 - Të ardhurat e pushtetit vendor

Menaxhimi i Financave Publike në nivel vendor është një proces i cili ka ndjekur një trajektorë të fortë ndryshimesh përmes modernizimit dhe decentralizimit fiskal pas miratimit të reformës administrativo-territoriale. Fragmentimi i pushtetit vendor ka bërë që në një pjesë të konsiderueshme të njësive të qeverisjeve vendore (sidomos në ish komunat) niveli i menaxhimit të financave publike të ishte i ulët. Janë evidentuar dobësi të theksuara në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, në kryerjen më efiçencë të shpenzimeve, në mbajtjen e kontabilitetit publik dhe domosdoshmërisht këto janë shoqëruar me një stok të lartë të detyrimeve të prapambetura. Si rrjedhim, menaxhimi i financave vendore ka reflektuar një sistem jo efikas si në rolin kushtetues që kanë njësitë në ofrimin e shërbimeve publike por gjithashtu edhe si kontributor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor të vendit.

Në mbështetje të plotë me planin e veprimit të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, ndër vite janë ndërmarrë hapa të thellë në reformimin administrativ dhe financiar të pushtetit vendor në Shqipëri. Në dhjetor të vitit 2015, u miratua ligji "Për vetëqeverisjen vendore", nëpërmjet të cilit një paketë funksionesh të

transferohen nga qeverisja qendore tek ajo vendore sëbashku me mbulimin financiar të tyre si një siguri më tepër për vazhdimësinë e ofrimit të tyre me një cilësi të lartë, financimi i cili ka vazhduar plotësisht edhe në buxhetin vendor 2019. Reformat e nisura imponuan ndryshime të rëndësishme edhe në aspektin financiar të qeverisjes vendore duke bërë që tashmë njësitë e reja vendore me shtrirjen e gjërë administrative të kenë edhe burime më të mëdha financiare për tu përdorur. Në këtë kuadër gjithashtu u hartua ligji nr. 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i cili siguroj plotësimin dhe mbështetjen financiare e fiskale të reformave të decentralizimit të ndërmarra deri më tani nga Qeveria shqiptare. Reformat në qeverisjen vendore ndër vite janë fokusuar si në thellimin e decentralizimit fiskal duke riparë të gjithë skemën e të ardhurave të pushtetit vendor, ashtu edhe anën e shpenzimeve publike vendore, pra menxhimin e financave publike në nivel vendor. Është punuar ngushtësisht me njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim jo vetëm me plotësimin e kuadrit nënligjor por gjithashtu edhe në drejtim të implementimit sa më të suksesshëm nga NJVQV-të. Në këtë kuptim disa prej arritjeve në realizimin e buxhetit faktik 2019 paraqiten si më poshtë:

Vazhdimi i implementimit të udhëzimeve të procedurave standarte për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të monitorimit të buxhetit vendor;

Ekzekutimi me sukses i procedurave të hartimit të projektbuxhetit afatmesëm në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas udhëzimeve ;

Hartimi i udhëzimeve vjetore për përgatitjen e buxhetit vendor në përputhje me nevojat për informacion që kanë NJVQV-të në secilën fazë të përgatitjes së PBA-së;

Buxhetimi dhe ekzekutimi për herë të parë gjatë vitit 2019 mbi bazën e programeve buxhetore të standartizuara në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizimin e shpenzimeve sipas funksioneve;

Të gjitha njësitë vendore janë asistuar drejtpërdrejt nga personeli i MFE në procesin e implementimit të risive që solli udhëzimi i përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022.

Zhvillimi i seancave periodike degjimore dhe konsultative midis qeverisë qendrore e asaj vendore;

Trajtimi me prioritet i kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe problematikave të paraqitura nga ana e tyre gjatë vitit 2019.


Gjatë viti 2020, do të sigurohet vazhdimësia e këtyre reformave që rrisin autonominë financiare dhe për rrjedhojë sigurojnë më shumë fonde për njësitë e vetëqeverisjes vendore, garantojnë më shumë parashikueshmëri, stabilitet dhe transparencë të buxheteve vendore dhe njëkohësisht disiplinë financiare dhe mirëmenaxhim të financave publike në nivel vendor.

8.3.1 Të ardhurat e Pushtetit Vendor dhe kapaciteti fiskal

Burimet e të ardhurave të pushtetit vendor mbështeten në përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9632, datë 30.06.2018 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe ligjin nr. 68, datë 27.01.2017 "Për vetëqeverisjen vendore". Mbështetur mbi burimet e veta, të ardhurat e pushtetit vendor gjatë dekadës së fundit janë prekur nga shumë ndryshime ligjore për taksat dhe tarifat vendore, të cilat kanë ndikuar në ndryshime të vazhdueshme të të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe njëkohësisht kanë ndikuar në uljen e parashikueshmërisë së buxheteve vendore. Gjithashtu, ndryshimet kanë patur efekte edhe sa i përket administrimit të taksave dhe tarifave vendore duke e detyruar administratën tatimore vendore në shumë raste të përshtatet me një ambient të ndryshëm fiskal. Njëri nga shembujt më tipik ka qënë ndryshimi i shpeshtë i cili ka ndodhur në bazën, nivelin dhe administrimin e taksës së biznesit të vogël në 10 vitet e fundit apo taksën e pasurisë.


Në këndvështrimin e shpenzimeve publike njësitë e vetëqeverisjes vendore vazhdimisht kanë qënë problematike dhe kryesisht në disiplinimin e tyre. Në këto kushte përpjekjet që hapat e decentralizimit fiskal vendor të sjellin një menaxhim financiar efektiv, kanë bërë të mundur hartimin e një sërë udhëzimesh standarte sic janë udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqverisjes vendore" dhe udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Grafiku 45 Të ardhurat vendore për periudhën 2017 - 2018



Për vitin 2019, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura (tatimore dhe jo-tatimore) në masën 25,614 milionë lekë, shifër kjo që është 1.1 miliard lekë më shumë ose gati 5 për qind më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë vitit 2015.


Grafiku 46 Të ardhurat sipas burimit, për njësitë e qeverisjes vendore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Ndër vite të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të këtyre të ardhurave. Të ardhurat që siguron pushteti vendor nga taksat lokale janë ato që zënë pjesën më të madhe ose 76% të shumës totale të këtyrë të ardhurave. Kjo konfirmon edhe një herë që procesi i decentralizimit kryesisht në vitin 2016 e pas ka dhënë një efekt shumë të madh duke bërë që tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore të mbledhin më shumë dhe sigurisht të ofrojnë më shumë shërbime cilësore. Parë në këtë këndvështrim, rritja e efektshmërisë së mbledhjes së taksave nga pushteti vendor bën që ato të sigurojnë një nivel më të lartë pavarësie financiare dhe gjithashtu kjo tregon që tashmë për pushtetin vendor ka nisur një periudhë e re menaxhimi financiar. Gjithashtu, duke ju referuar totalit të këtyre të ardhurave tendencat rritëse janë qartazi të evidentueshme, ku pothuajse të gjithë zërat përbërës të të ardhurave vendore janë në rritje me përjashtim të taksës mbi mbiznesin e vogël. Kjo rritje e konsiderueshme në të ardhurat e përgjithshme të pushtetit vendor i referohet kryesisht rritjes që vjen nga taksat lokale.


Grafiku 47 Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit vendor



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Taksa mbi pasurinë përbën një burim të rëndësishëm të të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipas treguesve fiskal të sistemit të thesarit taksa mbi pasurinë përbën rreth 22.5% e totalit të të ardhurave që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore në vitin 2019. Ndër vite ashtu si paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme kjo taksë ka qënë në luhatje të vazhdueshme me ulje dhe ngritje nga viti në vit. Në këtë kuptim vëme re që ky ndryshim reflektohet qartë me një rritje të konsiderueshme nga viti 2013 në vitin 2014 me rreth 50% të shumës së mbledhur, rënie me 6% në vitin 2015 dhe rikthim tek rritja me 19% në vitin 2016 e me tej nje rritje konstante vjetore në rreth 6% deri në vitin 2019. Nga burim i të ardhurave, në raport me vitin 2018 gjatë vitit 2019 janë mbedhur pothuajse e njëjta shumë. Gjatë vitit 2020 e në vazhdim, do të synohet konsolidimi i kadastrës së pronës me qëllim sigurimin e një të ardhure të qëndrueshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga taksa e pasurisë


Grafiku 48 të ardhurat nga taksa mbi pasurinë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Taksa e biznesit të vogël është një taksë e ndarë nga e cila pushteti vendor ka përfituar në mënyrë konstante një shumë ndër vite. Prandaj vërehet qartë që shuma e përfituar nga pushteti vendor ndër vite ka ndryshime të vogla që nuk kanë ndikuar buxhetin vendor. Në buxhetin e vitit 2016 u reduktua përqindja që përfitonte pushteti vendor nga Taksa e Biznesit të Vogël dhe kjo paraqitet qartë edhe në grafikun e mëposhtëm ku të ardhurat nga kjo taksë u reduktuan me 71% në raport me vitin 2015. Gjatë vitit 2019, pushteti vendor nga kjo taksë ka përfituar një vlerë 355 milion lekë ose pothuajse në të njëjtin nivel me një vit më parë. Në kushtet kur pesha që zë ky burim i të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore është shumë e vogël edhe ndryshimi i tij sigurisht që nuk afekton ndjeshëm politikat fiskale të pushtetit vendor.

Grafiku 49 të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të ardhurat nga taksat lokale janë forma më e rëndësishme e të ardhurave të pushtetit vendor. Prandaj duke ju referuar vlerave faktike të buxhetit 2019 ky zë në totalin e të ardhurave vendore zë 75.6% të tyre. Në këtë mënyrë për sa paraqitet në grafikun e mëposhtëm në raport me vitin 2018 të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor në vitin 2019 janë rreth 1.1 miliard lekë më shumë. Kjo rritje e konsiderueshme është pasqyrë e qartë e reformës së suksesshme administrativo-territoriale e cila ka bërë të mundur që me bashkitë e reja efekshmëria e mbledhjes

të taksave lokale të rritet dhe njësitë në kushtet e administrimit të një territori më të madh të zotërojnë më shumë burime për të ardhura e më shumë mundësi për investime. Parë edhe në kënvështrimin e trendit të rritjes në vite të këtij burimi të të ardhurave vihet re që nga viti në vit ky trend ka qëndruar në një rritje konstante.

Grafiku 50 Të ardhurat nga taksat lokale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

ANALIZA E BORXHIT PUBLIK
(Viti 2019)

PËRMBAJTJE

PËRMBLEDHJE
1. Ecuria e Borxhit Publik
2. Borxhi Shtetëror
3. Borxhi Shtetëror i Garantuar
4. Huamarrja
4.1. Huamarrja e Brendshme
4.2. Huamarrja e Huaj
5.Kosto dhe Risqet
5.1. Kosto
5.2. Risqet
6. Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë
6.1. Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë
6.2. Ecuria e normave të interesit
ANEKSI I (Akronime dhe Fjalor Shpjegues)
ANEKSI II (Të Dhëna Shtesë)

PËRMBLEDHJE

Borxhi publik vitit 2019 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2019 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit *(SAMB)*.

Në përputhje me objektivat makro-fiskale, niveli i borxhit publik në raport me PBB[7] për të katërtin vit radhazi u vlerësua me rënie. Vlerësimet paraprake sinjalizojnë një rënie të borxhit publik në raport me PBB me rreth 2.0 pikë përqindje.

Në linjë me nevojat buxhetore u realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi rifinancimin e borxhit ekzistues dhe financimin e pjesshëm të deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2019. Huamarrja u realizua nëpërmjet burimeve të brendshme dhe burimeve të huaja, përkatësisht në nivelin 73.2% dhe 118.8% të planit vjetor[8].

[7] Referuar të dhënave në "Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2021-2023", miratuar me VKM Nr. 53, datë 29.01.2020.

[8] Referuar planit vjetor në Aktin Normativ Nr. 11, datë 24.12.2019, "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 99/2018 "Për Buxhetin e Vitit 2019"", i ndryshuar.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2019 u menaxhua reduktimi i mëtejshëm i ekspozimit ndaj risqeve të borxhit të brendshëm në raport me kostot, si edhe u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

Në portofolin e borxhit të brendshëm është ulur pesha e borxhit që maturohet brenda një viti dhe pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme, duke mundësuar reduktimin e ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit.

Kosto mesatare e portofolit të borxhit ka vijuar të ulet edhe përgjatë këtij viti, kryesisht ndikuar nga rënia e mëtejshme e normave të interesit në tregun e brendshëm të titujve shtetërorë.

Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë vitit 2019 është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së *yield-it* në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë. Në këtë drejtim vlen të përmendet vijimi me Projektin Pilot për emetimin e obligacionit 5 vjeçar referencë dhe shtrirja e këtij projekti edhe tek obligacioni 3 vjeçar.

Për sa i përket zhvillimeve në tregun primar, kërkesa për tituj shtetërorë, megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, gjatë vitit 2019 ka qenë e kënaqshme dhe ka mbuluar plotësisht nevojat e qeverisë për huamarrje të brendshme.

Gjatë vitit 2020 dhe në vijim, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit *(kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm)* në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostove.

Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet rifinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të realizohet huamarrja e re e planifikuar.

Huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja do të shërbejë si plotësues i burimeve të brendshme, duke kontribuar në uljen e presionit për hua në tregun e brendshëm, optimizimin e kostos së borxhit, si edhe sigurimin e pjesshëm të flukseve valutore të nevojshme për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë.


Burimet kryesore të huamarrjes së huaj do të jenë huatë me terma të buta ose pjesërisht të buta, cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria, si edhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur reformat dhe politikat zhvillimore të vendit. Gjithashtu, edhe humarrja nëpërmjet instrumenteve të huasë nga burime private (p.sh. Eurobond) është planifikuar dhe do të shërbejë kryesisht për rifinancimin e instrumenteve që maturohen dhe menaxhim të detyrimeve të borxhit.

1. Ecuria e Borxhit Publik

Në fund të vitit 2019, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,112.6 miliard Lekë ose 65.9% e PBB[9]. Krahasuar me fundin e vitit të kaluar, niveli i borxhit publik në raport me PBB ka shënuar një rënie prej 2.0 pikë përqindje, duke vazhduar të qëndrojë në trajektoren rënëse, e cila ka nisur që prej vitit 2016. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në uljen e nivelit të borxhit në raport me PBB kanë qenë konsolidimi fiskal dhe mbiçmimi i monedhës vendase në raport me monedhat e tjera të portofolit të borxhit.

Paraqitje Grafike 1 (a): *Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2015–2019)*

[9] PBB mbi bazë vjetore, referuar të dhënave në "Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2021-2023", miratuar me VKM Nr. 53, datë 29.01.2020.




Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Niveli i borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm në raport me totalin e borxhit publik janë përkatësisht rreth 54% dhe 46%, duke ruajtur pothuajse të njëjtat raporte me fundin e vitit të kaluar, si edhe duke qenë në linjë me objektivat e vendosura në SAMB në kuadër të menaxhimit të riskut të kursit të këmbimit *(Ref. Aneksi II, Tabela 1.1)*.

Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit publik sipas instrumenteve, më shumë se 60% të peshës vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme *(bono thesari, obligacione, eurobond)*, ndjekur nga huatë e huaja me destinacion financimin e projekteve dhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore.

Paraqitje Grafike 1 (b): *Përbërja e borxhit publik sipas instrumenteve (2015–2019)*




Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Borxhi i pushtetit lokal vazhdon të qëndrojë në nivele të ulëta *(rreth 581.7 milion Lekë ose 0.05% e totalit të borxhit publik)*, kryesisht për shkak të kapaciteteve të ulëta që kanë njësitë e qeverisjes vendore për të akumuluar borxh të ri. Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur asnjë kërkesë nga njësitë e qeverisjes vendore për huamarrje të re.

2. Borxhi Shtetëror

Gjatë vitit 2019 portofoli i borxhit shtetëror vazhdon të dominohet mbi 50% nga titujt shtetërorë të tregtuar në tregun vendas, në përputhje me objektivat strategjikë.


Paraqitje Grafike 2 (a): *Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror sipas instrumenteve (2015–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, gjatë vitit 2019, ashtu si edhe gjatë vitit paraardhës, në përputhje me politikat menaxhuese për uljen e ekspozimit ndaj risqeve, ka vazhduar tendenca e rritjes së peshës së titujve afatgjatë *(kryesisht të titujve me afat maturimi mbi 5 vite)*. Gjithashtu, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme është reduktuar, pasi edhe gjatë këtij viti nuk ka pasur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës.


Paraqitje Grafike 2 (b): *Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit të titujve dhe tipit të interesit (2015–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 50% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Ndërkohë, për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pavarësisht diversifikimit të portofolit drejt instrumenteve të tregtueshme *(Eurobond-i)*, peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë kreditë me burim kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore.

Paraqitje Grafike 2 (c): *Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas tipit të instrumenteve dhe tipit të interesit (2015–2019)*




Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Përbërja e borxhit shtetëror sipas valutave në fund të vitit 2019 paraqitet pothuajse e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Pjesën më të madhe të portofolit të borxhit shtetëror e zë valuta vendase me 54.4% të totalit, ndjekur nga valuta EUR me 30.2% dhe USD me 10.3%.

Portofoli i borxhit të brendshëm në dallim nga viti i kaluar përbëhet tërësisht nga valuta vendase, pasi gjatë vitit 2019 nuk janë emetuar tituj në valutë të huaj, në përputhje me politikat menaxhuese për të kufizuar ekspozimin e portofolit të borxhit ndaj riskut të kursit të këmbimit. Ndërkohë, portofoli i borxhit të jashtëm kompozohet tërësisht nga valuta të huaja, ku mbizotëron me 66.2% valuta EUR, e ndjekur nga USD me 22.6%.

Paraqitje Grafike 2 (d): *Kompozimi i borxhit shtetëror sipas valutës (2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*


3. Borxhi Shtetëror i Garantuar

Në fund të vitit 2019, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 41.9 miliard Lekë *(2.5% e PBB)* ose 3.8% e portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore *(Ref. Aneksi II, Tabela 1.2)*. Krahasuar me fundin e vitit të kaluar, borxhi i garantuar është reduktuar në vlerë absolute me rreth 2.8 miliard Lekë, pasi nuk ka patur emetime të reja të garancive qeveritare edhe përgjatë vitit 2019.

Për sa i përket kompozimit sipas rezidencës së kreditorit, garancitë e brendshme ndër vite kanë pasur një tendencë rritëse, ndërkohë që janë reduktuar ndjeshëm gjatë vitit 2018, si rezultat i bërjes efektive të marrëveshjes së huasë me BERZH për projektin "Shqipëria: Plani i

Ristrukturimit të KESH"[10]. Gjatë vitit 2019, ashtu si edhe gjatë vitit pararadhës, peshën më të madhe e mbajnë garancitë e lëshuara në favor të kreditorëve të huaj.


Paraqitje Grafike 3 (a): *Portofoli i borxhit të garantuar sipas rezidencës së kreditorit (2015–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Më shumë se 80% e totalit të garancive shtetërore vazhdojnë t'i përkasin sektorit të energjisë, duke reflektuar politikat e qeverisë në drejtim të mbështetjes së sektorit të energjisë, në kuadër të përmirësimit të performancës financiare dhe rritjes së efiçencës.

Paraqitje Grafike 3 (b): *Garancitë shtetërore sipas sektorëve ekonomikë (2015–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

4. Huamarrja


Huamarrja gjatë vitit 2019 u realizua në linjë me nevojat buxhetore dhe në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostot dhe risqeve. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua rifinancimi i borxhit ekzistues dhe financimin e pjesshëm i deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2019.

Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 322.6 miliard Lekë, nga të cilat 93.4% (ose 301.2 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 6.6% (ose 21.4 miliard Lekë) nëprmjet burimeve të huaja. Rreth 313.0 miliard Lekë shërbyen për rifinancimin e borxhit ekzistues, ndërsa pjesa tjetër për mbulimin e pjesshëm të deficitit buxhetor, pasi një pjesë e deficitit u financua nëpërmjet gjendjes së likuiditetit të trashëguar nga viti paraardhës.

Huamarrja në raport me PBB, si edhe në raport me të ardhurat tatimore gjatë vitit 2019 kanë shënuar një rënie përkatësisht me 4.5 pp dhe 16.1 pp, duke reflektuar një reduktim në riskun fiskal dhe përmirësim në kapacitetin e shlyerjes së detyrimeve që burojnë nga borxhi.

[10] Kjo hua u garantua nëpërmjet Garancisë Shtetërore të ratifikuar nëpërmjet Ligjit Nr.125/2016, datë 15.12.2016

Paraqitje Grafike 4 (a): *Huamarrja bruto në vlerë absolute dhe në raport me të ardhurat tatimore dhe PBB (2015–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

4.1 Huamarrja e Brendshme

Gjatë vitit 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 301.2 miliard Lekë, nga të cilat 197.7 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatshkurtër dhe 103.5 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatgjatë. Rreth 94% e huamarrjes së brendshme ka shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues dhe pjesa tjetër për të shërbyer nevojat buxhetore.


Tabela 4.1(a): *Huamarrja e brendshme (2019)*

Lloji i Titullit	Viti 2019			
	Emetim (në mld Lekë)	Maturim (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në % të totalit)
Tituj Afatshkurtër	**197.7**	**198.5**	**-0.8**	**-4.5%**
Bono Thesari në Lekë	197.7	198.5	-0.8	-4.5%
Bono Thesari në Euro	0.0	0.0	0.0	0.0%
Tituj Afatgjatë	**103.5**	**84.7**	**18.8**	**104.5%**
Obligacione 2 vjeçare	40.8	54.8	-14.0	-77.5%
Obligacione 3 vjeçare	18.2	10.7	7.6	42.0%
Obligacione 5 vjeçare	21.4	14.3	7.1	39.5%
Obligacione 7 vjeçare	11.4	5.0	6.5	35.9%
Obligacione 10 vjeçare	11.6	0.0	11.6	64.6%
Gjithsej Tituj Shtetërorë	**301.2**	**283.2**	**18.0**	**100.0%**

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Huamarrja nëpërmjet titujve afatshkurtër ka shërbyer për të realizuar rifinancimin e këtyre titujve, ndërkohë që huamarrja e re është siguruar tërësisht nëpërmjet titujve afatgjatë, duke qenë në linjë me objektivat për reduktimin e riskut të rifinancimit. Në po të njëjtën linjë, gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin paraardhës, nevoja për huamarrje të brendshme është reduktuar me rreth 1.8 miliard Lekë.

Paraqitje Grafike 4.1: *Huamarrja e brendshme në terma neto sipas titujve shtetërorë (2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

4.2 Huamarrja e Huaj

Gjatë vitit 2019 huamarrja e huaj u realizua në nivelin 21.4 miliard Lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, huamarrja e huaj është rreth 61 miliard Lekë më e ulët, për shkak të emetimit të Eurobond-it në vitin 2018, i cili mundësoi menaxhimin e detyrimeve të borxhit në periudhën afatmesme dhe financoi pjesërisht buxhetin e vitit 2019.

Ndërkohë, për sa i përket huamarrjes nëpërmjet burimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe vërehet një rritje e moderuar gjatë vitit 2019, ndikuar kryesisht nga niveli më i lartë i disbursimeve të huave që financojnë projektet.

Tabela 4.2 (a): *Huamarrja e huaj në terma bruto (2018- 2019)*

Huajamarrja e Huaj Bruto	2018		2019	
	Vlera (në mld Lek)	%/Total	Vlera (në mld Lek)	%/Total
Kredi për financim projektesh	**18.6**	**22.6%**	**19.6**	**91.9%**
Energjia	4.6	5.6%	1.2	5.6%
Transporti	5.6	6.8%	9.5	44.4%
Ujësjellës Kanalizime	3.8	4.7%	4.7	21.9%
Infrastruktura Urbane	2.7	3.3%	3.1	14.6%
Të Tjera	1.9	2.3%	1.1	5.3%
Mbështetje Buxhetore	**0.9**	**1.2%**	**1.7**	**8.1%**
Eurobond	**62.5**	**76.2%**	**0.0**	**0.0%**
Total Huamarrja e Huaj	**82.1**	**100.0%**	**21.4**	**100.0%**

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

5. Kosto dhe Risqet

Gjatë vitit 2019, menaxhimi i borxhit ka mundësuar reduktimin e mëtejshëm të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston nën kontroll. Struktura e borxhit është përmirësuar, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Përmirësimi i raportit ndërmjet kostos dhe risqeve ka ardhur jo vetëm si rezultat i mirëmenaxhimit në përputhje me objektivat strategjikë, por edhe si rezultat i kushteve të favorshme të tregjeve dhe faktorëve makroekonomikë të vendit, të tillë si:

Normat e ulta të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj, si rezultat i politikave monetare lehtësuese të bankave qendrore;

-Disponueshmëria në nivele të konsiderueshme e burimeve të huaja të financimit me terma koncesionale;

-Kërkesa e kënaqshme për titujt shtetërorë afatgjatë me norma interesi fikse;

-Mbiçmimi i monedhës vendase në raport me monedhën EUR.


5.1 Kosto

Kosto për njësi e portofolit të borxhit shtetëror ka vazhduar të ulet edhe përgjatë vitit 2019, kryesisht si rezultat i normave të interesit në nivele ende të ulëta, shoqëruar me rifinancimin e borxhit që maturohet *(kryesisht atij afatgjatë)* me borxh më pak të kushtueshëm.

Vlen për t'u përmendur reduktimi i kostos për njësi në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, megjithëse është rritur pesha e borxhit afatgjatë, gjë e cila reflekton përmirësimin e mëtjeshëm të raportit ndërmjet kostos dhe risqeve.

Kosto për njësi e portofolit të borxhit të jashtëm ka pësuar rritje, kryesisht të ndikuar nga rritja e peshës së instrumenteve nga burime financimi private. Megjithatë, ky portofol vijon të ketë kosto ndjeshëm më të ulët se portofoli i borxhit të brendshëm, kryesisht për shkak të stokut me terma koncesionale, dhe emetimit të instrumenteve të tregtueshme si Eurobond-i në tregje më konkurruese dhe më likuide se tregu vendas.


Paraqitje Grafike 5.1 (a): *Kosto mesatare e borxhit shtetëror (2015-2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Shpenzimet për interesa gjatë vitit 2019 vlerësohen rreth 1.4 miliard Lekë më të ulëta së shpenzimet për interesa të vitit të kaluar. Rreth 40% e kësaj ulje i atribuohet emetimit të Eurobond-it dhe procesit të parablerjes së pjesshme gjatë vitit 2018. Ndërkohë, pjesa tjetër i atribuhet rënies së normave të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj.

Paraqitje Grafike 5.1 (b): *Shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror (2015–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*


5.2 Risqet

Gjatë vitit 2019 ekspozimi i portofolit të borxhit ndaj risqeve është arritur të menaxhohet në linjë me objektivat strategjike afatmesme. Ulja e peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me

norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm kanë qenë faktorët mbizotërues në optimizimin e riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Ndërkohë, qëndrimi pothuajse në të njëjtin nivel i borxhit në valutë ka bërë që risku i kursit të këmbimit të mbahet nën kontroll.

Risku i rifinancimit është përmirësuar pasi jetëgjatësia e borxhit të brendshëm ka ardhur duke u rritur, ndërkohë që edhe vlera e instrumenteve që maturohen në harkun kohor të një viti është ulur nga 49.4 në dhjetor 2018 në 47.7% në dhjetor 2019.


Paraqitje Grafike 5.2 (a): *Ecuria e tregtuesve të riskut të rifinancimit (2014–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Risku i normave të interesit gjithashtu është reduktuar pasi pesha e instrumenteve që rifiksojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 54.3% në dhjetor 2018 në 50.9% në dhjetor 2019. Në këtë drejtim, ndikim ka pasur reduktimi i peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, përkatësisht me 1.23 dhe 2.31 pikë përqindje. Ulja e ekspozimit ndaj këtij risku ka ulur ndjeshmërinë e borxhit ndaj goditjeve të normave të interesit, duke reduktuar burimet që qeveria duhet të angazhojë në raste të tilla.


Paraqitje Grafike 5.2 (b): *Ecuria e tregtuesve të riskut të rifinancimit (2014–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll, pasi stoku i borxhit shtetëror në monedhë të huaj edhe gjatë vitit 2019 vazhdon të qëndrojë nën kufirin strategjik të përcaktuar në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe atë të qëndrueshmërisë së borxhit[11].

Paraqitje Grafike 5.2 (c): *Ecuria e riskut të kursit të këmbimit (2014–2018)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*


6. Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë vitit 2019 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden: i) kërkesa e kënaqshme e tregut në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje; ii) rënia e normave të interesit në krahasim me ato të vitit 2018; iii) vijimi me projektin pilot për emetimin e obligacionit 5-vjeçar referencë dhe shtrirja e këtij projekti edhe tek obligacioni 3-vjeçar.

6.1 Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë vitit 2019 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 398.4 miliard Lekë, nga të cilat 237.0 miliard Lekë për bono thesari dhe 161.4 miliard Lekë për obligacione. Kërkesa gjatë vitit 2019 ka qenë relativisht më e lartë se oferta e qeverisë për tituj shtetërorë, duke rezultuar në një raport të përgjithshëm mbulimi prej 1.29.

Paraqitje Grafike 6.1 (a): *Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (Viti 2019)*




Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

[11] Referuar kufijve të përcaktuar në analizën e qëndrueshmërisë së borxhit të publikuar nga FMN në raportin për Shqipërinë: Artikulli IV, (Janar, 2019); https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2019/01/28/Albania-2018-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-46556

Nga pikëpamja e investitorëve, kërkesa përgjithësisht ka shfaqur karakteristika të njëjta me vitin e kaluar, duke vazhduar të jetë e përqendruar tek sektori bankar.

Karakteristikat e kërkesës përgjithësisht janë reflektuar edhe në drejtim të mbajtësve të borxhit të brendshëm. Baza e investitorëve, vijon të jetë i përqendruar në mbi 60% tek sektori bankar duke e bërë portofolin e borxhit të brendshëm të ndjeshëm ndaj risqeve sistemike që mund të paraqesë ky sektor.

Paraqitje Grafike 6.1 (b): *Mbajtësit e borxhit të brendshëm shtetëror (2015–2019)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 është vijuar me zbatimin e projektit pilot për emetimin e obligacioneve referencë, i cili ka për qëllim të nxisë tregtimin e titujve në tregun sekondar dhe të risë zbulueshmërinë e çmimit të titujve, duke reduktuar në këtë mënyrë kostot e huamarrjes në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Ky projekt monitorohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si edhe realizohet në bashkëpunim me disa zhvillues tregu *(Market Makers)*. Në dallim nga ankandet e zakonshme, në ankandet e obligacioneve referencë në tregun primar lejohet të marrin pjesë vetëm zhvilluesit e tregut *(banka të nivelit të dytë ose institucione të tjera financiare)*, të cilët marrin përsipër të tregtojnë këtë titull në tregun sekondar.


Nisur nga rezultatet premtuese të gjeneruara nga emetimi i obliacioneve 5 vjeçare referencë në vitin 2018, ky projekt gjatë vitit 2019 u shtri edhe tek titujt me maturitet 3 vite.

6.2 Ecuria e normave të interesit

Normat e interesit në tregun e titujve shtetërorë janë ulur ndjeshëm gjatë vitit 2019, duke reflektuar vazhdimin e politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë dhe nivelin e kënaqshëm të kërkesës, shoqëruar me nevojat e ulta për huamarrje të brendshme.

Paraqitje Grafike 6.2: *Norma mesatare e ponderuar i titujve shtetërorë*[12] *(2017-2019)*

[12] I referohet normës mesatare të ponderuar të titujve shtetërorë të emetuar vetëm në tregun primar.



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)*

ANEKSI I
AKRONIME DHE FJALOR SHPJEGUES

AKRONIME

BSH	Banka e Shqipërisë
DMM	Ditët Mesatare në Maturim
EUR	Monedha e Bashkimit Evropian
JPY	Monedha kombëtare e Japonisë
KMM	Koha Mesatare në Maturim
KMR	Koha Mesatare në Rifiksim
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PP	Pikë Përqindje
PB	Pikë Bazë
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
USD	Monedha Shteteve të Bashkuara të Amerikës
NMP	Norma Mesatare e Ponderuar

FJALOR SHPJEGUES

Ankande shkëmbimi *(exchange auctions)* – Parablerja e titujve shtetërorë më përpara datës së maturimit, ndërkohë që transaksioni kryhet duke e paguar mbajtësin e titullit të parablerë me një titull të emetuar rishtazi.

Borxh – Referuar si "Borxh Total" ose "Totali i detyrimeve të borxhit", konsiston në të gjitha detyrimet që janë instrumente borxhi.

Borxh afatgjatë – Borxh me afat maturimi më të lartë se një vit.

Borxh i brendshëm – Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj rezidentëve të po atij vendi.

Borxh i jashtëm – Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj jo rezidentëve.

Borxhi publik i garantuar – Detyrimet e borxhit të sektorit publik dhe privat, shërbimi i të cilit është i garantuar me marrëveshje nga njësitë e sektorit publik.

Buyback – Është forma e ndërsjellë e emetimit të titujve shtetërorë, e cila mundëson maturimin e parakohëshëm të një titull shtetëror.

Disbursim – Transaksioni i vënies në dispozicion të burimeve financiare.

Eurobond – Një obligacion (*titull financiar*) me afat maturimi më shumë se një vit i emetuar dhe tregtuar në tregjet ndërkombëtare financiare, jashtë kufijve të vendit që e emeton atë.

Kreditor dypalësh – Tipi i kreditorëve si qeveritë dhe agjencitë e tyre.

Kredi koncesionale – Kredi me terma më të favorshme se ato të tregut.

Kreditor shumëpalësh – Tipi i kreditorëve që përfshinë institucionet financiare si Banka Botërore, FMN, etj..

Kreditorë privatë – Kreditorët që nuk janë as qeveri dhe as agjenci të sektorit publik. Këto përfshijnë mbajtësit privatë të titujve shtetërorë, bankat private dhe institucionet e tjera financiare.

KMM – Tregues i riskut të ri-financimit për borxhin. KMM është periudha mesatare e shprehur në ditë ose në vite, që i duhet portofolit të borxhit për t'u maturuar. Sa më larg në kohë të jetë e projektuar data e maturimit të një instrumenti, aq më i ulët është risku i ri-financimit dhe aq më e lartë është vlera e këtij treguesi. KMM për instrumentet financiarë të borxhit përllogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{KMM} = \frac{\sum_{t \in T} t\,Nt}{\sum_{t \in T} Nt}$$

Nga ku:

t – data e maturimit;
T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit;
N_t – Vlera nominale që do të paguhet në datën t.

KMR – Tregues i riskut të normave të interesit për borxhin. Jep informacion lidhur me ekspozimin e portofolit të borxhit kundrejt ndryshimit të normave të interesit. KMR interpretohet si koha mesatare (në vite) që i duhet portofolit të borxhit për të ripërcaktuar normën e interesit. Sa më e madhe të jetë sasia e instrumenteve afatshkurtër dhe sasia e instrumenteve me norma interesi të ndryshueshëm në portofolin e borxhit, aq më i madh është risku i normave të interesit dhe aq më i vogël ky tregues dhe anasjelltas. KMR për instrumentet financiarë të borxhit përllogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{KMR} = \frac{\sum_{r \in R} r\,Nr + \sum_{t \in T} t\,Nt}{\sum_{r \in R} Nr + \sum_{t \in T} Nt}$$

Nga ku:

r – data e pagesës së kuponit të instrumentit me norma interesi të lëvizshme;
t – data e maturimit të instrumentit me norma interesi fikse;
N_r – vlera nominale e instrumentit me norma interesi të lëvizshme;
N_t – vlera nominale e instrumentit me norma interesi fikse;
R – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi të lëvizshme;
T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi fikse.

PBG – Është garanci e emetuar nga Banka Botërore, e cila garanton vlerën e plotë ose të pjesshme të një huaje, me qëllim mundësimin e saj me kosto më të favorshme se ajo e ofruar nga tregu.

Raport mbulimi – Raporti ndërmjet shumës së kërkuar *(nga investitorët)* dhe shumës së ofruar *(nga shteti)* në ankandet e titujve shtetërorë. Shërben për të vlerësuar nivelin e plotësimit të ankandeve dhe gjendjen e likuiditetit.

Risku i kursit të këmbimit – I referohet ndikimit të lëvizjes së kursit të këmbimit të një va;ute, mbi nivelin e borxhit dhe shërbimin e tij në një masë të caktuar mbi pritshmëritë. Psh.: "Mbiçmimi ose nënçmimi i monedhës vendase kundrejt një monedhe të huaj, e cila është pjesë përbërëse e portofolit të borxhit, mund të rezultojë në rënie ose rritje proporcionale të volumit të borxhit ose shërbimit të tij (*të denominuar në monedhë vendase*)".

Risku i likuiditetit – Risku që lidhet me humbjen e aftësisë së buxhetit të shtetit për të likuiduar detyrimet korrente dhe ekzektutimin në kohë të shpenzimeve buxhetore. Me qëllim minimizimin e këtij risku, shteti duhet të ketë akses mbi një sasi të caktuar asetesh likuide me qëllim garantimin e fondeve në raste krizash të përkohshme, gjatë të cilave bëhet e vështirë ose me kosto të lartë, sigurimi i tyre.

Risku i normave të interesit – Risku që pagesat e shërbimit të borxhit të ndryshojnë si rrjedhojë e lëvizjes së normave të interesit. Ky risk krijohet nga nevoja për të shërbyer borxhin që maturohet dhe pagesat e kuponëve të instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme në të ardhmen.

Risku operacional – Risku që ka të bëjë me rritjen e kostos së menaxhimit të borxhit ose me rritjen e nivelit të risqeve të tjera si rezultat i gabimeve njerëzore, dëmtimit të pajisjeve elektronike, dëmeve natyrore, etj. Risku operacional është një risk relativisht i vështirë për t'u matur dhe vlerësuar. Ulja e ekspozimit të riskut operacional mund të arrihet nëpërmjet integrimit të procedurave të menaxhimit të borxhit në një strukturë organizative, duke pasur strukturën, infrastrukturën dhe procedurat të drejtuara nga aktivitete operacionale efiçente për menaxhimin e administratës shtetërore dhe tregjeve financiare.

Risku i rifinancimit – Risku që lidhet me aftësinë për të emetuar instrumente ose marrë hua me qëllim ri-financimin dhe shërbimin e borxhit aktual. Sa më i madh të jetë volumi i shumave që maturohen dhe sa më i afërt në kohë, aq më i lartë është risku i ri-financimit dhe anasjelltas. Risku i ri-financimit ndikohet nga niveli i borxhit ekzistues dhe profili i amortizimit. Rritja e maturitetit të borxhit dhe shpërndarja në kohë e maturimeve ndikon në reduktimin e riskut të ri-financimit.

Stoku i borxhit – Balanca e principalit të borxhit në një moment të dhënë të kohës.

Shërbim i borxhit – Pagesat e principalit dhe interesit në përputhje me termat e përcaktuara në marrëveshje.

Sistemi Primary Dealer – Është një marrëveshje institucionale ndërmjet strukturës përgjegjëse për menaxhimin e borxhit dhe disa ndërmjetësve financiarë *(që kanë funksione të specializuara në tregun e titujve shtetërorë),* me qëllim zbatimin e një strategjie që ka për funksion sigurimin e nevojave për financim të qeverisë dhe zhvillimin e tregut të titujve.

Tregu primar – Është hapësira fizike ose funksionale në të cilin Shteti Shqiptar emeton për herë të parë titujt.

Tregu sekondar – Është hapësira fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt pasi janë emetuar në tregun primar.

Tituj afatmesëm – I referohet titujve të borxhit shtetërorë me afat maturimi nga 2 deri në 5 vite.

Tituj afatgjatë – I referohet titujve të borxhit shtetërorë me afat maturimi mbi 5 vite.

Tituj referencë *(benchmark)* – Është emetimi më i fundit i titujve të shtetit shqiptar për një maturitet të caktuar. Ankandi për titullin referencë mund të rihapet periodikisht deri në arritjen e një vlere të paracaktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ky titull përdoret si pikë referimi për vlerësimin e titujve të tjerë shtetërorë me maturitet, shumë emetimi dhe normë kuponi të ngjashëm.

Përgjithësisht, titujt referencë gëzojnë likuiditet më të lartë se emetimet e zakonshme, për shkak të detyrimit që kanë Zhvilluesit e Tregut për të kuotuar çmime blerjeje/shitjeje në tregun sekondar sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Tituj shtetërorë – Janë bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emetuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përputhje me ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt"; si edhe aktet nënligjore.

ANEKSI II
TË DHËNA SHTESË

1. STOKU I BORXHIT PUBLIK DHE QEVERISJES QENDORE

Tabela 1.0: *Stoku i borxhit publik 2015-2019* *(në milion Lekë)*

	2015	2016	2017	2018	2019
Borxhi Publik	**1,043,228.6**	**1,066,610.3**	**1,088,169.3**	**1,107,284.5**	**1,112,625.9**
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	1,042,271.8	1,065,709.0	1,087,341.9	1,106,568.8	1,112,044.2
Borxhi i Pushtetit Lokal	956.8	901.3	827.5	715.7	581.7
PBB	**1,434,308.0**	**1,472,479.6**	**1,551,281.4**	**1,630,904.8**	**1,688,894.1**
Borxhi Publik/PBB	**72.7%**	**72.4%**	**70.1%**	**67.9%**	**65.9%**
Borxhi i Qeverisjes Qendrore/ PBB	72.7%	72.4%	70.1%	67.8%	65.8%
Borxhi i Pushtetit Lokal/ PBB	0.1%	0.1%	0.1%	0.0%	0.0%

Tabela 1.1: *Stoku i Borxhit të qeverisjes qendrore 2015-2019* *(në milion Lekë)*

	2015	2016	2017	2018	2019
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	**1,042,271.8**	**1,065,709.0**	**1,087,341.9**	**1,106,568.8**	**1,112,044.2**
Borxhi i Brendshëm	551,374.3	561,120.0	577,055.7	580,310.3	597,290.0
Borxhi i Jashtëm	490,897.5	504,589.0	510,286.2	526,258.5	514,754.2

Tabela 1.2: *Stoku i Borxhit të qeverisjes qendrore 2017-2019* *(në milion Lekë)*

	2015	2016	2017	2018	2019
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	**1,042,271.8**	**1,065,709.0**	**1,087,341.9**	**1,106,568.8**	**1,112,044.2**
Borxhi Shtetëror	986,241.7	1,012,241.0	1,037,456.7	1,061,896.8	1,070,191.4
Borxhi i Garantuar	56,030.1	53,468.0	49,885.2	44,672.1	41,852.8

Tabela 1.3: *Kompozimi i stokut të borxhit të qeverisjes qendore 2018-2019*

Kompozimi	2017		2018		2019	
	mln Lekë	% / Totalit	mln Lekë	% / Totalit	mln Lekë	% / Totalit
I. Sipas Maturitetit Origjinal	**1,087,341.9**	**100.0%**	**1,106,568.8**	**100.0%**	**1,112,044.2**	**100.0%**
i. Afatshkurtër	**225,163.5**	**20.7%**	**209,762.7**	**19.0%**	**208,893.7**	**18.8%**
Tituj Shtetërorë	195,046.5	17.9%	194,544.9	17.6%	193,739.3	17.4%
Kredi	30,117.0	2.8%	15,217.8	1.4%	15,154.4	1.4%
ii. Afatgjatë	**862,178.4**	**79.3%**	**896,806.1**	**81.0%**	**903,150.5**	**81.2%**
Tituj Shtetërorë	411,719.8	37.9%	463,112.6	41.9%	479,723.8	43.1%
Kredi	450,458.7	41.4%	433,693.5	39.2%	423,426.7	38.1%
II. Sipas Monedhës	**1,087,341.9**	**100.0%**	**1,106,568.8**	**100.0%**	**1,112,044.2**	**100.0%**
Monedhë Kombëtare	552,054.0	50.8%	565,813.0	51.1%	592,614.1	53.3%
Monedhë e Huaj	535,287.9	49.2%	540,755.8	48.9%	519,430.1	46.7%
III. Sipas Residencës	**1,087,341.9**	**100.0%**	**1,106,568.8**	**100.0%**	**1,112,044.2**	**100.0%**
Kreditorë Vendas	599,478.5	55.1%	601,872.1	54.4%	623,443.4	56.1%
Kreditorë të Huaj	487,863.5	44.9%	504,696.7	45.6%	488,600.8	43.9%
IV. Sipas Tipit të Interesit*	**1,057,230.3**	**97.2%**	**1,091,351.0**	**98.6%**	**1,096,889.8**	**98.6%**
Interesa Fikse	758,266.4	69.7%	802,200.8	72.5%	818,736.5	73.6%
Interesa të Ndryshueshme	298,963.9	27.5%	289,150.2	26.1%	278,153.3	25.0%
V. Sipas Koncesionalitetit*	**1,057,230.3**	**97.2%**	**1,091,351.0**	**98.6%**	**1,096,889.8**	**98.6%**
Interesa Koncesionale	257,882.8	23.7%	241,001.0	21.8%	234,715.7	21.1%
Interesa Tregtare	799,347.5	73.5%	850,350.0	76.8%	862,174.1	77.5%


**Nuk përfshihet borxhi i brendshëm i garantuar*

2. HUAMARRJA SHTETËRORE

Tabela 2.0: *Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme dhe të jashtme në terma bruto 2018-2019*

Burimet e Huamarrjes	2018		2019	
	Vlera (në mld Lekë)	%/Total	Vlera (në mld Lekë)	%/Total
Burime të Brendshme	**303.0**	**78.7%**	**301.2**	**93.4%**
Bono Thesari	204.4	53.1%	197.7	61.3%
Obligacione	98.6	25.6%	103.5	32.1%
Burime të Jashtme	**82.1**	**21.3%**	**21.4**	**6.6%**
Hua për financimin e projekteve ekzistuese	18.6	4.8%	19.6	6.1%
Mbështetje Buxhetore	0.9	0.2%	1.7	0.5%
Eurobond	62.5	16.2%	0.0	0.0%
Total Huamarrja	**385.0**	**100.0%**	**322.6**	**100.0%**

Paraqitje Grafike 2.0: *Huamarrja e brendshme neto sipas jetëgjatësisë së titujve (2015–2019)*



3. KOSTOT

Tabela 3.0: *Shërbimi i borxhit shtetëror 2015-2019* *(në milion Lekë)*

	2015	2016	2017	2018	2019
Shërbimi i Borxhit Shtetëror	**100,335.7**	**58,257.5**	**57,672.5**	**88,191.9**	**64,933.4**
Interesat e Borxhit Shtetëror	**38,642.4**	**36,259.5**	**31,903.8**	**36,513.4**	**35,142.8**
Interesat e Borxhit të Brendshëm	27,384.6	25,526.5	21,414.6	23,158.0	22,837.9
Interesat e Borxhit të Jashtëm	11,257.8	10,733.0	10,489.2	13,355.4	12,304.9
Principali i Borxhit të Jashtëm	**61,693.3**	**21,998.0**	**25,768.7**	**51,678.5**	**29,790.6**
PBB	**1,434,308.0**	**1,472,479.6**	**1,551,281.4**	**1,630,904.8**	**1,688,894.1**
Shërbimi i Borxhit Shtetëror/PBB	**7.0%**	**4.0%**	**3.7%**	**5.4%**	**3.8%**
Interesat e Borxhit Shtetëror/PBB	**2.7%**	**2.5%**	**2.1%**	**2.2%**	**2.1%**
Interesat e Borxhit të Brendshëm/PBB	1.9%	1.7%	1.4%	1.4%	1.4%
Interesat e Borxhit të Jashtëm/PBB	0.8%	0.7%	0.7%	0.8%	0.7%
Principali i Borxhit të Jashtëm/PBB	**4.3%**	**1.5%**	**1.7%**	**3.2%**	**1.8%**
Të Ardhura Tatimore	**345,569.0**	**369,898.0**	**398,629.0**	**419,333.0**	**426,271.0**
Interesa/Të Ardhura Tatimore	11.2%	9.8%	8.0%	8.7%	8.2%

** Krahas shërbimit të borxhit shtetëror përfshihet edhe shërbimi i borxhit që qeveria ka paguar në favor të entiteteve për të cilat ka lëshuar garanci shtetërore.*


4.TREGUESIT E TREGUT PRIMAR TË TITUJVE SHTETËRORË

Tabela 4.0: *Treguesit e ecurisë së kërkesës dhe ofertës në tregun primar të titujve shtetërorë 2018-2019*

Periudha	Treguesi	B.Thesari	Obligacione	Gjithsej
2018	Nr i ankandeve	27	30	57
	Kërkesa *(në mld Lekë)*	259.7	141.4	401.1
	Oferta *(në mld Lekë)*	209.8	101.5	311.3
	Raporti i mbulimit	1.24	1.39	1.29
2019	Nr i ankandeve	25	32	57
	Kërkesa *(në mld Lekë)*	237.0	161.4	398.4
	Oferta *(në mld Lekë)*	204.6	104.0	308.6
	Raporti i mbulimit	1.16	1.55	1.29


5. KOMPOZIMI I BORXHIT TË JASHTËM

Paraqitje Grafike 5.0: *Stoku i borxhit të jashtëm sipas valutës 2018-2019*




**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

Paraqitje Grafike 5.1: *Stoku i borxhit të jashtëm sipas tipit të interesit 2015-2019*




**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

Paraqitje Grafike 5.2: *Stoku i borxhit të jashtëm sipas koncesionalitetit 2015-2019*



**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

Paraqitje Grafike 5.3: *Stoku i borxhit të jashtëm sipas kreditorëve 2015-2019*



**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

6. DISBURSIMET E BORXHIT TË JASHTËM

Tabela 6.0: *Disbursimet sipas kreditorëve 2015-2019* *(në milion Euro)*

	2015	2016	2017	2018	2019
Shumëpalësh	171.7	211.2	385.9	229.0	135.9
Dypalësh	103.0	81.0	53.2	42.9	49.2
Kreditorë Privat	701.1	14.9	0.6	498.5	0.0
TOTAL	**975.8**	**307.1**	**439.7**	**770.4**	**185.1**

**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

Tabela 6.1: *Disbursimet sipas sektorëve ekonomik 2015-2019* *(në milion Euro)*

Sipas sektorëve ekonomikë	2015	2016	2017	2018	2019
ADMINISTRATA SHTETËRORE	1.0	1.4	0.9	0.6	0.8
ARSIMI	1.3	1.0	0.3	-	-
BILANCI I PAGESAVE	-	-	-	-	-
BUQËSI, UITJE	1.8	-	-	0.1	-
ENERGJETIKË	45.5	27.2	51.8	153.8	14.2
IMPORT MALLRASH DHE PAJISJESH	-	-	-	-	-
INDUSTRI E LEHTË	-	-	-	-	-
INFRASTRUKTURË URBANE DHE RURALE	16.9	23.7	24.3	21.1	25.5
KLUBI I PARISIT DHE RISKEDULIME TË TJER	-	-	-	-	-
MBËSHTETJE PËR BUXHETIN	801.5	153.2	234.3	506.1	14.1
MBROJTJA	-	-	-	-	-
MBROJTJA E MJEDISIT	0.4	0.7	0.0	2.2	0.4
PYJE	-	-	-	-	-
SHËNDETËSI	10.2	1.1	0.6	12.4	7.1
SIGURIME SHOQ./ TREGU I PUNËS	-	-	-	-	-
STREHIMI	1.3	-	-	-	-
TELEKOMUNIKACION	-	-	-	-	-
TRANSPORT	52.4	41.3	79.7	44.3	77.6
TRANSPORTI AJROR	-	-	-	-	-
TRANSPORTI HEKURUDHOR	-	-	-	-	-
UJËSJELLËSA/ KANALIZIME	31.7	42.4	45.2	29.9	44.6
ZHVILL. SEK.PRIVAT	7.0	-	-	-	-
TË TJERA	-	-	2.1	-	0.9
ZHVILLIMI RURAL	1.3	0.2	0.6	-	-
MEDIA TELEVIZIVE	3.5	14.9	-	-	-
TOTAL	**975.8**	**307.1**	**439.7**	**770.4**	**185.1**

**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

RAPORT PERIODIK, MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË BUXHETIT TË SHTETIT DERI MË DATË 31.12.2019

I. Fondi Rezervë

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr.9936 datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar*", buxheti i shtetit përfshin edhe një fond rezervë i cili përdoret për rastet e financimit të shpenzimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

1. Ligji nr.99/2018 "*Për Buxhetin e vitit 2019*" miratoi Fondin Rezervë të Buxhetit të Shtetit në masën 2.9 miliardë lekë në nivel total vjetor, ndërkohë që Neni 13 përcakton përdorimin i tij si mëposhtë:

a) Fondi rezervë i Buxhetit prej 1 500 milionë lekësh, përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njesive të qeverisjes së përgjithshme.

b) Fondi rezervë i Sistemit të Drejtësisë përdoret:

- Deri në 1 miliard lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomise, për financimin e pagave të reja të magjistratëve;

-Deri në 400 milionë lekë, nga Këshilli i Ministrave, për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.

2. Me Aktin Normativ nr. 2, datë 2.10.2019 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 99/2018, "Për Buxhetin e vitit 2019", Fondi Rezerve u miratua në masën 3 350 milionë lekë dhe në nenin 13 përcaktohet:

c) Fondi rezervë i Buxhetit prej 2 000 milionë lekësh, përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njesive të qeverisjes së përgjithshme.

d) Fondi rezervë i Sistemit të Drejtësisë përdoret:

-Deri në 1 miliard lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomise, për financimin e pagave të reja të magjistratëve;

- Deri në 350 milionë lekë, nga Këshilli i Ministrave, për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.

3. Me Aktin Normativ nr. 11, datë 24.12.2019 , paragrafi i parë i nenit 13 u ndryshua:

a) "Fondi rezervë i buxhetit prej 2 235 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme."

Deri në datën 31 Dhjetor 2019, **Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit** është **përdorur** nëpërmjet 23 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej **2 056.4 milionë lekësh**, nga 2.235 miliard lekë të planifikuara ose në rreth **92% përqind të planit**.

Tabela 1: Përdorimi i fondit rezervë deri më 31.12.2019 (në milionë lekë)

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit 2019	Miratuar me ligj për vitin 2019	Përdorur me VKM deri 31.12.2019	Mbetur pa përdorur me 21.11.2019	Përqindja (Përdorur/Planifikuar)
	2 235	2 056.4	178.6	92%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Më konkretisht, nga përdorimi deri më 31.12.2019, rezulton se:


-Rreth 1.758 miliard lekë ose 78.6 përqind e planit, janë akorduar për shpenzime korente (shpenzime operative dhe transferta të brendshme);

-Rreth 91.25 milionë lekë ose 4 përqind e planit, janë akorduar për shpenzime personeli; dhe

-Rreth 207 milionë lekë ose 9.2 përqind e planit, janë akorduar për investime.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme paraqet përkatësisht, strukturën e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit dhe përfituesit respektiv, deri me 31.12.2019:

Grafiku.1 Përdorime të Fondit Rezervë, deri me 31.12.2019 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Tabela 2: Përdorimi i fondit rezervë, sipas institucioneve përfituese (në 000/lekë)

Kodi instit.	Emërtimi i institucionit	Numri i VKM-ve të miratuara	Fondi i përdorur	
			Vlera e akorduar	Në % ndaj planit
87	Institucione të tjera Qendrore	5	82 120	4%
16	Ministria e Brendshme	2	52 000	2.5%
17	Ministria e Mbrojtjes	3	213 000	10.4%
26	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit	2	283 000	13.8%
11	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	1	1 020 000	49.6%
15	Ministria për Evropën e Punët e Jashtme	3	19 375	0.9%
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	2	200 000	9.7%
40	Partitë Politike	1	65 000	3.2%
57	Qendra Kombëtare Kinematografike	1	10 500	0.5%
10	Ministria Financave dhe Ekonomisë	2	14 305	0.7%
12	Ministria e Kulturës	1	25 120	1.2%
19	Radiotelevizioni Shqiptar	1	2 000	0.1%
20	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	70 000	3.4%
	TOTALI	**23**	**2 056 420**	**100%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në mënyrë analitike rezulton se:

-1.02 miliardë lekë, ose 49.6 përqind e të gjithë fondit rezervë të përdorur për vitin 2019, janë akorduar në Mars 2019 për programin "Arsimi Universitar" të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si mbështetje e masave të ndërmarra nga Qeveria në kuadër të "Paktit për Universitetin";

-200 milion lekë janë akorduar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet dy VKM-ve si shtesë të fondeve të planifikuara për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetqeverisjes vendore të vitit 2019.

-Shuma prej 82.12 milion lekë e akorduar për Institucionet e tjera qeveritare përmban: 66.9 milionë lekë janë akorduar në Janar 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, me qëllim organizimin e eventit, dedikuar Samitit të Dytë të Diasporës; Kjo shume është ndryshuar me një VKM në muajin Prill, duke mundësuar kthimin e shumave të papërdorura prej 14.56 milion lekë në buxhet. Në muajin korrik është miratuar 22.5 milionë lekë për financimin e "Konferencës së 41-të Nderkombetare të mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë-Tirana 2019 (ICDPPC)". Janë akorduar 4.2 milion lekë për investime për financimin e projektit "Diaspora shkencore si nje faktor ndryshimi në procesin e integrimit të Shqipërisë" dhe 3 milion lekë për financimin e projektit "Për dhomën e biznesit të Diasporës-krijimi dhe nxitja e investimeve të Diasporës -krijimi dhe nxitja e investimeve të Diasporës në Shqipëri".

-65 milion lekë janë akorduar në programin "Mbështetje për partitë politike", për financimin e fushatës zgjedhore, të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, të vitit 2019.

-42 milion lekë janë akorduar në Janar 2019 për Ministrinë e Brendshme, me qëllim trajtimin financiar të Anëtarëve të Bordit të Përzgjedhjes të Komisionit të Jashtëm të vlerësimit kalimtar të Punonjesve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çeshtjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme dhe të Sekretariatit teknik pranë këtij Komisioni (strukturat e Vettingut në Policinë e Shtetit); 10 milion lekë janë akorduar në muajin Prill, si kapital fillestar për shoqërinë "Ilirian Guard".

-14 milionë lekë janë akorduar për Ministrine e Financave dhe Ekonomisë për: ekzekutimin e VJGEDNJ për çështjen "Caka kundër Shqipërisë"(1.39 milion lekë), dhe për ekzekutimin e VGJEDNJ, dt. 5.03.2019 "Për çështjen "Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë" (për 12.7 milion lekë).

-13 milionë lekë janë akorduar në Janar 2019 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me destinacion kryerjen e pagesës ndaj Qendrës Ndërkombëtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve (ICSID).

-12.5 milion lekë janë akorduar në muajin Prill për Ministinë e Punëve të Jashtme, ndihmë për qeverinë franceze për rindërtimin e katedrales Notre Dame në Paris, 3.7 milion leke janë dhënë ndihmë financiare për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, për mbështetjen e funksionimit të ketij Keshilli si dhe të zyrave të tij në Preshevë dhe Medvegje, ndërsa 3 milion lekë janë akorduar për dhenie ndihme financiare nga KM I RSH per KK te Shqiptareve ne Mal te Zi, per mbeshtetjen e funksionimit te ketij Keshilli dhe te Zyres Koordinuese te tij ne Plavë.

-200 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Mbrojtjes per rikonstruksionin dhe rindertimin e banesave te prekura nga tërmeti i dt 21.09.2019 në qarqet Tiranë dhe Durrës, 10 milion lekë janë akorduar për kompesimin e veçantë të familjeve të ushtarakëve të rënë në krye të detyrës, 3 milion lekë jane akorduar për organizatën e veteranëve të LANC-it për organizimin e aktiviteteve për 75 vjetorin e clirimit të vendit,

-10.5 milion lekë janë akorduar për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, si grant për Akademinë e Filmit dhe Multimedia "Marubi".

-2 milion lekë janë akorduar Radiotelevizionit për organizimin e aktiviteteve për 75 vjetorin e çlirimit të vendit.

-25.1 milion lekë janë akorduar për Ministrinë e Kulturës për organizimin e aktiviteteve për 75 vjetorin e çlirimit të vendit.

-70 milion lekw janw akorduar pwr Ministrinw e Infrastrukturws dhe Energjisw për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqsia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019".

Mbështetur në sa mësipër rezulton se, në datën <u>31 Dhjetor 2019</u>, gjendja e papërdorur e Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, rezulton të jetë <u>vetëm 178.5 milionë lekë .</u>

-Fondi Rezerve për Sistemin e Drejtësisë i planifikuar në masën 1.35 miliard lekë deri me 31 Dhjetor 2019 është përdorur në masën 1 321.2 milion lekë ose rreth 97.8% e planit si më poshtë;

-13.2 milion lekë janë akorduar me VKM fonde shtesë për Gjykatën e Lartë për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

-190 milion lekë janë akorduar me VKM fonde për institucionet e reja të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe këshillit të Lartë të Prokurorisë.

-600 milion lekë janë akorduar me miratimin e Ministrisë së Financave për përballimin e shtesës së pagave të prokurorëve.

-400 milion lekë janë akorduar me miratimin e Ministrisë së Financave për përballimin e shtesës së pagave të gjyqtarëve.

-18 milion janë akorduar shtese fonde per shpenzime korrente per institucionet e sistemit te drejtësisë.

-100 milion janë akorduar fonde për Ministrinë e Brendshme, për investime, për akomodimin dhe funksionimin e SPAK.

Mbështetur në sa më sipër rezulton se më datë 31 Dhjetor 2019, gjëndja e papërdorur e Fondit Rezervë për Sistemin e Drejtësisë rezulton 28.7 milion lekë.

II. Fondi Kontigjencë

Fondi Kontigjencë për risqet e borxhit, në masën prej 4.3 miliardë lekë, është miratuar sipas nenit 13 të Ligjit nr. 99/2018 "Për Buxhetin e vitit 2019", ku përcaktohet se: "...Kontigjenca për risqet e borxhit prej 4 300 milionë lekë, përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa". Deri në 31.12.2019, kjo kontigjencë rezulton e papërdorur.

Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2019

Ky raport është përgatitur nga:

Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE
LISTA E TABELAVE

LISTA E GRAFIKËVE
LISTA E FIGURAVE
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
KAPITULLI I- VLERËSIMI I MONITORIMIT TË PERFORMANCËS SË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME
1.1 ANALIZA PËR TREGUESIT E PERFORMANCËS:
KAPITULLI II- MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI
2.1 ANALIZA E SISTEMIT SIPAS 17 PARIMEVE TË MFK BAZUAR NË VETËVLERËSIMIN E NJËSIVE PUBLIKE
2.2 VLERËSIMI I PYETËSORIT TË VETËVLERËSIMIT TË KOMPONENTËVE TË MFK TË RISHIKUAR PËR BASHKITË E PËRZGJEDHURA PËR ASISTENCË TEKNIKE NGA PROJKETI I FINANCAVE LOKALE
KAPITULLI III. VLERËSIMI NË VEND I ZBATUESHMËRISË SË PARIMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM
3.1 MONITORIMI I NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME NGA ANA E DH/MFKK
KAPITULLI IV- MBËSHTETJA E MFE-SË PËR ZHVILLIMIN E SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM
4.1 MBËSHTETJA E MFE-SË PËR ZHVILLIMIN E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT
4.2 LEHTËSIMI I ZBATIMIT TË PROCEDURAVE NË FUSHËN E KONTABILITETIT NËPËRMJET PËRMIRËSIMIT TË BAZËS LIGJORE
KAPITULLI V- ZHVILLIMI I SISTEMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK
5.1 STRUKTURAT E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.1.1 Strukturat e auditimit të brendshëm në njësitë e vetëqeverisjes vendore
5.2 FUNKSIONIMI I KOMITETEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.3 ANALIZË E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.3.1 Realizimi i Planit të Angazhimeve të Auditimit
5.4 VLERËSIMI I RISKUT TË SISTEMEVE, GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT
5.4.1Vlerësimi i sistemeve me risk
5.5 GJETJET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.6 REKOMANDIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.7 AUDITIMET E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË NJËSIVE PUBLIKE
5.8 MBËSHTETJA PËR ZHVILLIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.9 VLERËSIMI I JASHTËM I CILËSISË SË VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.10 ZHVILLIMI PROFESIONAL I AUDITUESVE TË BRENDSHËM
5.11 PYETËSORI I VETËVLERËSIMIT TË NJAB
ANEKSI I. VLERËSIMI I SISTEMIT TË MFK-SË NË NJËSITË SHPENZUESE ME BUXHET TË MADH

LISTA E SHKURTIMEVE

AB	Auditimi i Brendshëm
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Europian
DH/AB	Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm
DH/MFKK	Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar,

	Kontrollin dhe Kontabilitetin
GMS	Grupi për Menaxhimin Strategjik
KAB	Komiteti i Auditimit të Brendshëm
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KB	Kontrolli i Brendshëm
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NPA	Nëpunës i Parë Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
NJAB	Njësi e Auditimit të Brendshëm
NJQP	Njësi e Qeverisjes së Përgjithshme
NJQQ	Njësi e Qeverisjes Qendrore
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
RSH	Republika e Shqipërisë

LISTA E TABELAVE

TABELA 1. TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE BURIMET E TË DHËNAVE SIPAS DREJTORIVE NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

TABELA 2. RANKIMI I MINISTRIVE TË LINJËS SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2019 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2018.

TABELA 3. RANKIMI I NJËSIVE SHPENZUESE ME BUXHET TË MADH SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2019 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2018*

TABELA 4. RANKIMI I BASHKIVE KRYESORE QENDËR QARKU, SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2019 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2018

TABELA 5. RANKIMI I BASHKIVE TË TJERA QË KANË NJËSI AUDITIMI TË BRENDSHËM, SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2019 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2018

TABELA 6. RANKIMI I BASHKIVE QË NUK KANË NJËSI AUDITIMI TË BRENDSHËM, SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2019 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2018

TABELA 7. RANKIMI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2019 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2018

TABELA 8. RANKIMI I INSTITUCIONEVE TË GRUPIT 87 NË VARËSI TË KRYEMINISTRISË, SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PER VITIN 2019 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2018

TABELA 9. TË DHËNA PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM

TABELA 10. GJETJET ME EFEKT FINANCIAR NEGATIV SIPAS SISTEMEVE PËR VITIN 2019

TABELA 11. REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT PËR VITIN 2019

LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU 1. NUMRI I NJQP-VE QË KANË PLOTËSUAR PYETËSORIN E VETËVLERËSIMIT PËR VITIN 2019

GRAFIKU 2. AUDITUESIT E BRENDSHËM SIPAS VJETËRSISË NË AUDITIM

GRAFIKU 3. REALIZIMI I AUDITIMEVE TË PLANIFIKUARA SIPAS LLOJIT PËR VITIN 2019
GRAFIKU 4. AUDITIME TË REALIZUARA SIPAS LLOJIT PËR VITIN 2019
GRAFIKU 5. AUDITIME TË PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA NË VITE
GRAFIKU 6. GJETJET SIPAS SISTEMEVE PËR VITIN 2019
GRAFIKU 7. REKOMANDIME TË PRANUARA DHE TË ZBATUARA NË VITE
GRAFIKU 8. REKOMANDIME TË ZBATUARA DHE NË PROCES GJATË VITIT 2019
GRAFIKU 9. REKOMANDIME TË ZBATUARA DHË NË PROCES GJATË VITIT 2019
GRAFIKU 10. OPINIONET PËR FUNKSIONIMIN E NJAB SIPAS AKTEVE LIGJORE
GRAFIKU 11. OPINIONET PËR IDENTIFIKIMIN, VLERËSIMIN DHE MENAXHIMIN E RISQEVE NGA NJAB
GRAFIKU 12. OPINIONET PËR VENDOSJEN E KONTROLLEVE EFEKTIVE DHE MONITORIMI I REKOMANDIMEVE
GRAFIKU 13. OPINIONET PËR VLERËSIMIN E BRENDSHËM TË CILËSISË SË VEPRIMTARISË AUDITUESE

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1. PËRBËRJA PROFESIONALE E AUDITUESVE TË BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qeveria shqiptare, nëpërmjet reformave në Administratën Publike është angazhuar në nxitjen dhe promovimin e rritjes së llogaridhënies së drejtuesve dhe punonjësve në sektorin publik, për të siguruar mirëadministrimin e fondeve publike në përputhje me parimet e kontrollit të brendshëm financiar publik për arritjen e objektivave strategjikë.

Raporti i konsoliduar për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri, hartohet si një kërkesë ligjore duke ofruar një përmbledhje vjetore të aktiviteteve të njësive të qeverisjes së përgjithshme në këtë fushë, arritjet dhe mangësitë e evidentuara në vitin 2019, si dhe sugjeruar rekomandime për njësitë publike për përmirësime të mëtejshme. Në këtë raport janë marrë në konsideratë aktivitetet e parashikuara në planin operacional të punës si edhe në objektivin specifik gjashtë të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, mbi reformat në fushën e kontrollit të brendshëm. Ky dokument strategjik ka për qëllim garantimin e një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik. Ky qëllim mund të arrihet vetëm nëpërmjet një sistemi të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm në të gjitha njësitë publike.

Përsa i përket sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, evidentohet se pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme në lidhje me rëndësinë e implementimit të instrumentave të kontrollit të brendshëm, ende ka institucione të cilat nuk janë ndërgjegjësuar siç duhet për të respektuar kërkesat ligjore të raportimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga 150 njësi publike, të cilave i'u është dërguar për plotësim pyetësori i vetëvlerësimit mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, 139 prej tyre (93%) kanë raportuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në këtë kontekst, një nga problematikat kryesore vazhdon të mbetet angazhimi i titullarëve të institucioneve në hartimin e instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe mungesa e përfshirjes së tyre në realizimin e aktiviteteve të përditshme të njësisë.

Ndërkohë, nëpërmjet përmirësimeve të fundit të kuadrit ligjor, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, është bërë i mundur lehtësimi i zbatimit të procedurave në fushën e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, në kuadër të rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të administratës publike dhe nivelit drejtues të njësive publike mbi rolin dhe rëndësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm janë kryer një sërë trajnimesh në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm. Asistenca teknike e ofruar dhe për ato institucione të cilat kanë shprehur interesin dhe kanë bashkëpunuar

për zbatimin e kërkesave të kontrollit të brendshëm, ka krijuar modele të mira të cilat mund të përdoren si shembull edhe për njësitë e tjera publike.

Raporti Vjetor mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme është përgatitur në bazë të raporteve individuale vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme mbi përshtatshmërinë dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm gjatë vitit 2019.

Konkretisht, zhvillimet kryesore në fushën e kontrollit të brendshëm për vitin 2019, paraqiten si më poshtë:

Nga analiza e 139 pyetësorëve të vetëvlerësimit të njësive të sektorit publik, rezulton se në përgjithësi, institucionet kanë pasqyruar një informacion të plotë, gjithëpërfshirës në lidhje me statusin e implementimit si dhe të arsyetuar me evidenca mbështetëse konkrete, duke evidentuar një rritje të ndërgjegjësimit të institucioneve përsa i përket plotësimit me cilësi të këtij pyetësori.

Në vitin 2019, janë trajnuar 149 persona, nëpërmjet trajnimeve të zhvilluara në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike në kuadër të rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të administratës publike, mbi rolin dhe rëndësinë e zbatimit të instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm.

Bazuar në pyetësorët e vetëvlerësimit, ka një përmirësim për sa i përket raportimit në lidhje me funksionimin e linjave të raportimit si dhe është kuptuar më mirë roli i drejtuesve të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve mbi diskutimin e çështjeve thelbësore referuar sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të marra në analizë, vetëm 110 prej tyre e kanë paraqitur planin e veprimit për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit pranë DH/MFKK-së. Krahasuar me vitin e kaluar, ka një rënie në numrin e njësive që e kanë dorëzuar këtë dokument, kryesisht e shkaktuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat për shkak të zgjedhjeve lokale ka pasur ndryshime të mëdha strukturore dhe menaxheriale.

Pavarësisht se shumica e institucioneve e hartojnë dhe konsolidojnë regjistrin e riskut, si element që kërkohet dhe auditohet si nga auditimi i brendshëm dhe Kontroli i Lartë i Shtetit, përsëri vihet re një mungesë e përfshirjes së këtij dokumenti në realizimin e aktiviteteve të përditshme të njësisë. Gjithashtu, në pjesën më të madhe të institucioneve ende nuk janë krijuar Grupet e Menaxhimit të Riskut si dhe ka një mungesë të pjesëmarrjes të të gjitha strukturave brenda njësisë publike në hartimin e regjistrit të konsoliduar të riskut apo dhe përdorimin e mëtejshëm të tij në realizimin e aktiviteteve të ndryshme apo proceset e vendimmarrjes në institucion.

Pavarësisht se një nga risqet financiare tipike në sektorin publik është risku i mashtrimit, nga përgjigjet e pyetësorëve, vihet re se, institucionet nuk kanë procedura specifike të brendshme të shkruara në lidhje me zbulimin e mashtrimit, duke u mbështetur vetëm në bazën rregullatore të sinjalizuesve, për të cilat evidentohet një nivel i ulët i zbatimit të këtyre procedurave dhe efektivitetit të tyre në institucion.

Nga analiza, rezulton se ende pjesa më e madhe e institucioneve kryejnë procedura delegimi sipas kërkesave të Kodit të Procedurave Administrative dhe jo delegim sipas kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndyshuar "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". Arsyet kryesore për mosimplementimin e procedurave të delegimit kryesisht konsistojnë në mungesën e informacionit të nevojshëm në këtë fushë dhe mungesën e besimit të menaxherëve për të ushtruar këtë të drejtë. Në këtë kuadër, në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, DH/MFKK ka hartuar udhëzimin për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, fokusi kryesor i të cilit qëndron në përcaktimin e qartë të termave, rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike.

Është hartuar dhe miratuar dokumenti strategjik kombëtar për ndërtimin e një sistemi kontabël të besueshëm në sektorin publik, në të cilin parashikohen aktivitetet dhe hapat e mëtëjshëm që do të ndërmerren për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS).

Në vijim, nga analiza e përgjithshme e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm konstatojmë se, sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2019 paraqitet pjesërisht efektiv, ku peshën kryesore në këtë rezultat e zënë mangësitë lidhur me raportimin në kohën e duhur të problematikave të sistemit të kontrollit të brendshëm. Këto problematika duhet të transmetohen nëpërmjet linjave të përcaktuara të raportimit tek palët përkatëse të brendshme dhe të jashtme, për t'i mundësuar njësisë publike vlerësimin e menjëhershëm të tyre. Në këtë kontekst, lind nevoja e ndërmarrjes së

masave efektive për ndërgjegjësimin e menaxherëve për vlerësimin e çështjeve të identifikuara përmes raportimeve dhe aktiviteteve të monitorimit.

Çështjet për adresim në të ardhmen lidhur me kontrollin e brendshëm janë si më poshtë vijon:

-Ndërgjegjësimi i menaxherëve përmes ofrimit të asistencës teknike e cila do të mundësojë shpërndarjen e informacionit në të gjitha strukturat e përfshira në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Forcimi i përgjegjshmërisë menaxheriale, nëpërmjet ndërthurjes së procesit të identifikimit dhe monitorimit të risqeve të njësive publike me procesin e delegimit të kompetencave.

-Hartimi i kurrikulave të trajnimeve të mirëfillta, për tematikat e veçanta lidhur me sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit nga njësitë publike, duke vënë në fokus nëpunësit autorizues, drejtuesit e programeve buxhetore si dhe nëpunësit zbatues të institucioneve.

-Krijimi i një rrjeti profesional me ekspertë të fushës së financave publike, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe përmirësimin e rregulloreve dhe procedurave standarde, ngelet ende një nga pikat, të cilat ka vend për përmirësim. Është e nevojshme të ketë më tepër kualifikime e seminare për njësitë publike me qëllim njohjen dhe kuptimin e legjislacionit në fuqi, mënyrën e analizës së menaxhimit të riskut, duke siguruar pjesëmarrjen në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, drejtuesve të njësive shpenzuese, nëpunësve autorizues dhe zbatues, si dhe koordinatorëve të riskut, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe eficencës së punës të njësive publike.

-Zbatimi me sukses i reformës së kontabilitetit të sektorit publik, nëpërmjet përmirësimit të bazës rregullatore në fushën e kontabilitetit të sektorit publik, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS).

-Miratimi i një dokumenti politikash mbi Zhvillimin e Mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri, për periudhën 2021-2022, i cili do të përcaktojë të gjitha prioritetet, objektivat, aktivitetet, arritjet, sfidat, treguesit e performancës dhe planet e veprimit të vendit tonë në fushën e kontrollit të brendshëm publik.

-Bazuar në raportimet dhe monitorimet e kryera nga stafi i DH/MFKK, konstatohet se institucionet e audituara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit karakterizohen nga një ndërgjegjësim më i lartë mbi implementimin e instrumentave të kontrollit të brendshëm.

Në lidhje me auditimin e brendshëm në sektorin publik, zhvillimi i sistemit është përqendruar në hartimin e metodologjive dhe ngritjen e kapaciteteve të auditimit të brendshëm, përfshirë krijimin e një sistemi monitorimi efikas dhe efektiv, rritjen e ekspertizës audituese dhe qasje sistematike në kontrollin e cilësisë së punës, krijimin e kushteve të përshtatshme për ruajtjen e pavarësisë dhe objektivitetit të veprimtarisë audituese.

Rritja e ndërgjegjësimit të strukturave menaxheriale të përfituesve të fondeve publike për kuptimin e duhur të funksionit të auditimit të brendshëm, në mënyrë që ta përdorin atë në mënyrë më efikase si mjet për menaxhimin mbetet një sfidë e përhershme.

Forcimi i rolit të auditimit të brendshëm mundëson një vlerësim efikas të sistemeve të menaxhimit financiar, të risqeve në lidhje me objektivat e vendosuara dhe përcaktimin e kontrolleve adekuate që ndikojnë në rritjen e sigurisë në miradministrim e fondeve publike. Ligji nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manuali Auditimit të Brendshëm, Kodi Etikës për Audituesit e Brendshëm dhe standardet e pranuara të auditimit, formojnë bazën mbi të cilën organizohet, funksionon dhe realizohet shërbimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Brenda konceptit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (të përcaktuar nga Komisioni Evropian), auditimi i brendshëm është krijuar dhe kërkohet të funksionojë si një shërbim i kryer nga një njësi e autorizuar, profesionale që ofron siguri objektive dhe këshillim për titullarin, me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e operacioneve të njësië publike dhe të ndihmojë në arritjen e objektivave përmes vlerësimit sistematik , të disiplinuar të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Në këtë raport është analizuar veprimtaria e auditimit të brendshëm, bazuar në konsolidimin e të dhënave të raporteve vjetore të veprimtarisë së 122 njësive të auditimit të brendshëm nga 129 që funksionojnë në sektorin publik. Ky raport analizon strukturat audituese, realizimin e planit të angazhimeve, vlerësimin e risqeve, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm, kufizimet me të cilat janë përballur audituesit dhe prioritetet për të ardhmen, bazuar në mënyrën e raportimit të përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Zhvillimet në Sistemin e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik gjatë vitit 2019 konsistojnë në disa tregues kryesorë që përfshijnë:

Shërbimi i auditimit të brendshëm ka gjetur zbatim në pjesën më të madhe të njësive të qeverisjes së përgjithshme nëpërmjet krijimit të 129 Njësi të Auditimit të Brendshëm, dhe vendosjes së 17 marrëveshjeve ndërinstitucionale apo kontraktimit të shërbimit.

Gjatë vitit 2019, janë angazhuar në kryerjen e shërbimin e auditimit, 428 auditues të brendshëm nga të cilët 95 drejtues te auditimit, të punësuar në njësi të qeverisjes së përgjithshme, qendrore dhe vetëqeverisjes vendore si dhe shoqëri aksionere te sektorit publik.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm është parashikuar në Planin Vjetor të Veprimtarisë së çdo Njësie të Auditimit të Brendshëm, në zbatim të të cilit, gjatë vitit 2019 janë realizuar 1210 angazhime kundrejt 1,187 të planifikuar, që përbëjnë rreth 2 % auditime më shumë se çka është planifikuar (102% realizimi). Nga këto angazhime 42 shërbime të këshillimit kanë synuar që auditimi i brendshëm të ofrojë opinione dhe asistencë për titullarin lidhur me sistemet apo projekte e iniciativa të reja për t'u ndërmarrë.

Nga auditimet e ushtruara janë dhënë 8314 rekomandime për përmirësim sistemi, ndryshime të kuadrit rregullator dhe masa organizative dhe të qeverisjes kundrejt 7910 rekomandimeve të dhëna në vitin e mëparshëm.

Rekomandimet e dhëna nga audituesit e brendshëm janë pranuar në nivelin 99,8% ndërkohë që zbatueshmëria e tyre nga subjektet e audituara gjatë vitit 2019 është arritur deri në 60% ose 3% më shumë se niveli i zbatimit të rekomandimeve të vitit 2018 (57 %), duke ruajtur një trend rritës, në përputhje me objektivat strategjikë të vendosur në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019 -2022 dhe Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2018 -2020.

Sistemet me risk më të lartë janë prokurimet publike, përfshirë blerjet dhe investimet, sistemi i tatim taksave, regjimi doganor, administrimi i pronës publike, legalizimet dhe privatizimet e pronës shtetërore, koncensionet, si dhe sisteme të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Efekti financiar negativ është identifikuar në masën 908 milionë lekë, në dëm të buxhetit të shtetit ku gjetjet në sistemin e prokurimit publik kanë shtrirjen më të madhe ndërmjet njësive të qeverisjes së përgjithshme.

Megjithë përmirësimet e vazhdueshme në funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, auditimi i brendshëm ka identifikuar dobësi të hallkave në zbatimin dhe operimin e subjekteve për të ndërtuar, mbajtur dhe përditësuar elementët e nevojshëm të tillë si: hartimi dhe mbajtja e regjistrit të riskut, zhvillimi i procedurave efektive dhe manualeve të punës, miratimi i gjurmës së auditimit për proceset kryesore, përditësimi i rregulloreve të brendshme deri në përcaktimin e përshkrimit të saktë të detyrave dhe përgjegjësive, mosefektiviteti i të cilave ka ndikuar dhe ndikon në përgjigjen e këtyre sistemeve në objektivat e kontrollit.

Audituesit e brendshëm kanë identifikuar mangësi në evidentimin e aktiveve dhe pasaktësi në hartimin e regjistrit të aktiveve, që përbën një faktor risku potencial në mirëadministrimin e suksesshëm të pronës publike.

Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore është përcaktuar si një nga faktorët kyç për realizimin e përgjegjësive dhe arritjen e objektivave të njësive publike. Rekomandimet e auditimit të brendshëm kanë adresuar përmirësimin e hallkave të sistemit që nga plotësimi i pozicioneve vakant të punës që do të siguronte mbështetjen me burimet e nevojshme po ashtu dhe ndarjen e përcaktimin e qartë të detyrave dhe vlerësim real i performancës së punonjësve.

Si një nga fushat e identifikuara me risk të lartë në zbatimin e buxhetit të shtetit, Njësitë e Auditimit të Brendshëm në 32 njësi të qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat 4 Ministri, 20

Bashki, 5 Spitale Rajonale dhe 3 shoqëri aksionare me kapital publik, kanë kryer auditimin e detyrimeve të prapambetura duke identifikuar shkakun dhe natyrën e krijimit të këtyre detyrimeve si dhe kanë adresuar rekomandimet përkatëse.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit për detyrimet financiare të pashlyera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, dhe në mënyrë të veçantë në njësitë e vetëqeverisjes vendore ka performuar me dobësi të theksuara, duke mos arritur të minimizojë risqet që lidhen me shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Dobësitë lidhen me identifikimin, regjistrimin, raportimin, ndjekjen dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, që e bën sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit për këtë fushë me risk të lartë, ku duhet të merren masa dhe veprime konkrete për vendosjen e procedurave shtesë për përmirësim.

Nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm janë identifikuar 3 raste të shkeljeve, të cilat në gjykimin profesional të audituesve janë dërguar për investigim të mëtejshëm.

Zhvillimi profesional i 338 audituesve të brendshëm të certifikuar në detyrë është realizuar nëpërmjet zbatimit të Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional për vitin 2019, miratuar nga Ministra e Financave dhe Ekonomise. Kjo ka mundësuar që 100% e audituesve të ndjekin 40 orë trajnimi (në klasë) temat e të cilave kanë synuar përditësimin dhe thellimin e njohurive të dijeve në çështje specifike të aplikimit të standardeve në praktikën audituese. Trajnimet kanë ofruar një bazë të gjerë dhe të qëndrueshme për të arritur ndryshime pozitive në qasjen e auditimit mbi bazë risku dhe adresimin e rasteve të korrupsionit dhe mashtrimit financiar.

Në përfundim të procesit të certifikimit për sezonin 2018 -2019 , fituan titullin "Auditues i Brendshëm në sektorin publik", të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 41 auditues të rinj në detyrë.

Komitetet e Auditimit të Brendshëm janë ngritur dhe kanë funksionuar në 9 Ministri, ndërkohë që Ministria e Brendshme dhe Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nuk e kanë krijuar ende këtë strukturë. Komitetet kanë raportuar tek Titullari dhe kanë adresuar rekomandime në drejtim të veprimtarisë së auditimit të brendshëm po ashtu dhe njësisë përkatëse. Titullarët e njësive publike dhe veçanërisht të njësive të vetëqeverisjes vendore kanë një nivel të ulët të ndërgjegjësimit dhe njohjes mbi rolin e Komiteteve të Auditimit.

Zhvillimet e shpejta të profesionit dhe ndryshimet në Standardet Ndërkombëtare kanë shtruar nevojën e zhvillimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të kuadrit metodologjik udhëheqës për auditimin e brendshëm. Gjatë vitit 2019 u punua për përshtatjen e kërkesave të standardeve me praktikën e punës audituese të cilat u reflektuan në ndryshimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Auditimi i brendshëm luan një rol të rëndësishëm në mirëqeverisjen e shëndetshme, dhe për këtë arsye nuk kërkohet vetëm kryerja e shërbimeve të sigurisë të ofruara nëpërmjet auditimeve të përputhshmërisë dhe auditimeve financiare, por edhe të shërbejë si partner strategjik dhe të shtojë vlerë në veprimtarinë e njësisë publike drejt përmirësimit të proceseve organizative dhe sigurimit të efektivitetit dhe efikasitetit të tyre.

Nën këtë këndvështrim, prioritetet për të ardhmen në fushën e auditimit të brendshëm do të përfshijnë:

Angazhimi i audituesve të brendshëm në vlerësimin e proceseve të vendimmarrjes, vendimeve strategjike dhe operacionale, mbikëqyrjen e menaxhimit të riskut, promovimin e etikës dhe vlerave të përshtatshme brenda organizatës, sigurimin e menaxhimit efektiv organizativ të performancës dhe llogaridhënies. Kjo do të përkthehej në rritjen e numrit dhe cilësisë së auditimeve të performancës.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të bazohet në vlerësimin e risqeve më të rëndësishme për planifikimin dhe zbatimin e projekteve dhe programeve për arritjen e objektivave strategjikë të njësive publike, duke mundësuar kryerjen me efektivitet dhe eficencë të auditimit. Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve për qasje e auditimit mbi bazë risku do t'i paraprijë

intensifikimit të trajnimeve të audituesve të brendshëm, për t'i bërë ata të aftë për zbatimin në praktikën e punës audituese.

Njësitë e auditimit të brendshëm duhet të monitorojnë në vazhdimësi nivelin e zbatimit dhe cilësinë e rekomandimeve të dhëna, me qëllim që realizimi i shërbimit të auditimit të konsiderohet si vlerë e shtuar nga titullarët e njësive publike dhe të gjithë grupet e interesit.

Në planifikimin e veprimtarisë, auditimi i brendshëm duhet të përfshijë të gjitha sistemet dhe fushat që lidhen me dobësitë sistemike dhe risqet e identifikuara nga vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në subjektet publike.

Auditimi i detyrimeve të prapambetura, si sistem me risk të lartë të përfshihet në planin vjetor të NJAB për të gjithë ato njësi shpenzuese që paraqiten me të tilla detyrime, mbështetur në një analizë të hollësishme të rrënjës. DH/AB të koordinojë e sigurojë bashkëpunim dhe komunikim me të gjithë këto institucione duke ofruar një qasje të unifikuar auditimi për të gjitha NJAB dhe auditimin e jashtëm.

Krijimi i një rrjeti efektiv të komunikimit me dhe ndërmjet njësive publike dhe monitorimi i vazhdueshëm për t'u siguruar që shërbimi i auditimit të brendshëm realizohet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor, Standardeve Ndërkombëtare të pranuara dhe praktikave të mira profesionale.

Realizimi i vlerësimeve të jashtme të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, për vlerësimin e përputhjes së kësaj veprimtarie me standardet ndërkombëtare të pranuara, si një mjet i rëndësishëm në identifikimin e mangësive dhe ndërmarrjen e iniciativave dhe veprimeve për ndryshim pozitiv dhe fuqizim të sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Forcimi dhe zhvillimi profesional i audituesve të brendshëm nëpërmjet programeve efektive te trajnimit dhe certifikimit, ku të ndërthuren përgjigjet efektive të nevojave individuale dhe institucionale për ndërtimin dhe rritjen e kapaciteteve audituese.

Programi i Zhvillimit Profesional të ofrojë siguri të arsyeshme që audituesit e brendshëm janë të kualifikuar për të ushtruar funksionin e audituesit me nivel të lartë të aftësive dhe kompetencave profesionale.

Zhvillimi i një kuadri ligjor dhe metodologjik adekuat, udhëheqës për auditimin e brendshëm, i mbështetur në një analizë e thellë të realizimit të veprimtarisë audituese duke siguruar përputhshmërinë me *acquis communaitaire,* kërkesat e standardeve dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian.

Bashkëpunimi me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për të sjellë në sistemin e auditimit të brendshëm eksperiencat më të mira dhe praktikat bashkëkohore të profesionit të vendeve më të zhvilluara anëtare të BE.

Krijimi dhe zyrtarizimi i rrjetit të drejtuesve dhe audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe vendosja e kanaleve efektive të komunikimit për të siguruar harmonizimin dhe lidhjen e ngushtë ndërmjet tyre, në funksion të shtrirjes dhe shkëmbimit të njohurive dhe ekspertizës profesionale.

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, duke ndarë mundësi dhe eksperienca të përbashkëta në fushën e zhvillimit profesional, metodologjive dhe qasjeve të auditimit.

Sa më sipër, vijimi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Kontrollin e Lartë të Shtetit, bazuar në marrëdhënie të ndërsjellta bashkëveprimi sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërinstitucional dhe nën drejtimin e Sekretariatit Teknik të Përbashkët, mbetet i rëndësishëm.

Në vija të përgjithshme, raporti përbëhet nga 5 kapituj kryesorë. Kapitulli i parë i raportit fokusohet në rezultatet nga vlerësimi i monitorimit të performancës së njësive publike. Në kapitullin e dytë trajtohet vlerësimi i sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në njësitë publike, bazuar në analizën e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së, sipas 17 parimeve të kontrollit të brendshëm. Kapitulli i tretë pasqyron gjetjet e evidentuara nga monitorimi në vend i

zbatueshmërisë së standardeve të kontrollit të brendshëm. Ndërsa, në kapitullin 4 pasqyrohen aktivitetet e ndërmarra nga DH/KBFP, në kuadër të mbështetjes së njësive të qeverisjes së përgjithshme për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Analiza e detajuar e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe rezultatet e evidentuara nga analiza e pyetësorit të vetëvlerësimit të AB paraqiten në kapitullin pesë të këtij raporti. Në seksionin e anekseve, është pasqyruar dhe analiza e detajuar e performancës së njësive shpenzuese me buxhet të madh.

KAPITULLI I- VLERËSIMI I MONITORIMIT TË PERFORMANCËS SË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit ka realizuar analizimin e 18 treguesve të performancës, bazuar në Metododologjinë për Monitorimin e Performancës së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike, e cila është miratuar nëpërmjet Urdhrit nr. 117, datë 01.04.2019 "Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike".

Konkretisht, metodologjia përmban 18 tregues performance, të cilët klasifikohen si më poshtë vijon:

Tabela 1. Treguesit e Performancës dhe burimet e të dhënave sipas Drejtorive në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit	**Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit**	**Drejtoria e Harmonizimit të MFKK**	**Drejtoria e Harmonizimit të AB**
1. Realizimi i shpenzimeve buxhetore (në %)	1.Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit	1.Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara	1.Organizimi i NJAB-ve dhe kapacitetet e AB
2.Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik (në %)	2.Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)	2.Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm	2.Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të
3. Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura	3.Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit	3.Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik	3.Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve
4.Realizimi i shpenzimeve kapitale	4.Numri i urdhër prokurimeve të paautorizuara		4.Zbatimi i rekomandimeve të AB-së
5. Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit	5.Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës		
	6.Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi		

Bazuar në vlerësimet e treguesve të mësipërm nga drejtoritë përkatëse, është realizuar rankimi i ministrive të linjës, bashkive, institucioneve të pavarura dhe njësive shpenzuese me buxhet të madh për vitin 2019, duke krahasuar performancën e tyre me vitin 2018, si më poshtë vijon:

- Rankimi i Ministrive të Linjës

Tabela 2. Rankimi i Ministrive të Linjës sipas treguesve të performancës për vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018.

Rankimi	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2018(+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2019 (nga 72 pikë gjithsej)*
1	↑ (+2)	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	52
1	↑ (+6)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	52
2	↓ (-1)	Ministria e Brendshme	48
3	↓ (-2)	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	47
3	↑ (+1)	Ministria e Kulturës	47
3	↑ (+3)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	47
4	↑ (+1)	Ministria e Mbrojtjes	44
5	↓ (-3)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	43
5	↑ (+3)	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	43
6	(-)	Ministria e Drejtësisë	42
7	↓ (-1)	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	41

**Krahasimi me vitin 2018 është bërë bazuar vetëm në ndryshimin në rankim duke qënë se numri i treguesve të përformancës ka ndryshuar ndërmjet dy viteve.*

- Rankimi i njësive shpenzuese me buxhet të madh

Në vijim të procesit të rëndësishëm të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike si dhe në kuadër të rekomandimeve të vazhdueshme të organizmave ndërkombëtare, DH/MFKK ka zgjeruar gamën e institucioneve që plotësojnë pyetësorin e vetëvlerësimit të MFK-së, duke përfshirë një grup institucionesh varësie, me qëllim sigurimin e një pamje më të qartë të progresit. Për këtë arsye, edhe këtë vit, janë përzgjedhur 13 institucione publike bazuar në dy kritere:

Totali i buxhetit të miratuar të njësisë publike për vitin 2019 është të paktën sa 10% e totalit të buxhetit të grupit; dhe/ose

Totali i buxhetit të miratuar të njësisë publike për vitin 2019 është të paktën 1 miliard lekë.

Analiza e detajuar e treguesve të performancës për këto institucione paraqitet në Aneksin nr.1 të këtij raporti.

Tabela 3. Rankimi i njësive shpenzuese me buxhet të madh sipas treguesve të performancës për vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018*

Rankimi	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2018 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2019 (nga 72 pikë gjithsej)*
1	↑ (+8)	Autoriteti Kombëtar Ushqimit	59
2	↑ (+4)	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	54
3	↓ (-1)	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	53
3	↑ (+1)	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	53
3	↑ (+5)	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	53
4	↑ (+1)	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	51
5	↑ (+2)	Spitali Universitar i Traumës	49
5	↑ (+2)	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	49

6	↑ (+4)	Garda e Republikës*	48
7	↓ (-6)	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	47
8	(-)	Agjencia e Trajtimit të Pronave*	44
9	↓ (-6)	Autoriteti Rrugor Shqiptar	38
10	(-)	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve*	29

**Për vitin 2019, në krahasim me vitin 2018, nuk janë marrë në analizë institucioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për arsye të mungesës së të dhënave për disa tregues performance, duke qënë se këto institucione janë njësi të fondeve speciale dhe nuk kryejnë veprime të tjera financiare me degët e thesarit, përveç transfertave.*

- Rankimi i bashkive që kanë njësi auditimi në strukturë

Tabela 4. Rankimi i Bashkive kryesore qendër qarku, sipas treguesve të performancës për vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018

Rankimi	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2018 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2019 (68[13] nga 72 pikë gjithsej)*
1	↑ (+4)	Bashkia Fier	51
2	↑ (+4)	Bashkia Tiranë	48
3	↓ (-2)	Bashkia Shkodër	46
4	↑ (+4)	Bashkia Gjirokastër	42
5	↑ (+4)	Bashkia Vlorë	41
6	↓ (-2)	Bashkia Kukës	40
7	↓ (-5)	Bashkia Korçë	39
8	↓ (-1)	Bashkia Durrës	38
9	↓ (-6)	Bashkia Lezhë	37
10	↓ (-2)	Bashkia Berat	30
11	↓ (-5)	Bashkia Elbasan	28
12	↓ (-4)	Bashkia Dibër	17

Tabela 5. Rankimi i Bashkive të tjera që kanë njësi auditimi të brendshëm, sipas treguesve të performancës për vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018

Rankimi	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2018 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2019 (68 nga 72 pikë gjithsej)*
1	↑ (+4)	Bashkia Patos	52
2	↑ (+7)	Bashkia Bulqizë	47
3	↑ (+5)	Bashkia Finiq*	46
3	↑ (+7)	Bashkia Mirditë	46
4	↑ (+7)	Bashkia Kamëz	45
5	↓ (-4)	Bashkia Këlcyrë*	44
5	↓ (-2)	Bashkia Vau Dejës	44
6	(-)	Bashkia Përmet*	43
7	↓ (-5)	Bashkia Dropull	41

[13] Treguesi i performancës "Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit" nuk është vlerësuar për shkak të mungesës së të dhënave për këtë grup institucionesh

7	(+6)	Bashkia Maliq	41
8	(+8)	Bashkia Prrenjas	40
8	(+1)	Bashkia Sarandë	40
9	(+1)	Bashkia Librazhd	39
10	(+2)	Bashkia Mallakastër	38
10	(-3)	Bashkia Pustec*	38
11	(-5)	Bashkia Divjakë	37
11	(-5)	Bashkia Fushë Arrëz	37
11	(+2)	Bashkia Krujë	37
11	(-7)	Bashkia Lushnjë	37
11	(+2)	Bashkia Selenicë	37
11	(-1)	Bashkia Tepelenë	37
12	(-)	Bashkia Devoll	36
12	(-5)	Bashkia Memaliaj	36
13	(+2)	Bashkia Gramsh	34
13	(+6)	Bashkia Mat	34
13	(-3)	Bashkia Pogradec	34
14	(+5)	Bashkia Malësi e Madhe	33
15	(-5)	Bashkia Roskovec	33
16	(-3)	Bashkia Vorë	32
17	(-5)	Bashkia Cërrik	31
17	(-11)	Bashkia Tropojë	31
17	(-4)	Bashkia Ura Vajgurore	31
18	(-1)	Bashkia Kolonjë	30
18	(-17)	Bashkia Libohovë*	30
19	(-5)	Bashkia Peqin	29
19	(-)	Bashkia Poliçan	29
19	(-10)	Bashkia Shijak	29
20	(-5)	Bashkia Kavajë	28
21	(-3)	Bashkia Skrapar	27
22	(-13)	Bashkia Kuçove	26
22	(-3)	Bashkia Kurbin	26
23	(-5)	Bashkia Klos	25
24	(-)	Bashkia Rrogozhinë	24
25	(-11)	Bashkia Himarë	22

*Bashki që realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm me akt-marrëveshje me njësi auditimi të njësive të tjera publike

- Rankimi i bashkive që nuk kanë njësi auditimi në strukturë

Tabela 6. Rankimi i Bashkive që nuk kanë njësi auditimi të brendshëm, sipas treguesve të performancës për vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018

Rankimi	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2018 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2019 (52 pikë nga 72 pikë gjithsej)*

1	⬆ (+5)	Bashkia Delvinë	37
2	⬇ (-1)	Bashkia Has	36
3	⬇ (-1)	Bashkia Pukë	26
4	(-)	Bashkia Belsh	20
5	(-)	Bashkia Konispol	16

- Rankimi i institucioneve të pavarura dhe Grupit 87 në varësi të Kryeministrisë

Tabela 7. Rankimi i Institucioneve të Pavarura sipas treguesve të performancës për vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018

Rankimi për vitin 2019	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2018 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2019 (68 pikë nga 72 pikë gjithsej)*
1	⬆ (+8)	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*	60
2	⬆ (+3)	Shërbimi Informativ Shtetëror ≠	58
3	⬇ (-2)	Shkolla e Magjistraturës*	57
4	⬇ (-3)	Agjencia për Mbështetje për Shoqërinë Civile*	56
5	⬆ (+5)	Kontrolli i Lartë i Shtetit ≠	55
5	(-)	Radio Televizioni Shqiptar*	55
6	(-)	Instituti i Statistikave ≠	54
7	⬇ (-5)	Autoriteti i Konkurrencës*	52
8	⬇ (-5)	Qendra Kombëtare e Kinematografisë*	51
8	⬇ (-1)	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit*	51
8	⬆ (+5)	Këshilli i Lartë Gjyqësor ≠	51
9	⬇ (-1)	Prokuroria e Përgjithshme≠	49
10	⬆ (+3)	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ≠	48
11	⬆ (+6)	Komisionerët Publik	47
12	⬇ (-1)	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	45
13	⬇ (-6)	Kuvendi≠	43
13	⬆ (+3)	Avokati i Popullit	43
14	⬇ (-2)	Agjencia Telegrafike Shqiptare	42
15	⬇ (-3)	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	41
15	⬇ (-2)	Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi dokumentet ish-sigurimit*	41
16	(-)	Kolegji i Posaçëm i Apelimit	40
17	⬇ (-1)	Gjykata Kushtetuese	39
18	(-)	Kryeministria	37
19	⬇ (-2)	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	35
20	⬇ (-5)	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	34
20	⬇ (-3)	Komisioni i Prokurimit Publik	34
21	⬇ (-5)	Akademia e Shkencës	33
21	⬇ (-7)	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	33
22	⬇ (-3)	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	32
23	⬇ (-3)	Presidenca	30

24	(-)	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	28

*Institucione që realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm nëpërmjet një marrëveshje me një institucion tjetër
≠Institucionet që kanë Njësi Auditimi të Brendshëm

Institucionet, të cilat nuk e kanë realizuar shërbimin e auditimit të brendshëm as me marrëveshje dhe nuk kanë as njësi auditimi, janë vlerësuar me 0 pikë, pasi kemi të bëjmë më një detyrim ligjor.

Tabela 8. Rankimi i institucioneve të Grupit 87 në varësi të Kryeministrisë, sipas treguesve të performancës per vitin 2019 dhe krahasimi me vitin 2018

Rankimi për vitin 2019	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2018(+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2019(68 pikë nga 72 pikë gjithsej)*
1	(+1)	Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike *	60
2	(+6)	Autoriteti Shtetëror Gjeohapsinor (ASIG) *	58
3	(+4)	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore*	54
4	(-3)	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)≠	46
5	(-)	Drejtoria e Shërbimit Qeveritar ≠	45
6	(+3)	Agjencia Autonome e Audimit të Fondeve të Bashkimit Evropian	44
7	(-3)	Agjencia e Prokurimit Publik	41
7	(-)	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	41
8	(-5)	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	40
8	(-2)	Komiteti Shtetëror i Kulteve	40
9	(-1)	Agjencia Kombëtare për Diasporën^	38
9	(-2)	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	38
9	(-)	Avokatura e Shtetit	38
10	(-3)	Komiteti Shtetëror i Minoriteteve^	37
10	(-)	Inspektoriati Qendror	37
10	(-3)	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	37
10	(-)	Agjencia Kombëtare e Planifikim Territorit	37
11	(-)	Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit^	34
12	(-7)	Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkëqeverisje	33
13	(-3)	Departamenti i Administratës Publike	28

* Institucione që realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm nëpërmjet një marrëveshje me një institucion tjetër
≠Institucionet që kanë Njësi Auditimi të Brendshëm
^Institucione që nuk kanë investime për vitin 2019.

Një vështrim i përgjithshëm për treguesit kryesorë të analizuar për ministritë e linjës, bashkitë, institucionet e pavarura dhe Grupin 87 në varësi të Kryeministrisë paraqitet si vijon:

1.1 Analiza për treguesit e performancës:

1. Treguesi i parë i analizuar nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e faturave të dërguara në thesar për pagesë pas afatit kohor prej 30 ditësh kundrejt numrit total të faturave të dërguara për pagesë. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 1.9 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 47.6%), duke reflektuar një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin e kaluar. Pavarësisht situatës së prezantuar këtë vit, realizimi i këtij treguesi mbetet ende i ulët për të gjitha grupet e

institucioneve. Kryesisht, arsyet e mosdërgimit në kohë të faturave në thesar vijnë për shkak se furnitorët nuk paraqesin faturat në kohë në institucion, dokumentacioni mbështetës i dërguar nuk është i plotë ose i saktë si dhe ndodh që shpesh të ketë vonesa në lidhje me dërgimin e të dhënave bankare të furnitorit. Për këtë tregues, grupi i institucioneve që shfaq më shumë problematika janë njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët janë vlerësuar më pak se sa grupet e tjera, me vetëm 1.85 pikë.

2. "Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)" është një tjetër tregues i analizuar nga struktura përgjegjëse për thesarin. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar me 1.85 pikë (ose 46.2 %), që do të thotë se 46.2% e faturave të detyrimeve të prapambetura nuk janë kontabilizuar brenda afatit kohor prej 30 ditësh në SIFQ. Kryesisht, kjo problematikë vjen për shkak të mungesës së fondeve buxhetore nga ana e institucioneve, të cilat ndërmarrin angazhime përtej kapaciteteve të tyre ose për shkak të mosplanifikimit të duhur mujor të arkës.

3. Një tregues tjetër i analizuar është **"Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e kontratave të dërguara pranë degëve të thesarit pas tre ditëve nga data e nënshkrimit të tyre kundrejt numrit total të kontratave të dërguara në thesar. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 1.75 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 43.8%), duke reflektuar një situatë të përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar, e vlerësuar me 0.6 pikë për njësitë e marra në analizë. Të gjitha grupet e institucioneve paraqesin mangësi në këtë fushë, kryesisht ministritë e linjës, të cilat janë vlerësuar mesatarisht me 0.81 pikë, vlerësim më i lartë se viti 2018. Ndërkohë, arsyet për mosrealizimin e këtij treguesi vijnë kryesisht si pasojë e mungesës së disponibilitetit të personave, të cilët nënshkruajnë kontratën, duke shkaktuar vonesa në dërgimin e tyre. Gjithashtu, afati ditor prej 3 ditësh për dërgimin e kontratave në thesar është praktikisht i pamundur për t'u zbatuar nga institucionet, të cilat nënshkruajnë dhe menaxhojnë një numër shumë të madh kontratash.

4. Treguesi **"Numri i urdhër-prokurimeve të paautorizuara"** paraqet numrin e urdhër prokurimeve të paautorizuara kundrejt shumës totale të urdhër prokurimeve të dërguara për pagesë në thesar. Për vitin 2019, ky tregues paraqet një performancë të kënaqshme për të gjitha grupet e institucioneve, duke u vlerësuar me 2.95 pikë (ose 73.7%), pavarësisht se ka një përkeqësim të situatës në krahasim me vitin 2018. Institucionet më problematike paraqiten ministritë e linjës, ndërkohë që institucionet e pavarura karakterizohen nga një efektivitet i këtij treguesi prej 89.4 %. Ky rezultat për institucionet e pavarura evidenton faktin se pothuajse të gjitha këto njësi janë efiçiente dhe efektive në mbarëvajtjen e procesit të dërgimit të urdhër-prokurimeve të autorizuara në thesar. Të gjitha njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimeve Publike me autorizimin e Thesarit. Kryesisht, ato raste të cilat shfaqin problematika, vijnë për shkak të mungesës ose mospërputhjes së dokumentacionit mbështetës të tyre.

5. Një tjetër tregues i marrë në analizë nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës"**, i cili përcakton vlerën e avancimeve të kryera gjatë vitit nga njësitë shpenzuese kundrejt totalit të planit vjetor të arkës. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 3.63 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 90.6%), duke reflektuar për një situatë pozitive për këtë fushë për të gjitha institucionet e marra në analizë, veçanërisht për institucionet e pavarura, të cilat karakterizohen nga një efektivitet prej 98%. Problematikat në këtë tregues vijnë për shkak të situatave emergjente të paparashikuara të institucioneve si dhe mungesës së parashikimit të duhur të fluksit të mjeteve monetare, për shkak se njësitë nuk raportojnë në intervale kohore të shpeshta në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Në bazë të analizës së kryer, evidentohet nevoja e parashikimit mujor të fluksit të mjeteve monetare nga institucionet si dhe dërgimin e këtij informacioni pranë strukturave përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

6. Treguesi i fundit i marrë në analizë nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi",** i cili mat respektimin e afatit kohor, nënshkrimit, përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar në nivelin 3.7 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 92.6 %), duke reflektuar një situatë shumë pozitive në këtë fushë si dhe në të njëjtin nivel si dhe viti 2018. Gjatë vitit 2018, është miratuar Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i cili përcakton paraqitjen e pasqyrave financiare dhe afatet kohore ligjore për dorëzimin e pasqyrave financiare. Pavarësisht problematikave që kanë pasur institucionet në

përshtatjen me udhëzimin e ri për përgatitjen e pasqyrave financiare në vitin 2019, pjesa më e madhe e institucioneve i kanë paraqitur pasqyrat financiare në kohën e duhur dhe me formatin e duhur.

7. Treguesi i parë i analizuar nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore"**, i cili përcakton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet buxhetore gjatë vitit kundrejt planit të buxhetit të miratuar nga Kuvendi. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.23 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 55.8%), duke reflektuar një performancë mesataretë tij për njësitë e marra në analizë, duke evidentuar një ulje të performancës në krahasim me vitin 2018. Rezultati evidenton faktin, se pjesa më e madhe e njësive janë efiçiente dhe efektive në përdorimin e buxhetit dhe realizimin e shpenzimeve të planifikuara për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit. Ndërkohë që, rrsyet për mosrealizimin e këtij treguesi vijnë kryesisht si pasojë e mosrealizimit të shpenzimeve për paga, sigurime në rastet kur nuk plotësohet struktura organizative me punonjës, nga mosrealizimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime apo shpenzimeve për udhëtim e dieta për jashtë, apo nënzërave të tjerë të këtij grupi shpenzimesh. Në vijim, shtyrja e afateve të realizimit nga procesi i prokurimit, apo edhe nga vonesat në paraqitjen e dokumentacionit teknik e financiar për lëvrimin e fondeve janë faktorë të cilët ndikojnë në mosrealizimin e këtij treguesi. Për ato institucione në të cilat realizimi faktik i fondeve paraqitet me i lartë se sa plani fillestar i miratuar në Kuvend, arsyeja është se gjatë vitit këtyre institucioneve i janë shtuar fondet e planifikuara përkatësisht me Aktet Normative nr. 2 dhe nr. 11 të vitit 2019, si edhe me përdorimet nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit dhe nga Fondi i Rritjes se Pagave. Gjithashtu, vlen të theksojmë se edhe mbartja e grantit të papërdorur të arsimit universitar nga viti 2019, ka ndikuar në shtesën e planit për Minsitrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ne krahasim me planin fillestar.

8. Një tregues tjetër është **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik"**, i cili mat diferencën midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit faktik në fund të vitit për çdo grup të shpenzimeve buxhetore të ndara sipas klasifikimit ekonomik. Nga vlerësimi i kryer për këtë tregues, rezultati është 1.39 pikë ose 34.8%, duke paraqitur një nivel të ulët të performancës së njësive lidhur me këtë tregues, krahasuar dhe me vitin 2018. Njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqiten me vlerësimin më të ulët për këtë tregues me 0.38 pikë (ose 9 %), ku kryesisht evidentohet se llogaritë me treguesin më të ulët janë ato të investimeve dhe subvencioneve, i cili lidhet me afatet kohore që në shumë raste tejkalohen duke vështirësuar realizimin në kohë të këtyre shpenzimeve.

9. Treguesi **"Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura"** paraqet diferencën e stokut 12 – mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12 – mujor të vitit paraardhës. Për vitin 2019, ai është vlerësuar mesatarisht me 2.6 pikë (65 %), një vlerësim më i ulët në krahasim me vitin 2018. Në nivel të përgjithshëm stoku 12-mujor i detyrimeve të prapambetura për vitin 2019 është rritur me 33% krahasuar me stokun e detyrimeve të vitit paraardhës 2018. Specifikisht, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme rezultojnë me shkallën me të lartë të reduktimit të detyrimeve nga viti 2018 në vitin 2019. Ndërkohë që, disa ministri të tjera rezultojnë me një nivel më të lartë detyrimesh në vitin 2019 krahasuar me një vit më parë, ku rritjen më të lartë e ka pasur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Brendshme, të cilat janë vlerësuar me 1 pikë.

10. Treguesi **"Realizimi i shpenzimeve kapitale"** paraqet devijimin nga plani i realizimit i shpenzimeve kapitale në një vit kundrejt shpenzimeve kapitale totale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 0.65 pikë (16.3%), duke shfaqur një performancë jo të kënaqshme të njësive publike, duke qenë se paraqet një nivel të konsiderueshëm devijimi nga fondet e planifikuara. Ky tregues paraqitet në një nivel më të ulët dhe në krahasim me vitin 2018. Nga të gjitha grupet e njësive të qeverisjes së përgjithshme të marra në analizë, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë devijimin më të lartë, në krahasim me ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura. Për ato njësi, të cilat paraqesin një performancë shumë të ulët të realizimit të këtij treguesi, evidentohet se shkaqet kryesore janë të lidhura kryesisht me problematikat dhe vonesat që ndodhin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit.

11. "Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit" është një tregues tjetër i rëndësishëm, i cili paraqet shumën totale të shpenzimeve për projektet e investimeve në periudhën e vlerësimit (një ose disavjeçare) kundrejt shumës totale të planit shumëvjeçar të parashikuar për projektet. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk përfshihen në analizë për këtë tregues. Për periudhën analizuese, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 3 pikë (ose 73 %) të nivelit referues, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm në krahasim me vitin 2018, ku ka qënë i

vlerësuar me vetëm 1.5 pikë. Ky rezultat evidenton faktin se pothuajse të gjitha njësitë publike të marra në analizë kanë pasur përmirësime përsa i përket parashikimit të fondeve në fillim të vitit buxhetor, gjë e cila ka sjellë diferenca apo devijime më të ulëta të planeve buxhetore. Ndërkohë që, problematikat e këtij treguesi vijnë kryesisht nga rishikimi i buxhetit, i cili kryhet duke i kaluar fondet nga projektet me ecuri më të ulët në ato me ecuri më të lartë, ku ecuria e ulët mund të jetë rezultat edhe i planifikimit të gabuar dhe nuk janë mbajtur parasysh faktorët që mund të pengojnë ecurinë e projektit gjatë vitit.

Treguesi i parë i analizuar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollin dhe kontabilitetin është **"Hartimi me cilësi i planit të veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara**", i cili përcakton respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 1.83 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 45.8 %), duke reflektuar një performancë mesatare në këtë fushë për të gjitha grupet e institucioneve. Kryesisht, situata paraqitet më pozitive për institucionet e pavarura, për të cilat efektiviteti i këtij treguesi është 71 %. Plani i veprimit për MFK-në është një instrument i ri i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe për këtë arsye, shumë institucione kanë pasur vështirësi në kuptimin e rëndësisë dhe në plotësimin e tij. Pavarësisht informimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me institucionet në lidhje me objektivin dhe rëndësinë e planit të veprimit, vihet re një mungesë ndërgjegjësimi e tyre mbi mënyrën e marrjes së masave dhe ndjekjes së mëtejshme të zbatimit të tyre në lidhje me fushën e kontrollit të brendshëm. Kryesisht, për vitin 2019, problematikat më të mëdha në lidhje me dërgimin e këtij instrumenti e kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore, për shkak të zhvillimit të zgjedhjeve lokale dhe ndryshimeve të përgjithshme të stafit të tyre, të cilët kishin marrë informacion në lidhje me rëndësinë dhë mënyrën e përgatitjes së këtij instrumenti. Gjithashtu, një problematikë që vazhdon të ekzistojë nga analiza e tyre është vështirësia që kanë institucionet për të përcaktuar qartësisht dhe përfshirë në plan rekomandimet e lëna nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

12. Një tjetër tregues i analizuar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollin dhe kontabilitetin është **"Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm",** i cili përcakton përmbushjen e kritereve ligjore, cilësinë e raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si dhe gjithëpërfshirjen e informacionit mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike (nëpërmjet pyetësorëve të vetëvlerësimit). Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.84 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 71 %), duke reflektuar një performancë të mirë në këtë fushë për të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura. Pjesa më e madhe e institucioneve kanë respektuar afatin kohor të dërgimit të raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si dhe i kanë paraqitur ato në formatin e duhur. Gjithashtu, pyetësorët e vetëvlerësimit, në përgjithësi, kanë pasqyruar një informacion të plotë, gjithëpërfshirës në lidhje me statusin e implementimit si dhe të arsyetuar me evidenca mbështetëse konkrete, duke treguar për një ndërgjegjësim më të lartë të institucioneve në lidhje me mënyrën dhe rëndësinë e plotësimit të tij në kuadër të paraqitjes së situatës reale të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike. Ndërkohë, situata paraqitet më problematike në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku realizimi i këtij treguesi është në nivele më të ulta (2.3 pikë), çka evidenton një mungesë të ndërgjegjësimit për hartimin me cilësi të dokumentacionit përkatës dhe zbatimit me rigorozitet të kërkesave ligjore.

13. Treguesi i fundit i analizuar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollin dhe kontabilitetin është **"Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik",** i cili vlerëson se në çfarë mase dhe sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjshmërisë menaxheriale. Për këtë arsye, nga pyetësori i vetëvlerësimit, janë zgjedhur 28 pyetje, të cilat lidhen me fushën e përgjegjshmërisë menaxheriale. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.5 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 62.6%), duke reflektuar një performancë mesatare në këtë fushë, në të njëjtin nivel me vitin 2018 për të gjitha grupet e institucioneve. Në përgjithësi, institucionet kanë miratuar struktura organizative të përshtatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre. Kryesisht, institucionet theksojnë se objektivat e tyre i kanë të paraqitura në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe shumë pak prej tyre kanë një plan vjetor të konsoliduar të miratuar nga titullari i institucionit. Në lidhje me raportimin brenda institucionit ose me njësitë e varësisë vihet re se ka mungesë informacioni në lidhje me arritjen e objektivave apo analizimin e treguesve të performancës, duke realizuar kryesisht raportim mbi tregues financiarë ose buxhetorë. Gjithashtu, vihet re që institucionet nuk kanë një procedurë formale të shkruar përsa i përket mënyrës së raportimit si brenda dhe jashtë institucionit. Një ndër elementet thelbësorë përbërës të përgjegjshmërisë

menaxheriale është delegimi i detyrave. Delegimi i mundëson nivelit të lartë menaxherial angazhimin në detyra strategjike dhe më të rëndësishme në një periudhë të dhënë. Aktualisht, nga përgjigjet e pyetësorëve të vetëvlerësimit, rezulton se ende pjesa më e madhe e institucioneve kryejnë procedura delegimi sipas kërkesave të Kodit të Procedurave Administrative dhe jo delegim sipas kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndyshuar "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". Arsyet kryesore për mosimplementimin e procedurave të delegimit kryesisht konsistojnë në mungesën e informacionit të nevojshëm në këtë fushë dhe mungesën e besimit të menaxherëve për të ushtruar këtë të drejtë. Për këtë arsye, theksojmë se është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit të nivelit të lartë menaxherial për të përdorur delegimin si një instrument të rëndësishëm të realizimit me efektivitet të funksioneve të tyre, duke përcaktuar qartësisht dhe mënyrën e raportimit për detyrën e deleguar. Në këtë kuadër, në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, DH/MFKK ka hartuar dhe miratuar Udhëzimin nr .4, datë.29.01.2020 "Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", fokusi kryesor i të cilit është që të përcaktojë qartë termat, rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike.

KAPITULLI II- MENAXHIMI fINANCIAR DHE KONTROLLI

Menaxhimi financiar dhe kontrolli (MFK) është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre. Një sistem i shëndoshë i MFK-së përfshin veprimtarinë e përgjithshme dhe përshkon të gjithë strukturën organizative të njësisë publike. Megjithatë, thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë. Arsyeja është se, në këto fusha mund të shihen pasojat përfundimtare të veprimtarisë së njësisë. Kjo do të thotë që këto fusha tregojnë ndikimin e aktiviteteve të ndërmarra ose të atyre që nuk u arritën të merren, vendimeve të vëna në zbatim, projekteve e investimeve të kryera, etj.

Në këtë kuadër, elementë veçanërisht të rëndësishëm për MFK-në përfshijnë ato që lidhen me buxhetin (planifikimin dhe ekzekutimin), kontabilitetin, raportimin dhe prokurimin publik. Këto janë në të njëjtën kohë elementë kyç për përgjegjëshmërinë menaxheriale dhe menaxhimin e fondeve publike me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi.


Është e rëndësishme të theksohet se *MFK nuk mund të jetë çështje vetëm e* strukturës së financës, por përkundrazi përbën një pjesë integrale të përgjegjshmërisë menaxheriale në të gjitha nivelet e menaxhimit. Vlerësimi i sistemit të MFK-së, në njësitë publike, bazohet në pyetësorin e vetëvlerësimit dhe në raportet mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Pranë DH/MFKK janë depozituar 139 pyetësorë vetëvlerësimi nga 150 pyetësorë të shpërndarë në njësitë e sektorit publik. Nga kjo rezulton se rreth 93% e njësive kanë përmbushur kërkesat ligjore për plotësimin e pyetësorëve[14].

Në vazhdim, jepen të dhënat për numrin e subjekteve që kanë plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit:

Grafiku 1. Numri i NJQP-ve që kanë plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2019

[14] Për vitin 2019, 5 njësi të vetëqeverisjes vendore (Bashkia Dibër, Konispol, Kurbin, Himarë, Kuçovë, Këshilli i Qarkut Berat, Këshilli i Qarkut Fier, Këshilli i Qarkut Korçë, Këshilli i Qarkut Lezhë, Këshilli i Qarkut Elbasan, Këshilli i Qarkut Kukës dhe Këshillii Qarkut Durrës) nuk kanë përmbushur kërkesat e nenit 18, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin finsanciar dhe kontrollin", ku përcaktohet detyrimi i nëpunësit autorizues për depozitimin e deklaratës dhe raportit përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon.



2.1 Analiza e sistemit sipas 17 parimeve të MFK bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike

I. Mjedisi i Kontrollit

Parimi 1 - Njësia Publike demostron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i njësive publike në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga analizimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit, evidentojmë se mbi 90% e njësive demostrojnë një nivel të kënaqshëm (Efektivë dhe pjesërisht efektivë) përsa i përket implementimit të këtij parimi. Një nga elementët, i cili ndikon në efektivitetin e institucionit në lidhje me këtë parim është rregullorja e brendshme. Në përgjithësi, ky dokument nuk është i përditësuar dhe në përputhje me ndryshimet e fundit strukturore të institucioneve, duke rezultuar në paqartësi të ndarjes së përgjegjësive, linjave të raportimit, ndarje jo të saktë të detyrave si dhe mosrealizim të delegimeve konform rregullave të MFK-së. Përsa i përket kodit të etikës, pjesa më e madhe e institucioneve respektojnë rregullat e etikës, të cilat i kanë të integruara në rregulloren e brendshme, me përjashtim të institucioneve të pavarura, në të cilat vërehet një mungesë e përshirjes së këtij elementi në rregullore.

Gjithashtu, nga vlerësimi i përgjigjeve të pyetësorit vihet re se pjesa më e madhe e institucioneve ka mungesë të programeve individuale të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës, duke u bazuar vetëm në planin e punës që ofrohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Parimi 2 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Ashtu si dhe viti 2018, edhe për këtë vit, situata paraqitet pjesërisht efektive duke evidentuar se në pjesën më të madhe të institucioneve janë të pranishme mekanizmat bazë për mbikëqyrjen dhe raportimin.

Problematikë vazhdon të mbetet mungesa e raportimeve të rregullta periodike si dhe ndërmarrja e masave konkrete për adresimin e çështjeve në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm, gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion. Ndërkohë, raportimet përqëndrohen kryesisht në performancën financiare, si shpenzimet buxhetore apo në ecurinë e investimeve.

Në rastin e institucioneve që funksionojnë me borde, evidentohet që ky organ realizon funksionet e tij të përcaktuara në momentin e krijimit të tyre, dhe anëtarët e bordeve informohen mbi objektivat përkatëse të institucionit.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Për vitin 2019, ky parim vlerësohet pjesërisht efektiv, duke evidentuar një rezultat të njëjtë si dhe viti i kaluar. Të gjitha institucionet kanë të përcaktuara deklaratat e misionit si dhe objektivat e tyre strategjikë dhe operacionalë, pjesë e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, duke pasur gjithashtu një lidhje organike midis këtyre prioriteteve dhe objektivave të performancës. Në hartimin e këtij dokumenti janë të përfshirë të gjithë drejtuesit e programeve, të cilët analizojnë situatën dhe përcaktojnë, monitorojnë dhe raportojnë prioritetet dhe objektivat për t'u realizuar.

Vlen të theksojmë se problematikë vazhdon të mbetet zbatimi i procedurave të delegimit nga ana e menaxherëve të njësive publike. Mungesa e ndërgjegjësimit të institucioneve mbi konceptin e delegimit sipas ligjit të MFK-së dhe devijimi i rregullave të delegimit të dokumentuar, ndikon në veprimtarinë e përditshme të institucioneve. Gjithashtu, vihet re vazhdimi i mungesës së besimit nga ana e Nëpunësve autorizues/zbatues për delegimin e përgjegjësive tek vartësit funksionalë.

Parimi 4 -Njësia publike demostron angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

Nga njësitë publike të marra në analizë, rezulton se ky parim paraqitet pjesërisht efektiv, ku pjesa më e madhe e institucioneve të marra në analizë, kryejnë procesin e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve në përputhje me formatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës për nënpunësit civilë si dhe hartojnë përshkrimet e punës, në bazë të rregullave të vendosura nga Departamenti i Administratës Pulike.

Gjithashtu, politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin transparent, emërimin, trajnimin e vazhdueshëm, vlerësimin korrekt të performancës, avancimin në detyrë bazuar në rezultatet e performancës si dhe me veprimet disiplinore të punonjësve të institucioneve publike. Pjesa më e madhe e institucioneve nuk kanë politika të mirëfillta favorizuese për punonjësit e tyre.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, pothuajse të gjitha njësitë e marra në analizë nuk kanë hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Në lidhje me Komitetet e Auditimit, bazuar në përgjigjet e dhëna nga Ministritë e Linjës, ato janë ngritur dhe kanë organizuar mbledhje gjatë vitit 2019 në pjesën më të madhe prej tyre, pavarësisht se mbetet për t'u analizuar në vend aktiviteti dhe kontributi konkret i këtij Komiteti në përmirësimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Ky parim vlerësohet pjesërisht efektiv dhe rezulton se njësitë publike, kryesisht, kanë vetëm të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme, bazuar në funksionet dhe pozicionet e punës të secilit.

Një problematikë e vazhdueshme, e cila ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe mosfunksionimi i rregullt i Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS), në kuadër të diskutimit të çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara. Njësitë publike pohojnë se marrin pjesë në takimet e GMS të zhvilluara nga institucionet eprore, por në pak raste diskutohen zhvillimet lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kryesisht këto takime nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale.

II. Menaxhimi i Riskut

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Në lidhje me këtë parim, situata paraqitet efektive duke qënë se njësitë përgatisin Programin Buxhetor Afatmesëm, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Procesi i vendosjes së objektivave në të gjithë njësinë publike drejtohet nga titullari dhe u komunikohet të gjitha strukturave të njësisë në mënyrë elektronike ose me memo. Të gjitha njësitë publike (drejtoritë dhe departamentet) i zhvillojnë objektivat e tyre dhe i vendosin në linjë me objektivat e vendosur në nivelet më të larta të njësisë.

Të gjithë objektivat janë të shkruara dhe menaxherët e njësive publike duhet të sigurohen se punonjësit i kuptojnë objektivat dhe se si puna e tyre ndihmon në arritjen e këtyre objektivave.

Lidhja e qartë midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërben si një pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme.

Nga analiza e këtij parimi rezulton se institucionet pjesërisht kanë përcaktuar mekanizma të mirëorganizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut, efekt që pasqyrohet edhe në rezultatet e treguesve të performancës së buxhetit dhe thesarit duke shfaqur mangësi gjatë lidhjes dhe zbatimit të kontratave, parashikimit të likuiditeteve që çojnë në tejkalimin e planit mujor të arkës, moskontabilizimin në kohën e duhur të faturave të detyrimeve të prapambetura si edhe rritjen e nivelit të detyrimeve të prapambetura (33%).

Për më tepër, në pjesën më të madhe të institucioneve ende nuk janë krijuar Grupet e Menaxhimit të Riskut si dhe ka një mungesë të pjesëmarrjes të të gjitha strukturave brenda njësisë publike në hartimin e regjistrit të konsoliduar të riskut apo dhe përdorimin e mëtejshëm të tij në realizimin e aktiviteteve të ndryshme apo proceset e vendimmarrjes në institucion.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi është një element, ekzistenca e të cilit lidhet me kulturën organizative, integritetin apo personalitetin e punonjësve, efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion apo dhe kushteve të punës.

Në lidhje me këtë parim, evidentohet se pjesa më e madhe e njësive publike nuk vlerësojnë mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryejnë vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Në këtë mënyrë, rezulton se vlerësimi i riskut të mashtrimit nuk është pjesë integrale e procesit të menaxhimit të riskut, çka e bën këtë proces më pak efektiv. Në përgjithësi, nuk ka procedura specifike të vlerësimit të riskut të mashtrimit në institucione si dhe nuk merren masa konkrete ndaj tij, ndërkohë që baza ligjore në të cilën mbështeten institucionet në rastet e mashtrimit mbetet ligji i sinjalizuesve.

Për shkak të këtyre problematikave të evidentuara gjatë analizës së pyetësorëve, institucionet vlerësohen relativisht jo-efektive në lidhje me këtë parim.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga vlerësimi i këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare. Ashtu sikurse vitin e kaluar, situata paraqet një mungesë të mekanizmave për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që lidhen me ndryshimet e rëndësishme. Në përgjithësi, institucionet analizojnë shumë pak ose pjesërisht ndyshimet që ndodhin në sistemin e kontrollit të brendshëm për shkak të ndryshimeve strukturore apo menaxheriale., Ky rezultat, vjen kryesisht si pasojë e vështirësisë në identifikimin e shkaqeve potenciale, të cilët ndikojnë në arritjen ose jo të një objektivi si dhe vështirësisë në vlerësimin e probabilitetit të ndodhjes së këtyre shkaqeve, për të cilët duhet vlerësuar efekti i mundshëm në arritjen e objektivave dhe shkalla në të cilën mund të menaxhohet risku.

Problematikë tjetër e evidentuar në lidhje me këtë parim është mungesa e rregullave të shkruara në lidhje me procedurën që ndiqet për lëvizjet e stafit dhe mungesa e pasqyrimit të këtyre ndryshimeve si risqe në regjistrin e riskut të institucionit. Situata paraqitet problematike në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku efektiviteti në rënie për këtë grup institucionesh, vjen si pasojë e ndryshimeve të shpeshta të drejtuesëve të këtyre njësive të cilët kanë shfaqur luhatje të vazhdueshme të kulturës dhe qëndrimeve filozofike përsa i përket menaxhimit të ndryshimeve dhe zhvillimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Për rritjen e stabilitetit të strukturave dhe menaxhimin me efektivitet të risqeve të lidhura me to, ndryshimet strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Aktivitetet e Kontrollit

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm.

Nga analiza e kryer për vitin 2019, rezulton se, institucionet të cilat zbatojnë me efektivitet procesin e menaxhimit të riskut, duke identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore që pengojnë realizimin e objektivave, krijojnë dhe menaxhojnë me efektivitet aktivitete kontrolli të cilat eleminojnë apo reduktojnë në një nivel të pranueshëm risqet ndaj të cilave këto institucione janë të ekspozuara.

Kështu, evidentohet se pjesa më e madhe e njësive publike kanë implementuar aktivitetet e nevojshme të kontrollit për minizimin e risqeve në kuadër të përmbushjes së objektivave, menaxhimit dhe ruajtjes së aktiveve, përmirësimit të performancës financiare sidomos nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të procedurave dhe rregullave të prokurimit publik dhe angazhimeve të tjera financiare.

Pavarësisht angazhimit të njësive publike, në zbatimin e veprimtarive të duhura të kontrollit vërehen ende problematika për t'u adresuar, të cilat konsistojnë kryesisht në mungesën e hartimit me cilësi të hartave apo manualeve të proceseve të punës të cilat rezultojnë në mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Kjo problematikë, shfaqet kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura, të cilat duhet të konsiderojnë përcaktimin e aktiviteteve alternative të kontrollit për ndarjen e detyrave apo identifikimin e funksioneve të papajtueshme.

Për sa më sipër, ky parim vlerësohet pjesërisht efektiv.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrolli mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, pavarësisht përfitimeve që rrjedhin si pasojë e nivelit të lartë të saktësisë së operimit të këtyre sistemeve, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e software-it ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë që vijnë si rezultat i gabimeve apo keqpërdorimit. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Nga analiza e pyetësorëve për vitin 2019, rezulton se parimi është pjesërisht efektiv ku pjesa më e madhe e njësive publike ka vendosur procese për zgjedhjen, zhvillimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e teknologjisë së një njësie publike si dhe procedurat e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë kundrejt risqeve potenciale. Në përgjithësi, institucionet bazohen në rregullat e përgjithshme të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe nuk kanë procedura të brendshme specifike për këtë fushë.

Një nga elementët e rëndësishëm për mirëfunksionimin e sistemeve të teknologjisë së informaconit është edhe ndarja e detyrave, ku bazuar në përgjigjet e dhëna në pyetësorë, ato janë kryesisht të evidentuara në rregulloret e brendshme dhe përshkrimet e punës. Kjo ka sjellë një lehtësim të nivelit të riskut si dhe rritje të besueshmërisë së raportimit.

Në varësi të natyrës së veprimtarisë që kryejnë, disa prej njësive pohojnë se përdorin sisteme të teknologjisë së informacionit, të ndryshme nga ato fikse. Mund të përmendim sistemet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, atë të administratës tatimore dhe doganore, Bashkisë Tiranë dhe bashki të tjera të mëdha.

Edhe për këtë vit, problematika paraqiten në mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit, ku evidentohen mangësi në zbatimin e procedurave të rikuperimit si dhe në planet e rikuperimit në raste fatkeqësie, të cilat sjellin si pasojë ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të sistemit.

Ngjarje të tilla rrezikojnë humbjen e të dhënave të institucionit dhe cënimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Parimet e mëparshme mbi komponentin e menaxhimit të riskut shprehen se njësia publike duhet të zgjedhë dhe zhvillojë aktivitete kontrolli, përfshirë aktivitetet e kontrollit mbi teknologjinë, që kontribuojnë në minimizimin e risqeve për arritjen e objektivave në nivele të pranueshme. Megjithatë, ky parim sqaron që, edhe pse parimet e mëparshme janë të rëndësishme, objektivat e njësisë publike nuk do të përmbushen, vetëm në rast se janë të dokumentuara dhe zbatuara siç duhet si politika apo procedura. Këto politika, pasi të jenë zhvilluar, duhet të shpërndahen nga menaxherët përkatës në të gjithë njësinë publike. Politikat dhe procedurat, përveçse duhet të vlerësohen rregullisht, duhet të rishikohen edhe sa herë ekziston një nevojë specifike për modifikimin e tyre.

Nga anliza për vitin 2019, vlerësimi i këtij parimi rezulton pjesërisht efektiv, ku një pjesë e njësive të marra në analizë evidentojnë se përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme. Ashtu si në vlerësimin e vitit të kaluar, mangësitë e paraqitura ndikojnë në cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke reklamuar nevojën e menjëhershme për krijimin dhe zbatimin me përpikmëri të një dokumenti politikash dhe procedurash, kryerjen e vlerësimeve të rregullta të aktiviteteve të kontrollit me qëllim përditësimin dhe përmirësimin dhe e tyre sa herë është e nevojshme.

IV. Informimi dhe Komunikimi

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Rëndësia e informacionit për menaxhimin e një organizate nuk mund të mbivlerësohet. Informacioni përkatës mund të merret si nga kanalet e komunikimit brenda dhe jashtë njësisë publike dhe mund të ketë kërkesa të reja nga organet/strukturat rregullatore për raportimin financiar ose informacion për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm. Prandaj, menaxhimi duhet të bëjë përpjekje konkrete për të siguruar informacione mbi përgjegjësitë e tyre lidhur me kontrollin të brendshëm.

Në vijim të analizës së kryer, parimi rezulton pjesërisht efektiv ku një pjesë e madhe e njësive publike i kushtojnë rëndësinë e duhur përcjelljes së një informacioni cilësor dhe raportimit periodik të këtij informacioni. Ato kanë një sistem komunikimi dhe raportimi , si brenda dhe jashtë institucionit. Praktika e ndjekur rezulton e njëjtë me atë të vitit të kaluar, ku evidentohet se njësitë përgatisin për menaxhimin/drejtuesit, raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efiçencë dhe efektivitet, por nuk rezulton që të ketë një bazë rregullative që të përcaktojë llojet e raportimit dhe periodicitetin e tyre. Megjithatë, nga analiza e kryer evidentojmë se pjesa më e madhe e raporteve të përgatitura përmbajnë informacion kryesisht financiar siç janë raportet për monitorimin e buxhetit apo raportet për detyrimet financiare. Ndërkohë, vlen të theksohet, se ka një rritje të numrit të njësive publike që përgatisin raporte periodike mbi ecurinë dhe statusin e implementimit të objektivave të vendosura apo edhe çështjeve që lidhen me sistemet e kontrollit të brendshëm. Përjashtim bëjnë disa prej njësive të vetëqeverisjes vendore ku vërehen mangësi në formatet dhe cilësinë e raportimit, si pasojë e mungesës së angazhimit të menaxherëve mbi zhvillimin e kësaj fushe dhe ndryshimit të herëpashershëm të drejtuesve të njësisë, të cilët përcjellin kultura të ndryshme në mënyrën e organizimit të institucionit.

Edhe për sa i përket sistemeve të kontabilitetit, ashtu si vitin e kaluar njësitë përdorin kryesisht programe kompjuterike si Financa 5 apo Alpha, por nuk kanë një program të unifikuar si dhe nuk parashikojnë përmirësime të mëtejshme në sistemin e tyre të kontabilitetit. Më problematike në këtë aspekt janë konsideruar bashkitë, të cilat nuk kanë sisteme të mirëfillta, por përdorin programet e Excel për kontabilitetin dhe Alpha për magazinën. Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që t'i përgjigjet përmbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të njësisë publike. Gjithashtu, lind nevoja për përmirësimin e cilësisë së informacionit përmes një programi/procedure për menaxhimin e të dhënave dhe identifikimin, sigurimin dhe ruajtjen e informacionit dhe të dhënave financiare. Ndërkohë që, nga rezultatet e pyetësorëve të vetëvlerësimit, rregullat për marrjen, gjenerimin dhe përdorimin e informacionit përcaktohen vetëm në rregulloret e brendshme të njësive, të cilat shpeshherë nuk janë në harmoni me nevojat e njësisë.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Nuk është e mjaftueshme marrja e informacionit të kërkuar për objektivat dhe përgjegjësitë e menaxhimit/drejtuesve për kontrollin e brendshëm, Informacioni i disponuar duhet të komunikohet në mënyrën e duhur dhe të shpërndahet me personat e duhur. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë funksionimin optimal të sinjalizuesve, është i nevojshëm përdorimi i linjave të veçanta të raportimit.

Për vitin 2019, për sa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, pjesa më e madhe e njësive të marra në analizë, sqarojnë se parimet bazë dhe procedurat e komunikimit janë përcaktuar në dokumentin e rregullores së brendshme të institucionit. Ndërveprimi i brendshëm apo marrëdhënia me instituconin epror realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare, takimeve të grupit të menaxhimit strategjik apo në pak raste edhe nëpërmjet kërkimeve në faqen zyrtare.

Edhe për këtë vit, nuk paraqiten raste konkrete, ku gabime apo keqkuptime të komunikimeve ndërmjet institucioneve të kenë ndikuar në performancën e sistemeve të kontrollit të brendshëm të tyre.

Pavarësisht performancës së kënaqshme dhe vlerësimit relativisht pozitiv të efektivitetit të këtyre elementëve, me synimin kryesor përmirësimin e sistemeve të komunikimit të brendshëm por jo vetëm, ende mbeten për t'u adresuar çështje që lidhen me parashikimin e rasteve të transmetimit të informacioneve të pasakta dhe marrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e tyre si dhe zhvillimi i kanaleve alternative të komunikimit dhe raportimit mbi kontrollin e brendshëm.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm. Ky parim sanksionon të drejtën e palëve të jashtme të njësisë publike për përvetësimin e informacionit mbi zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe konsiderimin e informacioneve përmes burimeve të jashtme.

Nga vlerësimi i kryer, rezulton se, në përputhje me parimet dhe procedurat e sistemeve të komunikimit të brendshëm, edhe për komunikimin e jashtëm, pjesa më e madhe e njësive kanë përcaktuar rregullat bazë për zbatimin e këtij komunikimi në rregulloren e brendshme të institucionit. Pothuajse të gjitha njësitë publike hyjnë në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.

Pjesa më e madhe e njësive publike të analizuara pohojnë se zbatojnë procedurat për konsultimin publik në kuadër të transparencës lidhur me aktivitetet apo projektet dhe investimet, realizimi i të cilave ka impakt në shoqëri. Komunikimi i informacionit me palët e jashtme përkatëse, ndihmon njësitë publike në përfitimin e informacioneve në shkallë të gjerë dhe përmirësimin e procedurave të komunikimit të jashtëm duke rritur ndjeshëm efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

V. Monitorimi

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës, me qëllim mirëfunksionimin e tyre.

Procesi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit të menaxherëve për strukturat që ata drejtojnë, hartimit të deklaratave dhe raporteve mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm, monitorimeve në vend si dhe nëpërmjet shërbimit të auditimit të brendshëm ku ofrohet siguri e arsyeshme nëse sistemet e kontrollit të brendshëm funksionojnë në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm. Nga analiza e kryer, vlerësohet se një pjesë e madhe e njësive kanë përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre. Problematika evidentohen kryesisht në përcaktimin e detyrimit për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, ku pjesa me e madhe e institucioneve nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

Për vitin 2019, institucionet e marra në shqyrtim kanë plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit duke dhënë një vlerësim pjesërisht efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm që lidhen me këtë parim. Gjithashtu, në kuadër të përforcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike, me asistencën e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, institucionet kanë hartuar një plan veprimi për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ku janë përcaktuar disa masa/aktivitete me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara gjatë vlerësimeve të

vazhdueshme të këtij sistemi. Nga analiza e thelluar e çdo plani veprimi, kryesisht për ministritë e linjës, institucionet e pavarura dhe njësitë shpenzuese me buxhet të madh, në ndryshim nga viti i kaluar, evidentohet një përmirësim i cilësisë së përmbajtjes së këtij dokumenti, ku masat e parashikuara janë të fokusuara në ndërmarrjen e aktiviteteve për ngritjen e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm. Ndërkohë, situata paraqitet mjaft problematike në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku një numër i konsiderueshëm i tyre nuk kanë hartuar planin e veprimit për vitin 2020. Kjo situatë, vjen kryesisht si rrjedhojë e ndryshimit të stafit teknik të bashkive përkatëse dhe gjithashtu paraqet një nivel të ulët të përfshirjes së menaxherëve të nivelit të lartë në elementët që lidhen me krijimin e sistemeve të shëndosha të kontrollit të brendshëm dhe raportimin mbi ecurinë e planit të masave të ndërmarra.

Gjithashtu, shërbimi i auditimit të brendshëm realizon një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm, ku pjesa më e madhe e njësive janë audituar të paktën një herë lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij sistemi. Situata vijon e njëjtë për institucionet e pavarura, të cilat nuk kanë pjesë të strukturës së tyre organizative njësi auditimi dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre e realizojnë këtë shërbim nëpërmjet akt-marrëveshjeve me njësitë e auditimit të brendshëm të njësive të tjera publike. Kryesisht, për të gjitha njësitë publike të marra në analizë, në përfundim të misoneve të kryera të audtimit të brendshëm, gjetjet i bëhen të njohura titullarit dhe në bazë të tyre paraqitet plani i rekomandimeve për përmirësim. Mbetet ende problematikë, niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve, çka shpreh angazhimin minimal të menaxherëve në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Ky objektiv mund të arrihet përmes vlerësimit dhe raportimit të mangësive si dhe monitorimit në vazhdimësi të veprimeve korrigjuese.

Në bazë të analizës dhe vlerësimit të kryer, parimi rezulton pjesërisht efektiv, ku një pjesë e institucioneve pohojnë se menaxhimi identifikon mangësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe i bëhen të njohura titullarit apo nëpunësit autorizues, por në pyetësor nuk janë parashtruar evidencat mbështetëse. Gjithashtu, këto njësi publike mbajnë në konsideratë ndërmarrjen e masave për përmirësimin e sistemit por ende nuk janë të formalizuara plotësisht në planet e veprimit apo në një regjistër të evidentimit të mangësive dhe aktiviteteve për adresimin e tyre. Nga përgjigjet e dhëna rezulton se, në disa njësi procesi i vlerësimit dhe komunikimit të gjetjeve mbi ecurinë e sistemit të kontrollit të brendshëm kryhet vetëm nga njësia e auditimit të brendshëm duke anashkaluar angazhimin e çdo menaxheri apo ndërveprimin midis strukturave brenda njësisë.

2.2 Vlerësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të komponentëve të MFK të rishikuar për bashkitë e përzgjedhura për asistencë teknike nga Projketi i Financave Lokale

Gjatë vitti 2019, 18 njësi të vetëqeverisjes vendore u asistuan nga Projekti i Financave Lokale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Konkretisht, bashkitë e përfshira në këtë projekt janë Bashkia Berat, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Dibër, Bashkia Durrës, Bashkia Gramsh, Bashkia Lushnjë, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Korçë, Bashkia Pogradec, Bashkia Devoll, Bashkia Tropojë, Bashkia Shkodër, Bashkia Tiranë, Bashkia Kavajë, Bashkia Vlorë, Bashkia Sarandë, Bashkia Mirditë dhe Bashkia Përmet.

Me mbështetjen e Projektit të Financave Lokale, me qëllim përmirësimin e vlerëësimit dhe raportimit të ecurisë së sistemit të MFK, këto bashki janë asistuar për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe përmbushjen e detyrimit ligjor për vlerësimin e këtij sistemi për vitin 2019. Konkretisht, është mundësuar rishikimi dhe ndryshimi i pyetësorit të vetëvlerësimit, i cili është testuar paraprakist në këto bashki pilot. Pyetësori i rishikuar përbëhet nga 117 pyetje në total, krahasuar me pyetësorin me 99 pyetje të vetëvlerësimit. Ndryshimet konsistojnë në përmirësimin e pyetjeve ekzistuese, evidencave mbështetëse dhe shtimin e disa pyetjeve të reja, vlerësimi i të cilave mbështetet në treguesit e performancës së PEFA (Shpenzimet Publike dhe Përgjegjshmëria Financiare), si një mjet efektiv për vlerësimin e statusit të menaxhimit të financave publike.

Vlerësimi i këtij pyetësori të rishikuar për 18 bashkitë e përzgjedhura për asistencë nga Projekti i Financave Lokale, do të jetë një bazë për të vijuar më tej me ndryshimin në tërësi të pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, duke vlerësuar në këtë mënyrë mënyrën e përceptimit, përthithjes së pyetjeve të reja nga ana e institucioneve.

KAPITULLI III. Vlerësimi NË VEND I ZBATUESHMËRISË SË PARIMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

3.1 Monitorimi i njësive të qeverisjes së përgjithshme nga ana e DH/MFKK

Bazuar në nenin 25 dhe 26, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, DH/MFKK me qëllim realizimin e detyrave kryesore funksionale, ka zhvilluar monitorime në 17 njësi të qeverisjes së përgjithshme lidhur me zbatueshmërinë e instrumenteve të MFK-së gjatë vitit 2019, raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Raportit Vjetor të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe pyetësorit të rishikuar të vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së, duke përfshirë edhe zhvillimet e mundshme gjatë vitit 2019. Procesi i monitorimit synon verifikimin e besueshmërisë së informacioneve të përfshira në pyetësorët e rishikuar të vetëvlerësimit dhe inkurajimin e njësisë publike për të kryer një vetëvlerësim të hollësishëm dhe të besueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm. Procesi i realizimit të monitorimeve bazohet në metodologjinë e vizitave në terren, pjesë e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Për përzgjedhjen e institucioneve që u monitoruan, DH/MFKK, u mbështetet në rankimin e njësive publike (ministri linje, bashki, institucione të pavarura dhe grupi 87 në varësi të Kryeministrisë) mbi bazë performance, duke përzgjedhur përkatësisht 50% të njësive publike me performancë të ulët, 25% të njësive publike me performancë mesatare dhe 25% të njësive publike me performancë të lartë.

Në këtë proces përzgjedhjeje, është mbajtur në konsideratë fakti që, njësitë publike të monitoruara në vitet e kaluara të evitohen, me qëllim përzgjedhjen e atyre njësive të cilat nuk janë monitoruar më parë. Në këtë mënyrë, sigurohet një mbulim i plotë i vlerësimit në vend të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Konkretisht, gjatë vitit 2019 janë monitoruar 8 ministri linje, (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Kulturës) 2 institucione të pavarura (ish Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor/Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kryeministria) dhe 6 bashki (Vlorë, Tropojë, Krujë, Shijak, Pogradec, Devoll). Për këto institucione, rezultoi se rreth 80% e përgjigjeve të pyetësorëve të tyre janë të besueshme duke evidentuar gjetjet e mëposhtme:

1. Rregullat bazë për funksionimin e institucioneve janë përshkruar në dokumentin e Rregullores së Brendshme, por këto rregullore në përgjithësi kanë rezultuar të pa rishikuara me ndryshimet e fundit strukturore ose në fazë draftimi të pa miratuara ende nga titullari i institucionit;
2. Janë hartuar planet vjetore të punës, me objektiva dhe aktivitete të specifikuara;
3. Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike;
4. Regjistrat e Risqeve janë përgatitur nga çdo drejtori dhe janë miratuar. Por në disa institucione të vetëqeverisjes vendore rezultojnë edhe në fazë drafti të pa konkluduara në miratim;
5. Në pjesën më të madhe nuk janë ndërtuar Strategji për Menaxhimin e Riskut;
6. Janë hartuar planet e trajnimeve;
7. Delegimi i funksioneve realizohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Përdoret shumë rrallë delegimi sipas kërkesave të ligjit të MFK-së;
8. Grupet e Menaxhimit Strategjik janë ngritur me urdhër të brendshëm të titullarit, i shoqëruar me plan veprimi, por në këto grupe nuk ka evidencë që të jenë diskutuar çështje të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
9. Në pjesën më të madhe të institucioneve nuk janë ndërtuar hartat dhe manualet e proceseve të punes sipas formateve të përcaktuara në manualin e MFK-së;
10. Nuk janë ndërtuar Gjurmët e Auditimit për proceset kryesore të punës;
11. Institucionet ndjekin rregullat ligjore në fuqi për etikën;
12. Respektohen procedurat ligjore të rekrutimit;
13. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike";
14. Komunikimi i informacionit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe nëpërmjet emaileve.

Rekomandimet kryesore adresuar institucioneve në lidhje me këto gjetje, janë si më poshtë vijojn:

1. Finalizimi me miratim i Rregulloreve të Brendshme të institucioneve dhe rishikimi i rregulloreve të cilat nuk janë përshtatur me ndryshimet strukturore të institucionit;
2. Trajtimi gjatë takimeve të GMS, të problematikave që lidhen me MFK-në dhe ndërmarrja e masave të nevojshme për përmirësimin e sistemit, duke i evidentuar këto takime në bazë dokumentare;

3. Të rishikohet regjistri i riskut për ndryshimet në vijimësi;

4. Të hartohen dhe miratohen strategjitë e riskut;

5. Të ndërtohen hartat e proceseve të punës;

6. Hartimi dhe miratimi i manualeve të proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK;

7. Të ndërtohen gjurmët e auditimit për proceset kryesore të punës;

8. Të hartohen baza rregullative në lidhje me raportet e përhershme, standarde që duhet ti raportohen drejtuesit si dhe menaxherëve të tjerë të strukturave të institucionit. Kjo bazë rregullative duhet të përmbajë formatet, mënyrën e raportimit, periodicitetin e raportimit, treguesit e performancës, si dhe mënyrën se si informacioni duhet të shpërndahet në të gjitha nivelet e njësisë;

9. Të ndiqet zbatimi i planit të veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së dhe të raportohet në mënyrë periodike zbatimi i tij pranë Nëpunësit Autorizes (NA);

10. NA mund të monitorojë sistemin e kontrollit të brendshëm duke përdorur metodologjinë e monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 117, datë 01.04.2019.

Gjetjet e sipërcituara janë propozuar që të përfshihen në planet vjetore të veprimit të MFK-së për secilin nga institucionet e monitoruara.

KAPITULLI IV- MBËSHTETJA E MFE-së PËR ZHVILLIMIN E SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Ashtu si çdo vit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, analizon dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme performancën e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit në të gjithë sektorin publik për përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara të auditimit të brendshëm dhe kontrollit të brendshëm.

Analiza dhe vlerësimi realizohen nëpërmjet një komunikimi dhe bashkëpunimi të vazhdueshëm me NJAB e ministrive të linjës, institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe të pushtetit vendor nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, dhënies së mendimeve për ndryshimet e akteve ligjore, vlerësimit të jashtëm të cilësisë, si dhe nëpërmjet planeve strategjike dhe vjetore dhe raporteve vjetore të veprimtarisë së strukturave audituese në sektorin publik. Gjithashtu, ndërveprimi i vazhdueshëm ekziston edhe me menaxherët e tjerë të njësive publike, lidhur me vlerësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë në fushën e menxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përditësimeve në fushën e kontabilitetit.

4.1 Mbështetja e MFE-së për zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit

Objektivat e DH/MFKK-së gjatë vitit 2019 kanë konsistuar në:

Monitorimin e vazhdueshëm të sistemit të MFK-së për njësitë e qeverisjes së përgjithshme;

Zbatimin e sistemit efektiv të kontrollit të brendshëm dhe ndërtimi i instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike;

Rritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të administratës publike dhe nivelit drejtues të njësive publike mbi rolin dhe rëndësinë e sistemit të MFK-së;

Përmirësimi i bazës rregullative në fushën e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit;

Lehtësimin e zbatimit të procedurave në fushën e kontabilitetit nëpërmjet përmirësimit të bazës ligjore.

-Monitorimi i vazhdueshëm i sistemit të MFK-së

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit në përputhje me nenin 25 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, siguron monitorimin sistematik të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik me qëllim mbledhjen e informacionit për të përmirësuar metodologjinë dhe standardet e punës. Monitorimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit ndihmon në ofrimin e sigurimit se aktivitetet e kontrollit, së bashku me aktivitetet e tjera të planifikuara në njësitë publike, kryhen në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe rezultati përfundimtar është realizimi i një kontrolli të brendshëm efektiv.

Aktivitetet e monitorimit vlerësojnë dhe përmirësojnë hartimin, ekzekutimin dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm financiar. Gjithashtu, ky proces ka si synim verifikimin e besueshmërisë së informacioneve të përfshira në pyetësorët e vetëvlerësimit dhe inkurajimin e njësisë publike për të kryer një vetëvlerësim të hollësishëm dhe të besueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm. Në përfundim të këtij procesi, njësive të monitoruara, i'u dërgohet një raport i hollësishëm me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.Për vitin 2019, bazuar në planin operacional të punës, janë realizuar monitorime në 17 njësi publike (9 ministri linje, 6 bashki dhe 2 institucione të pavarura), me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatueshmërisë së kërkesave të ligjit të MFK-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe evidentimin e vërtetësisë së përmbajtjes së pyetësorëve të vetëvlerësimit të depozituara nga këto njësi. Ashtu si në vitin 2018, edhe në monitorimet e realizuara në institucionet publike, është vënë re mungesa e instrumentave të konsoliduar të MFK-së, mungesa e vlerësimeve periodike të sistemit të kontrollit të brendshëm nga menaxherët si dhe komunikimi i gjetjeve tek NA. Gjithashtu, në këto institucione është evidentuar edhe mungesa e një sistemi të konsoliduar për menaxhimin e riskut.

Zbatimi i sistemit efektiv të kontrollit të brendshëm bazuar në asistencën teknike të ofruar nga DH/MFKK

DH/MFKK në kuadër të implementimit të një sistemi modern të MFK-së, ka ofruar asistencë teknike për hartimin e manualeve të proceseve të punës për MFE dhe njësitë e varësisë së MFE, ku u realizua hartimi dhe konsolidimi i proceseve kryesore të punës në MFE në një instrument të unifikuar kontrolli sipas përcaktimeve dhe përshkrimeve në Manualin e MFK.

Rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të administratës publike dhe nivelit drejtues të njësive publike mbi rolin dhe rëndësinë e sistemit të MFK-së

Në funksion të detyrave kryesore të drejtorisë si dhe adresimit të rekomandimeve kryesore të organizmave ndërkombëtare mbi zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike, për zbatimin me efektivitet të sistemeve të kontrollit të brendshëm, gjatë vitit 2019, janë realizuar 4 seanca trajnimi me qëllim ofrimin e asistencës mbi mënyrën e plotësimit të pyetësorit të rishikuar të vetëvlerësimitsi edhe të dokumentave të tjerë shoqërues të cilët duhet të depozitohen pranë MFE (130 pjesëmarrës).

a) Trajnime të organizuara në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)

Në kuadër të realizimit me sukses të objektivave të përcaktuar në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike mbi rëndësinë e zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale, DH/MFKK në bashkëpunim me ASPA-n, realizoi 8 seanca 1-ditore trajnimi, ku morën pjesë 149 pjesëmarrës dhe konsistonin në rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm.

b) Takime me titullarët e institucioneve publike përgjatë monitorimeve mbi vlerësimin e performancës

Gjatë vitit 2019, drejtuesit e DPH/KBFP realizuan takime ndërgjegjësuese me menaxherët e nivelit të lartë të disa prej ministrive të linjës, bashkive dhe institucioneve të pavarura mbi vlerësimin e performancës së këtyre institucioneve për vitin 2018. Kjo, për shkak se roli i menaxherëve konsiderohet thelbësor në efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Bazuar në treguesit e performancës të vlerësuara sipas metodologjisë së monitorimit, nëpërmjet kësaj praktike evidentohen gjetjet kryesore lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm, të cilat së bashku me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm u komunikohen menaxherëve të nivelit të lartë të institucioneve të sektorit publik.

c) Trajnime në disa institucone të qeverisjes së përgjithshme lidhur me implementimin e instrumentave të MFK-së, bazuar në kërkesat e tyre për asistencë

DH/MFKK, ndër të tjera, menaxhon kërkesat e institucioneve për ofrimin e trajnimeve me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e performancës referuar fushës së menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjithashtu, në muajin Korrik është realizuar trajnimi në Kolegjin e Posaçëm të

Apelimit, ku morrën pjesë rreth 12 pjesëmarrës. Gjithashtu, është bërë i mundur menaxhimi i kërkesës për trajnim i stafit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të trajnuar pranë ASPA.

Përmirësimi i bazës rregullative në fushën e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar përmirësimet ligjore dhe rregullative si më poshtë vijon:

-Miratimi i urdhrit nr. 117, datë 01.04.2019 "Për miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Performancës së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike", i cili përmirësoi metodologjinë ekzistuese të monitorimit të performancës me qëllim analizimin, vlerësimin dhe monitorimin me detaje të sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike mbi bazë performance, si dhe për të adresuar problematikat gjatë zbatimit të saj;

-Pyetësori i rishikuar i vetëvlerësimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (Njësi të qeverisjes së përgjithshme dhe njësi vartësie) i kompozuar mbi bazën e 17 parimeve gjithëpërfshirëse që i përgjigjen respektivisht komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sipas standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm i cili mundësoi një vlerësim gjithëpërfshirës të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike;

-Rishikimi i Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 (shtylla e KB dhe Kontabilitetit në sektorin publik), ku janë përcaktuar objektivat strategjikë dhe produktet kryesore për implementimin e mëtejshëm të një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm;

-Urdhrat për shpalljen e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit (8 urdhra);

-VKM nr. 505, datë 17.07.2019 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit", e rregullon plotësimin e kërkesave të parashikuar në ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe përmirëson procesin e hartimit të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, duke rritur transparencën dhe shkallën e përfshirjes së palëve të tjera të interesit si dhe të përkthimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, duke përcaktuar qartë detyrat dhe kompetencat e Komitetit të Rishikimit dhe Koordinatorit të procesit.

-Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Veprimit për zhvillimin e kontabilitetit në sektorin publik në Shqipëri, i cili përcakton në mënyrë të detajuar aktivitetet që do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar të njësive të sektorit publik në vend;

-Hartimi i udhëzimit për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ku fokusi kryesor është përcaktimi i qartë i detyrave të cilat mund të delegohen apo jo si dhe rregullave, procedurave që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësive së qeverisjes së përgjithshme në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të MFK;

4.2 Lehtësimi i zbatimit të procedurave në fushën e kontabilitetit nëpërmjet përmirësimit të bazës ligjore

Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar për adoptimin gradual të një sistemi modern të kontabilitetit në sektorin publik, bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Cilësia e raportimit financiar varet në masë të madhe nga cilësia e standardeve të kontabilitetit mbi të cilat bazohet raportimi. Vendeve si Shqipëria, që synojnë përmirësimin e mjedisit të biznesit, rritjen e mundësive për të gjetur financim dhe thithjen e investimeve të huaja direkte, u nevojiten standarde të mira kombëtare të kontabilitetit që sigurojnë informacione financiare transparente dhe të sakta. Kontabiliteti në sektorin publik në Shqipëri, aktualisht mbahet mbi bazë monetare, ku të ardhurat njihen në momentin kur arkëtohen paratë, ndërsa shpenzimet në momentin që paratë paguhen. Por, gjithashtu ka disa elementë të kontabilitetit mbi bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në lidhje me kontabilizimin e aktiveve dhe detyrimeve, ku sipas të cilit transaksionet njihen në momentin që ato ndodhin dhe jo kur paratë janë arkëtuar apo paguar fizikisht.

Me qëllim zhvillimin e kontabilitetit në sektorin publik, si dhe adoptimin e sistemit të kontabilitetit mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Banka Botërore, nëpërmjet financimit nga Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet

Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) në zbatimin e reformës për zhvillimin e kontabilitetit në sektorin publik në Shqipëri, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, duke patur si synim kryesor përmirësimin e vendimmarrjes, përgjegjshmërisë, transparencës dhe performancës në sektorin publik.

Projekti ka për qëllim arritjen e dy objektivave të tij kryesorë:

Zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS); si dhe

Zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale në fushën e kontabilitetit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe për financierët e sektorit publik.

Përmirësimi i raportimit financiar në sektorin publik ndërton themelin për mirëfunksionimin e këtij sektori, si dhe ka ndikim thelbësor dhe pozitiv referuar interesave të publikut. Zhvillimi i kontabilitetit në sektorit publik si dhe adoptimi i kontabilitetit në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, ka një sërë përfitimesh për Shqipërinë. Ndër to mund të përmendim:

-Rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë për vendimet financiare të ndërmarra nga donatorët, qytetarët apo investitorët. Rritja e transparencës përfshin programe dhe praktika të menaxhimit operacional si kostoja e plotë e PPP-ve individuale, e cila do të mund të jetë e disponueshme publikisht. Gjithashtu, ndikon në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, ku palët do të jenë më të informuara mbi qëndrueshmërinë e financave publike si dhe burimet e kufizuara do të mund të përdoren më me efektivitet për të dhënë rezultatet më të mira për publikun.

-Posedimin e informacionit më të plotë, i cili ndihmon në procesin e vendimarrjes financiare. Informacioni i plotë dhe kuptimi më i mirë dhe i qartë i të gjitha aktiveve dhe detyrimeve ndihmon në realizimin e planifikimit efektiv financiar afatmesëm, rrjedhimisht edhe në përdorimin më efektiv të fondeve publike për të dhënë rezultate të përmirësuara për qytetarët.

-Disponimin e një inventari të plotë të aktiveve, i cili u lejon njësive ekonomike të vlerësojnë nëse këto të fundit përdoren në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomike për të ofruar shërbime publike. Nëse të gjitha njësitë publike brenda një juridiksioni ndjekin të njëjtën strukturë për mbajtjen e kontabilitetit, atëherë krijohen baza për krahasim dhe për identifikimin e praktikave më të mira, të cilat mund të adaptohen nga qeveri të ndryshme, si dhe me anë të të cilave minimizohen apo eliminohen humbjet e shkaktuara.

-Cilësia e kuadrit të raportimit të qeverisë është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e stabilitetit financiar të një vendi dhe atraktivitetit të tij për investime. Duke përdorur një mënyrë raportimi të njohur ndërkombëtarisht, pasqyrat financiare të qeverisë të bazuara në sistemin e kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, do të ndihmojnë në realizimin e vlerësimeve më të drejta dhe më të sakta të kredisë si dhe do të inkurajojnë investimet e huaja direkte.

Në kuadër të zbatimit të projektit për zhvillimin e kontabilitetit në sektorin publik në Shqipëri, gjatë vitit 2019 është ndërtuar infrastruktura e përshtatshme dhe e nevojshme për realizimin e një sërë aktivitetesh me qëllim përmbushjen e objektivave të projektit të ndërmarrë.

Si fillim, duhet të zhvillohet kuadri ligjor dhe rregullator i kontabilitetit në sektorin publik, që është parashikuar të realizohet nëpërmjet instalimit të software-it TRADOS, i cili tashmë posedohet nga strukturat përkatëse dhe është i domosdoshëm për përmbushjen në vazhdim të aktiviteteve të përkthimit dhe rishikimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik (IPSAS).

Së dyti, me qëllim përmbushjen e objektivave të projektit duhet të arrihet zbatimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në përputhje me standarded IPSAS. Ndërtimi dhe zhvillimi i aftësive profesionale të punonjësve është domosdoshmëri në mbarëvajtjen e këtij procesi. Për këtë arsye, parashikohet ndërtimi i një mekanizmi të qendrueshëm trajnimesh si dhe realizimi i këtyre trajnimeve referuar standardeve IPSAS për punonjësit jo vetëm për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por edhe për punonjësit e institucioneve të tjera buxhetore në Shqipëri.

Së fundmi, me qëllim realizimin e objektivave dhe aktiviteteve me efektivitet, do të merret edhe asistencë teknike nga ekspertët ndërkombëtarë të Bankës Botërore. Gjithashtu, do të ndërtohen kapacitetet teknike të nevojshme pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke marrë mbështetjen e duhur për udhëheqjen e reformës mbi zbatimin e IPSAS, bazuar në dokumentin strategjik të vendit për ndërtimin e një sistemi kontabël të besueshëm në sektorin publik.

KAPITULLI V- ZHVILLIMI I SISTEMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

5.1 Strukturat e Auditimit të Brendshëm

Gjatë vitit 2019, në sektorin publik kanë funksionuar 129 njësi të auditimit të brendshëm, të cilat kryejnë shërbimin e tyre në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ku vërehet një rritje e lehtë e numrit të NJAB-ve krahasuar me vitin e mëparshëm (2 më shumë se në vitin 2018). Struktura organike e miratuar për stafin auditues në Njësitë e Auditimit të Brendshëm ka parashikuar 478 audituesë të brendshëm por në fund të vitit 2019 evidentohen të punësuar vetëm 428 , duke krijuar një hendek prej 50 pozicione vakante çka mbart riskun që veprimtaria audituese të mos mbështetet me burimet e nevojshme, kapacitete profesionale njerëzore që do të mundësonin realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimit të auditimit.

Në strukturat e auditimit të brendshëm 344 audituesë të brendshëm në detyrë janë të certifikuar si "Audituesë të brendshëm në sektorin publik" ndërkohë 84 të tjerë[15] nuk e zotërojnë këtë certifikatë, dhe kanë detyrimin që të ndjekin procesin e certifikimit gjatë 2 viteve të para të punësimit.

Vërehet se, pjesa më e madhe e të punësuarve të pa certifikuar si audituesë të brendshëm i përkasin njësive të vetëqeverisjes vendore 44 punonjës, shoqërive aksionere 16 punonjës dhe pjesa tjetër ministrive të linjës 2 punonjës, në institucionet qendrore 6 punonjës, në institucionet e pavarura 6 punonjës, në universitetet 5 punonjës dhe qendrat spitalore 5 punonjës.

Konstatohet se kjo mangësi vjen si rezultat i disa faktorëve të tillë si vështirësi në gjetjen e punonjësve të kualifikuar në zonat urbane dhe rurale (rasti i bashkive) apo kuadër ligjor kompleks , siç është rasti i shoqërive aksionere publike, i cili lë shkak për keqinterpretime.

Tabela 9. Të dhëna për Audituesit e Brendshëm


Emërtimi	Struktura (numri)	Audituesë të brendshëm Plan/Fakt	Të certifikuar	Të pa certifikuar
Ministritë e Linjës	11	71/62	60	2
Inst. Qendrore	18	80/73	67	6
Universitete	7	24/20	15	5
Inst.të Pavarura	11	38/34	28	6
Qendrat Spitalore	15	24/22	17	5
Shoqëritë Aksionere	16	81/77	61	16
Bashki (49+1)	51	160/140	96	44
Shuma	129	478/428	344	84

Figura 1. Përbërja profesionale e Audituesve të Brendshëm

[15] Punësuar sipas pikës c te nenit 11 të Ligjit për Auditimin e Brendshëm 114/2015


Përbërja profesionale të stafit audituesgjatë vitit 2019 ka konsistuar në numrin më të madh të specialistëve nga fusha e ekonomisë :

- 353 audituesjanë ekonomistë,
- 58 juristë dhe
- 17 i përkasin disiplinave të tjera.



Nevoja për këtë profilizim të audituesve të brendshëm lidhet me fushat objekt i auditimit, të cilat në sektorin publik në disa raste kërkojnë specializim të veçantë[16]. Kjo vërehet në : NJAB e Ministrisë së Mbrojtjes që ka në përbërje oficer logjistike, NJAB e Ministrisë së Mjedisit që ka në përbërje inxhinier pyjesh, NJAB e Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor që në përbërje mjekë dhe farmacistë, NJAB në Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike që kanë në përbërje inxhinier elektrik, etj. Nga viti në vit, vihet re një trend në rritje e audituesve të brendshëm me profesion bazë në shkencat juridike, nga 50 juristë të punësuar në vitin 2018 në 60 juristë në vitin 2019.

Grafiku 2. Audituesit e Brendshëm sipas vjetërsisë në auditim



Larmishmëria e profesionistëve të përfshirë në strukturat audituese vlerësohet si një tregues pozitiv në orientimin e auditimit të brendshëm jo vetëm në operacione financiare dhe të përputhshmërisë por dhe në sisteme të tjera jo financiare.

Eksperienca në profesion është një kriter bazë për punësimin dhe zhvillimin në karierë të audituesve e diferencuar për drejtues të NJAB dhe audituestë brendshëm. Gjatë vitit raportues evidentohen që 199 auditues kanë eksperiencë pune në auditim ***deri në 5 vjet*** dhe 229 ***mbi 5 vjet punë si audituesi***.

5.1.1 Strukturat e auditimit të brendshëm në njësitë e vetëqeverisjes vendore

[16] Evidentuar në analizën e raporteve të KAB

Në njësitë e vetëqeverisjes vendore që realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë krijuar NJAB përfshihen 50 Bashki dhe 1 Drejtori e Përgjithshme e Tatim Taksave Vendore të Bashkisë Tiranë, ku janë të punësuar 140 audituesë të brendshëm kundrejt 160 të miratuar në strukturat organike përkatëse.

Ndërkohë njësitë e vetëqeverisjes vendore relativisht të vogla (Pustec, Përmet, Këlcyrë, Finiq, Poliçan[17] dhe Libohovë) e kanë realizuar shërbimin e auditimit me akt-marrëveshje me njësi auditimi të brendshëm të njësive të tjera publike[18].

Njësitë e vetëqeverisjes vendore (Belsh, Has, Pukë, Konispol, Delvinë) nuk realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm me asnjë nga format e përcaktuara në kuadrin rregullator edhe pse lidhur me këtë problem Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm ka adresuar shkresë[19] të Ministres së financave dhe Ekonomisë në tërheqje të vëmendjes të titullarëve përkatës për marrjen e masave që shërbimi i auditimit të brendshëm të realizohet në përputhje të plotë me kërkesat e kuadrit ligjor.

Niveli i ulët profesional dhe shtrirja e pamjaftueshme e shërbimit të auditimit të brendshëm në mbulimin e njësive të vetëqeverisjes vendore tregon së në këtë nivel qeverisje , ndërgjegjësimi dhe njohja e Kryetarëve të Bashkive mbi rolin, rëndësinë dhe përfitimet nga auditimi i brendshëm është mjaft i ulët dhe kërkon vëmendje të veçantë në strategjitë e së ardhmes.

5.2 Funksionimi i Komiteteve të Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm si organ i pavarur që monitoron dhe ofron këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike, në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm ,vlerësohet të jetë një mjet shumë efektiv në mbështetje të njësisë së auditimit të brendshëm për përmbushjen e përgjegjësive të saj, dhe garanci shtesë në ruajtjen e pavarësisë së auditimit.

Krijimi i Komiteteve të Auditimit, ka gjetur zbatim vetëm në nëntë Ministri ku përfshihen:

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë
-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
-Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
-Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimit Social
-Ministria e Drejtësisë
-Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
-Ministria e Kulturës
-Ministrinë e Mbrojtjes[20]
-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Vërehet që dy Ministri të linjës , Ministria e Brendshme dhe Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nuk e kanë krijuar. Për më tepër kjo mangësi është plotësisht evidente në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku në asnjërën prej tyre nuk është krijuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm edhe pse disa prej tyre si : Bashkisë Tiranë, Bashkisë Durrës, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Lezhë, Bashkisë Kavajë dhe Bashkisë Pogradec iu është referuar në mënyrë individuale nga Ministrja e Financave dhe Ekonomisë nëprmjet shkresës[21] zyrtare rëndësia dhe vlerat që sjell në mbështetje të mirëqeverisjes krijimi KAB.

Raportet e Komiteteve të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019 prezantojnë një pamje të përgjithshme mbi situatën dhe performancën e strukturave të auditimit, duke identifikuar gjetjet për dobësitë e sistemit dhe adresuar konkluzionet me rekomandimet përkatëse. Çështjet kryesore të trajtuara nga KAB përfshijnë sa vijon:

Vlerësohet se në disa raste NJAB funksionojnë jo në kapacitet të plotë me numër të reduktuar dhe kualifikime të pjesshme të audituesve, ku KAB ka evidentuar ekzistencën e riskut për

[17] Germa c, pika 1 , neni 10 e Ligjit të auditimit të brendshëm 2014/2015
[18] Germa ç, pika 1 , neni 10 e Ligjit të auditimit të brendshëm 2014/2015
19 Shkrese nr.3227, datë 25.02.2019 "Mbi realizimin e shërbimit të AB"dërguar në 7 Bashki
[20] KAB në MM është krijuar por që nga muaji Shtator 2019 nuk është riorganizuar akoma
[21] Shkresë nr.13893, datë 22.07.2019 "Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm"

moseficencë të funksionit të auditimit që mund të sjellë si rezultat mos arritjen e objektivave të vendosura, duke ndikuar në performancën e ulët të njësive publike ku operojnë. Për këtë KAB-të kanë rekomanduar sigurimin e burimeve të nevojshme për arritjen e një performance më të mirë në veprimtarinë audituese (MFE, M.Energjisë, M.Drejtësisë, M.Kulturës).

Për fusha specifike të përgjegjësisë së njësive publike është e nevojshme sigurimi i ekspertizës ose nëpërmjet punësimit të audituesve me profesione specifike (inxhinier, mjek, etj) ose angazhimi i specialistëve të fushës sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi. (M.Energjisë)

Megjithëse NJAB kanë plan strategjik dhe vjetor të miratuar, disa prej tyre (DPD, DPT) realizojnë angazhime auditimi me kërkesë të titullarëve (kthim përgjigje ankesash të qytetarëve), pa miratuar nga titullari ndryshimin e planit vjetor dhe në të njëjtën kohë nuk kanë njoftuar zyrtarisht në DH/AB. Rekomandohet që çdo ndryshim i argumentuar i planeve vjetore të miratohet.

Nga shqyrtimi i raporteve të auditimit të brendshëm vlerësohet se në rastet kur evidentohen gjetje me efekt financiar, nga NJAB nuk përcaktohen zyrtarët përgjegjës. Rekomandohet përcaktimi i saktë i afateve të zbatimit të rekomandimeve dhe personat përgjegjës, si dhe ky proces të monitorohet vazhdimisht.

Konstatohet se një pjesë e NJAB nuk kanë të miratuar Programin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ose janë në fazën e hartimit të këtij programi (DPD, DPT, Posta Shqiptare sha), duke mos vlerësuar si duhet veprimtarinë e grupeve të auditimit. Rekomandohet hartimi, miratimi dhe nëse është i nevojshëm përditësimi i treguesve për Programin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Vlerësohet se sistemi pagave dhe shpërblimit për audituesit e brendshëm nuk nxit dhe promovon zhvillimin profesional të tyre , por mund të behët shkak për cënimin e pavarësisë. Rekomandohet rishikimin e politikave të pagave të audituesve të brendshëm në sektorin publik, si dhe për disa funksione mbështetëse si psh paga e sekretarit në komitete.

Ka mangësi në planifikimin e auditimeve të teknologjisë së informacionit dhe auditimet e performancës. Në lidhje me këtë rekomandohet të trajnohen audituesit e brendshëm me përvojë në lidhje më këto auditime specifike dhe të planifikohen në vazhdimësi angazhimet e auditimit të sipërcituara, duke siguruar mbështetjen me ekspertizën e nevojshme sipas përcaktime që ofron kuadri ligjor në fuqi.

Puna në terren planifikohet dhe realizohet për një periudhë të pamjaftueshme e cila mund të ndikojë cilësinë e auditimit. Në lidhje me këtë rekomandohet që drejtuesi i NJAB –së të studiojë dhe përcaktojë në mënyrë të argumentuar normimin e punës audituese, duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë në planifikimin e burimeve : kohës, numrit dhe kompetencave të audituesve.

Në kuadrin e reformave të ndërmarra dhe procesit të integrimit evropian të vendit , kërkesa për auditimin e fondeve IPA vjen gjithnjë në rritje çka duhet të shoqërohet me intensifikimin e trajnimeve të posaçme në këtë fushë, brenda dhe jashtë vendit.

Mbajtja nën monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të rekomandimeve duhet të jetë në fokus të të gjitha NJAB-ve dhe rekomandohet gjetja e mekanizmave efektivë që do të sigurojnë një nivel të lartë të zbatueshmërisë në kohë të rekomandimeve të auditimit .

Komitetet e Auditimit të Brendshëm konkludojnë se veprimtaria audituese është në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator, por evidentohet se ka nevojë për përmirësim në fusha specifike për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse, për çdo NJAB nga Komiteti që mbështet veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

Titullarët e njësive publike duhet të mbështesin më shumë strukturat e auditimit të brendshëm.

Duke vlerësuar kontributin që KAB jep në mbështetjen dhe garantimin e realizimit të auditimit të brendshëm si funksion i pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin, krijimi i Komiteteve të Auditimit në njësitë e qeverisjes qëndrore dhe të vetëqeverisjes vendore konsiderohet si një domozdoshmëri për funksionimin e auditimit sipas standarteve dhe praktikave më të mira , në mënyrë të veçantë në njësitë publike që paraqiten me risk të lartë në Matricën e Riskut .

5.3 Analizë e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

5.3.1 Realizimi i Planit të Angazhimeve të Auditimit

NJAB-të kanë hartuar Planin Vjetor të Veprimtarisë Audituese dhe rishikuar Planin Strategjik për një periudhë afatmesme 3 vjeçare(1+2 vjet), ku janë përfshirë angazhime auditimi që lidhen me tërësinë e risqeve të subjektit publik , të reflektuara këto në matricën e riskut.

Për vitin 2019, universi auditimit përfshiu 1,187 angazhime auditimi të programuara (duke përfshirë ndryshimet e planeve, të miratuara, gjatë vitit),për tú kryer në sisteme dhe fusha, prioritarizimi i të cilave u mbështet në disa kritere si:


Vlerësimi i riskut dhe prioritarizimi i auditimeve në subjektet e vlerësuara me risk të lartë;

Marrja në konsideratë e sugjerimeve të titullarëve të njësive publike në fazën e hartimit të planit të auditimeve;


Vlerësimi i gjetjeve dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Gjatë këtij viti strukturat e auditimit të brendshëm kanë realizuar 1,210 angazhime auditimi kundrejt që e shprehur në përqindje përbën 102% të realizimit të Planit Vjetor.

Grafiku 3. Realizimi i auditimeve të planifikuara sipas llojit për vitin 2019



Grafiku 4. Auditime të realizuara sipas llojit për vitin 2019



Angazhimet e kryera përfaqësojnë lloje të ndryshme të auditimit dhe përfshijnë:

- 495 auditime të kombinuara
- 390 auditime përputhshmërie
- 115 auditime financiare
- 56 performance
- 9 auditime të TI

por dhe një numër i konsiderueshëm i auditimeve të pa planifikuara, ***103 me kërkesë të titullarëve të njësive publike***.

Këto të fundit, zëvendësojnë llojet e tjera të auditimeve të planifikuara, dhe janë faktorë të cilët shkaktojnë shmangie nga plani në llojin e auditimit , edhe pse numri i angazhimeve ruhet formalisht. Shkak për këtë janë faktorë të ndryshëm të tillë si: mos trajtimi i planeve paraprakisht me titullarët e njësive publike, ndërgjegjësimi i ulët i titullarëve ose në disa raste për shkak të

ndryshimit të shpeshtë të këtyre të fundit. Këtu ndikon dhe niveli profesional i drejtuesve të auditimit duke treguar për mangësi në vlerësimin e riskut që në fazën e planifikimit çka sjell që sisteme me risk potencial të lartë nuk adresohen dhe prioritarizohen në universin e auditimit. Po ashtu pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore dhe financiare të mbështetjes së auditimit të brendshëm , si dhe qarkullimi i shpeshtë i stafit audituesë janë faktorë të cilët rrisin riskun e realizimit efektiv të punës.

Grafiku 5. Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vite



Gjatë vitit janë kryer dhe 42 shërbime të këshillimit nga audtimi i brendshëm për titullarët e subjekteve publike, përgjithësisht kur është kërkuar hartimi i ligjeve, procedurave, apo projekte te reja, për të cilat audituesi ka dhënë mendimet por nuk është përfshirë në vendimmarrje. Shërbimet e këshillimit kërkojnë nivel të lartë të kapaciteteve profesionale të audituesve dhe njëkohësisht mbartin riskun e cëniit ët pavarësisë për shkak të konfliktit të interesave që mund të shkaktohet. Për këtë shkak audituesit e brendshëm duhet të mbajnë në konsideratë të tilla risqe kur angazhohen në shërbimet e sigurisë.

Të dhënat e planit të konsoliduar vjetor të njësive të auditimit të brendshëm janë analizuar me të dhënat e realizimit të auditimeve, evidentuar në raportet vjetore të veprimtarisë së NJAB. Vërehet se gjatë vitit ka një ndryshim të pranueshëm nga plani fillestar i miratuar, dhe mund të konsiderohet tregues pozitiv për një planifikim efektiv dhe cilësor, cka ka zvogëluar rastet e shmangieve nga plani.

Sidoqoftë ndonëse numri i angazhimeve të planifikuara është realizuar me sukses , 102%, mbetet problem shmangiet në llojin e auditimit. Nga analiza rezulton se në ndryshimin e realizimit të llojeve të auditimit nga llojet e përcaktuara në Planin Vjetor të miratuar kanë ndikuar disa faktorë si:

Ndryshimi i prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut, përgjatë vitit ushtrimor.

Ndërhyrja e titullarëve të njësive publike duke kërkuar auditime të rëndësisë së veçantë jashtë planeve (103 angazhime auditimi me kërkesë të titullarëve).

Planifikim të pabazuar në burimet reale të NJAB (planifikojnë numër të madh auditimesh dhe nuk arrijnë ti realizojnë), ku mund të përmendim: Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare 12/8, Spitali Rajonal Gjirokastër 10/3, Albgaz sha 11/8, Albkontrol 6/2, Bashkinë Roskovec 10/5, Bashkinë Memaliaj 8/0, Bashkinë Shkodër 14/8, etj.

Mungesa në kapacitete profesionale dhe aftësi të duhura për kryerjen e auditimeve sipas kërkesave të standardeve, e theksuar kjo sidomos në stafin pa eksperiencë, të pa trajnuar e të pa certifikuar për njohuritë që kërkon profesioni. (Bashkia Kuçovë, Bashkia Mat, Bashkia Roskovec, Bashkia Prrenjas, Bashkia Kurbin, Bashkia Cërrik, Bashkia Peqin, Bashkia Rrogozhinë, etj).

Planifikim "me rezerva" ku vihet re që NJAB-të kanë më shumë kapacitete në dispozicion duke planifikuar një numër të kufizuar auditimesh por në fakt realizojnë shumë më tepër cka tregon mungesë efektiviteti dhe shpërdorim të burimeve. (Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve 22/57, Instituti i Sig. Shoqërore 11/15, Shërbimi Kombëtar i Punësimit 16/34, KESH sha 8/22, Albpetrol sha 11/25, Posta Shqiptare sha 7/38, Drejtoria e Përgjithshme Tatim Taksave Vendore 9/40, Bashkia Mirditë 7/9, etj.).

Qarkullimi i shpeshtë i stafit audites, largimi i audituesve me eksperiencë dhe te kualifikuar dhe zëvendësimi i tyre me staf të ri , çka tregon për humbje të investimit që është bërë më parë në kapacitete. Ky fenomen bëhet më i theksuar në NJAB e pushtetit vendor dhe shoqërive aksionare.

Mangësitë e vërejtura në planifikimin e veprimtarisë audituese mbartin riskun që angazhimet e auditimit nuk sigurojnë që risqet kryesore janë adresuar dhe fushat apo sistemet me risk të lartë e të mësëm që kanë ndikim thelbësor në arritjen e objektivave të jenë mbuluar me auditim. Ato gjithashtu "falsin"për një eficencë të ulët në planifikimin e burimeve të faktorëve të cilët mund të ndikojnë në të gjitjhë cilësinë e procesit të auditimit si gjate punës në terren ashtu dhe në arritjen e objektivave të auditimit.

Dobësitë në planifikimin e veprimtarisë dhe ndryshimet e shpeshta gjatë vitit, bartin riskun që veprimtarisë audituese të mos realizohet në mënyrë sistematike dhe të disiplinuar , duke vazhduar të jetë e orientuar nga inspektimet financiare . Me qëllim që t'i përgjigjet zhvillimeve dhe ndryshimeve të ambientit ku operojnë , qasja auditimit me bazë risku duhet të aplikohet për të planifikuar angazhimet e auditimit, me qëllim që auditimet të fokusohen tek sistemet me risk më të lartë me qëllim që ti përgjigjen sa më mirë nevojave të subjektit , si në numër ashtu dhe sipas llojit të auditimit.

Gjatë procesit të konsolidimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB, Drejtoria e harmonizimit të Auditimit të brendshëm ka identifikuar në mënyrë individuale të metat dhe dobësitë e çdo NJAB dhe i ka adresuar për ndryshim dhe përmirësimet përkatëse.

5.4 Vlerësimi i Riskut të Sistemeve, Gjetjet dhe Rekomandimet e Auditimit

5.4.1Vlerësimi i sistemeve me risk

Në aplikimin e qasjeve se auditimit mbi bazë risku , si faktorë të riskut mbi të cilët NJAB-të kanë mbështetur përcaktimin e riskut për sistemet janë përzgjedhur në bazë të rëndësisë së sistemit, natyrës së veprimtarisë së subjektit të audituar, objektivave të auditimit si dhe në mendimin dhe opinionin e titullarit. Në vlerësimin e riskut faktorët që janë marrë në konsideratë nga audituesit përshijnë:

-Mos përcaktimi i saktë i objektivave të njësisë publike;

-Mos arritje e objektivave strategjikë të vendosura nga njësitë publike;

-Mosfunksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm;

-Ekspozimi ndaj parregullsive, etj.

-Lëvizjet e shpeshta të stafeve në strukturat menaxhuese.

Duke marrë parasysh që veprimatritë e NJAB janë ushtruar në ambiente me shkallë të ndryshme kompleksiteti, fusha të ndryshme të përgjegjësisë, nivele të ndryshme të kualifikimit të dhe kapaciteteve audituese etj. analiza e raporteve të NJAB për qëllime të këtij raporti është realizuar e ndarë në disa grupime/klasa si: ministri linje, njësi shpenzuese me buxhet të madh, institucionet e pavarura, shoqëritë aksionere dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në këtë analizë janë evidentuar sistemet e vlerësuara me risk të lartë nga ana e secilit grupim, gjetjet më kryesore sipas sistemeve dhe rekomandimet e adresuara për përmirësimin e problematikave të evidentuara.

Vlerësimi i riskut në Ministritë e Linjës

NJAB në ministritë e linjës në subjektet që nga veprimtaria audituese janë vlerësuar me risk të lartë kanë informuar titullarët për nivelin e riskut në fusha/sisteme të caktuara, në të cilat ka nevojë të ndërmerren veprime për përmirësim duke rekomanduar për të:

Përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm dhe përcaktimin e përgjegjësive;

Përcaktuar risqet dhe vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme ato për shkak të ndryshimit të objektivave, prioriteteve dhe strukturave organizative të njësive publike;

Menaxhuar risqet, me qëllim përballimin e efekteve, minimizimin dhe frenimin e tyre;

Rishikuar dhe shqyrtuar në mënyrë të vazhdueshme kontrollet respektive.

NJAB në ministritë e linjës kanë evidentuar me risk të lartë këto sisteme:

Sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve;

Sistemin e administrimit të aseteve;

Sistemin e koncesioneve, ankandeve dhe administrimit të pronës.

Vlerësimi i riskut në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

NJAB në njësitë e vetëqeverisjes vendore përveç risqeve të identifikuara gjatë hartimit të planit strategjik dhe vjetor, por edhe gjatë hartimit të planit të angazhimit analizojnë informacionet e marra në takimet me drejtuesit e subjekteve, për shqetësimet dhe problematikat e evidentuar referuar risqeve të evidentuara nga vetë ato. Nga të gjitha këto janë identifikuar me risk të lartë sistemet e mëposhtme:

Sistemi i kontrollit të brendshëm.

Sistemi i menaxhimit buxhetor

Sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore

Sistemi i prokurimeve

Sistemi i menaxhimit të aktiveve

Sistemi i kontabilitetit

Sistemi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura

Nga sa më sipër, u evidentuan sistemet e prokurimeve, detyrimeve të prapambetura dhe aseteve, të cilat vlerësohen me risk të lartë në veprimtarinë audituese të të gjitha grupimeve të analizuara.

Vlerësimi i riskut në Njësitë Shpenzuese me buxhet të madh

NJAB në grupin e njësive shpenzuese me buxhet të madh kanë identifikuar me risk të lartë këto sisteme:

Sistemin e menaxhimit e kontrollit financiar;

Sistemin e Teknologjisë së Informacionit;

Sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve;

Sistemin e administrimit të aseteve;

Sistemin e detyrimeve të prapambetura.

Vlerësimi i riskut në Shoqëritë Aksionere

NJAB në shoqëritë aksionere kanë identifikuar me risk të lartë këto sisteme:

Sistemin e programimit financiar dhe të ardhurave;

Sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe zbatimit të kontratave;

Sistemin e kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i riskut në Institucionet e Pavarura

NJAB në institucionet e pavaruara kanë identifikuar me risk të lartë këto sisteme:

Sistemin e investimeve publike;

Sistemin e mbikqyrjes së projekteve**.**

Vlerësimi i riskut të sistemeve, edhe pse është një element thelbësor mbi të cilin mbështetet çdo fazë e procesit auditues dhe ka impakt të rëndësishëm në arritjen e objektivave të auditimit, nuk bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve, nuk kuptohet nga vetë audituesit dhe si i tillë gjen zbatim në nivel të ulët në praktikë. Kjo tregon mangësi në udhëzuesit dhe metodologjitë për qasjen e auditivit mbi bazë risku dhe kompetencat dhe aftësitë e audituesve janë të pamjaftueshme për të siguruar kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë dhe efektivitet.

5.5 Gjetjet e Auditimit të Brendshëm

Audituesit e brendshëm gjatë realizimit të veprimtarisë së tyre kanë evidentuar problematika të ndryshme në të gjitha sistemet e kontrollit të brendshëm, për të cilat kanë dhënë opinionet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit të

riskut, kontrollit dhe qeverisjes, me qëllim që objektivat të arrihen dhe fondet publike të përdorën për qëllimin që ato janë buxhetuar me ekonomi, eficensë dhe efektivitet.

Gjatë kësaj periudhe gjetjet kryesore kanë të bëjnë kryesisht me dobësi të sistemit të prokurimeve, blerjeve dhe investimeve, sistemit të administrimit të asteteve, sistemit të administrimit të pronës dhe pasurisë shtetërore, sistemi i tatimeve, taksa dhe dogana, si dhe sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit. etj.

Si rezultat i auditimeve të ushtruara gjatë vitit 2019 janë identifikuar shkelje të disiplinës financiare të cilat kanë shkaktuar efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit prej 908 milion Lekë në sisteme të ndryshme si: prokurimi publik, paga dhe shpërblime, tatime dhe taksa, koncesione dhe administrimin e pronës shtetërore.

Tabela 10. Gjetjet me efekt financiar negativ sipas sistemeve për vitin 2019

Nr.	**Gjetjet me efekt financiar negativ sipas sistemit**	**Dëmi ekonomik (000/lekë)**
1	Prokurim, blerje dhe investime	191,766.2
2	Paga, shpërblime, trajtime, komisione	102,258.7
3	Fondet e sig. shoq dhe shëndetësore	9,661.8
4	Tatime, taksa dhe dogana	260,323
5	Admin. prone dhe pasurie	9,615.6
6	Privatizime, shitje dhe qeradhënie	55,183
7	Koncesione dhe ankande	90,039
8	Legalizime, Urbanistikë, kth. Pronash	2,950
9	Kreditim, suvencione	4,645
10	Të tjera	181,581
	TOTALI	908,022,68


Për vlerën e dëmit të shkaktuar është kërkuar rikuperimi i shumës dhe ndjekja e arkëtimit deri në zhdëmtimin e plotë. Krahas, janë dhënë rekomandime për forcimin e kontrolleve dhe procedurave me qëllim parandalimin e përsëritjes të këtyre rasteve në të ardhmen.
Gjatë këtij viti janë evidentuar nga audituesit e brendshëm 3 raste për investigim të mëtejshëm nga njësi të specializuara. Këto janë trajtuar nga: 1 rast Ministria e Brendshme, 1 rast Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe 1 rast Bashkia Kukës.



Krahas keqfunksionimit apo ineficencës së procedurave dhe kontrolleve, dobësitë në sistem janë identifikuar dhe në shkelje të disiplinës financiare të cilat kanë shkaktuar efekt negativ në dëm të buxhetit të shtetit. Në këtë drejtim është punuar që roli i auditimit i brendshëm si një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e luftës kundër korrupsionit dhe shpërdorimit të fondeve publike, të forcohet jo vetëm në drejtim të identifikimit të shkeljeve dhe zhdëmtimit të vlerave të dëmit ekonomik të shkaktuar , por sidomos të marrë një profil të ri i orientuar më shumë tek parandalimi dhe mos përsëritja e fenomeneve negative. Kjo kërkon trajnime të thelluara për kualifikimin e kapaciteteve audituese , për t'i bërë të afta të identifikojnë fushat ku risku i mashtrimit dhe korrupsionit është më i lartë, duke ndikuar në një ndarje gjithnjë e më të qartë të rolit të audituesit të brendshëm nga inspektimi financiar, dhe në formimin e audituesit si

profesionist , vlerësues e këshillues, i fokusuar jo vetëm në sisteme financiare por dhe jo financiare.

Grafiku 6. Gjetjet sipas sistemeve për vitin 2019



Gjetjet në Ministritë e Linjës

Gjatë kësaj periudhe NJAB në ministritë e linjës kanë konstatuar mungesën e rregulloreve dhe udhëzimeve për aktivitete të caktuara, për të dhënë siguri që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm. Kjo, veçanërisht në fushën e menaxhimit të aktiveve, e pagesave për aktivitete të veçanta, për kontrollin e zbatimit të kontratave të shërbimit dhe të blerjes së mallrave, etj.

-Gjetjet kryesore në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore evidentohen në:

-Mos plotësimin e vendeve vakante me persona që plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe eksperiencë;

-Mos përcaktimin e rregullave të sakta dhe të qarta në rekrutimin e stafit;

-Mungesën e përshkrimeve të punës dhe mos vendosjes së treguesve të matshëm për të vlerësuar performancën.

-Gjetjet kryesore në sistemin e prokurimeve evidentohen në:

-Shkelje të procedurave të prokurimit publik përfshirë specifikimet teknike, procedurat e tenderimit, si dhe zbatimi i kontratave;

Nënshkrim të kontratës duke ndryshuar kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit me të cilat është shpallur fitues subjekti;

-Mos argumentim të plotë të fondi limit, si bazë për fillimin e procedurave të prokurimit;

-Mos ndjekjen e të gjithë hapave ligjorë për blerjet me vlera të vogla, si dhe favorizimi në disa raste të blerjeve të të njëjtit operator ekonomik;

-Mos argumentim dhe mbështetje me kërkesat dhe nevojat e njësisë në planifikimin për mallra/shërbime, si dhe përllogaritjen e fondit limit.

Gjetjet kryesore në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar evidentohen në:

Mos hartimin e regjistrit të aktiveve nga njësitë publike;

Mos administrimin e rregullt të dokumentacionit të shfrytëzimit të mjeteve të transportit për shpenzimet e karburantit;

Ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve dhe për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, në kundërshtim me rregullat në fuqi;

Mos menaxhimi i mirë nga njësitë publike i procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve dhe kryesisht të aparaturave dhe pajisjeve;

Kryerjen e pagesave për blerje mallrash, pa hartuar më parë proces verbalet e marrjes në dorëzim nga komisionet përkatëse dhe të pashoqëruara me dokumentacionin justifikues;

Në problemet me menaxhimin e aseteve në përdorimin dhe plotësimin e tyre me dokumentacionin specifik.

-Gjetjet kryesore në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit evidentohen në:

-Mos identifikimin e risqeve dhe mos hartimin e përditësimin e regjistrave të risqeve;

-Mos hartimin e strategjisë për menaxhimin e riskut;

-Mos përgatitjen e manualeve të proceseve të punës;

-Mos hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset kryesore;

Mungesën e përgjegjësisë menaxheriale që ka të bëjë me ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara;

Mos përcaktimin e qartë të detyrave për secilin punonjës.

-Gjetjet kryesore në sistemin e koncesioneve dhe ankandeve evidentohen në:

-Mos monitorimin e zbatimit të kontratave koncesionare që janë në fazën e ndërtimit ose kanë hyrë në fazën e shfrytëzimit;

-Mos monitorimin e veprimtarisë së sektorit të oponencës teknike;

-Mos respektimin e kushteve të marrëveshjeve lidhur me garancitë financiare të marrëveshjeve.

Audituesit e brendshëm në minitritë e linjës kanë vlerësuar se sistemet e kontrollit të brendshëm në disa raste nuk funksionojnë efektivisht, si pasojë e magësive në zbatimin e përshtatshëm të rregullave dhe procedurave. Këto dobësi janë më evidente dhe më të shpeshta në strukturat e varësisë për shkak të ndryshimit të shpeshtë të organizimit të strukturave dhe stafit, ndarjen jo të qartë të detyrave, ka mbivendosje, raste të konflikt të interesit dhe mos zbatim të procedurave ligjore, evidentimin e përsonave përgjegjës, të cilët nuk kanë menaxhuar me efektivitet dhe eficensë burimet njerëzore dhe financiare, parregullsi në dokumentimin dhe menaxhimin e aseteve publike.

Gjetjet në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

NJAB në njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë evidentuar gjetjet sipas sistemeve.

Sistemin e prokurimeve, blerjeve

Fondit limit të llogaritur i mungon argumentimi dhe analiza e nevojave nga sektorët përkatës në momentin e përgatitjes së PBA.

Për përllogaritjen e vlerës së kontratës nuk kanë marrë parasysh gjendjen e magazinave në fund viti te cilat rezulton me gjendjen fizike dhe kontable në shuma të konsiderueshme.

Shpallja padrejtësisht fitues e operatorit nga Komisioni pasi rezulton me detyrime të pashlyera ndaj organeve shtetërore.

Sistemi i pagesave të pagave, sigurimeve.

Dhënë shtesë page punonjës të administratës me funksionion veprimtari administrative për punë turni i dytë dhe turni i tretë.

llogaritjen gabim të shtesës së vjetërsisë për pozicionin kategoria II, klasa IV, të vendosur gabim dhe jo në përputhje me aktet nënligjore.

Në urdhërat e emërimit evidentohen se mungon specifikimi i kategorisë, grupit dhe vjetërsisë në punë që i takon punonjësit.

Kontratat e punës me një afat të caktuar 3 mujor, pas mbarimit të periudhës së provës nuk janë nënshkruar kontrata të reja, tek të cilat duhet të cilësohet afati i ri kohor i marrëdhënies së punës të punonjësit. Gjithashtu për punonjësit, të cilët janë transferuar në pozicione të tjera brenda institucionit nuk janë lidhur kontrata të reja pune ku të evidentohet pozicioni i ri dhe afati kohor i këtij pozicioni.

Sistemi i administrimit të pronave, pasurive

Në dokumentat fletë hyrje në magazinë mungonin procesverbalet e hartuara nga komisionet e marjes në dorëzim si dhe dokumentacioni tjetër shoqërues si Fletë analizë, certifikata, etj., nuk janë të bashkëlidhura në dokumentat e magazinës.

Formati i regjistrit të aktiveve të qëndrueshme si Pyje kullota plantacione, ndërtime dhe kostruksione, rrugë, mjete vepra ujore përveç vlerës fillestare të kontabilitetit nuk përmban kërkesat specifike të përcaktuara në udhëzimin përkatës.

Fletët e inventarit të llogarisë përkatës enë kontabilitet për aktive të qëndrueshme nuk mbaheshin të ndara sipas adresave përkatës të vendndodhjes, gjë që vështirëson verifikimin fizik të tyre dhe vlerësimin nëse ky inventar është kryer në mënyre korrektë për vetë hapësirën teritoriale të Bashkive.

Fletët e inventarit janë të panënshkruara nga komisioni por vetëm nga punonjësit me përgjegjësi materiale.

Për zërin mjete transporti është kryer vetëm inventarizimi fizik për konstatimin dhe rivlerësimin e tyre dhe nuk është vazhduar me procedurat e tjera të kontrollit periodik.

Evidentohen probleme me trasferimin e aseteve, duke mos zbatuar aktet nënligjore në fuqi.

Gjetjet kryesore në sistemin e kontrollit të brendshëm evidentohen në:

-Mos përcaktimin e objektivave strategjikë;

-Mos përcaktimin e saktë të dhe risqeve që mund të cënojnë realizimin e objektivave;

-Mos miratimin e rregulloreve të brendshme;

-Mos hartimin dhe përditësimin e përshkrimeve të punës.

Gjetjet kryesore në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit evidentohen në:

-Mos planifikimin real dhe mos realizimin e shpenzimeve me efektivitet dhe efiçencë;

-Mos realizimin e buxhetit në raport me objektivat e realizuara;

-Mos hartimin dhe monitorimin e procedurave për përfituesit nga lehtësirat e taksave dhe tarifave vendore;

Gjetjet kryesore në sistemin e menaxhimit të aktiveve evidentohen në:

-Mos hartimin dhe mos përditësimin e regjistrave të aktiveve (njësitë administrative- ish komuna;

-Mos administrimin e aktiveve për parandalimin e keqmenaxhimit të tyre;

-Mos plotësimin e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave të inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të ndërtesave.

Gjetjet kryesore në sistemin e blerjeve dhe prokurimeve evidentohen në:

Mos hartimin sipas përcaktimeve ligjore të regjistrave të prokurimeve

Audituesit e brendshëm në njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm kanë evidentuar që janë eficente por gjithmonë ka nevojë për përmirësime në hartimin dhe përditësimin e rregulloreve, përcaktimin e saktë të detyrave dhe përgjegjësive, identifikimin e risqeve, etj.

Gjetjet në Njësitë Shpenzuese me buxhet të madh

NJAB në grupi i njësive shpenzuese me buxhet të madh kanë evidentuar gjetjet sipas sistemeve.

Gjetjet kryesore në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore evidentohen në:

-Mospërputhjen e kërkesave të vendit të punës me aftësitë dhe eksperiencën e stafit;

-Lëvizjet e shpeshta të stafit dhe mos plotësimin në kohë të vendeve vakante;

-Mos zbatimin e procedurave lidhur me punësimin, lëvizjen dhe largimin e stafit.

Gjetjet kryesore në sistemin e prokurimeve evidentohen në:

-Mos respektimin e rregullave për argumentimin dhe dokumentimin qartësisht të llogaritjes së fondit limit;

-Përcaktimin e fondeve në kundërshtim me procedurat e miratuara;

-Realizimin e procedurave të prokurimit në kundërshtim me ligjet dhe aktet nenligjore;

-Pagesën e kontratave/faturave tatimore pa u realizuar punimet, kryer shërbimi, apo në kundërshtim me kontratën e firmosur.

Gjetjet kryesore në sistemin e kontrollit të brendshëm evidentohen në:

-Mos funksionimin e procesit të identifikimit, analizimit dhe menaxhimit të riskut;

-Mungesën e rregulloreve të brendshme, ndarjen konkrete të detyrave dhe përgjegjësive.

Gjetjet kryesore në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar evidentohen në:

-Mungesën e kartelave të AQT sipas viteve të vënies në pune, vlerës fillestare, amortizimit të akumuluar dhe vlerës së mbetur;

-Mos vlerësimin e aseteve stok, për vënien në eficensë apo nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre;

-Mos regjistrimin e pasurive të paluajtshme në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive;

Plotësimin e gabuar të pasqyrave financiare.

-Gjetjet kryesore në sistemin e detyrimeve të prapambetura evidentohen në:

-Mos identifikimin e risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;

-Mos kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të gjitha detyrimeve që nga koha e krijimit të tyre.

Audituesit e brendshëm në grupin e institucioneve me buxhet të madh në lidhje me vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm kanë evidentuar përmirësime nga auditimet e mëparshme por akoma evidentohen magësi në zbatimin, kjo për shkak të ndryshimit të shpeshtë të strukturave, mos zbatimin e procedurave ligjore, mos përditësimin e rregulloreve, mos identifikimin e risqeve, parregullësive në menaxhimin e aseteve publike, etj.

Sfide e institucioneve vazhdon te mbetet menaxhimi i riskut, pasi përgjithësisht nuk kane procedura te dokumentuara ne menaxhimin e riskut, nuk identifikojnë, analizojnë, vlerësojnë, dhe as nuk ndërmarrin veprime per te menaxhuar riskun ne arritjen e objektivave.

Gjetjet në Institucionet e Pavarura

NJAB në institucionet e pavarura kanë evidentuar gjetjet sipas sistemeve.

Gjetjet kryesore në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore evidentohen në:

-Mos zbatimin e procedurave të punësimit nga BNJ;

-Mos plotësimin e vendeve vakante dhe rekrutimin e personelit të pa kualifikuar;

-Mos ndryshimin e përshkrimeve të punës për shkak të ndryshimeve strukturore.

Gjetjet kryesore në sistemin e prokurimeve evidentohen në:

Mos kryerjen e përllogaritjes së fondit limit dhe vlerës limit të kontratave publike konform kërkesave ligjore;

Copëzimin e fondit limit për blerjen e të njëjtit mall apo shërbim, për të shmangur procedurat përkatëse të tenderimit;

Mos përcaktimin e drejtë të specifikime teknike.

Gjetjet kryesore në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit publik evidentohen në:

-Mos krijimin e regjistrave kontabël të të gjitha aktiveve;

-Mbajtjen në kontabilitet të vlerave të objekteve, që nuk i përkasin njësisë publike;

-Mos kontabilizimin në llogarinë e debitoreve të vlerës së masës së zhdëmtimeve të rekomanduar nga auditimet e mëparshme.

Gjetjet kryesore në sistemin e kontrollit të brendshëm evidentohen në:

-Mos hartimin e gjurmëve të auditimit dhe përshkrimit të proceseve të punës;

-Mos hartimin e përditësimin e regjistrave të riskut dhe planeve për aktivitetet e kontrollit për menaxhimin efektiv të risqeve;

-Mos përditësimin e rregulloreve pas ndryshimeve strukturore.

Gjetjet kryesore në sistemin e pagesave dhe shpërblimeve të punës evidentohen në:

-Mos interpretim i saktë i kuadrit ligjor për pagesat për punën jashtë kohës normale, në ditët e pushimit, festave zyrtare dhe për pagesat e vështirësive;

-Mos interpretim i saktë i kuadrit ligjor dhe mungesë dokumentacioni justifikues për shpenzimet për udhëtime e dieta.

Gjetjet kryesore në sistemin e menaxhimit të aktiveve evidentohen në:

-Mos krijimin e regjistrit të aseteve;

Procesin e vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aseteve.

Audituesit e brendshëm në institucionet e pavarura në lidhje me vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm kanë evidentuar që janë eficente por gjithmonë ka nevojë për përmirësime në hartimin dhe përditësimin e rregulloreve, përcaktimin e saktë të detyrave dhe përgjegjësive, identifikimin e risqeve, etj.

Gjetjet në Shoqëritë Aksionere

NJAB në shoqëritë aksionere kanë evidentuar gjetjet sipas sistemeve.
Gjetjet kryesore në sistemin e kontrollit të brendshëm evidentohen në:
-Mos hartim të regjistrit të riskut;
-Mos hartimin e strategjisë për menaxhimin e riskut;
-Mungesën e veprimtarive të kontrollit;
-Mos hartimit dhe miratimit të gjurmës së auditimit;
-Mos përditësimin e manualeve të proceseve të punës.
Gjetjet kryesore në sistemin e prokurimeve evidentohen në:
-Mos hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike;
-Mos zbatimin e "Gjurmës së auditimit";
-Mos llogaritjen e drejtë të vlerës së fondit limit.
Gjetjet kryesore në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit publik evidentohen në:
-Mos mirëmenaxhimin e bazës materiale të dalë nga magazina;
-Mungesën e procedurave të lëvizjes së materialeve;
-Mos marrjes në ngarkim të bazës materialo-teknike nga personat përgjegjës.
Gjetjet kryesore në sistemin e pagesave dhe shpërblimeve të punës evidentohen në:
-Pagesat për punën e kryer jashtë kohës normale të punës;
-Mos dokumentimin sipas kërkesave ligjore të shpenzimeve për udhëtim e dieta;
-Përfitime të pa justifikuara të pagës së grupit duke mos e argumentuar me dokumente justifikuese.


NJAB vlerësojnë që sistemet e kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara nuk janë efektive dhe nuk kanë të miratuara procedura për funksionimin e tyre (OSHEE, KESH, OST, Posta Shqiptare, Albpetrol dhe Albgaz). Dobësitë bëhen dhe më të dukshmen ë kushtet e ekzistencës së një kuadri legjislativ tepër kompleks ku ushtrojnë veprimtarinë këto shoqëri.

5.6 Rekomandimet e Auditimit të Brendshëm

Rekomandimet e dhëna nga audituesit e brendshëm, janë rezultat i analizave dhe vlerësimeve të sistemeve dhe kontrolleve të brendshme që funksionojnë në njësitë publike. Ato përcaktojnë dhe i japin prioritet veprimeve që duhet të ndërmerren për një funksionim më të mirë të këtyre sistemeve, ndreqjen e parregullsive, ruajtjen e aseteve dhe minimizimin e rasteve të mashtrimit duke ndikuar në mirë administrimin e aseteve dhe fondeve publike.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit është treguesi kryesor i performancës së auditimit të brendshëm. Kuadri ligjor në fuqi, njeh të drejtës, por njëkohësisht detyrimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit si përgjegjësi e titullarëve të subjekteve të audituara, por auditimi i brendshëm duhet të monitorojë dhe verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe të pranuara, pasi vetëm në këtë mënyrë vlerësohet impakti dhe vlera e auditimit të brendshëm si promotor i ndryshimit pozitiv.

Grafiku 7. Rekomandime të pranuara dhe të zbatuara në vite




Nga auditimet e ushtruara gjatë vitit 2019, janë dhënë 8314 rekomandime për përmirësim sistemi , ndryshime të kuadrit rregullator dhe masa organizative dhe të qeverisjes kundrejt 7910 rekomandime të dhëna në vitin e mëparshëm 2018.


Rekomandimet e dhëna nga audituesit e brendshëm janë pranuar në një masë të madhe prej 99,8% ndërkohë që zbatueshmëria e tyre nga subjektet e audituara gjatë vitit 2019 është arritur deri në 60% ose 3% më shumë se niveli i zbatimit të rekomandimeve të vitit 2018 (57 %).

Grafiku 8. Rekomandime të zbatuara dhe në proces gjatë vitit 2019

Në funksion të ndjekjes deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve, NJAB vazhdojnë të monitorojnë zbatueshmërinë e rekomandimeve deri në dy vjet pas lëshimit të raportit Final të Auditimit. Për vitin 2018 është evidentuar një rritje e konsiderueshme nga 57% e nivelit të zbatimit e evidentuar në raportin vjetor 2018 në 73% e nivelit të zbatimit gjatë analizës së këtij treguesi në vitin 2019.



Grafiku 9. Rekomandime të zbatuara dhë në proces gjatë vitit 2019



Nëpërmjet rekomandimeve , auditimi i brendshëm ofron këshillim dhe sugjerime për marrjen e veprimeve të nevojshme të cilat kanë si qëllim përmirësimin e sistemeve, përmirësime të kuadrit legjislativ, masa organizative dhe të tjera për të cilat titullari i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e tyre. Por audituesi është përgjegjës për dhënien e rekomandimeve cilësore të cilat të jenë konkretë , të zbatueshëm dhe të përshtatshëm në mënyrë që zbatimi i tyre të sjellë ndryshim pozitiv dhe përmirësim në sistemet e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm duke rritur kështu sigurinë se objektivat do të arrihen dhe fondet publike përdoren me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet.

Nga raportet e paraqitura vihet re se, rekomandimet i referohen gjetjeve të konstatuara dhe kanë synim përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut në

këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.

Tabela 11. Rekomandimet sipas llojit për vitin 2019

Nr.	**Rekomandimet sipas llojit**	**Rekomandimet (në numër)**
1	Rekomandime për përmirësim sistemesh	2686
2	Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor	372
3	Rekomandime të karakterit organizativ	2936
4	Rekomandime për arkëtime	842
5	Rekomandime të tjera	1458
	TOTALI	**8294**

Nga viti në vit evidentohet rritje e nivelit të zbatimit të rekomandimeve, por për këtë është gjithnjë e më shumë e nevojshme ndërmarrja e veprimeve të duhura nga titullarët e njësive publike, të cilët në shumë raste nuk i shohin strukturat e auditimit të brendshëm si funksione që shtojnë vlerë dhe ndihmojnë në realizimin e objektivave të njësive publike.

Gjatë analizës së rekomandimeve janë evidentuar mangësi në lidhje me cilësinë e rekomandimeve të dhëna (NJAB e pushtetit vendor), ku ndër më kryesoret mund të përmendim:

Në disa raste formulimi i rekomandimeve është parashkruar si zbatim i aktit ligjor në fuqi, i cili nuk mund t'i rekomandohet subjekteve të audituara, por duhet të bëhet adresim konkret i rekomandimit, bazuar në mos respektimin e procedurave apo sistemeve përkatëse.

Rekomandime që nuk bazohen logjikisht tek gjetjet, konkluzionet dhe pasojat përkatëse.

Rekomandime që nuk propozojnë zgjidhje të qartë për problemin, afatet të përcaktuara qartë për zbatim ose të përmendin zgjidhje alternative të tij.

Nga analiza ka rezultuar se njësitë e qeverisjes së përgjithshme raportojnë se ka një progres të dukshëm në monitorimin e nivelit të zbatimin e rekomandimeve, por në njësi auditimi të caktuara shkalla e implementimit të rekomandimeve të dhëna lë vend për përmirësime në të ardhmen.

Rekomandimet në Ministritë e Linjës

Rekomandimet e dhëna nga ministritë e linjës vlerësohen në përgjithësi si të përshtatshme, të qarta dhe të zbatueshme. Rekomandimet kryesore janë fokusuar në përmirësim sistemesh dhe kuadri rregullator, si dhe të karakterit organizativ:

Rekomandime të karakterit organizativ që lidhen me miratimin ose përmirësimin e rregulloreve të brendshme, miratimin e manualeve të proceseve të punës, rishikim i përshkrimeve të punës për çdo punonjës, ndarjen e qartë të detyrave, miratim i rregullave të brendshme për delegimin e detyrave, etj.

Specifikisht, në rekomandime për përmirësimin e sistemeve që lidhen me hartimin e regjistrit të aseteve, hartimin e regjistrit të risqeve, hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, rritjen e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, ruajtja e aseteve, etj.

Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor lidhen me propozime për ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore, për miratim udhëzimesh etj. të lidhura me fushën e përgjegjësisë së çdo ministrie.

Rekomandimet e auditimit në Njësitë Shpenzuese me Buxhet të Madh

Rekomandimet e lëna pranë subjekteve të audituara nga NJAB e grupit të institucioneve me buxhet të madh janë të sakta, realiste dhe të zbatueshme por disa prej rekomandimeve të lëna paraqesin referencën ligjore mbi të cilën ato janë mbështetur ose rekomandohet zbatimi i legjislacionit të fushës, duke mos dhënë opinion e rekomandim konkret për sistemin e vlerësuar:

Rekomandime për përmirësimin e sistemeve që lidhen me hartimin e regjistrit të riskut, hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, etj.

Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor që lidhen me propozime për ndryshime ligjore, për përditësim të urdhrave, udhëzimeve dhe manualeve në fuqi, të lidhura këto me misionin dhe fushën e veprimtarisë së subjekteve të audituara.

Rekomandime të karakterit organizativ që lidhen me përmirësim e rregulloreve të brendshme, miratim i manualesh të proceseve të punës, miratim i procedurave për delegimin e detyrave.

Rekomandime sipas qëllimit dhe misionit të institucionit. Numri më i madh i rekomandimeve të propozuara nga NJAB pranë: QSUT, DPT, DPD, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Spitali Universitar i Traumës, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, janë të lidhura me sistemet specifike sipas qëllimit dhe misionit të subjektit të audituar.

Rekomandimet në Institucionet e Pavarura

Rekomandimet e lëna pranë subjekteve të audituara nga NJAB në institucionet e pavarura janë të sakta, specifike, bindëse në përmbajtje duke patur si qëllim përmirësimin e proceseve të punes, duke përcaktuar "nivelin e prioritetit" dhe "afatin e zbatimit". Por ndërmjet tyre veçojmë se disa prej rekomandimeve paraqesin referencën ligjore mbi të cilën ato janë mbështetur apo subjektit të audituar i është rekomanduar zbatimi i legjislacionit në fushën e audituar, duke mos dhënë opinion e rekomandim konkret për sistemin specifik të vlerësuar (Prokuroria e Përgjithshme dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare):

Rekomandime për përmirësimin e sistemeve që lidhen me hartimin e regjistrit të aseteve, hartimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, rritjen e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, ruajtja e aseteve, etj.

Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor që lidhen me propozime për ndryshime ligjore, për përditësim të urdhrave, udhëzimeve dhe manualeve në fuqi, të lidhura këto me misionin dhe fushën e veprimtarisë së subjekteve të audituara.

Rekomandime të karakterit organizativ që lidhen me rishikim të rregulloreve të brendshme, përcaktimin e metodave dhe procedurave të unifikuara dhe dokumentacionit standard që duhet të hartohet nga çdo specialist, rishikim i hartës së proceseve të punës për çdo sektor, rishikim dhe azhornim i përshkrimeve të punës dhe ndarje e detyrave për çdo specialist.

Rekomandime sipas qëllimit dhe misionit të institucionit. Numri më i madh i rekomandimeve të propozuara nga NJAB pranë FSDKSH dhe Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, janë të lidhura me sistemet/fushat specifike sipas qëllimit dhe misionit të subjektit të audituar.

Rekomandimet në Shoqëritë Aksionere

Rekomandimet më të rëndësishme të njësive të auditimit të brendshëm në janë fokusuar në:

Rekomandime për përmirësimin e kuadrit rregullator të fushës, të cilat lidhen me propozime për ndryshime të akteve nënligjore, përditësim e ndryshim të udhëzimeve, manualeve dhe rregulloreve në fuqi.

Rekomandime për përmirësimin e sistemeve, që lidhen me hartimin e rregulloreve të brendshme sipas përshkrimeve të punës në përshtatje me ndryshimet strukturore të shoqërive, hartimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, hartimin e një strategjie në funksion të minimizimit të riskut, delegimin e detyrave për koordinimin e riskut tek menaxherët në varësi direkte të administratorëve, etj.

Rekomandime të karakterit organizativ, në funksion të rritjes së efektivitetit të punës, të cilat lidhen me përcaktimin e metodave dhe procedurave të unifikuara sipas një dokumentacioni standard që duhet të zbatohet nga çdo punonjës në shërbim të shoqërive aksionere, etj.

5.7 Auditimet e detyrimeve të prapambetura të njësive publike

Në kuadër të objektivit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për një sistem të shëndetshëm të menaxhimit financiar, i cili synon ndër të tjera shmangien e krijimit të detyrimeve financiare të papaguara, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm[22], ka

[22] Shkresë e Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr. 22772, datë 27.12.2018 |

koordinuar angazhimin e auditimit të brendshëm në të gjitha njësitë publike të cilat figuronin Raportin e Zbatimit të Buxhetit në fund të vitit 2018, me detyrime të prapambetura.

Objekti i angazhimeve të auditimit ishte vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të sistemit të detyrimeve financiare të prapambetura, përputhshmërinë me ligjet. rregullat e procedurave dhe zbatimit të tyre si dhe identifikimi i mangësive dhe ndërmarja e veprimeve korrigjuese.

Nëpërmjet auditimeve të detyrimeve të prapambetura auditmi i brendshëm ka si qëllim dhe objektiv përfundimtar t'i japë siguri menaxhimit se kontrollet e brendshme dhe procedurat për detyrimet e prapambetura kanë funksionuar në mënyrë eficente dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe të japë rekomandime të vlefshme për përmirësimin dhe fuqizimin e kontrolleve në parandalimin e krijimit të detyrimeve financiare të prapambetura për një mirëadministrim të fondeve publike.

Pjese e këtij angazhimi u bënë 58 njësi të vetëqeverisjes vendore, si dhe Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria Brendshme, Ministria Mbrojtjes, Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria Financave dhe Ekonomisë, Ministria Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria Drejtësisë, Drejtoria Përgjithshme të Tatimeve, ARRSH-së, strukturave të auditimit të brendshëm të tyre, iu kërkua që të përfshijnë në Planin e Angazhimeve të Auditimit për vitin 2019 dhe të raportonin në mënyrë specifike për gjetjet dhe rekomandimet lidhur me mënyrën e funksionimit të kontrolleve për detyrimet prapambetura.

Gjatë vitit 2019 janë raportuar të realizuara në total 32 auditime te detyrimeve të prapambetura përkatësisht në : 4 në Ministritë e linjës, 20 Bashki, 5 Spitale Rajonale dhe 3 shoqëri aksionere me kapital publik. Gjetjet lidhur me vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, vlerësimin, evidentimin, verifikimin, rakordimin dhe regjistrimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura të konstatuara përfshinë sa vijon:

Gjetje

Në sistemin e kontabilitetit:

Pasaktësi të informacionit kontabël , që mbartin gabime në rregjistrimin e plotë të të gjitha detyrimeve që nga koha e krijimit të tyre mungon Gjurma e Auditimit për procesin.

Nuk ka një baze të dhënash të saktë dhe të rregullt, me informacionin e plotë të krijimit të këtyre detyrimeve, arsyen e krijimit dhe vazhdimit të këtij detyrimi në vite për këta furnitorë .

Njohja dhe klasifikimi i detyrimeve nga vendimet gjyqësore dhe kohës së krijimit të tyre për këtë kategori nuk është kryer sipas standardeve të kontabilitetit publik. Jo të gjitha llojet e detyrimeve financiare të pashlyera janë pasqyruar në Deklaratat dhe Raportitet Financiare , specifikë kjo e detyrimeve të krijuara nga proceset gjyqësore.

Detyrimet për vendimet gjyqësore, kontabilizohen në momentin e pagesës dhe nuk janë regjistruar sipas vlerës së përcaktuar në vendim apo përllogaritjeve te kryera nga Drejtoria Juridike, bazuar ne vendimet gjyqësore.

Nuk është respektuar parimi FIFO në shlyerjen e detyrimeve si dhe janë shkelur afatet e likuidimit të pagesave. Pagesat e detyrimeve kontraktore janë kryer me vonesë, tej afateve të përcaktuara në kontratë apo në ligj nga ana e autoritetit publik kontraktor. Nuk janë kryer likuidime sipas kushteve të kontratës, për kontratat e lidhura me afate disa vjeçare. Avancimi i punimeve nga operatorët ekonomik, është njohur si detyrim i prapambetur

Mos rakordimi i informacionit financiar ndërmjet Degës së Thesarit dhe Njësisë shpenzuese identifikon riskun se sistemet e kontrollit nuk japin siguri për besueshmërinë e informacionit financiar (nuk përputhet gjëndja e faturave të palikujduara sipas Akt Rakordimit ndërmjet Degës së Thesarit me atë të llogarisë "Furnitor" dhe llogari të lidhura me to"). Shkaqet qe kanë sjellë këtë situatë përfshijnë:

Mos dërgimi i shtesave të kontratave në Degën e Thesarit .

Likuidimi i faturës pa kontabilizuar më parë lindjen e detyrimit.

Në llogarinë 401, janë shtuar disa "Furnitorë", faturat e të cilëve janë pranuar, janë bëre hyrje dhe janë kontabilizuar, ndërsa në fakt nuk figurojnë në pasqyrat financiare të viti 2018, të depozituar në Degën e Thesarit, si "Detyrime Financiare të prapambetura".

Shkelje të standardeve të kontabilitetit, Llogaria e të tretëve, Klasa IV, nuk është mbajtur në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Njësia publike ka kryer likuidimin pjesor të faturave. Mos hartimi i një akt rakordimi midis palëve, ka ndikuar që regjistrimi në pasqyrat financiare të këtyre detyrimeve të jetë më i vogël ose më i madh nga gjendja reale e palikujduar.

Ka mospërputhje midis vlerës së mbetur të fatura të palikujduara dhe të regjistruara në kontabilitet

Në sistemin e programomit dhe zbatimit të buxhetit:

Pasaktësia në informacionin e Deklaratave Financiare mbart efektin dhe ne buxhetimin për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura duke mos u parashikuar saktë kërkesat për fonde në PBA afat-mesëm 2018 -2020.

Nuk ka rakordim periodik dhe cdo fundviti të vlerave të rregjistruara në kontabilitet për saktësimin e vlerave të detyrimeve sipas vendimeve gjyqësore. Përmbarimi gjyqësor nuk ka përcjellë pranë titullarit të njësisë shpenzuese dhe degës së thesarit, njoftimin për ekzekutimin vullnetar dhe të detyruar të detyrimit.

Njësia publike nuk ka hartuar dhe depozituar pranë Degës së Thesarit, planin e shlyerjen së detyrimeve financiare të prapambetura.

Njësia publike nuk ka respektuar plotësisht planin e shlyerjes së "Detyrimeve të prapambetura financiare" për vitin 2018, të përfshirë në buxhetin e saj.

Plani i shlyerjes së detyrimeve të vendimeve gjyqësorë është sipas afatit kohor të krijimit të tyre, por nuk është bërë publike në faqen on-line të njësisë shpenzuese, ose në forma të tjera të publikimit, grafiku i shlyerjes së detyrimeve.

Nuk është raportuar në mënyrë periodike mbi bazë 3/mujore, me shkrim ose me rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura si dhe ato të lindura rishtazi.

Regjistri i riskut nuk ka përfshirë identifikimin e risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja.

Mos identifikimin e risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;

Ka mungesë të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve/strukturave të përfshira në proces si rezultat i komunikimit të dobët ose mungesës totale të komunikimit:

në rastet e detyrimeve për proceset gjyqësore mos komunikim ndërmejt Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës

në rastet e blerjeve dhe investime mungesë komunikim infektiv ndërmjet Deges teknike /njësisë së prokurimit/mbikëqyrësve të kontratës dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës)

mungon komunikimi dhe negocimi mes operatorit ekonomik dhe autoritetit kontraktor, lidhur me furnizimet dhe ekzekutimin e kontratave.

Në sistemin e prokurimit:

Nuk është dërguar dhe depozituar pranë Degës së Thesarit dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, regjistri i prokurimeve për fondet publike, mallra ,shërbime në fillim të çdo viti buxhetor si dhe gjatë vitit ushtrimor .

Bllokimi i llogarisë së Thesarit nga sekuestro e Zyrave Përmbarimore, nga mos pagesat e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Ka devijime të angazhimeve buxhetore pasi me lidhjen e kontratave të mallrave, shërbimeve apo blerjeve me vlera të vogla ,nuk merret përsipër likuidimi i detyrimit që lind për operatorin kontraktues (furnitorin).

Njësia publike, ka patur fonde të papërdorura ,përpara mbylljes së vitit buxhetore dhe këto fonde nuk janë përdorur për shlyerjen e një pjese të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Lidhja e kontratave, përtej fondeve të disponueshme . Edhe pse subjekt nuk ka fonde të alokuara, merren përsipër angazhime për tu shlyer në periudha e ardhshme

Për vitin 2019 ka lidhje kontrate pas lëvrimit të mallarave ose kryerjes së shërbimit, pa patur fond limit e pa kryer procedurat përkatëse të prokurimit .

Konkluzione:

Janë krijuar dhe ka ritje të detyrimeve për fatura të palikujduara, nga vitet 2014 deri në vitin 2018.

Sistemi i dobet i menaxhimit të fondeve buxhetore të akorduara për mbulimin e shpenzimeve deri në përdorimin dhe ndryshimi i destinacionit.

Stafi menaxhues, si ai zbatues dhe autorizues, nuk ka ushtruar me kompetencë detyrat funksionale, në drejtim të zbatimit të kërkesave të menaxhimit financimit dhe kontrollit dhe përdorimit me eficencë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike.

Rekomandime:

Rekomandimet e dhëna dhe që kanë si qëllim forcimin e procedurave parandaluese për krijimin e detyrimeve të prapambetura përfshijë:

Titullari dhe Drejtoria e Financës në institucion të marrin masa të nevojshme që në programin buxhetor të vitit 2020 dhe pasardhëse, nëpërmjet Këshillave Bashkiakë të miratojë buxhetet vjetore, për të programuar financimin e detyrimeve të palikujduara ndaj të tretëve, me qëllim uljen në minimum të borxhit financiar duke hartuar grafik për shlyerjen e detyrimeve të evidentuara.

Në programet buxhetore vjetore dhe me afat të mesëm, të parashikohen pagesa për detyrimet gjyqësore të cilët kanë marrë formë të prerë, duke i kontabilizuar këto si detyrime në momentin e konstatimit.

Në lidhje me largimet nga puna, të nxirren përgjegjësitë që lidhen me largimet e padrejta, zgjidhjet e njëanshme të kontratave të punës, si jo të argumentuara sipas Kodit të Punës, duke krijuar kështu debitorë pa arësye objektive.

Mbi baën e analizës së rrenjës , dhe identifikimin e lidhjes shkak – pasojë, nëpunësi zyrtat autorizues dhe nëpunësi zbatues të nxjerrin përgjegjësinë lidhur me furnitorët e papaguar, ku si rezultat i një menaxhimi financiar dhe ekonomik jo të mirë nuk kanë bërë të mundur të parandalojnë detyrimet e pritshme, duke lejuar pranimin e mallit në magazinë pa kryer procedurat e prokurimit.

Kontrollet e brendshme të jenë më efiçente, si dhe nga menaxhimi të analizohen shkaqet dhe pasojat që ka sjellë mos shlyerja e detyrimeve të prapambetura, ndër vite për subjektin publik.

Plan Veprimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të hartohet në përgjigje të situatës në kushte të një buxheti të kufizuar.

Të identifikohen dhe përgjegjësitë për të gjitha rastet e shkeljeve me qëllim të disiplinës financiare dhe të merren masa ndaj strukturavë përkatëse.

Dega e Thesarit të luajë rol aktiv në zbatimin e rregullave dhe procedurave parandaluese për të minimizuar riskun e krijimit të detyrimeve të prapambetura

Ministria e Financave dhe Ekonomise , Drejtoria e Harmonizimit Financiar të analizojë dhe nxjerrë rregulla shtesë në udhëzimin ekzistues lidhur me ndjekjen dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Vlerësim i Përgjithshëm : Identifikimi rregjistrimi, raportimi, ndjekja dhe parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura kanë funksionuar me mangësi cka e bën Sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollt për detyrimet e prapambetura me RISK TË LARTË , ku duhet të merren masa dhe veprime konkrete për vendosjen e procedurave shtesë për përmirësim .

5.8 Mbështetja për zhvillimin e Auditimit të Brendshëm

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përgjegjësinë e bashkërendimit, harmonizimit dhe monitorimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, nëpërmjet Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, analizon dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme

performancën e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në të gjithë sektorin publik për përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar.

Nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me NJAB-të e ministrive të linjës, institucioneve qendrore, institucioneve të pavarura dhe të pushtetit vendor, Drejtoria Harmonizimit ofron udhëheqjen metodologjike dhe mbështet zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm, çka e siguron me anë të shkëmbimit të informacionit, konsolidimit të planeve strategjike dhe vjetore dhe raporteve vjetore të veprimtarisë së strukturave audituese në sektorin publik, hartimit dhe zhvillimit të politikave, manualeve, metodologjive dhe udhëzuesve si dhe programit të trajnimit dhe certifikimit profesional.



Harmonizimi i tre elementëve : krijimi dhe mbajtja e përditësuar e kuadrit ligjor, metodologjik e profesional, trajnimi dhe zhvillimi profesional i kapaciteteve audituese dhe vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm kanë synuar të krijojnë një ambient që të nxisë progresin dhe zhvillimin e sistemit të auditimit të brendshëm në linje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira profesionale.

Krijimi dhe mbajtja të përditësuar e akteve ligjore e nënligjore që lidhen me auditimin e brendshëm, hartimi i metodologjive dhe udhëzuesve për auditimin duke reflektuar çdo ndryshim dhe përmirësim në nivel global të profesionit synojnë të krijojnë një ambient të përshtatshëm dhe të nxisin zhvillim dhe progres të vazhdueshëm në sistemin e auditimit të brendshëm. Hartimi dhe ofrimi i programeve të trajnimit dhe certifikimi i audituesve të brendshëm kanë si qëllim që të përcjellin tek audituesit njohuritë dhe dijet që ofron kuadri ligjor e metodologjik , për t'i aftësuar audituesit, për t'i pajisur me kompetencën e duhur profesionale në mënyrë që të kryejnë auditime cilësore e në pajtueshmëri të plotë me standardet. Monitorimi i veprimtarisë së njësive të auidtimit të brendshëm shërben për të vlerësuar se deri në çmasë veprimtaria e auditimit të brendshëm kryhet në përputhje me kërkesat e standardeve , kuadrit ligjor dhe praktikat e mira profesionale.

Në këtë mënyrë të tre hallkat e sistemit janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën dhe ndikojnë në mënyrën se si funksionon i gjithë sistemi i auditimit të brendshëm në sektorin publik në tërësi: outputet e njërës hallkë janë inpute për hallkën tjetër dhe shërbejnë për të sjellë ndryshim dhe progres të nevojshëm për të çuar përpara sistemin. Veprimtaritë e realizuara nga

DH AB i kanë shërbyer përmbushjes së misionit dhe arritjes së objektivave që përcaktohen sa vijon:

Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së së auditimit të brendshëm, zbatimi metodologjisë së vlerësimit të jashtëm të cilësisë së veprimtarisë audituese;

Harmonizimin, bashkërendimin dhe udhëheqjen metodologjikë të të gjithë NJAB në sektorin publik duke siguruar dhe mbështetje efektive për zhvillimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik;

Zhvillimin e vazhdueshëm profesional nëpërmjet trajnimit të audituesve të brendshëm në detyrë; dhe

Certifikimin e punonjësve të njësive të auditimit të brendshëm, bazuar në programin e miratuar.

5.9 Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm

Angazhimet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë të ushtruara në Njësitë e Auditimit të Brendshëm kanë si qëllim të vlerësojnë veprimtaritë e NJAB, lidhur me zbatimin e standardeve të auditimit, sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe efektiviteti dhe eficienca e kështillave dhe rekomandimeve të adresuara nga auditimi për subjektet e audituara. Mbështetur në metodologjinë e vlerësimit , në përfundim të procesit bazuar në gjetjet e vlerësimimit, konkluzioni jepet nëpërmjet Opinionit të Përgjithshëm të Pajtueshmërisë në një nga katër format e mëposhtëme:

P**ërputhje e plotë** me standardet;

Përputhje e pjesshme me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;

Përputhje në disa fusha me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet;

Mospërputhje e plotë me standardet.

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë synon të ndihmojë njësitë e auditimit të brendshëm, për të kryer veprimtarinë e tyre në përputhje të plotë me standardet, duke identifikuar dobësitë dhe adresuar risqet që kërcënojnë arritjen e objektivave të auditimit,

Për vitin 2019, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm vlerësoi në total 15 njësi të auditimit të brendshëm (3 Ministri Linje, 3 Institucione Qendrore, 7 Bashki dhe 2 Shoqëri Aksionere) ,vlerësimi përfundimtar rezultoi me dhënien e opinioneve si më poshtë vijon:

Nr.	INSTITUCIONI	VLERËSIMI	PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET
1	Ministria e Kulturës		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		**Përputhje e plotë me standardet**
3	Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
4	Bashkia Sarandë		**Mospërputhje e plotë** me standardet.
5	Bashkia Vlorë		**Përputhje e pjesshme** me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të

			caktuara.
6	Bashkia Devoll		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
7	Bashkia Pogradec		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
8	Bashkia Tropojë		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
9	OSHEE sha		**Përputhje e pjesshme** me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara.
10	KESH sha		**Përputhje e pjesshme** me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara.
11	Shërbimi Social Shtetëror		**Përputhje e pjesshme** me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara.
12	Instituti i Sig. Shoqërore		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
13	Bashkia Krujë		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
14	Bashkia Shijak		**Mospërputhje e plotë** me standardet.
15	Ministria e Industrisë dhe Energjisë		**Përputhje e pjesshme** me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara.

Gjetjet kryesore të vlerësimeve

Ndër gjetjet më të rëndësishme në këto procese vlerësimi për 15 njësitë e mësipërme u evidentuan:

Karta e Auditimit të Brendshëm nuk është hartuar dhe miratuar ose duhet përditësuar.

Rregullorja e Brendshme nuk përshkruan të drejtat, përgjegjësitë e audituesve si punonjës të institucionit, si dhe kufizimet për mos përfshirjen e tyre në procese vendimmarrëse, etj.

Programi i Angazhim Auditimit nuk është hartuar sipas formatit të MAB dhe nuk përfshin vlerësimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm.

NJAB nuk kanë respektuar fazat e kryerjes së angazhim auditimit (faza përgatitor) dhe nuk përgatisin testet dhe pyetësorët mbi sistemet/fushat e përzgjedhura

Raportet e auditimit janë të gjata dhe jo të qarta dhe konçize, për të adresuar rekomandime me mesazh të plotë për titullarët e subjekteve të audituara.

NJAB nuk respektojnë strukturën e raporteve sipas përcaktimeve në MAB, nuk respektohet lidhja organike gjetje, konkluzion e rekomandim, nuk trajtohen observacionet e subjektit, nuk ka opinion për funksionimin e KB.

Nuk është hartuar dhe miratuar programin për sigurimin e cilësisë dhe janë përcaktuar treguesit e matjes performancës,

Nuk është identifikuar mungesa dhe nuk është rekomanduar hartimi i regjistrit të riskut.

Procedurat, për planifikimin, raportimet periodike, sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe monitorimin e progresit të rekomandimeve nuk kryhen në respektim të MAB dhe nuk ishin përcaktuar treguesit e matjes së cilësisë së perfomancës së veprimtarisë audituese.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve jo efektiv dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve shumë i ulët, si dhe evidentohet se në shumë raste nuk ishte plotësuar planveprimi nga subjekti i audituar.

Rekomandimet kryesore të vlerësimeve

Bazuar në gjetjet konstatuara grupet e vlerësimit kanë dhënë rekomandime lidhur me masat që duhet të merren nga këto njësi për përmirësimin e veprimtarisë së auditimit në të ardhmen. Rekomandimet kryesore për NJAB mund të përmendim:

NJAB të marrë masa për miratimin/ përditësimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm, dhe plotësimin e strukturës së këtij dokumenti sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

NJAB të marrë masa për të reflektuar në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të saj, jo vetëm të drejtat, por dhe përgjegjësitë ligjore si për Drejtuesin e NjAB dhe specialistët, linjat e hapura të komunikimit, si dhe pjesëmarrjen e Drejtuesit të NjAB në takimet e herëpashershme me Drejtorin e Përgjithshëm apo dhe me drejtues të të gjitha niveleve brenda Institucionit.

Programet e angazhim auditimit të përfshijnë si pikë të veçantë vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si drejtim kyç për vlerësimin e riskut, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e risqeve brenda njësisë publike.

Auditimi i brendshëm në mbështetje të gjetjeve të rezultuara, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, të japë opinion mbi funksionimin dhe vlerësimin e tyre, analizën e riskut dhe përcaktimin e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut.

Drejtuesi i NJAB, në çdo rast të ndryshimeve të planit të auditimit të brendshëm, pas arsyetimit dhe argumentimit me shkrim të ndryshimeve të bëra dhe marrjes së miratimit të tyre nga titullari i institucionit, të përcjellë këtë plan të rishikuar pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e audit8imit të brendshëm.

NJAB të hartojë e miratojë regjistrin e riskut që përfshin risqet më të rëndësishme që pengojnë realizimin e objektivave të njësisë, apo risqet e mundëshme, veprimet për të adresuar boshllëqet, si dhe personat përgjegjës për adresimin e riskut.

NJAB të dokumentojë procesin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe komunikimin me subjektin e audituar, lidhur me marrjen e informacionit mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve, duke e përfshirë këtë monitorim dhe në raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

Planveprimin për zbatimin e rekomandimeve, të plotësohet dhe miratohet nga menaxhimi i lartë i subjektit të audituar dhe jo nga grupi i auditimit.

Të kryhet proçesi i sigurimit të cilësisë, për çdo angazhim auditimi dhe të hartohet Programin për Sigurimin e Cilësisë dhe treguesit e matjes së cilësisë së performancës (të dokumentohet procedura).

Njësitë e auditimit të brendshëm, të cilat janë vlerësuar me mospërputhje të plotë me standardet (e kuqe) dhe përputhje në disa fusha me standardet (portokalli) do të jenë në fokus të vazhdueshëm të DH/AB duke ju ofruar gjithë asistencën e nevojshme për rritjen e cilësisë së punës.

5.10 Zhvillimi Profesional i Audituesve të Brendshëm

Certifikimi audituesve të brendshëm

DH/AB në bashkëpunim me Komisionin e Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm (KKAB) organizojnë dhe menaxhojnë procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik.

Në zbatim të akteve ligjore në fuqi dhe Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.162, datë 29.05.2018 "Për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshem ne sektorin publik për sezonin 2018-2019", DH/AB në bashkëpunim me KKAB kanë vazhduar angazhimin me organizimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2018-2019. Ky proces ka startuar në muajin maj 2018 dhe u finalizua në

muajin korrik 2019. Në këtë sezon certifikimit kanë aplikuar 80 kandidatë, nga të cilët vetëm 48 kandidatë përmbushën kriteret e përcaktuara në kuadrin rregullator përkatës.

Në këtë sezon certifikimit aplikuan 80 kandidatë, nga të cilët 48 kandidatë plotësuan kriteret, u kualifikuan dhe u përfshinë në këtë proces, por vetëm 41 prej tyre finalizuan procesin dhe u certifikuan si "Auditues i Brendshëm në sektorin publik".

Mbështetur në rregulloren mbi procedurat e certifikimit (miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.37, datë 16.03.2016, i ndryshuar) ky proces u zhvillua sipas kalendarit vjetor të certifikimit miratuar nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, bazuar në programin e përbërë nga 6 Module me kurrikul të mirëpërcaktuar, duke synuar dhënien e njohurive të mjaftueshme, teorike dhe praktike për kryerjen e shërbimit të auditimit.

Programi i Certifikimit ka përfshirë ndjekjen e gjashtë moduleve me temat në fushat e përshkruara më poshtë:

1. "Mjedisi i auditimit të brendshëm"
2. "Standardet profesionale për auditimin e brendshëm"
3. "Planifikimi i auditimit të brendshëm"
4."Kryerja e auditimit të brendshëm"
5. "Raportimi i auditimit të brendshëm"
6. "Aftësitë dhe teknikat e auditimit të brendshëm"

Nga vlerësimi i këtij procesi, vecojmë që kandidatët e certifikuar kanë përfituar njohuri të plota në disiplinën e auditimit të brendshëm me kurrikula bashkëkohore si dhe të gjitha strukturat e ngarkuar në këtë proces, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe Lektorët e kanë monitoruar me shumë përgjegjshmëri këtë proces.

Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (DH/AB) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe kuadrit rregullator të procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik në bashkëpunim me KKAB ka organizuar, mbikëqyrur dhe monitoruar këtë proces, si dhe ka organizuar ceremoninë e dorëzimit të certifikatës "Auditues i brendshëm në sektorin publik" të gjithë kandidatëve që ndoqën këtë proces.

Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm

Në funksion të zhvillimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm për përafrim të performancës së veprimtarisë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, për praktikat profesionale, si dhe përditësimit të njohurive me zhvillimet e reja në këtë fushë, bazuar në "Programin e trajnimit të vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2018", i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 351, datë 28.12.2018, DH/AB në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ka organizuar trajnimin e vijueshëm profesional të 338 audituesve të brendshëm në detyrë.

Ky program u zhvillua në periudhën Mars–Nëntor 2019 përgjatë 13 fazave (javë trajnimi). Kurrikulat u përgatitën nga trajnerët të përzgjedhur nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, të cilët me temat e prezantuara ndanë me pjesëmarrësit në trajnim eksperiencat e tyre në këtë fushë.

Organizimi dhe monitorimi i procesit të trajnimit ka qenë një nga objektivat kryesorë të DH/AB, ky proces është trajtuar jo vetëm si detyrim ligjor për audituesit e brendshëm në detyrë, por edhe si ofrues i njohurive shtesë në fushën e auditimit të brendshëm, me qëllim që shërbimet e sigurisë dhe këshillimit të realizojnë performancë gjithnjë e në rritje të veprimtarisë audituese.

Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm si një faktor i rëndësishëm në këtë proces, në përmbushje të përgjegjësive të përcaktuara në aktet ligjore. zhvilloi procedurën e përzgjedhjes, duke vlerësuar materialet e përgatitura dhe aftësitë prezantuese për secilin trajner.

Grupi i trajnerëve të përzgjedhur përbëhej nga auditues të brendshëm të kualifikuar dhe eksperienca të mëparshme si trajnues apo edhe si pedagogë në institucione të arsimit të lartë. Me temat e prezantuara dhe rastet studimore, trajnerët nxitën shkëmbimin e eksperiencave duke iu

dhënë mundësi audituesve të jenë në kontakt me praktikat më të mira të fushës së auditimit në sektorin publik me qëllim përditësimin e njohurive.

Programi u implementua i ndarë sipas katër moduleve të hartuara në përshtatje me grupet e synuara, si më poshtë:

Moduli I-rë: Drejtues të njësive të auditimit të brendshëm në ministri dhe institucione qendrore e vendore;

Moduli II-të: Auditues të njësive të auditimit të brendshëm në ministri e institucione qendrore, shoqëri aksionere, universitete e qendra Spitalore në vend;

Moduli III-të: Auditues të brendshëm të njësive të auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes vendore;

Moduli IV-të: Auditues të brendshëm në institucionet përfituese të fondeve IPA.

Trajnimi i vijueshëm profesional 2019 ka pasur dinamikat e tij të zhvillimit lidhur me pjesëmarrjen, ku përmendim faktin se në të gjitha rastet kur janë dokumentuar punësimet rishtas të audituesve, këta të fundit janë bërë pjesë e procesit duke ju mundësuar përditësimin e njohurive lidhur me zbatueshmërinë e standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe njohjen me praktikat më të mira. Po kështu pjesë e procesit u bënë edhe kandidatët që fituan titullin "Auditues i Brendshëm në sektorin publik", në procesin e certifikimit 2018-2019.

Në opinionin e përgjithshëm audituesit e kanë vlerësuar trajnimin të dobishëm për mënyrën si është konceptuar në funksion të përditësimit, zhvillimit të njohurive dhe pasurimit të përvojës së tyre për ushtrimin e detyrës. Bashkëbisedimi, shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave, si dhe analizimi i rasteve studimore u mundëson audituesve në detyrë të njohin praktikat më të mira në fushën e auditimit të brendshëm në përmbushjen e detyrimit të zbatimit të ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuara.

Për të garantuar efektivitet të lartë të përfitimit të njohurive si dhe realizimin me sukses të procesit, audituesit kanë sugjeruar përfshirjen në programet e ardhshme të trajnimit, trajtimin praktik të një angazhimi auditimi në të gjitha hapat e tij, trajtimin praktik të auditimit të performancës, identifikimin e rasteve të mashtrimit, auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, etj.

5.11 Pyetësori i Vetëvlerësimit të NJAB

Njësitë e auditimit të brendshëm për vitin 2019, kanë plotësuar Pyetësorin e vetëvlerësimit të NJAB, bazuar në Metodologjinë për monitorimin e performancës së njësive publike. Nga 129 NJAB të cilat kanë raportuar, këtë pyetësor e kanë plotësuar 116 NJAB.

Disa njësi publike megjithëse e kanë të miratuar strukturën e NJAB nuk e kanë të plotësuar dhe për këtë arsye nuk kanë dërguar raport për vitin 2019 (Bashkia Klos, Bashkia Fushë Arrëz, Universiteti i Mjekësisë, Spitali Rajonal Korçë dhe Spitali Rajonal Elbasan), megjithëse kanë paraqitur raportin vjetor nuk kanë paraqitur pyetësor Spitali Rajonal Fier, Bashkia Patos, Bashkia Vorë dhe Bashkia Cërrik, ndërsa Bashkia Kuçovë ka paraqitur një pyetësor të pa përditësuar.

Pyetësori i vetëvlerësimit përmban pyetje për të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Kjo analizë është fokusuar në katër grupime pyetjesh, përkatësisht mbi:

Funksionimin e NJAB sipas akteve ligjore


NJAB e krijuara në sektorin publik duhet të funksionojnë në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duhet të përbëhen minimalisht nga tre auditues. Kriteret e përcaktuara nuk janë të plotësuara nga një pjesë e konsiderueshme e njësive publike dhe kjo sjell si pasojë performancë të njësive të auditimit jo në kërkesat e standardeve ndërkombëtare. Nga analiza e të dhënave vetëm 83% e NJAB janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, pra e përmbushin këtë kriter.

Një nga parimet e auditimit të brendshëm është pavarësia. Një veprimtari audituese e pavarur funksionalisht jep gjykime dhe vlerësime të pa ndikuara për risqet dhe sistemet e kontrollit të

brendshëm. Në të njëjtën kohë të gjitha NJAB duhet të kenë komunikim të rregullt me titullarin e njësisë publike.

Nga analiza e të dhënave rezulton se vetëm 82% e NJAB e plotësojnë këtë kriter. Nga të dhënat e konsoliduara të pyetësorëve, rezulton se vetëm në 86% të NJAB audituesit e brendshëm nuk përfshihen në veprimtari operacionale. Pjesa tjetër 14% e tyre rezulton në kundërshtim me kriteret ligjore, në to vihet re përfshirje e audituesve të brendshëm në veprimtari operacionale. Roli i auditimit të brendshëm është të ndihmojë njësinë publike në arritjen e objektivave. Objektivat e NJAB gjithnjë duhet të jenë në përputhje me objektivat e njësisë publike. Nga analiza e të dhënave, vihet re se 88% e NJAB i kanë objektivat e tyre në përputhje me objektivat e njësive publike në të cilat ato operojnë.

Grafiku 10. Opinionet për funksionimin e NJAB sipas akteve ligjore



Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga NJAB


Është detyrë e NJAB që në procesin e planifikimit duhet të përdorin metodologji për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve e njësive publike, si dhe të marrin opinionin e titullarit gjatë këtij procesi. Në bazë të kësaj metodologjie organizohet puna që njësitë e identifikuara me risk të lartë të përfshihen në planin vjetor të auditimit. Nga analiza e përgjigjeve të NJAB, rezulton që 75% e tyre e bazojnë planin e auditimit plotësisht në vlerësimin e riskut të veprimtarisë së njësisë publike.

Evidentohet se vetëm 68% e NJAB kanë vlerësuar drejt risqet e lidhura me objektivat e njësisë publike, kurse 28% e NJAB kanë nevojë për përmirësime në këtë vlerësim. Në lidhje me këtë është e nevojshme të trajtohet me prioritet si në programet e trajnimit ashtu dhe në seminaret e ndërgjegjësimit në fushën e auditimit të brendshëm, sepse është një nga vlerësimet e rëndësishme që duhet trajtuar nga audituesit.

NjAB si pjesë integrale e strukturës organike të njësisë publike duhet të japë kontributin e saj në hartimin e regjistrit të riskut. Nga të dhënat e analizuara vetëm 66% e NJAB përmbushin këtë kriter, sepse nga të dhënat që MFE disponon një numër i konsiderueshëm njësish publike nuk kanë hartuar regjistrin e riskut.

NjAB gjatë veprimtarisë së tyre duhet të vlerësojnë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Nga analiza evidentohet se 82% e NJAB e përmushin këtë kriter dhe 15% e vlerësojnë pjesërisht, duke mos përmbushur detyrimin ligjor. Megjithëse është e nevojshme të përmirësohet ky vlerësim evidentohet në të gjitha raportet e auditimit NJAB të vlerësuara nga DH/AB gjatë vitit 2019.

Grafiku 11. Opinionet për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga NJAB




Vendosja e kontrolleve efektive dhe monitorimi i rekomandimeve.

Vihet se, vetëm 67 % e NJAB vlerësojnë përshtatshmërinë e kontrolleve të vendosura, kurse 30% e tyre i vlerësojnë ato pjesërisht. Në këtë fushë kërkohet vëmendje më e madhe si e drejtuesve të NJAB ashtu dhe nga audituesit për të marrë trajnimet e nevojshme në këtë fushë.

Nga analiza e përgjigjeve të NJAB në lidhje me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna rezulton që vetëm 80% të NJAB i monitorojnë në vazhdimësi këtë komponent dhe 19% e NJAB i monitorojnë ato pjesërisht. Ky proces i rëndësishëm është në monitorim të vazhdueshëm nga DH/AB.

Vihet re se 83% të drejtuesve të NJAB paraqesin analizën vjetore të veprimtarisë në KAB dhe tek titullari i njësisë publike. Manuali i auditimit të brendshëm ka një procedurë të qartë në lidhje me raportimin e angazhimit të auditimit. 15% e NJAB e realizojnë pjesërisht këtë kërkesë të Manualit.

Grafiku 12. Opinionet për vendosjen e kontrolleve efektive dhe monitorimi i rekomandimeve




Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese.

Në lidhje me Programin e Sigurimit të Cilësisë vetëm 55% të NJAB rezultojnë të kenë hartuar, miratuar dhe zbatuar këtë program dhe 28% e NJAB e kanë zbatuar pjesërisht këtë program. Kjo mangësi është evidentuar në pjesën më të madhe të NJAB të vlerësuara nga MFE, kryesisht në NJAB që funksionojnë jashtë kritereve (me 1 ose 2 audites) të cilat duhet ta

realizojnë këtë shërbim nga ana e NJAB tjetër (sipas përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Brendshëm).

Në lidhje rishikimin e brendshëm të cilësisë nga ana e drejtuesve të NJAB rezulton se vetëm 66% e tyre realizojnë këtë proces në përputhje me standardet. Në këtë tregues evidentohet se 12% e NJAB nuk e realizojnë fare këtë proces për shkak të strukturave të cunguara dhe jashtë kritereve (me 1 ose 2 auditues). Kjo problematikë me nivelin e strukturave është në monitorim të vazhdueshëm nga MFE. Evidentohet se vetëm në 66% të NJAB rekomandimet e rishikimit të brendshëm të cilësisë merren në konsidetaë nga audituesit. Në këtë element evidentohet se 5% e tyre nuk bien dakort me rekomandimet e dhëna nga ana e rishikuesve.

Grafiku 13. Opinionet për vlerësimin e brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese



Nga analiza në tërësi e "Pyetësorit të vetëvlerësimit", vihet re që një pjesë e konsiderueshme e NJAB nuk kanë qenë të qarta dhe koncize në përgjigjet e tyre. Të dhënat tregojnë që përgjigjet e dhëna nuk janë plotësisht në përputhje me të dhënat reale, të cilat janë konsoliduar nga të dhënat e raporteve vjetore të veprimtarisë së NJAB.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në këtë analizë, DH/AB do të ketë një nga prioritetet e saj ndërgjegjësimin dhe koordinimin më të madh të informacionit me NJAB për mirëfunksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në përafrim të plotë me standardet ndërkombëtare.

ANEKSI I. VLERËSIMI I SISTEMIT TË MFK-së NË NJËSITË SHPENZUESE ME BUXHET TË MADH

Në vijim të procesit të rëndësishëm të implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike si dhe në kuadër të rekomandimeve të vazhdueshme të organizmave ndërkombëtare, edhe në vitin 2019, DH/MFKK ka përfshirë në gamën e institucioneve që plotësojnë pyetësorin e vetëvlerësimit, një grup institucionesh varësie, me qëllim sigurimin e një pamje më të qartë të progresit. Për këtë arsye, janë përzgjedhur 13 institucione publike bazuar në dy kritere:

-Totali i buxhetit të miratuar të njësisë publike për vitin 2019 është të paktën sa 10% e totalit të buxhetit të grupit; dhe/ose

-Totali i buxhetit të miratuar të njësisë publike për vitin 2019 është të paktën 1 miliard lekë.

Vlerësimi i sistemit të MFK-së në këto institucione varësie për vitin 2019 u bazua në pyetësorët e vetëvlerësimit të MFK-së, të cilët gjenerojnë 3 tregues performance gjithëpërfshirës; në treguesit e performancës së strukturës përgjegjëse për thesarin si dhe treguesit e performancës së strukturës përgjegjëse për buxhetin, në total 18 tregues të parashikuar në metodologjinë e monitorimit të performancës.

Gjatë kësaj analize u vlerësuan edhe 17 parimet e MFK-së me qëllim evidentimin e progresit të sistemit të kontrollit të brendshëm në tërësi dhe adresimin e problematikave të cilat kufizojnë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sistemi, përfundimet e së cilës janë paraqitur në Kapitullin nr. 2.

Nga vlerësimi i treguesve të përformancës institucioni, i cili paraqet një nivel të kënaqshëm të efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm, është Agjencia Kombëtare e Ushqimit, duke u renditur në vendin e parë me 59 pikë nga 72 pikë maksimale të mundshme dhe me një realizim performance prej 82%. Gjithashtu, vlerësohet se performanca e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, si në vitin 2018, është në nivele mjaft të ulëta, duke u pozicionuar në vendin e fundit me 29 pikë krahasuar me 22 pikë nga viti 2018, ndërmjet 13 njësive të marra në analizë.

Një vështrim i përgjithshëm për treguesit e performancës për këto njësi varësie paraqitet si më poshtë vijon:

1. Treguesi i parë i analizuar nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore",** i cili përcakton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet buxhetore gjatë vitit kundrejt planit të buxhetit të miratuar nga Kuvendi. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 3.6 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 90%), duke reflektuar një performancë të mirë të tij për njësitë e marra në analizë. Rezultati evidenton faktin se, pjesa më e madhe e njësive janë efiçiente dhe efektive në përdorimin e buxhetit dhe realizimin e shpenzimeve të planifikuara për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, ndërkohë që, arsyet për mosrealizimin e këtij treguesi vijnë kryesisht si pasojë e shtyrjes së afateve të realizimit nga procesi i prokurimit, mosrealizimi i shpenzimeve për udhëtim e dieta për jashtë si dhe nënzërave të tjerë të këtij grupi shpenzimesh, apo edhe nga vonesat në paraqitjen e dokumentacionit teknik e financiar për lëvrimin e fondeve. Gjithashtu, për ato institucione në të cilat realizimi faktik i fondeve paraqitet më i lartë sesa plani fillestar i miratuar në Kuvend, arsyeja është shtimi i fondeve të planifikuara përkatësisht me Aktet Normative nr. 2 dhe Nr. 11 të vitit 2019 nga Fondi Rezerve i Buxhetit të Shtetit, si dhe nga Fondi i Rritjes së Pagave.

2. Një tregues tjetër është **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik"**, i cili mat diferencën midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit faktik në fund të vitit për çdo grup të shpenzimeve buxhetore të ndara sipas klasifikimit ekonomik. Nga vlerësimi i kryer për këtë tregues, rezultati është 2.2 pikë ose 54%, duke paraqitur një nivel mbi mesatar të performancës së njësive lidhur me këtë tregues. Për ato njësi, që paraqiten me një nivel të realizimit të shpenzimeve më të ulët se plani fillestar i miratuar në Kuvend, evidentojmë se shkaqet kryesore që ndikojnë në performancë, konsistojnë në mosrealizimin e shpenzimeve për paga, sigurim si edhe rastet e mosplotësimit të punonjësve në organikë. Gjithashtu, mund të përmendim problematikat e krijuara nga mosrealizimi i shpenzimeve për "Mallra e shërbime", për shkak të mosrealizimit të zërave të tillë si shpenzime për udhëtim dhe dieta për jashtë, mosrealizimi i zërit "Transferta tek individët", ku një ndër institucionet me performancën më të ulët është edhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural për shkak të mosrealizimit të fondeve për skemën e mbështetjes së fermerëve.

3. Treguesi **"Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura"** paraqet diferencën e stokut 12 – mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12 – mujor të vitit paraardhës. Për vitin 2019, ai është vlerësuar mesatarisht me 2.7 pikë (67%) duke reflektuar një performancë relativisht të mirë, si dhe duke mos pasqyruar gjendje problematike në lidhje me detyrimet e prapambetura për njësitë shpenzuese me buxhet të madh.

4. Treguesi **"Realizimi i shpenzimeve kapitale"** paraqet devijimin nga plani i realizimit i shpenzimeve kapitale në një vit kundrejt shpenzimeve kapitale totale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 1.5 pikë (37%), duke shfaqur një performancë nën mesatare të njësive publike me buxhet të madh si dhe duke pësuar ulje krahasuar me vitin 2018, ku ky tregues është vlerësuar me 56%. Për ato njësi të

cilat paraqesin një performancë të ulët të realizimit të këtij treguesi, evidentohet se shkaqet kryesore janë të lidhura kryesisht me kryerjen e procedurave të prokurimit.

5. "Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit" është një tregues tjetër i rëndësishëm, i cili paraqet shumat totale të shpenzimeve për projektet e investimeve në periudhën e vlerësimit (një ose disavjeçare) me shumën totale të planit shumëvjeçar të parashikuar për projektet. Për periudhën analizuese, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 2.2 pikë (ose 54%) të nivelit referues. . Vihet re, se në krahasim me vitin paraardhës 2018, ky rezultat ka paraqitur rritje të ndjeshme prej 33%. Duhet evidentuar fakti se, pothuajse të gjitha njësitë e varësisë të marra në analizë shfaqin problematika përsa i përket parashikimit të fondeve në fillim të vitit buxhetor, gjë e cila ka sjellë dhe diferencat apo devijimet e planeve buxhetore. Gjithashtu, rishikimi i buxhetit kryhet duke i kaluar fondet nga projektet me ecuri më të ulët në ato me ecuri më të lartë. Ecuria e ulët mund të jetë rezultat edhe i planifikimit te gabuar, ku nuk janë mbajtur parasysh faktorët që mund të pengojnë ecurinë e projektit gjatë vitit. Gjithësesi, duke marrë parasysh rezultatin e këtij treguesi, vihet re se për vitin 2019, është përmirësuar saktësia në parashikim dhe planifikim.

6. Treguesi i parë i gjeneruar nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e faturave të dërguara në thesar për pagesë përtej afatit kohor prej 30 ditësh kundrejt numrit total të faturave të dërguara për pagesë. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 1.85 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 46 %), duke pësuar rritje të lehtë krahasuar me vitin 2018, ku ky tregues është vlerësuar me 1.73 pikë. Gjithësesi situata e reflektuar mund të konsiderohet relativisht problematike në këtë fushë për njësitë e marra në analizë. Kryesisht, arsyet e mosdërgimit në kohë të faturave në thesar vijnë për shkak se furnitorët nuk paraqesin faturat në kohë në institucion, dokumentacioni mbështetës i dërguar nuk është i plotë ose i saktë si dhe ndodh që shpesh të ketë vonesa në lidhje me dërgimin e të dhënave bankare të furnitorit. Për këtë tregues, institucionet që shfaqin më shumë problematika janë: Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Spitali Universitar i Traumës, institucione të cilët janë vlerësuar me pikë minimale, si në vitin 2018.

7. "Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)" është një tjetër tregues i analizuar nga struktura përgjegjëse për thesarin. Vihet re se të gjitha institucionet me buxhet të madh janë vlerësuar maksimalisht me 4 pikë apo 100%. Pra, mund të themi se këto institucione nuk kanë hasur probleme në lidhje me mjaftueshmërinë e fondeve buxhetore apo planifikimin e saktë mujor të arkës.

8. Një tregues tjetër i analizuar nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e kontratave të dërguara pranë degëve përkatëse të thesarit pas tre ditëve nga data e nënshkrimit të tyre, kundrejt numrit total të kontratave të dërguara në thesar. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 0.85 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 21%), përafërisht e njejtë me vitin 2018 (19%), duke reflektuar për një situatë shumë problematike në njësitë e marra në analizë. Mangësitë e evidentuara vijnë kryesisht si pasojë e mungesës së disponibilitetit të personave, të cilët nënshkruajnë kontratën, duke shkaktuar vonesa në dërgimin e tyre. Gjithashtu, afati ditor prej 3 ditësh për dërgimin e kontratave në thesar është praktikisht i pamundur për t'u zbatuar nga institucionet, të cilët nënshkruajnë dhe menaxhojnë një numër shumë të madh kontratash. Në këtë kuadër, mund të përmendim rastin e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", e cila menaxhon rreth 80% të numrit të përgjithshëm të kontratave të lidhura dhe njëkohësisht është vlerësuar me pikë minimale.

9. Treguesi **"Numri i urdhër-prokurimeve të paautorizuara"** paraqet numrin e urdhër prokurimeve të paautorizuara kundrejt shumës totale të urdhër prokurimeve të dërguara për pagesë në thesar. Për vitin 2019, ky tregues paraqet një performancë shumë të kënaqshme, me një vlerësim mesatar prej 3.1 pikë (78%). Ndërkohë, që të gjitha institucionet e tjera janë

vlerësuar maksimalisht (4 pikë), Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Policia e Shtetit janë vlerësuar me pikë minimale (0 pikë). Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimeve Publike me autorizimin e Thesarit. Rezultati evidenton faktin se, njësitë janë përgjithësisht efiçente dhe efektive në mbarëvajtjen e procesit të dërgimit të urdhër-prokurimeve të autorizuara në thesar.

10.Një tjetër tregues i marrë në analizë nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës"**, i cili përcakton vlerën e avancimeve të kryera gjatë vitit nga njësitë shpenzuese kundrejt totalit të planit vjetor të arkës. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar maksimalisht me 4 pikë (ose 100%), duke reflektuar një përmirësim në realizimin krahasuar me vitin 2018. Referuar këtij treguesi, mund të konkludojmë se njësitë e marra në analizë kanë reflektuar performancë mjaft të mirë për këtë fushë ku, evidentohet një aftësi e mirë parashikuese e flukseve të mjeteve monetare.

11. Treguesi i fundit i marrë në analizë nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi"**, i cili mat respektimin e afatit kohor, nënshkrimit, përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar në nivelin 3.7 pikë (ose 93%), duke reflektuar një situatë shumë pozitive në këtë fushë, edhe pse më të ulët nga viti 2018, ku performanca në lidhje me këtë tregues është vlerësuar me pikë maksimale 4. Gjatë vitit 2018, është miratuar Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i cili përcakton paraqitjen e pasqyrave financiare dhe afatet kohore ligjore për dorëzimin e pasqyrave financiare. Pavarësisht problematikave që kanë pasur institucionet në përshtatjen me udhëzimin e ri për përgatitjen e pasqyrave financiare në vitin 2019, të gjitha institucionet e marra në analizë i kanë paraqitur pasqyrat financiare në kohën e duhur dhe me formatin e duhur.

12. Treguesi **"Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara"**, paraqet respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Për vitin 2019, të dhënat pasqyrojnë një performancë të mirë për njësitë e marra në analizë, duke qënë se treguesi është vlerësuar mesatarisht me 2.9 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 73%) të nivelit referues të vlerësimit, në nivel pothuajse të njejtë me vitin 2018 (3 pikë nga 4 ose 75%). Faktorët që ndikojnë në performancën e këtyre njësive lidhen kryesisht me informimin e vazhdueshëm mbi rëndësinë e këtij dokumenti dhe formatet e nevojshme për hartimin e tij si edhe asistencën e ofruar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Pavarësisht hartimit dhe dorëzimit brenda afateve kohore të planit të veprimit evidentohet se, përmbajtja cilësore e tij ka ende nevojë për përmirësime pasi një pjesë e aktiviteteve të parashikuara janë të fokusuara në përmirësimin e performancës financiare apo të çështjeve teknike të njësisë dhe shumë pak prej tyre janë fokusuar në ndërmarrjen e aktiviteteve për ngritjen e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm.

13. Treguesi **"Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm"**, përcakton respektimin e afatit kohor për depozitimin e pyetësorit të vetëvlerësimit të njësive të marra në analizë si dhe cilësinë e tij, ku një pyetësor është konsideruar gjithëpërfshirës nëse përmban një informacion të plotë, të saktë, të mbështetur në statistika dhe evidenca. Për vitin 2019, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 2.85 pikë ose 71%, duke reflektuar një performancë mesatare si në vitin 2018 (70%). Nga analiza e kryer evidentohet se, rezultatet e arritura justifikohen kryesisht me suportin e vazhdueshëm të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin mbi mënyrën e plotësimit të pyetësorit të rishikuar të vetëvlerësimit si edhe të dokumentave të tjerë shoqërues. Në këtë kuadër, DH/MFKK zhvilloi 8 seanca trajnimi me pjesëmarrës nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në vitin 2019, pyetësorët e vetëvlerësimit të institucioneve të marra në këtë analizë, në përgjithësi

kanë pasqyruar një informacion më të plotë dhe gjithëpërfshirës në lidhje me statusin e implementimit, si dhe të arsyetuar me evidenca mbështetëse konkrete.

14. Treguesi **"Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik"** vlerëson se në çfarë mase dhe se sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjësisë menaxheriale, të specifikuara në ekzistencën e një strukture organizative, të përshatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, hartimin e planit vjetor të punës me objektiva të matshëm e të miratuar nga titullari i njësisë dhe monitorohet të paktën një herë në vit, raportime vjetore mbi nivelin e rezultateve të arritura kundrejt objektivave dhe synimeve të paracaktuara si dhe procedura delegimi sipas bazës ligjore në fuqi. Për vitin 2019, ky tregues është analizuar duke marrë në konsideratë 28 pyetje të pyetësorit të vetëvlerësimit, nga vlerësimi i të cilave, efektiviteti i këtij treguesi është mesatarisht 3.2 pikë ose 79%, e njëjtë me vlerësimin e vitit 2018. Referuar këtij treguesi, institucionet me buxhet të madh kanë reflektuar një performancë të mirë. Nga analiza e kryer evidentohet se, pjesa me e madhe e njësive publike kanë miratuar një strukturë të përshtatshme organizative, me përgjegjësi të përcaktuara dhe objektiva të përfshira në programin buxhetor afatmesëm. Ndërkohë, mbetet ende problematikë përcaktimi dhe ndjekja e linjave korrekte të raportimit si dhe zbatimi i procedurave të delegimit. Arsyet kryesore për mosimplementimin e procedurave të delegimit kryesisht konsistojnë në mungesën e informacionit të nevojshëm në këtë fushë dhe mungesën e besimit të menaxherëve për të ushtruar këtë të drejtë. Për këtë arsye, theksojmë se është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit të nivelit të lartë menaxherial për të përdorur delegimin si një instrument të rëndësishëm të realizimit me efektivitet të funksioneve të tyre, duke përcaktuar qartësisht dhe mënyrën e raportimit për detyrën e deleguar. Në këtë kuadër, në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, DH/MFKK ka hartuar dhe miratuar udhëzimin nr.4, datë 29.1.2020 "Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", fokusi kryesor i të cilit është që të përcaktojë qartë termat, rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike.